





**PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQPERISE**



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

VELLIMI

71

MAJ 1979 – TETOR 1979

**SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1990**

## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 71-të

Vëllimi i 71-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin materiale të periudhës maj-tetor 1979. Pjesa më e madhe e tyre botohen për herë të parë.

Në shkrimet, fjalimet, bisedat e diskutimet e kësaj periudhe pasqyrohet problematika e punës së Partisë, trajtohen një sërë çështjesh që shtronte për zgjidhje ecuria e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit, jepen ide dhe shtrohen detyra për përmirësimin e veprimtarisë udhëheqëse, drejtuese e organizuese të organizatave të Partisë për përparimin e gjithanshëm të shoqërisë sonë, për kapërcimin e pengesave e të vështirësive, për shmangien e të metave e të dobësive.

Kompleksiteti i problemeve në kushtet e një ekonomie tashmë të zgjeruar, vështirësitë që përballonte rritja e saj, të shkaktuara nga faktorë të jashtëm e të brendshëm, kërkesa imperative për ritme optimale në shtimin e prodhimit shoqëror dhe për rritjen e mirëqenies së popullit, e bënin më të theksuar nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm të stilit e të metodës së punës të organeve e të organizatave të Partisë.

Në një sërë materialesh të këtij vëllimi nënvizohet domosdoshmëria e një veprimtarie të gjallë, të efektshme, të Partisë dhe të kuadrove të saj, larg forma-

lizmit e shabllonizmit. Puna e Partisë, theksohet në vëllim, të mos jetë punë rutine dhe as burokratike. Ajo t'u përgjigjet kohës, detyrave, kushteve të reja, ndryshimeve që ndodhin vazhdimisht në jetën e shoqërisë. Duke kritikuar format e vjetruara të punës me njerëzit, shoku Enver Hoxha thekson se nuk është fjala të mblidhen punëtorët dhe t'u mbahet atyre konferencë. Tash gjendja ka ndryshuar, prandaj edhe metoda e punës me punonjësit duhet t'u përshtatet situatave e detyrave të reja që kanë dalë e dalin vazhdimisht. Këto kërkojnë të dëgjohet zëri i masave, të hidhen ato në veprim, se janë masat që krijojnë e realizojnë.

Veprimtaria e organizatës së Partisë ka rezultate kur ajo përqendrohet në problemet kapitale të rrethit, të ndërmarrjes a të kooperativës, në punën me njerëzit. Jo të ndodhë që organizatat-bazë marrin e analizojnë probleme teknike e anësore, sa për të thënë se po bëhen mbledhje. Në organizatë duhet të ziejnë mendimet, kritikën, debatin, se, aty ku mungojnë këto, ka familjaritet, komprometim, situatë të përgjumur, të cilat bëhen pengesë për mbarëvajtjen e punëve dhe për revolucionarizimin e njerëzve. Që të luftohen këto të këqija, kërkohet që organizatat-bazë të diskutojnë për to, të zbulojnë shkaqet që i sjellin. Në këto analiza do të dalin në pah ata komunistë e kuadro që qëndrojnë në pozita të shëndosha dhe ata që janë molepsur nga shfaqje të huaja. Këta të fundit duhet të vihen mirë në mengenenë e organizatës së Partisë, e cila u kërkon atyre llogari, jo thjesht për t'i ndëshkuar, por për t'i ndihmuar të vihen në pozita të shëndosha. Punë të ve-

çantë duhet të bëjë organizata e Partisë sidomos me ata drejtorë a kryetarë që janë prepotentë e që mendojnë se mund të bëjnë si të duan me punëtorët e kooperativistët, theksohet në vëllim.

Organizatat e Partisë të gjejnë format e përshtatshme të punës për zgjidhjen e problemeve. Po me ç'forma do ta rregullojnë këtë punë, — pyet shoku Enver, — me forma pune të 20 vjetëve të shkuar? Prandaj ai ngul këmbë në nevojën e ndryshimit të metodës e të formave të punës së Partisë në përputhje me kërkesat e kohës. Kjo, siç del qartë në materialet e këtij vëllimi, është shprehje e qëndrimit dialektik të Partisë sonë ndaj problemeve, por edhe ndaj jetës e veprimtarisë së vet. Format e vjetra të punës, të organizimit, të krijuara e të vendosura më parë, thekson autori, nuk mund dhe nuk duhet të jenë të përjetshme. Ato që e kanë humbur efikasitetin e tyre, ato që janë vjetruar e që bëhen pengesë duhen flakur tej dhe duhen zëvendësuar me të tjera. «Kurdoherë ka transformime, — nënvizon shoku Enver Hoxha, — dhe nuk mund të qëndrohet në një vend. Unë nuk jam i mendimit që rishikimet për çështje të tilla t'i bëjmë çdo ditë. Jo, por ato që na i dikton jeta, t'i bëjmë, ndryshe pengojmë përparimin».

Duke trajtuar çështjet e rëndësishme të zgjedhjeve në Parti dhe të përbërjes së forumeve udhëheqëse të saj, autori thekson me forcë se dhe këtu duhen pasur në qendër të vëmendjes kërkesat e kohës. Për këtë problem ekzistojnë orientime të Partisë, shkruan shoku Enver Hoxha, por në shumë raste ato zbatohen në mënyrë shabllone. Mirëpo zbatimi strikt e formal i këtyre

orientimeve, i përqindjeve nga aparatet jo vetëm nuk e ndihmon forcimin e rolit të Partisë, por, përkundrazi, e pengon dhe e dëmton atë.

Përbërja e forumeve duhet t'u përgjigjet detyrave të kohës, zgjidhjes së problemeve të ndërlikuara e komplekse ekonomike, politike e ideologjike, prandaj edhe pjesëmarrja e njerëzve të aftë e të devotshëm nga radhët e kuadrove e të inteligjencies nuk duhet të pengohet nga raportet dhe përqindjet e paravendosura.

Vërtet orientimet janë që në forumet e Partisë të mbizotërojë numri i punëtorëve, theksohet në vëllim, por është gabim që, duke iu mbajtur strikt përqindjeve, të lihen jashtë forumeve ata komunistë nëpunës e intelektualë të aftë e revolucionarë, të cilët nuk zgjidhen në udhëheqje për të përfaqësuar një shtresë të caktuar, por që të japin gjithë diturinë dhe eksperiencën e tyre në punën e Partisë. Nuk ka rëndësi fletanketa, — shkruan shoku Enver Hoxha, — por në radhë të parë puna që bën komunisti, aftësitë e tij.

Vëmendje e veçantë i kushtohet në vëllim edhe procedurave të zgjedhjeve në Parti, të cilat përbëjnë në vetvete një problem të madh që duhet parë seriozisht jo thjesht në aspektin organizativ, por në radhë të parë në planin politik. Theksi vihet në domosdoshmërinë e zbatimit realisht të demokracisë së brendshme në Parti, në bazë të së cilës, konferenca e Partisë, delegatët e saj, kanë të drejtë të rrëzojnë ato kandidatura të paraqitura nga përfaqësia për të cilat konferenca gjykon se nuk e meritojnë dhe të propozojë të tjera. Se në praktikë ndodh që propozohen po të njëjtët njerëz dhe kë-

shtu, thekson shoku Enver Hoxha, ka rrezik të krijohet jo vetëm kulti i personit, por dhe i disa personave, si i sekretarëve të komitetit të Partisë, ose i një instance të caktuar, si byroja e komitetit të Partisë të rrethit. Prandaj është e domosdoshme të zbatohet kjo e drejtë që ka konferenca e Partisë.

Në vëllim trajtohen edhe mjaft probleme të tjera, si ato të politikës së Partisë me kuadrin, të luftës ideologjike kundër shfaqjeve të huaja, të zhvillimit gjerësisht të kritikës pa druajtje të njerëzve, probleme të marrëdhënieve ekonomike e tregtare me vendet e tjera, të politikës së jashtme etj.

Vëllimi është i pajisur me tregues.



## **MYSLIM PEZA — LUFTËTAR I LAVDISHEM I POPULLIT**

*Nga biseda në darkën me rastin e 80-vjetorit  
të lindjes së shokut Myslim Peza*

**1 maj 1979**

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ku je, more Babë? Të na rrosh sa malet! Hajde, Babë, hajde të rrimë këtu. Ulu, ulu, e mbështetu këtu. Ja kështu! Si je, Babë? A je, si je?

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Faleminderit. Si ke qenë ti?

**SHOKU ENVER HOXHA:** A... a, mirë, mirë jemi, ashtu siç kemi qenë kur ishim të rinj!

Të na rrosh sa malet, Babë! T'i rrosh Partisë!

Hajdeni këtu, more pezakë! Hajde, moj plaka e xha Kasemit<sup>1</sup>, eja këtu, afër Babës. Si je ti? Nuk e harroj kurrë xha Kasemin, atë plak aq të mirë, që ka qenë njeri besnik i Partisë. Kam ngrënë bukën e thatë bashkë me të.

---

1. Kasem Sinani.

*Pasi kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH, shoku Haxhi Lleshi, mbajti fjalën e rastit, shoku Enver Hoxha i vuri në gjoks Myslim Pezës dekoratën e Heroit të Punës Socialiste. Pastaj vazhdoi përsëri biseda:*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ta mbash me nder si kurdoherë!

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Faleminderit shumë! Faleminderit Partisë. Faleminderit ty, shoku Enver!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të rrosh sa malet! Të rrojë Partia! Hajdeni, urojeni të gjithë Babën! Hajde ti, Shabë<sup>1</sup>, hajdeni të gjithë. Vetëm mos e lodhni shumë Babën. Eja, Partizan<sup>2</sup>, të na rrojë sa malet Baba! Dashi<sup>3</sup>, të na rrojë Baba!

Të gjithë jemi mirë, asgjë nuk na tund, jemi të fortë!

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Derisa të kemi ty dhe Partinë në krye, gjithmonë të fortë do të jemi!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, të fortë do të jemi, edhe ti, Babë, ashtu je, i fortë siç ke qenë, pavarësisht nga mosha, që bën të sajën. Por Partia, që është e vëmendshme dhe e kujdesshme në çdo çast për njerëzit e saj, ashtu si për gjithë popullin, kujdeset që Baba, edhe pse i kaluar në moshë, të mos plaket kurrë dhe populli, sidomos populli i Pezës, të shikojë se Myslim Peza është akoma në këmbë. Dhe kështu do të jetë derisa të rrojë, në këmbë.

---

1. Shaban Rexha.

2. Partizan Peza.

3. Dashamir Peza.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** I faleminderit shumë Partisë!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Me Myslimin jemi njohur 40 vjet më parë, te kafja e Dem Xhepës.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Po, po, tani më kujtohet edhe mua takimi te kafja e Dem Xhepës. Në atë kafe, unë dhe shoku Enver biseduam edhe herë të tjera. Shoku Enver më tha shumë fjalë të bukura e të mira për popullin, për grupet komuniste, për situatën e jashtme e të brendshme dhe për Partinë që do të formohej pas një kohe. Më kujtohet kur më pyete ti, shoku Enver: «A do të jesh me komunistët ti, shoku Myslim?». Dhe unë që atëherë ta dhashë fjalën, se do të jem me ju deri në fund.

**SHOKU ENVER HOXHA:** E drejtë, ashtu the, deri në fund.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Dhe kështu ngjau. Kur u ndamë, pas atij takimi, kisha në zemër një ndjenjë gëzimi e kënaqësie, por e ruaja në shpirt, nuk e qitsha. Unë isha takuar edhe me shumë komunistë të tjerë, me Vasil Shanton, me Mustafa Kaçaçin, të shumtë ishin ata shokë që kisha takuar, por takimi me ty ka qenë me shumë rëndësi për mua dhe ashtu doli edhe për popullin.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po kaq i rëndësishëm ishte edhe për mua takimi me ty.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Kështu, shoku Enver, erdhi ajo ditë kur ti më the se më 1 gusht radhët e çetës sime do të shtoheshin me plot të rinj. Dhe me të vërtetë, ditën e parë të gushtit më kanë ardhur të rinjtë në

Pezë. E gjithë kjo të dedikohet ty, shoku Enver, se çeta ime që dikur kishte pasur 30 veta, në atë kohë kishte mbetur me 25 njerëz.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Partisë, Partisë i dedikohet çdo gjë.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Partisë dhe ty, se ti na udhëhoqe me Partinë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Partisë dhe ne të tërëve.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Edhe neve, sigurisht, por unë, shoku Enver, them ty në radhë të parë dhe këtu nuk ke ku luan hiç. (*Duartrokitje.*) Edhe unë, që të gjithë më shohin sot këtu, jetën timë ia dedikoj Partisë, ty dhe gjithë shokëve të Partisë.

Pra, Peza u mbush me të rinj, që shtuan më vonë radhët e batalioneve.

**SHOKU ENVER HOXHA:** U mbush plot Peza heroike me të rinj e të reja, me burra e gra që kishin rrokur armët për çlirimin e vendit.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Megjithëse Peza u bë shkumb e hi, populli i saj rrëmbeu armët dhe i tëri erdhi me ne.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, u dogjën e u përcëlluan, por për ne i kishin gjithnjë hapur kasollet e tyre.

Babë Myslimi më ka dërguar një pjesë të kujtimeve të tij. Janë kujtime nga më origjinalet që kam parë. Atje ai flet për gjithë popullin e Pezës, duke shkruar me radhë për çdo njërin prej tyre e për çdo shtëpi, me të cilën e ka lidhur jeta, lufta e tij.

Është puna e madhe që bëri Partia, e cila edukoi

të tërë popullin. Pse e bëmë atë mbledhjen në Pezë për krijimin e Frontit Nacionalçlirimtar? E bëmë pikërisht në atë qendër, që të mblidhej gjithë populli e të bashkohej në luftë kundër pushtuesit e tradhtarëve të atdheut.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Po, besa, i gjithë populli u mbloodh. Por pati edhe nga ata që u zgjodhën në Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe që pastaj ndoqën rrugën e tradhtisë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Por i mundëm, Babë, i shkatërruam dhe triumfuam mbi ta.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Kështu, pra, duke përfunduar fjalën time, po them edhe një herë se ia dedikoj jetën time Partisë dhe ty personalisht, shoku Enver, në radhë të parë.

E falënderoj pa masë Partinë për dekoratën, me të cilën më nderoi, dhe i premtoj se deri në fund të jetës sime do ta mbaj me nder.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Babë Myslim, të na rrosh sa malet! Për çdo gjë mendon Partia. Tani mjaft, se u lodhe. Me ato gjëra aq të bukura që na the, na ngjalle kujtimet e së kaluarës, të asaj kohe heroike e të lavdishme.

Dhe tani hajde të shkojmë andej të hamë darkë. Shkojmë, Babë!

*Pasi zunë vendet, e mori përsëri fjalën:*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Do të më lejosh, babë Myslim, se dëshiroj të të them edhe unë nja dy fjalë nga zemra.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Fol, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** I dashuri Myslim, Ne, shokët e vjetër të tu të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të ndërtimit të socializmit, jemi mbledhur sonte këtu në një darkë gazmore tok me ty, për të të uruar 80-vjetorin e lindjes tënde, për të të uruar nga zemra shëndet të plotë, të na rrosh edhe njëqind vjet për të mirën e popullit dhe të Partisë, gjithashtu të të përgëzojmë edhe për titullin e lartë dhe plotësisht të merituar të «Heroit të Punës Socialiste» që të akordoi Presidiumi i Kuvendit Popullor. E mbajtsh atë si kurdoherë me nder!

I dashuri Myslim, ti linde në gjirin e popullit tonë të dashur të një krahine të Shqipërisë së Mesme dhe u rrite e rrojte tok me fshatarësinë e varfër të kësaj krahine, që tash ka marrë famë në historinë e popullit shqiptar, në Pezën heroike. Ti e ke dashur shumë popullin e Pezës e të gjithë Shqipërisë së Mesme dhe ai, gjithashtu, të ka dashur ty që kur ishe fare i ri dhe sidomos kur u rrite e u bërë burrë, pse pa tek ti një mbrojtës të vetin, një person që njihje dhe ia lehtësoje hallet, i ndaje këto me të, pse shumë halle kishte në kokë në kohët e kaluara ky popull, ashtu si gjithë populli ynë. Ai njohu tek ti djalin e ri me vullnet të fortë, me zgjuarsin e shpejtësi në mendime dhe në veprime, pa tek ti njeriun besnik të vetin dhe të dëshirave të tij.

Populli i këtyre krahinave më vonë të quajti Babë. Kështu e ka quajtur ai, Babë, edhe Haxhi Qamilin, i cili udhëhoqi pikërisht fshatarët e varfër të Shqipërisë së Mesme në kohë të vështira, nëpër të cilat kalonte atdheu më shumë se 60 vjet përpara, në luftë të papaj-

tueshme me bejlerët dhe pashallarët, me feudalët dhe me të huajt që kërkonin ta shtypnin Shqipërinë.

Pra, ata të quajtnë Babë dhe ne të gjithë të thërresim Babë. Këtë titull nuk ta japim se je më i moshuar nga ne, por ky ka një kuptim të madh politik për ato që thashë dhe për veprimin tënd që në kohën e Zogut, kur dhe sinjalin e revoltës dhe vrave pikërisht Osman Balin, torturuesin dhe vrasësin e Haxhi Qamilit, shërbëtorin e Shefqet Vërlacit e të Ahmet Zogut. Gjesti yt trimëror e burrëror s'ishte një gjest i thjeshtë hakmarrës ose terrorist, por një gjest politik, pse ai simbolizonte dorën e fshatarësisë sonë patriote që ngrihej kundër tiranisë.

Ty të ndoqi këmba-këmbës regjimi i Zogut, prandaj u detyrove të shkoje në mërgim, ku jetove si patriot shqiptar, i guximshëm dhe i ndershëm, në gjirin e shqiptarëve që jetonin nën robërinë e kralëve serbë. Ti atje jetove, por mendjen e kishe në Pezë, në Shqipërinë e dashur që vuante, pavarësisht se në krye të saj ishte një mbret që vetëm emrin kishte shqiptar, pse në fakt ai ishte i huaj, i shitur, tradhtar. Ti gjete rastin e volitshëm, erdhe, u ktheve në atdhe, jo për të marrë pozita, por për të luftuar.

Unë dhe ti kemi afër 40 vjet që jemi njohur. Kurdoherë «dhjetëshen» ti e mbaje në brez. Më ka njohur me ty miku yt dhe imi, patrioti Esat Dishnica, dhe që nga ajo kohë ne kurrë nuk u ndamë e nuk do të ndahemi nga njëri-tjetri, derisa të kemi jetë. U lidhëm së toku, pse na lidhi çështja e madhe e çlirimit të popullit dhe të atdheut, na lidhi Partia që formuam dhe

që do të na udhëhiqte në këtë luftë të madhe heroike, për të cilën kushti kryesor ishte të grumbulloheshin të gjitha forcat, të grumbullohej gjithë populli, gjë që nuk mund të bëhej me sukses veçse nën udhëheqjen e një partie që ndiqte me besnikëri teorinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Çështja e parë për fitoren mbi armiqtë e huaj dhe tradhtarët e atdheut ishte të bashkohej gjithë populli, se vetëm i bashkuar dhe i udhëhequr nga Partia Komuniste ai do të fitonte. Ti e kuptove këtë çështje që në momentin e parë dhe këtu qëndron merita e madhe e Partisë sonë që na e futi të gjithëve në kokë dhe në zemër këtë ide të madhe.

Çështja e dytë që na bëri të qartë dhe na e futi në kokë dhe në zemër Partia jonë ishte ideja tjetër e madhe e krijuar gjatë shekujve në mendjen e popullit tonë se liria fitohet me luftë dhe me gjak dhe kjo na bashkoi për jetë të gjithë ne.

Çështja e tretë ishte të bënim revolucionin, të çlirojmë popullin nga okupatorët dhe nga të gjithë ata që do të na dilnin përpara për të penguar zhvillimin e luftës deri në fitore dhe politikën e unifikimit të shtetit tonë në një shtet të ri demokratik popullor e të mos bënim asnjë kompromis me ata që do të lidheshin me okupatorët. Këto na i mësoi Partia jonë dhe këto na bënë që të lidheshim për jetë a për vdekje me njëri-tjetrin dhe të mos kishim frikë nga vdekja.

Tok ne kemi kaluar në Pezë, nga Peza në Maknor, nga Maknori në Cikallesh e Dorakë, nga Doraka në Mëçallë, nga Mëçalla në Alltat dhe nga Alltati në Arbanë

e në të gjitha fshatrat e Pezës, ku tërë populli ishte ngritur në këmbë. Ai na kuptonte, kuptonte drejtësinë e vijës së Partisë. Populli të ndiqte ty, Babë, pse ti ishe me Partinë. Dhe unë kam qenë shumë herë me ty dhe të kam dëgjuar kur u flisje fshatarëve me atë gjuhë aq të kuptueshme për ta, se ç'ishte Partia, e kujt ishte Partia, ç'do të bënte e ç'do të realizonte Partia. Tok me luftërat që bënte Partia nga të katër anët e Shqipërisë, edhe ti, Myslim, në krye të pezakëve, në krye të çetave të patriotëve, kreve me sukses detyrat që të caktoi Partia. Lufta, mjerimi, djegiet e vrasjet e shokëve tanë të dashur na dhimbnin, po ato kurrë s'na ligështuan, përkundrazi, të gjithëve na forcuan akoma më shumë ndërgjegjen, kurajën, heroizmin, prandaj i mposhtëm armiqtë, e çliruam Shqipërinë, ndërtuam atdheun socialist e tok me të edhe Pezën heroike.

Në mes të pezakëve, që na mbronin me armë në dorë, u bënë mbledhje të rëndësishme të Komitetit Qendror. Në Pezë u krijua Fronti Nacionalçlirimtar, u hodhën bazat e pushtetit të ri të demokracisë popullore. Është për këtë arsye që Peza u bë një vend historik. Me Pezën është lidhur edhe emri yt, personi yt si luftëtar i lavdishëm i popullit dhe anëtar i shkëlqyer i Partisë së Punës të Shqipërisë.

Prandaj ne sot jemi të gëzuar që të kemi me shëndet, i dashuri shoku ynë Myslim. Ne dëshirojmë të të kemi kurdoherë në ballë të luftës sonë për forcimin e pushtetit, për mbrojtjen e atdheut, për këtë atdhe, që s'e tund asgjëkafshë, as kërcënimet e armiqtve që na rrethojnë, as të imperializmit, as të socialimperializmit

as tërmetet, sado të fortë që të jenë. Përkundrazi, në vendin tonë çdo gjë ecën përpara.

Vrulli dhe entuziazmi i popullit tonë është në kulm. Ne sivjet do të festojmë 35-vjetorin e Çlirimit, të asaj date madhështore që u mbryjt me gjakun e popullit e të shokëve tanë që ranë në fushën e nderit. Ne do të festojmë këtë vit 100-vjetorin e Josif Stalinit, udhëheqësit të madh e të lavdishëm të Bashkimit Sovjetik e të Partisë Bolshevike të Leninit, udhëheqësit të Luftës së Madhe Patriotike të Bashkimit Sovjetik. që theu nazizmin gjerman e që pengoi intrigat skllavëruese të imperialistëve anglo-amerikanë.

Ne po festojmë gjithashtu këtë vit, dhe pikërisht sot, edhe 80-vjetorin tënd, babë Myslim, dhe më lejo të të lexoj me këtë rast letrën e përshëndetjes së Komitetit Qendror të Partisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të Këshillit të Ministrave dhe të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

*Pasi lexoi letrën e përshëndetjes, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Ju ftoj, shokë, ta ngremë këtë dolli për shëndetin e Babës, të na rrojë sa malet! T'i rrojë Partisë edhe 100 vjet! Kurdoherë ta shohim të lumtur, të gëzuar e të fortë! Për shëndetin tënd, babë Myslim!

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Faleminderit, shoku Enver, për fjalët e bukura që më the. Jam jashtëzakonisht i lumtur e i gëzuar. Të na rrojë Partia dhe ju!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Për shëndetin e Partisë sonë të lavdishme që na mësoi, na udhëhoqi e na

udhëheq në rrugën e socializmit dhe drejt komunizmit! Gjatë kësaj rruge do të mposhtim çdo armik. Për lavdinë e marksizëm-leninizmit! Hajde, ju të rinjtë, pije-ni me fund, mos na e vini re neve. Gëzuar!

Babë, këtu kam letrën e përshëndetjes që të drejtohet ty. Prandaj po të uroj, duke ta dhënë këtë në dorë. Më jep dorën këtu dhe hajde të të puth një herë nga ana e gjithë shokëve.

*SHOKU MYSLIM PEZA:* Faleminderit, shoku Enver, të na rrosh sa malet! Prej Partisë, me ju në krye, i kemi gjithë këto të mira.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të na rrojë Partia! Tani rri qetësohu e mos u lodh.

*SHOKU MYSLIM PEZA:* Ku ka si Partia jonë në botë! Të mirat që na dha ajo s'kanë të numëruar, i shikojmë me sy e i prekim me dorë shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* S'ka si Partia jonë, nuk ka.

Hajde, gëzuar, si në Rrapishte, Babë! Gëzuar! Të rroni sa malet!

*SHOKU MYSLIM PEZA:* Këta që më kanë vënë afër janë shokët e mi të vjetër.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Gëzuar! Gëzuar, Shabë! Gëzuar ju!

*SHOKU SHABAN REXHA:* Gëzuar! Të rroni sa malet ju, të rrojë Partia!

*SHOKU ENVER HOXHA:* E, Cen<sup>1</sup>, të kujtohet si na thoshin përpara? «Djemtë e fshatit nuk mësojnë

dot, se nuk kuptojnë, ata vetëm parmendën dinë». Kështu thoshin atëherë. Kurse ç'ndodhi në vitet e Partisë? Ja, shokë, djali i Cenit është doktor.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Është edhe doktor, edhe drejtor spitali në Tiranë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Posi, posi, doktor dhe drejtor. E si të mos mësojnë bijtë e fshatarëve? Ç'ndryshim kanë fshatarët nga qytetarët? Mos janë më të zgjuar këta? Jo, aspak! Njëlloj janë.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Jo, për nder, fshatarët janë njerëz të fortë e të qëndrueshëm.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kanë qenë më halle-xhinj, kanë vuajtur më shumë, kanë ecur zbathur, dhe ua dinë vlerën mësimi dhe punës.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Po, po, dhe sa djem e vajza fshatarësh ka, që janë bërë kuadro të aftë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Plot ka, plot.

Cen, a e ke shtëpinë në Dorakë? E kujtoj ngahera.

**SHOKU HYSEN CEKA:** E kam, e kam, edhe neve na ngjall shumë kujtime ajo shtëpi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po ti, Esat, pi ndonjë çikë?

**SHOKU ESAT DISHNICA:** Nga pak, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** E po, atëherë ngreje një herë. Hajde, qofsh me shëndet të plotë!

**SHOKU ESAT DISHNICA:** Faleminderit! Shëndeti i Babës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Babë, Esati po pi për shëndetin tënd.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Tungjatjeta, Esat. E kam

mik të vjetër Esatin, më erdhi edhe në shtëpi, por e kritikova se ka disa vjet që nuk më ka ardhur fare. Ka përtuar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ka qenë edhe i sëmurë, Myslim, megjithatë mbahet. Esati e ka ndihmuar Partinë.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** E ka ndihmuar me gjithë zemër.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk e ka bërë kurrë dy fjalën e saj, ka qenë njeri i mirë edhe politikisht. Ai i ka urryer bejlerët, agallarët, intelektualët e sëmurë e gjithë njerëzit e kësaj kategorie.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Si i thotë populli ynë, shoku Enver, «Shqiptari kur jep fjalën, ther edhe djalin».

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, kështu thotë populli. Por, ama, edhe djali duhet të ecë në rrugën e drejtë, ndryshe i tregojmë vendin.

*Pastaj shoku Enver Hoxha e pyet babë Myslimin, për sytë, për shikimin etj.*

**SHOKU MYSLIM PEZA:** I faleminderit Partisë, ju faleminderit juve për të gjitha ato që keni bërë për mua, për kujdesin e madh që keni treguar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po çfarë kemi bërë ne? Lëri këto, Myslim! As që duhen thënë fare këto fjalë.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Jo, jo, por e kam fjalën që nuk kam pse të mërzitem.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk duhet t'i thuash fare këto fjalë.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Për nder, shoku Enver,

ty dhe Partisë do t'jua them këto fjalë e do t'ju falënderoj pa masë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ato që ke bërë ti për Partinë e për popullin nuk mund të shpërblehen. E kishim për detyrë ne që të kujdeseshim për shëndetin tënd.

**SHOKU SHABAN REXHA:** Shëndeti i Partisë, shoku Enver, të na rroni sa malet për Partinë e për popullin!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Gëzuar, Shabë! Faleminderit! Gëzuar, Esat, hajde, ngrije. Gëzuar, Cen Ceka! Për shëndetin e Partisë! Për shëndetin e Babës.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Faleminderit shumë!

*Pastaj shoku Enver Hoxha u drejtohet të ftuarve nga Peza:*

Si jeni ju, mirë? Si dukeni me punët e bujqësisë sivjet, mirë? Baba atje e ka mendjen, te ju, si u bënë domatet, si u bë misri, si u bë gruri, si u bë puna e de-pos së ujit, jo rezervuari kështu, jo rezervuari ashtu. Baba ka shumë merak se si shkojnë punët në Pezë, po sidomos për rezervuarin.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Me ç'shoh unë, akoma nuk është në vijë puna e tij.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mos ki merak ti, Babë, se do të bëhet ai, do ta bëjnë. Ti ke të drejtë që interesohesh për atë, por edhe ne interesohemi.

Ha një çikë ti, Babë, ha. Po të duash, të të ndihmoj unë, që ta bëjmë si me ato piperkat me uthull që i hanim në kohën e luftës. «More, po m'i grive, — më thoshte Baba atëherë, — të paktën jepja një herë fa-

qores», se unë raki nuk pija, po ama piperkat me uthull, si ato që na bënte Ruzja, e shoqja e Esatit, i përlaja.

Ti, Babë, e kishe njohur gruan e Esatit, Ruzen. Ishte një grua shumë e mirë, e thjeshtë dhe e dashur. Ajo kishte mbi shpinë tërë punët e shtëpisë dhe nuk ankohej asnjëherë, por gjithmonë vetëm fjalë të mira i thoshte Esatit.

Hajde, gëzuar, të rrojë Myslimi, t'i rrojë Partisë!

**SHOKU SHABAN REXHA:** Të rroni ju e të rrojë Partia! Për shëndetin e shokëve të Byrosë Politike!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si e ke plakën, Cen, mirë? Mbahet?

**SHOKU HYSEN CEKA:** Mirë e kam, mirë.

**SHOKU SHABAN REXHA:** Mbahet mirë ajo, pastaj, edhe po të sëmuret, e ka djalin doktor, e shëron doktori.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk të harron Baba, o Nuz<sup>1</sup>, nuk të harron, më ka treguar për gjithë të mirat që ke bërë ti dhe për trimërinë e treguar në luftë.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Pikërisht me këta shokë kemi dalë faqebardhë në luftë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duhet filluar nga puna për mbledhjen e kujtimeve të tua, ti të flasësh e të të regjistrojnë në magnetofon.

**SHOKU MYSLIM PEZA:** E kemi lënë pas festës këtë punë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë, mirë. Unë kam

---

1. I drejtohet Jonuz Hakramës.

një pjesë të vogël të kujtimeve të tua që m'i ke dërguar ti. Ato me të vërtetë kanë vlerë të madhe, se atje del qartë që ke rrojtur e je shkriur, je bërë një me fshatarin fukara. Në ato kujtime të tuat ti shkruan për të gjitha, për familjet, kujton shtëpitë, bashkëkohësit e tu që i përmend me emra, bile deri te kalamanët. Prandaj duhet vazhduar kjo punë. Të dalë mirë në to lufta e popullit.

*SHOKU MYSLIM PEZA:* Kam shumë kujtime të bukura, mbaj mend shumë ngjarje të kohës së luftës, nuk di kë të kallëzohet më parë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* E... , ç'burim i madh është populli! Prandaj na porosit vazhdimisht Partia të mbështetemi gjithnjë në popull, të flasim me gjuhën e tij, të mësojmë nga populli, të zbulojmë ç'mendime ka ai. Po bëre gabim, thuaja popullit dhe ai të kupton e ta fal gabimin, në qoftë se e sheh se e ke bërë pa dashje.

*SHOKU MYSLIM PEZA:* Të gjitha, në kujtimet e mia, i kam të vërteta, asgjë nuk kam të tepruar ose jo të vërtetë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Natyrisht, janë gjëra që duken vetë. Nuk ka shumë rëndësi që ato të shkruhen bukur, ajo që ka më shumë rëndësi është të shkruhen drejt.

Babë, tashti do të ngrihem, se edhe ti je i lodhur. Hajde, nga vit gëzuar! Të na rrosh sa malet! Me shëndet të plotë!

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Faleminderit shumë, shoku Enver, faleminderit Partisë për të gjitha sa ka bërë për mua!

**Botohet për herë të parë i plotë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP**

## **QËNDRIMET E HUAJA NDAJ PRONËS NUK LUFTOHEN VETËM DUKE I BËRË THIRRJE NDËRGJEGJES**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**3 maj 1979**

Lexova një relacion të gjatë dhe me shumë probleme të njohura të Kryesisë së Këshillit të Ministrave për çështjen e përvetësimit të pasurisë dhe të të dënuarve, problem ky që na shqetëson të gjithë. Natyrisht, në këtë relacion vihet në dukje dëmi që i sjellin këto veprime ekonomisë, jepet edhe shifra në global e njerëzve që janë ndëshkuar për përvetësime të pronës. Gjithashtu, jepen disa mendime lidhur me këtë problem dhe bëhen propozime, të cilat mendoj se duhen parë.

Kështu, për shembull, propozohet që t'u rikthehem materialeve të Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të vitit 1973, si dhe materialeve të tjera të Partisë, në të cilat flitet për mbrojtjen e pasurisë socialiste etj. Ose thuhet që pas disa muajve të bëjmë një mbledhje

të plenumit të Komitetit Qendror dhe më pas të dërgohen nëpër rrethe disa anëtarë të tij, të cilët të ndihmojnë që t'i japin një hov luftës kundër qëndrimeve keqbërëse që shkaktojnë dëmtimin e ekonomisë socialiste dhe të pasurisë së qytetarëve.

Në fakt, problemin e luftës kundër shfaqjeve të huaja, dhe veçanërisht kundër përvetësimit të pasurisë socialiste ne e kemi parë vazhdimisht jo vetëm në mbledhjet e Plenumit, të Byrosë Politike, të Sekretariatit të Komitetit Qendror, të Qeverisë etj., por dhe në rrethe. Megjithatë shfaqje negative në qëndrimin ndaj pronës prapë ekzistojnë. Natyrisht, fjala nuk është që ta nxijmë realitetin, por sidoqoftë ky mbetet një problem serioz.

Në relacion kisha vënë disa shënime për të theksuar se nuk janë vetëm shifrat ato që duhen të na orientojnë ne. Në përgjithësi ne e dimë gjendjen. Prandaj në situatat aktuale unë mendoj se ky problem duhet ristudiuar më thellë dhe të bëhet një kategorizim i përvetësimit dhe i dëmtimeve të pronës sipas sektorëve dhe sipas rretheve, sipas kategorive e moshave të atyre që i kryejnë këto veprime. Këto të dhëna, më duket mua, kanë shumë rëndësi. Nga analizat e përditshme ne mund të themi se më shumë vjedhje bëhen në tregti, në fshat, në këtë apo në atë sektor. Por ne nuk duhet të mjaftohemi vetëm me kaq. Çështja është që nga këto konstatime të nxjerrim konkluzione, si për shembull: çfarë i shtyn të rinjtë apo të tjerët që të bëjnë një veprim të tillë? Cilat janë shkaqet e për-

vetësimit dhe të dëmtimeve të pronës, sa veta paditen në gjyq për veprime të tilla etj., etj.

Përse them që të studiohet më thellë ky problem? Këtë ta bëjmë, sepse është e nevojshme të nxjerrim konkluzionin se, megjithëqë Partia dhe organet e pushtetit kanë punuar dhe luftuar vazhdimisht kundër këtyre shfaqjeve të huaja, rezultati ende nuk është ai që dëshirojmë ne. Sigurisht, ulje ka në përvetësime e në dëmtime të pronës, por ato nuk janë të ndjeshme. Këto ne duhet t'i shohim edhe në dinamikë, se në shifrat që jepen mund të ketë edhe recidivistë. Pastaj nuk duhen parë vetëm shifrat e atyre që futen në burg, se jo të gjithë ata që dëmtojnë pronën futen në burg, por marrin qortime ose zhdëmtojnë. Në këtë kuptim, një analizë më e detajuar e kësaj çështjeje do të na shërbejë që të specifikojmë rastet e dëmtimit të pronës dhe në bazë të tyre të ndërtojmë më mirë e më konkretisht propagandën tonë për ta luftuar këtë sëmundje, duke vënë në lëvizje edhe organizatat e masave.

Sigurisht, pronën e përvetëson ai që nuk është i ndershëm. Por, ama, duhet thënë se ka shfaqje e qëndrime liberale, se vërtet i ndershmi nuk vë dorë mbi pronën, por ka nga ata që me indiferentizmin e liberalizmin e tyre i lënë të tjerët të sillen keq ndaj pasurisë së përbashkët. Detyra e secilit është ta mbrojnë pronën, ndërsa elementët e pandërgjegjshëm t'i ndreqim që të heqin dorë nga ky qëndrim.

Këtu qëndron roli i madh i Partisë, jo vetëm në fushën e edukimit, por dhe në atë të zbatimit të rregullave e rregulloreve administrative. Sepse qëndrimet

e huaja ndaj pronës nuk luftohen vetëm duke i bërë thirrje ndërgjegjes. Partia dhe organet shtetërore kërkojnë që të zbatohen kudo e nga të gjithë ligjet dhe rregullat e caktuara administrative, ndryshe, po nuk u veprua në të dyja këto drejtime së toku, nuk mund të arrihen rezultatet e dëshiruara në ruajtjen e pronës. E dimë që ndërgjegjja te njeriu zhvillohet më ngadalë dhe se shumë ferra dalin nëpër këmbë, të cilat, në mos ia prishin atij krejtësisht ndërgjegjen, e çorientojnë dhe e fusin në rrugë jo të drejtë, e bëjnë atë të kryejë akte të paligjshme, duke vënë dorë mbi pronën.

Mua më duket se këto gjëra nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra. Të gjithë ata që përvetësojnë dhe shpërdorojnë pronën e përbashkët shkelin ligjet. Këtë ata e bëjnë për shkak se ndërgjegjja e tyre është prishur, por edhe sepse atje ku ndodhin këto gjëra, ka drejtim dhe kontroll të dobët, ka indiferentizëm, ka oportunitizëm, ka liberalizëm. Ndodh që edhe revizori nuk e zbulon vjedhjen që ka filluar disa vjet më parë. Të gjitha këto ndikojnë që të prishet ndërgjegjja e njerëzve të predispozuar dhe të vihet dorë mbi pasurinë e shtetit. Çështja është të gjejmë përse ngjasin këto përvetësime e dëmtime të pronës, që të dimë ta luftojmë të keqen.

Nga analiza që bëjmë mund të na rezultojë që në kooperativat bujqësore ka edhe raste të përvetësimit të prodhimeve, që në arat e kooperativave futen bagëtitë personale të fshatarëve, duke shkaktuar goxha dëme. Ose një shitës në tregti, për shembull, del deficit etj. Këto çështje duhen parë konkretisht, duhen parë

shkaqet objektive, por edhe shkaqet subjektive që çojnë në këto veprime, që e shtyjnë subjektin t'i shkelë ligjet dhe normat e caktuara. Për shembull, nuk duhet të merret në punë një njeri i painstruktuar dhe të vihet në tregti që të administrojë gjithë ato mallra, ndoshta edhe të shpërndara nëpër disa depo andej-këndej, se ai mund të dalë ose deficit, ose suficit. Ligjërisht, në të dy rastet, ai dënohet, por ai s'duhej vënë në atë punë. Por ka edhe të tjerë që me ndërgjegje bëjnë veprime të tilla, përvetësojnë mallin, duke e ditur se çfarë bëjnë. Këta janë «ustallarë me mjekër».

Pse ngjasin këto gjëra? Njerëzit në shumicën e tyre dërrmuese janë të ndershëm. Në krye të këtyre njerëzve kemi Partinë, kemi njerëz me kulturë. Kemi, gjithashtu, organizatat e masave, Bashkimet Profesionale, organizatën e Gruas, organizatën e Rinisë, të Frontit, në të cilat janë të inkuadruara edhe komunistët. Brenda në fabrikë kemi kontroll për cilësinë, për sasinë dhe për normat. Kemi kontrollin e shtetit, i cili ushtron veprimtarinë e vet në mënyrë të befasishme ose atje ku shikon që puna është e dobët; kemi seksionet dhe degët e financës që bëjnë bilancin. Por kemi gjithashtu edhe kontrollin punëtor. Kemi, pra, një masë të tërë njerëzish të ndershëm, një sërë organizmesh, që, sipas mendimit tim, po të luftojnë e të veprojnë si duhet për ruajtjen dhe miradministrimin e pronës socialiste, atëherë dëmtimet e saj dhe shkeljet e disiplinës financiare në sektorin shtetëror e atë kooperativist jo vetëm që s'duhet të vijnë në rritje, por numri i

tyre dhe i njerëzve të implikuar në këto veprime anti-socialiste të ulen në mënyrë të ndjeshme.

Prandaj mua më duket se një analizë e tillë e problemit të qëndrimeve ndaj pronës është e domosdoshme të bëhet. Ky problem të shtrohet jo vetëm në Plenumin e KQ, por edhe në komitetet e Partisë të rretheve, edhe në organizatat-bazë të Partisë e deri dhe në organizatat e masave, se kjo është një çështje me rëndësi për socializmin. Pasi të analizohet, pastaj çdo gjë ta konkretizojmë me një punë të dendur edukative për ngritjen e ndërgjegjes së njerëzve, por edhe me përdorimin e masave administrative. Partia, me punën e vet dhe të levave të saj, synon që njerëzit t'i bindë e t'i bëjnë të ndërgjegjshëm të mbajnë qëndrim socialist ndaj pasurisë së shtetit, ndaj pasurisë së popullit. Por njëkohësisht ajo kërkon që të respektohen nga të gjithë ligjet e rregullat e vëna për mbrojtjen e pronës.

Problemi për të cilin po bisedojmë më parë duhet rishikuar në drejtimet që thashë dhe të mbahet vazhdimisht ndezur, që lufta kundër përvetësimeve të pronës të mos jetë si flakë kashte. Pse e them këtë? Sepse kam mendimin që në këtë drejtim nuk punojnë sa duhet organizatat-bazë të Partisë dhe levat e saj. Komunistët kudo që punojnë e militojnë duhet të jenë shembull dhe luftëtarë të flaktë kundër shfaqjeve të përvetësimit e të dëmtimit të pronës, të bëjnë një punë aktive me punonjësit, qoftë individualisht, qoftë si anëtarë të organizatës së Bashkimeve Profesionale, të Rinisë, të Gruas ose të Frontit. Anëtari i Partisë është

edhe në organet shtetërore. Ai duhet të jetë rigoroz, me tërë kuptimin e fjalës, për zbatimin e disiplinës shtetërore, të ligjeve e të rregullave për miradministrimin e pronës socialiste. Por njëkohësisht ai do të luftojë për edukimin e përditshëm të njerëzve me dashurinë dhe respektin ndaj pronës së përbashkët. Gjithashtu ai duhet të jetë edhe një kontrollues i rreptë dhe t'i heqë vërejtjen kujtdo që prek sadopak këtë pasuri. Me punën e tij ai të paraprijë ndalimin e përvetësimit dhe dëmtimin e pronës.

Studimi i thelluar i këtyre fenomeneve ka shumë anë pozitive dhe mirë është që ky studim të bëhet sa më parë dhe bashkë me relacionin që përmenda në fillim të shërbejnë për të ndërmarre veprime e masa konkrete për forcimin dhe ruajtjen e pasurisë socialiste, për uljen e rasteve të përvetësimit e të dëmtimit të saj.

Them të ndërmerren veprime konkrete, se e tërë puna e Partisë, edhe mbledhjet e Plenumit e të Byrosë Politike të Komitetit Qendror për këto probleme nuk kanë qenë dhe nuk bëhen vetëm për agjitacion e propagandë, as vetëm për çështjen e edukimit të njerëzve. Lidhur me to, në këto forume diskutohet e përcaktohen edhe rrugët e masa konkrete për zbatimin e kërkesave të ligjeve ekonomike të socializmit dhe të ligjshmërisë socialiste.

Unë mendoj se, qoftë në rrugë partie, qoftë në rrugë shtetërore, propaganda, puna ideopolitike me njerëzit nuk bëhet si duhet e lidhur ngushtë me propagandën ekonomike, me ligjet e ekonomisë. Në fla-

sim për humbjet e orëve të punës. Në vend që të punohet 8 orë, në mjaft uzina e fabrika punohet 6 orë e gjysmë, sepse mungon disiplina. Kjo ka të bëjë, si me ndërgjegjen politike të njerëzve, ashtu edhe me masat teknike, organizative, me kontrollin etj. Përveç kësaj, ne shikojmë se ka punëtorë që, ndonëse punojnë 6 orë e gjysmë në ditë, i tejkalojnë normat e punës 10-12 për qind. Por ç'thotë logjika e ekonomisë politike të socializmit? Me fjalë të tjera, aty ku ndodh kështu, vidhet, sepse nuk mund të shpjegohet ndryshe fakti që personi, i cili duhet të realizojë detyrën e planit qind për qind për 8 orë, në cilësi e në sasi, punon vetëm 6 orë e gjysmë dhe jo vetëm e realizon, por edhe e tejkalon normën. Si ndodh kjo? Këtu, mendojmë, mungon kontrolli, por duhen parë edhe normat e punës.

Këtu në aparatin e Komitetit Qendror vijnë të dhëna rreth këtyre çështjeve, por instruktorët tanë, e ca më pak instruktorët e komiteteve të Partisë të rretheve, nuk u futen shumë atyre. Partia ka dhënë e jep orientime të qarta për problemet e zhvillimit të ekonomisë, si duhet të ecë e si duhet të kontrollohet ajo etj. Këto orientime ekzistojnë. Por rëndësi vendimtare ka që ato të vihen në jetë. Dhe kjo nuk bëhet me mbledhje e duke i përsëritur ato që janë thënë. Për këtë është e domosdoshme të këmbëngulet që orientimet lidhur me këto çështje të zërthehen mirë që t'i kuptojë secili dhe menjëherë të kalohet në zbatimin e tyre, sepse gjatë procesit të punës edhe përvetësohen ato më mirë, edhe vihen në jetë. Këtu ne duhet ta forcojmë punën, sepse më duket që ka dobësi.

Këtë situatë duhet meoemos ta ndjekim seriozisht. Në ç'mënyrë ta ndjekim? Nuk them të ndiqet vetëm nga lart, sepse praktikisht kjo nuk mund të bëhet, por nga e gjithë Partia. Ne këtu të shikojmë, për shembull, se ç'efekte bëri në bazë mbledhja e Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë ose një dokument i Byrosë Politike për çështje të caktuara të ekonomisë ose për çështjen e qëndrimeve antisocialiste ndaj pronës. Mirëpo kush e bën këtë? Kam përshtypjen se kjo punë nuk ndiqet mirë në mënyrë të vazhdueshme e me vigjilencë, si nga ana politike, ashtu edhe nga ajo teknike, as nga organet shtetërore, as nga ato të Partisë, as nga organizatat e masave e nga kontrolli shtetëror. Mendoj se për këtë veprohet me metoda pune rutinë, globale. Për shembull, është caktuar si rregull që kontroll-revizioni në një qendër pune të bëhet një herë në vit. Po gjatë tërë vitit ç'punë bën kontroll-revizioni i fabrikës? Ai duhet ta ndjekë këtë çështje ditë për ditë, çdo ditë të ushtrojë veprimtarinë e tij, sepse i ka njerëzit për këtë.

Le ta shohim këtë çështje në rrugë partie. Organizata-bazë e Partisë ka për detyrë kryesore të punojë që, në radhë të parë, komunistët të jenë të ndershëm, të jenë besnikë të Partisë. Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë që ata të kryejnë si duhet detyrën që u ka ngarkuar Partia dhe këtë detyrë ta kuptojnë jo vetëm politikisht, por edhe teknikisht, administrativisht, organizativisht. Këtu, më duket mua, shfaqet patriotizmi komunist.

Shpesh dëgjojmë të thuhet se jemi në rrethim, pu-

nojmë dhe luftojmë në rrethim. Kjo është e drejtë dhe kështu është. Por kjo duhet kuptuar thellë se duhet punuar e duhet luftuar dita-ditës për ta çarë rrethimin dhe jo vetëm kur t'ia bëjë bam e tash të lihen të tjerët të përvetësojnë pasurinë e shtetit. Kjo është e palejueshme. Nuk duhet të ecet kështu. Preokupacioni kryesor i organizatave-bazë të Partisë për edukimin e punonjësve me frymën e me mësimet e Partisë, në rrugën e Partisë, politikisht, ideologjikisht, teknikisht, që të gjithë të jenë të disiplinuar, të devotshëm për kryerjen e detyrës, nuk është ende kudo në lartësinë e duhur. Këto çështje duhen pasur parasysh nga organizatat e Partisë, për të bërë që në çdo rast dhe secili në punën ku është, kur ta shohë tjetrin që sorollatet andej-këtej, t'i thotë: «Puno, mos e humb kohën kot». Është e domosdoshme, pra, që edhe kontrolli reciprok të bëhet pjesë e jetës dhe e ndërgjegjes politike të secilit.

Sigurisht, kjo nuk do të thotë se nuk kemi arritje në këto drejtime, por të kërkojmë dhe të punojmë që këto punë të ecin më mirë.

Këto gjëra duhet të jenë shumë të qarta për të gjithë, se Partia i ka shtruar vazhdimisht. Por në qoftë se atje në bazë, ku është prona, ku prodhohen të mirat materiale, nuk luftohet sa duhet për zbatimin e porosive, të udhëzimeve të dhëna e të rregullave të vendosura, kështu nuk ecet. Të forcohet kontrolli dhe për ruajtjen e pronës të kujdesen jo vetëm njerëzit e ngarkuar, por të gjithë punonjësit.

K kontrolli duhet forcuar në të gjitha drejtimet. Se

për edukimin, për ndërgegjen kemi folur e flasim përditë, por duhen marrë edhe disa masa, duhen parë edhe disa ligje. Është e nevojshme të studiohet çështja përse kemi kaq humbje kohe në punë, ç'kategori njerëzish janë ata që bëjnë mungesa në punë, a janë të rinj që s'kanë asnjë angazhim familjar etj. Mungesave në punë t'u themi ndal, t'u gjejmë ilaçin, jo vetëm me punë edukative, por edhe duke marrë masa të tilla që edhe t'i disiplinojnë të rinjtë që mungojnë pa arsye në punë, edhe të rritin interesin e tyre për punë.

Po kështu të shohim edhe çështjen e raporteve mjekësore, për lëshimin e të cilave ka mjekë që janë liberalë. Por a u është folur mjekëve për këtë? U është folur, bile shumë. Atëherë të shihet a ka mundësi që të gjenden edhe disa forma më shtrënguese në këtë drejtim për të mirën e shtetit tonë dhe për të mirën edhe të vetë individit. Për këtë të mendojmë.

Në këto çështje duhet bërë një punë më e koordinuar dhe jo gjithçka të pritet nga Partia. Pyetet, për shembull, «Kush do të na informojë e kush duhet të kujdeset për gjithë këto gjëra?». «Do ta bëjë Partia këtë punë», është përgjigjja. Dakord, sepse Partia është kudo, është në udhëheqje, por bashkimet profesionale, organizata e rinisë, ajo e gruas ç'punë kanë e ç'punë bëjnë? A nuk duhet, për shembull, që bashkimet profesionale të interesohen përse mungojnë punëtorët në uzinë, ç'u bë filan punëtor, përse s'erdhi ai sot etj., etj? Nuk është organizata e Partisë ajo që do ta ndjekë punëtorin nëse qenka i sëmurë, apo bën sikur është i sëmurë. Por komiteti profesional në uzinë të intereso-

het për punëtorin, të shohë ç'i ka ngjarë dhe nëse del që mungon pa ndonjë arsye, atëherë ta thërresë, ta këshillojë, ta nxjerrë para kolektivit, ta vërë para përgjegjesisë etj. Ç'është kjo punë? Kjo është ajo që Partia e quan punë politike kokë më kokë me njerëzit. Ose të marrim rastin e një tjetri që ka mik një mjek dhe merr tri ditë raport jashtë ligjeve. Këto raste nuk mund t'i ndjekë Partia. Po organizatat e masave përse janë?

Prandaj u duhet bërë analizë e thellë këtyre gjërave, jo vetëm për t'u prerë rrugën shfaqjeve të huaja, por edhe sepse këtej dalin edhe probleme. Duhet të dimë, për shembull, sa humbasim nga mungesa e çerdheve. Sa humbasim nga mungesat në punë, sa do të na kushtojë, ta zëmë, hapja e tri çerdheve të reja etj. dhe sa fitim kemi, po t'i hapim ato. Konkluzionet për këto gjëra të dalin nga analizat e hollësishme konkrete të gjendjes dhe jo të merren vendime në mënyrë arbitrare.

Ka shumë probleme që duhen parë me vëmendje, sepse ato që thashë, shkaqet subjektive dhe objektive, janë çështje me rëndësi. Nuk mjafton të themi se ka liberalizëm. Është e vërtetë që liberalizëm ka, por këto gjëra duhet t'i shohim më thellë. Le të marrim çështjen për shembull, siç e shtron fshatari: «Përse të dal në punë? — thotë ai, — xhepin e kam plot, dua tulla dhe tjegulla të ndërtoj një shtëpi, se do të martoj djalin». Po tjegulla në dyqan nuk ka. Atëherë, ndërsa dikujt për këtë gjë s'i bëhet vonë, ai s'del në punë, se para ka. Mirë, po këto gjëra, këto mungesa që ndikoj-

në në mosplotësimin e nevojave të popullit nuk llogariten në aspektin e prishjes së ndërgjegjes së njerëzve. Pra, ngaqë fshatarit nuk i plotësohen kërkesat për tulla, çimento etj., për të cilat ka nevojë, duhet të na bëjë që të shtojmë përpjekjet për t'i prodhuar këta artikuj që edhe fshatarit t'ia plotësojmë nevojat, edhe ta bëjmë që ai të dalë në punë.

Prandaj t'i shohim e t'i vlerësojmë mirë këto probleme që i krijohen popullit nga mungesat e ndryshme dhe që sjellin humbje jo vetëm në ndërgjegje, por edhe në ekonomi. Këto jo vetëm të mos i neglizhojmë, por dhe të gjejmë ku i kemi dobësitë. Për këtë qëllim mund të bëhen edhe mbledhje, mund të dërgohen edhe njerëz në bazë për t'i këqyrur në vend këto fenomene, por jo medoemos vetëm shokë të Komitetit Qendror, atje të dërgohen edhe kuadro e specialistë të ndryshëm. Një pjesë të mirë të anëtarëve të Komitetit Qendror ne i kemi në bazë, ndonjë në prodhim, ndonjë sekretar partie rrethi, një tjetër kryetar komiteti ekzekutiv, drejtor në ndërmarrje, ministër etj. Të gjithë këta ndeshen përditë me problemet që na preokupojnë dhe që kërkojnë zgjidhje. Të tërë këta i kanë edhe të dhënat, edhe materialet e Partisë, edhe mjetet, njerëzit e organizmat për t'i zgjidhur ato. Por ne duhet medoemos të përsosim metodën e punës, organizimin dhe drejtimin. Sepse organizimi luan rol të madh në mbarëvajtjen e punëve. Tash që ne kemi shumë njerëz të arsimuar, me arsim të lartë, dhe me arsim të mesëm, ka shumë mundësi të përsosen më tej organizimi e drejtimi i punëve, me qëllim që çdo gjë të ecë siç e kërkon zhvillimi i sho-

qërisë sonë. Me organizimin ka të bëjë edhe çështja e disiplinës, edhe çështja e formimit politik e të ndërgjegjes, edhe lufta kundër shfaqjeve të liberalizmit, të menefregizmit. Me një organizim të shëndoshë i zë mirë shtigjet dhe i parandalon këto shfaqje që dëmtojnë punët dhe ecjen tonë përpara.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

## ÇDO GJË NË SHQIPËRINË E RE E KEMI BERE VETË, ME FORCAT TONA

*Nga biseda me Iv Puliken<sup>1</sup>*

9 maj 1979

**SHOKU ENVER HOXHA:** Jam shumë i gëzuar që ju shoh, zoti Puliken. A njiheni me shokët?

**IV PULIKEN:** Ju falënderoj për mikpritjen. Jam shumë i gëzuar që ju takoj, zoti President, po njëkohësisht jam edhe i emocionuar, kur shoh se shumë nga ata që janë këtu flasin frëngjisht. Gjatë këtyre dy ditëve që ndodhem midis shqiptarëve, ata më kanë folur frëngjisht.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ata që ndodhen sot midis nesh flasin frëngjisht, sepse kjo gjuhë mësohet në shkollat tona dhe ne e vlerësojmë. Ne mendojmë, dhe mendojmë se gjykojmë drejt, që rinia jonë duhet ta dijë frëngjishten, se është gjuha e një populli me tradita të mëdha historike dhe kulturore. Unë vetë kam mbaruar liceun në gjuhën frënge që ka qenë hapur te

---

1. Mjek francez.

ne pesë-gjashtë dekada më parë. Më vonë shkova për të studiuar në Francë, atëherë kur ju mund të keni qenë 2-3 vjeç. Tani ju jeni i ri, ndërsa ne po plakemi.

Ne kemi shumë miq në Francë, sidomos në sferën e mjekësisë. Partia dhe populli ynë respektojnë shumë, sidomos, profesor Pol Miliezin. Me anë të mjekëve tanë që ishin në Francë, i kërkova atij të më rekomandonte një specialist francez në okulistikë. Jam shumë i kënaqur që erdhët ju, veçse më vjen keq që ju bëra të kryenit një udhëtim kaq të gjatë.

Tani jam 70 vjeç, por e ndiej se jam akoma i fortë. Ne, njerëzit e moshuar të brezit tonë, bëme luftën për çlirimin e vendit. Tani jemi duke bërë një luftë tjetër, të dytë, që është më e vështirë se e para. Unë nuk e dua luftën, por ama jo në kuptimin pacifist të fjalës. Njerëzit e varfër, të shtypurit, është e domosdoshme të luftojnë që të mund të jetojnë të lumtur. Unë nuk jam për atë që disa njerëz të jetojnë të lumtur duke spekuluar mbi të tjerët.

Gjatë jetës sime kam lexuar shumë. Kam filluar të lexoj që kur isha shumë i ri. Prandaj, në dëmtimin e syve të mi, mendoj se duhet të ketë ndikuar leximi intensiv. Natyrisht, nuk pretendoj të fitoj atë intensitet shikimi si në kohën e rinisë, por kam shumë besim te shkenca mjekësore se, me gjithë moshën që kam, do të ma rritë disi forcën e shikimit të syrit ose, të paktën, do të më ndihmojë të ruaj statukuonë.

*IV PULIKEN:* E ndiej veten të nderuar dhe të ndër-gjegjshëm për këtë mision që më është besuar, zoti President.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Jeni shumë i përzemërt zoti Puliken dhe jam i lumtur që vë re se, megjithëqë jeni i ri në moshë, zhvilloni me pasion veprimtarinë tuaj profesionale në një fushë të vështirë, ku punojnë pak njerëz. Megjithatë, kjo fushë, nga pikëpamja materialiste, është e rëndësishme.

Në shkrimet e tij një gazetar i juaj, që është shprehur se ushqen simpati për vendin tonë, ka shkruar për mua se jam dishepull i Dekartit. Unë e dua këtë filozof francez, se është materialist. Pikëpamjet e tij i njoh nga «Discours de la methodes»<sup>1</sup>.

Të gjithë mjekët nisen nga objekti. Çdo mjek, para se të veprojë, duhet ta tatojë pulsën e pacientit, të njohë mirë gjendjen e tij. Ju jeni një ndër nxënësit e Klod Bernarit, që sot janë në qendër të mjekësisë botërore. Ka edhe mjekë të vendeve të tjera, amerikanë, gjermanë, të cilët kanë arritur të bëjnë zbulime me rëndësi në shkencën e mjekësisë, por midis të gjithëve unë vlerësoj mjekët francezë, ashtu siç vlerësoj kulturën franceze, shkencëtarët francezë, sepse ata vërtet kanë punuar me pasion për vendin e tyre dhe kanë mbetur kurdoherë francezë, po asnjëherë nuk janë dalluar si egoistë. As Pastëri, as Zholio Kyri e të tjerë si këta nuk i bënë përpjekjet e tyre në fushën e shkencave për të arritur qëllime egoiste, megjithëse mbetën deri në fund të lidhur ngushtë me vendin e tyre.

**SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:** Shkenca e mjekësisë është më njerëzoria nga të gjitha shkencat e tjera.

1. «Arsyetime mbi metodën» (1637).

**IV PULIKEN:** Neve na është vënë një detyrë e madhe për restaurimin e shkencës franceze dhe kjo e ka arritur sot këtë stad për arsyet që dihen. Gjuha e amerikanëve është një gjuhë teknike, po ne jemi të lumtur që dëgjojmë të flitet edhe këtu gjuhën tonë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ne kemi respekt të veçantë për mjekët francezë. Shqiptarët nuk e harrojnë faktin që gjithë shkolla mjekësore e Ke d'Orsesë, porsa bisedoi ambasadori ynë me drejtuesit e saj, u vu menjëherë në dispozicion të një shokut tonë të sëmurë.

Thonë se shqiptarët nuk i respektojnë të tjerët, por nuk është kështu, në fakt, janë armiq të ata që s'e duan popullin shqiptar dhe mendojnë se komunistët nuk janë realistë. Po le të thonë ç'të duan! Jeta, faktet, provojnë të kundërtën, prandaj ata nuk i beson njeri ose, edhe ata që i besojnë, kur mësojnë të vërtetën, i braktisin.

Profesor Pol Miliezi nuk mendon si unë, por ai është një mik i popullit shqiptar. Pavarësisht nga pikëpamjet që ka secili, ne e respektojmë njëri-tjetrin.

**IV PULIKEN:** Edhe ne kemi të njëjtën platformë, për t'u lidhur në miqësi me njëri-tjetrin.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk dëshiroj ta takoj profesor Pol Miliezin vetëm kur kam nevojë, por mendoj që ai, sa herë të ketë dëshirë, të na vijë për vizitë si mik në vendin tonë, bile jo për një kohë shumë të shkurtër. Edhe ju, zoti Puliken, kurdoherë që do të gjeni kohë të lirë, bashkë me gruan dhe me fëmijët, mund të vini si miq te ne, sepse distanca midis dy vendeve tona, me mjetet e tanishme shumë të shpejta

të komunikacionit, është e shkurtër. Ju mund dhe duhet të vini shpesh në Shqipëri.

**IV PULIKEN:** Ju faleminderit. Shqipëria është një vend i mrekullueshëm. Dje asistova në një shfaqje artistike, ku pashë se si këndon e vallëzon populli juaj. Shfaqja m'u duk e mrekullueshme. Njëpërmjet kësaj shfaqjeje e njoha sadopak shpirtin e popullit tuaj. Ai është për ne një popull shumë interesant.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ne i kemi dhënë rëndësi folklorit, të cilin shumë shtete sot po e neglizhojnë. Mirëpo ai përbën një pasuri të madhe që mendojmë se nuk duhet lejuar të humbasë. Kjo që bëjmë, s'na pengon aspak të kultivojmë në masën e duhur edhe muzikën moderne, jo në drejtimin e zhvillimit të saj dekadent, por duke u mbështetur në tabanin e saj shqiptar, të arrihet që të krijohen pjesë të bukura që jo vetëm popullit tonë, po edhe të tjerëve, kur t'i dëgjojnë, t'u pëlqejnë. Kam pasur rast të dëgjoj muzikën e Bizesë. Ajo është shumë e bukur. Dihet se edhe ai mbi tabanin kombëtar francez u nxit të kompozonte opera aq të bukura. Këtë punë bëjnë edhe shkrimtarët, valltarët e krijuesit e vendeve të tjera, që bazohen në folklorin e popullit të tyre.

Listi, Shopeni, Shtrausi e të tjerë si këta, janë bërë kompozitorë të mëdhenj, sepse kanë qëmtuar e kanë thithur «mjaltin» e popullit, të cilit i kanë hedhur edhe më shumë «sheqer» (që s'është i rekomandueshëm për mua). (Të gjithë qeshin.) Kur dëgjon Listin, të ngjallet dashuria për popullin hungarez.

Edhe Franca ka pasur kompozitorë të tjerë të mëdhenj, si Berliozin etj. E kam dëgjuar muzikën e Berlio-

zit. Edhe ky në krijimtarinë e tij të pasur, pasi kishte shijuar muzikën e popullit, është mbështetur në këngët e tij, prandaj ka krijuar vepra të bukura.

*IV PULIKEN:* Zoti President, po përfitoj nga rasti për të folur me ju për tema të kësaj natyre, gjë që më kënaq pa masë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Nuk kam rast të takoj shpesh me miq francezë dhe ju e dini se funksionet që kam, nuk ma lejojnë një gjë të tillë. Shokët e tjerë kanë rast të takojnë me më shumë se unë.

*IV PULIKEN:* Funksionet që keni ju izolojnë ca.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Unë as jam dhe as e ndiej veten të izoluar për faktin se nuk takohem me shumë të huaj, pse veprat dhe idetë e tyre i njoh nëpërmjet leximit, librave, shtypit, televizionit etj. Prandaj sytë e mi duhet të gëzojnë mundësinë për të lexuar e për të parë më shumë.

Ta ngremë këtë gotë për shëndetin tuaj, zoti Puliken.

*IV PULIKEN:* Për shëndetin tuaj, zoti President!

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mendoj se Franca ka mundësi të mëdha në drejtim të zhvillimit të lëvizjes përparimtare në vend. Ne që e njohim literaturën dhe historinë e Francës, e dimë se ajo është e pasur me shembuj pozitivë që edhe ne na ndihmojnë në luftën tonë të vështirë. Vendi ynë ka qenë gjithmonë objekt i sulmeve të huaja.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore janë vrarë në vendin tonë 28 mijë njerëz, se na u desh të luftonim vetë kundër dy pushtuesve, më parë atyre italianë dhe, pasi kapi-

tulluan këta, atyre gjermanë. Pas Çlirimit, duke u mbështetur në forcat tona, kemi ndërtuar vendin deri në nivelin e sotëm. Vullnetarët e parë u hodhën menjëherë në sulm që në vitet e para, që ishin shumë të vështira, për të ndërtuar shtëpitë e djegura dhe rrugët e urat e shkatërruara nga okupatorët nazifashistë, për të tharë kënetat e për të rindërtuar vendin. E vërteta është se ne nuk kemi pasur ndihma nga jashtë, prandaj çdo gjë e kemi bërë vetë, me forcat tona. Jugosllavët, nën pretekstin e ndihmës, në vitet e para, na grabitën gjithë ato pasuri që populli ynë ia kishte konfiskuar borgjezisë tradhtarë vendëse që ishte bashkuar me pushtuesit. Ata jo vetëm nuk na kanë ndihmuar, po në të kundërtën. na rrëmbyen çdo gjë.

Ju lutem, zoti Puliken, merrni ëmbëlsira. Për vete e kam të ndaluar të ha ushqime me sheqer. Unë ha me racion, se vuaj nga diabeti, megjithatë jam mirë me shëndet. Përvoja më ka mësuar të krijoj mendimin se diabeti është një sëmundje që mund të kurohet, por duke mbajtur dietë shumë të rreptë. Sekretin në kapërcimin me sukses të kësaj sëmundjeje është respektimi me rreptësi i dietës.

Hrushovi i dha vendit tonë ndonjë kredi që konsistonte në ndërtimin e disa fabrikave, kurse të gjitha veprat e tjera industriale ne i kemi ndërtuar vetë. Vendi ynë nuk merr kredi nga asnjë shtet dhe jemi të bindur se kështu ruajmë pavarësinë tonë politike dhe ekonomike. Për këtë edhe populli ynë na mbështet, sepse ai do që të rrojë me djersën e tij dhe të jetë i pavarur. Por ne bëjmë tregti me shumë vende. Ne jemi marksistë

dhe marksizmi është ideologjia mbi të cilën mbështetet rendi ynë politiko-shoqëror. Të gjithë e dinë se, po të marrësh kredi nga një shtet, detyrimisht të kërkohet t'u nënshtrohesh disa kushteve. Hrushovi dhe Kina kërkonin që ne t'u nënshtroheshim e të vareshim prej tyre. Përpjekjet që bënë ata për të nënshtruar vendin tonë nuk zgjatën me 2-3 vjet, por shumë më tepër. Kreditë që na jepnin revizionistët sovjetikë apo më vonë ata kinezë, ishin me prapamendime. Por veprat e ndryshme industriale i projektuan dhe i ndërtuan specialistët e punëtorët tanë, sepse të huajt s'donin që ekonomia shqiptare të zhvillohej. Tani po vazhdojmë punën për t'i përfunduar ato që na lanë në mes kinezët.

*IV PULIKEN:* Ky qëndrim sigurisht ju ka kush-tuar shtrenjtë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* S'ka dyshim. Sidoqoftë ne bëmë investime për zhvillimin ekonomik të vendit dhe ndërtimi i çdo vepre është bërë me djersën e popullit tonë.

*IV PULIKEN:* Populli shqiptar është mjaft i zgjuar. Kurse vendi juaj ka lëndë të para me vlerë, si naftë, bakër etj.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Populli ynë është i ndershëm e punëtor dhe vendi ku jeton ai është i pasur.

Ne përpiqemi që populli të rritë mirëqenien e vet me punë, pse kjo përbën bukurinë e jetës. Ne themi: «Të gjithë për një e një për të gjithë».

Tërmeti i 15 prillit i këtij viti, që goditi vendin tonë, na shkaktoi shumë të vrarë e të plagosur, shkatërroi 18 mijë shtëpi, institucione social-kulturore etj. Ne morëm

vendim t'i ndërtojmë të tëra objektet e shkatërruara, t'i bëjmë të reja, brenda muajit tetor. Por ne do t'i ndërtojmë edhe më shpejt, me forcat tona të brendshme. Tani nga të gjitha krahinat e vendit po shkojnë atje ndihma materiale e njerëzore.

Edhe në Jugosllavi pati dëme nga tërmeti, por qeveria jugosllave u lodh së kërkuari ndihma e kredi nga të katër anët e botës. Në një koment të shtypit jugosllav lexova se ajo u ka bërë thirrje deri qytetarëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të japin ndihmë për të dëmtuarit nga tërmeti në Jugosllavi.

Me rastin e kësaj fatkeqësie që goditi vendin tonë, edhe neve na kanë ardhur shumë telegrame nga personalitete shtetërore dhe shoqërore, deri edhe nga njerëz të thjeshtë, disa prej të cilëve shprehin gatishmërinë të na dërgojnë ndihma në të holla. Ne i kemi falënderuar të gjithë për këtë gjest humanitar dhe për gatishmërinë e tyre, por ndihma monetare dhe materiale nuk kemi marrë e nuk marrim nga askush. Disa prej tyre i kemi ftuar të vijnë te ne për të parë se ç'mund të bëjë një popull i thjeshtë, i bashkuar dhe që ka vendosur një rend ekonomiko-shoqëror të vërtetë demokratik.

Populli ynë po bën tani përpjekje të realizojë e të tejkalojë planet e prodhimit, me qëllim që të zëvendësojë ato fonde materiale e monetare që po harxhon shteti jashtë planeve të parashikuara për likuidimin e pasojave të tërmetit. Punonjësit tanë janë treguar të gatshëm të falin vullnetarisht pagën e një ditë-pune në ndihmë të të dëmtuarve. Dëshira e tyre ishte të jepnin bile më tepër, kurse shumë nga kooperativat bujqësore

kanë marrë iniciativën për të ndërtuar sipas mundësi-ve me fondet e tyre apartamente banimi për të dëmtuarit.

**IV PULIKEN:** Megjithëse gjatë një vizite kaq të shkurtër është vështirë të shikosh gjithçka, duket se është diçka e jashtëzakonshme puna e madhe që po bëhet te ju për të zhdukur dëmet e tërmetit dhe kjo s'është gjë e vogël.

Mësova shumë gjëra këtu, te ju. Nuk e dija se rreth 85 për qind e popullsisë së Shqipërisë para Luftës së Dytë Botërore, ishte analfabete, prandaj e marr me mend, pa vështirësi, se ç'punë të madhe keni bërë për zhdukjen e kësaj të keqeje. Ju keni bërë shumë edhe në këtë drejtim.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Dhe këto i kemi bërë për një kohë të shkurtër, brenda pak më shumë se tri dekadash. Në të kaluarën kishim gjithsej 300 specialistë me arsim të lartë. Sot këta numërohen me dhjetëra mijë në degë të ndryshme të shkencës, teknikës, kulturës, shumica dërrmuese e tyre të përgatitur brenda vendit. Ne kemi hapur kurse ku studiojnë deri edhe punëtorë të thjeshtë. Sistemi ynë i jep mundësi të gjithë punonjësve, pa përjashtim, të studiojnë. Ne themi se pa mësuar, nuk ecet përpara. Ne u themi, gjithashtu, specialistëve se pa ditur një gjuhë të huaj, nuk mund të fitohen në shkallën e nevojshme të rejat e shkencës dhe të teknikës të arritura në vendet e tjera, siç është edhe Franca. Megjithatë, e dimë se kemi akoma shumë gjëra për të bërë.

Këtu, te ne, zoti Puliken, s'ka papunësi. Arsimi

është falas. Qiraja e apartamenteve është shumë e vogël. Kurse unë, për shembull, paguaj më shumë, se kam më shumë dhoma. Edhe pagat te ne kanë ndryshime fare të vogla. Diferenca midis pagës mesatare dhe asaj më të lartë lëkundet në përpjesëtimin 1 me 2. Këtë e kemi vendosur, sepse nuk është e drejtë të formohet një kastë në kurriz të të tjerëve. Dhe populli jeton mirë.

Një autor francez që e njeh vendin tonë ka shkruar mjaft libra për të. Në një prej tyre ai shkruan për ata që nuk besojnë në dinamizmin e rendit tonë politik-shoqëror: «Madam, mos fol keq për Shqipërinë. Para së gjithash dije se ka 2 shekuj që është ndërtuar Parisi, prandaj Shqipërisë jepi 10 vjet afat dhe atëherë mund të shkoni të shëtisni në bulevardet e këtij vendi dhe të mos ju thyhen takat».

*IV PULIKEN:* Ju keni një fond historik të vjetër.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë të vjetër. Shumë autorë francezë kanë shkruar me objektivitet e me simpati për vendin dhe popullin tonë. Montenji, për shembull, ka shkruar për virtytet e heroit tonë të madh kombëtar, Skënderbeut. Ronsari, një nga poetët e Plejadës, ka shkruar sonetë për Skënderbeun, që luftoi 25 vjet dhe kurdoherë fitoi kundër osmanëve. Ata e konsiderojnë atë si mbrojtës edhe të Evropës. Revolucioni i vitit 1848 në Francë ka pasur jehonë edhe në Shqipëri. Në atë kohë janë bërë revolta lokale te ne kundër mobilizimit të të rinjve shqiptarë nga ushtria osmane për t'i dërguar që të linin kockat në Jemen, në Arabinë Saudite etj.; shqiptarët janë ngritur edhe kundër taksave etj.

Ndërtimi i socializmit në vendin tonë është një tjetër luftë e madhe që po bëhet. Këtë luftë po na e vështirësojnë armiqtë e shumtë të jashtëm, sidomos fuqitë e mëdha imperialiste. Nuk mund të thuhet se unë jam dakord me politikën e Dë Golit, por nuk mund të mos vë në dukje se ai ishte njeri me ndjenja kombëtare. Ai i paralajmëroi trupat amerikane të shporrshin brenda vitit nga Franca. Ishte njeri i zgjuar dhe i kuptoi synimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vendin e vet. Dë Goli shkante mirë me Ajzenhauerin, megjithatë syrin e mbante hapur. Politika e Zhiskar d'Estënit është më pak rigoroze se ajo e Dë Golit. Megjithatë, as ky nuk i lejon amerikanët t'i shkelin me këmbë.

*IV PULIKEN:* Mendoj se dashuria për popullin, për të afërmin është kryesore.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Zoti Puliken, unë kam respekt për mjekët, sepse këta gjithnjë kanë lidhje me njerëzit që vuajnë. Ata ndiejnë dhimbjet e pacientëve, i njohin ato dhe bëjnë gjithçka për t'i shëruar njerëzit dhe jo për t'i vlarë.

*IV PULIKEN:* Tani mund të fillojmë nga ekzaminimi, bebëzat e syrit i keni të zmadhuara.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ja, lupa të cilën e përdor për të lexuar. (Vë muzikë.) Kjo është një muzikë popullore shqiptare që shpreh ndjenjat e thella të hidhërimit kur pushtuesit italianë erdhën në vendin tonë.

*IV PULIKEN:* Po më bën përshtypje. Te kjo duket influenza e orientit në muzikën tuaj.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ashtu është, por mba-

ni parasysh se kemi qenë pesë shekuj nën pushtimin e osmanëve. Sot mbi 2 milionë shqiptarë jetojnë në Turqi. Poeti më i madh romantik Kemal i Turqisë ishte me origjinë shqiptare. Një nga rilindësit tanë, nga vëllezërit Frashëri, gjithashtu enciklopedist i madh, ka vdekur në Turqi, ku janë edhe sot eshtrat e tij. Turoit na thonë: «E dimë që ai është juaji, po eshtrat e enciklopedistit tonë më të madh mos na i kërkon!».

*Pas procedurave të zakonshme mjekësore, ata u ndanë miqësisht<sup>1</sup>.*

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

---

1. Të nesërmen, më 10 maj 1979 shoku Enver Hoxha e priti mjekun Iv Puliken në shtëpinë e tij në një takim të shkurtër, ku, pasi e falënderoi për vizitën mjekësore, i uroi udhën e mbarë.

## **TE PËR SOSEN MË TEJ ORGANIZIMI E DREJTIMI NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE TË BASHKUARA**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**11 maj 1979**

*Në fillim të takimit shoku Hysni Kapo informoi për vizitat në rrethet Shkodër e Lezhë, të dëmtuara nga tërmeti i 15 prillit 1979. Më tej biseda u zhvillua rreth problemeve të kooperativave bujqësore të bashkuara dhe për aktivin e organizuar me ushtarakët e Shkodrës, ndërsa shoku Prokop Murra informoi për zhvillimin e punimeve të konferencës së Frontit Demokratik në rrethin e Lezhës.*

**SHOKU HYSNI KAPO:** Organizimi në kooperativat bujqësore të bashkuara është një problem me rëndësi, se këtu kemi të bëjmë me një pasuri kolosale.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Unë mendoj se duhet të forcohet njëherë organizimi i përgjithshëm i kooperativës së bashkuar, sigurisht jo nga ana formale e në mënyrë burokratike, por nga ana e drejtimit, e kontrollit. Pastaj është e nevojshme të forcohet puna në

atë që e quajmë sektor, që më parë ishte kooperativë më vete. Por edhe tani le ta konsiderojmë atë sikur është një kooperativë e veçantë, pra të ketë një drejtim të shëndoshë, të veprojë si njësi që lidhet dhe varret nga kooperativa e bashkuar, por që duhen parë kompetencat e planifikimit, ato ekonomike, teknike dhe të shpërblimit.

Është e domosdoshme që vetë sektori të drejtojë prodhimin, si dhe të ketë edhe disa kompetenca, që jo çdo gjë të bëhet siç do kryesia e kooperativës së bashkuar. Se ndodh që nga një drejtim jo shkencor, një sektor i kooperativës të hajë në kurriz të të tjerëve. Kooperativa mund të dalë me plan të realizuar në sajë të realizimeve në fushë, kurse një sektor që ajo e ka në zonën e malësisë, del me humbje. Që të evitohet kjo, këtij sektori t'i jepet mundësia, t'i jepen kompetenca që të kultivojë ato prodhime që i përshtaten malësisë, pra t'i caktojë vetë çfarë do të mbjellë, të mbajë bagëti të atij lloji që i nevojiten e që i përshtaten klimës së zonës etj.

Sektori, sigurisht, ka lidhje me kooperativën e bashkuar. Kjo e fundit duhet ta ndihmojë sektorin me gjithçka që ka kooperativa e bashkuar, me traktorë, me pleh, me kafshë pune etj. Këto do t'i jepen në bazë të planit që është bërë e aprovuar me kohë. Prandaj kryesia e kooperativës së bashkuar mund të vendosë për një shpërndarje me prioritet, ta zëmë, të plehut, pra një sektori të fushës t'i japë më shumë, për këtë gjë të jenë të ndërgjegjshëm përgjegjësit e sektorit (e ish-kooperativës). Por ama jo të lihet sektori i malë-

sisë pa pleh dhe i tërë plehu t'i jepet fushës. Është mirë të bëhet një ndarje e tillë që çdo sektori të kooperativës t'i jepet ajo që i përket, duke pasur parasysh edhe leverdinë ekonomike, të ardhurat e përbashkëta të kooperativës, por edhe të anëtarëve të sektorëve të ndryshëm të saj.

E njëjta gjë të bëhet edhe me kuadrot. Agronomët u janë dhënë një çikë pa llogari sektorëve të fushës, por për agronomin kanë nevojë edhe ata sektorë të kooperativës që janë në zonën malore. Prandaj t'u jepen këtyre sektorëve disa agronomë më shumë, qoftë edhe duke ia pakësuar ndonjë sektori që kooperativa e ka në fushë. Po sa agronomë t'u jepen? Aq sa u nevojiten, sipas detyrave të prodhimit, sipas vëllimit të punëve që kanë sektorët. Kuptohet që fusha ka prioritet, por kjo nuk do të thotë se malësia duhet lënë mënjanë. Edhe zona malore me punën e saj kontribuon në forcimin e kooperativës së bashkuar. Por edhe politikisht nuk është e drejtë që të mos fuqizohet zona malore. Ajo që thonë disa drejtues të sektorëve të fushës që «fusha mban malësinë» nuk qëndron. Pse nuk prodhohet edhe në malësi? Sektori i fushës vërtet e ngre vlerën e ditë punës, por edhe atë të malësisë duhet ta fuqizojmë që të ecë përpara vetë dhe tërë kooperativa.

Bashkimi i kooperativave u bë, por kjo çështje në disa raste nuk u pa mirë nga të gjitha anët, u bë një çikë e shpejtuar. Nuk mund të kthehet kaq shpejt pronë kooperativiste në pronë të përgjithshme shtetërore. Do të kalojë një periudhë e gjatë kohe për këtë. Kështu që edhe forma e kooperativës së bashkuar mund të

mos shpejtohej në këtë mënyrë. Duhet të kalojnë disa faza përpara kësaj pune, kjo e parë, si nga ana historike, nga ana ekonomike, ashtu edhe nga ana konkrete e zhvillimit të ndërgjegjes së fshatarit. Kështu, për shembull, tokën fshatari s'e kishte të tijën, ne ia dhamë atij me Reformën Agrare. U desh një kohë mjaft e gjatë, një propagandë e madhe dhe punë politike mjaft konkrete për t'i treguar atij epërsinë e kolektivizimit në bujqësi që të realizohej një gjë e tillë, sepse fshatari nuk e kishte të qartë perspektivën e bashkimit.

Po ta gjykojmë thellë dhe po të bëjmë studime të veçanta për këto periudha të ndryshme, do të shohim se jo gjithnjë kemi vajtur plotësisht të përgatitur për bashkimin e kooperativave, dhe ndonjëherë fushatizmit nuk i jemi shmangur, gjë që ka bërë të krijohen edhe kooperativa të zmadhuara jashtë mase. Në bashkime më të vogla të tyre, ato do të kishin një udhëheqje të përqendruar dhe do të vepronin më në unitet. Edhe kontrolli bëhet më mirë, sa më e vogël të jetë ekonomia. Kështu do të ishte më e lehtë ta fillonim tash këtë bashkim dhe jo atëherë, domethënë gjashtë, shtatë apo dhjetë vjet përpara. Po pse u shpejtuam atëherë? Për këtë në ato kohë u sollën argumente se me këtë bashkim do të lehtësoheshin rrethet, pasi kooperativa bujqësore e bashkuar do të ishte një njësi ekonomike më e madhe, fshatarët do të ishin më të bashkuar me njëri-tjetrin etj. Dhe në të vërtetë në vendin tonë kemi një unitet të madh të popullit. Këtë e vënë re edhe të huajt që vizitojnë Shqipërinë. Gjatë dy-tri ditëve që ndenji këtu, një mjek francez na tha se ai pa jo vetëm

vendin, por edhe zemrat e njerëzve, që rronin të gëzuar dhe të lidhur fort me njëri-tjetrin.

Pra fjalën e kisha, që me bashkimin e kooperativave në kishim parasysh se fshatarët do të ishin më të bashkuar, do të merrnin prodhim më të madh e të ardhura më shumë, do të mund të drejtoheshin më mirë etj. Të gjitha këto synime ishin të mira, por kur vjen puna në praktikë, shohim se organizimi dhe drejtimi në këto kooperativa çalojnë. Prandaj tash na duhet t'i forcojmë e të përmirësojmë gjendjen në këto ekonomi.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Duhet të forcohet organizimi, të luftohen praktikat burokratike dhe të forcohet sidomos drejtimi konkret i këtyre ekonomive, se ka rezerva shumë të mëdha.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kur mendojmë dhe themi që vija e Partisë sonë për kolektivizimin e bujqësisë është e drejtë, në kemi parasysh se ky proces i madh transformimi socialist ndikon edhe në rendimentet e prodhimeve bujqësore. Me kolektivizimin mund të marrësh rendimente jashtëzakonisht të mëdha. Sigurisht, jo përnjëherë, por gradualisht, duke perfeksionuar organizimin e punës, duke rritur shkallën e mekanizimit të bujqësisë, duke bërë sistemimin e tokave, ujitjen, duke përdorur farërat e zgjedhura etj. Por mbi të gjitha njeriu ynë i ri, uniteti politik dhe ideologjik i kooperativistëve tanë. kuptimi i drejtë i vijës së Partisë për kolektivizimin, të gjitha këto do të krijojnë mundësi për të rritur prodhimet bujqësore e blegtorale, rendimentet e tyre.

Çështja e organizimit ka rëndësi të madhe. Po të

kemi parasysh forcimin e përsosjen e pandërprerë të organizimit në bujqësi, të drejtimit të punëve, përgatitjen dhe edukimin e kuadrove e të gjithë punonjësve të bujqësisë, sistemimin e tokës, që është baza e rendimenteve, shtimin e futjen gjerësisht të mekanizimit, zbatimin e një agroteknike të përparuar etj. në të gjithë sektorin e bujqësisë do të ecet progresivisht përpara dhe bujqësia jonë socialiste do ta tregojë epërsinë e saj mbi bujqësinë kapitaliste.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Tani në Lezhë ndërmarrja bujqësore është ndarë në gjashtë sektorë, të cilët shtrihen që nga kufiri me Krujën, Bregu i Matit e deri në Shkodër. Drejtoria e ndërmarrjes bujqësore, që të kontrollojë mirë të gjithë këta sektorë, do njerëz. Po të jetë nevoja, mund t'i shtohen disa veta në organikë.

Më kanë thënë se një kooperativist nga Boga i dërgonte një letër Komitetit të Partisë, ku thoshte se nuk e njohin cili është kryetari i kooperativës së bashkuar. Kuptohet që nuk e njohin, sepse kooperativa e bashkuar është shumë e madhe dhe ai nuk shkon atje në Bogë, se mendjen dhe hallet i ka në Koplik, se këtu ka duhanin, misrin, këtu ka aktivitetin më të madh.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Është mirë të bëhet një studim konkret edhe për ndërmarrjet bujqësore, edhe për kooperativat e bashkuara, edhe për kooperativat e tipit të lartë, për të parë se si t'i forcojmë ato, se disa kanë filluar të na bien dhe duhen gjetur shkaqet pse kanë rënë.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Shkaku kryesor, shoku Enver, është ajo që thoni ju, çështja e organizimit

të strukturës. Kjo është shumë delikate. Kryetari i kooperativës së bashkuar nuk disponon mjete të nevojshme që të mund të shkojë sot për kontroll në të gjithë sektorët e saj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Më duket se edhe strukturat e ministrive, për shembull, prapë i kemi të vjetra. Të shikojmë vetëm Ministrinë e Bujqësisë. Ajo ka drejtorinë e blegtorisë, të mekanikës, të drithërave etj., po nuk ka diçka për kooperativat bujqësore. A nuk duhen ndjekur nga dikasteri këto jo thjesht se si i realizojnë apo pse nuk i realizojnë detyrat, mbollën apo nuk mbollën, por për probleme të rëndësishme të zhvillimit të tyre, për të parë nëse ka nevojë për korigjime, për forcimin e tyre etj.

Problemet kryesore që kemi ngritur, siç është çështja e tokës, e sistemimit, e kullimit të saj, ajo e mekanizimit etj., kanë rëndësi për zhvillimin e bujqësisë, por ato kërkojnë përgjigje, kërkojnë zgjidhje. Pse të mbeten prapa, për shembull, bonifikimet, përderisa Ministrisë së Bujqësisë iu dhanë të gjitha mjetet, njerëzit, fondet e të tjera ç'kishte Ministria e Ndërtimit? Ajo që çalon, më duket mua, është organizimi. Sigurisht, atje ka një drejtim, por jo një organizim të shëndoshë që punët dhe detyrat të kryhen në një kohë sa më të shkurtër dhe me plan. Prandaj unë mendoj që shokët e Qeverisë të bëjnë një studim për problemet që dalin, të mblidhen e t'i hedhin një herë ato për diskutim në Ministrinë e Bujqësisë për të parë nëse janë ato problemet kryesore, cilat janë më kryesoret, si drejtohen punët etj. Gjithashtu të merret struktura e Ministrisë së Bujqësisë e të

shikohen konkretisht drejtoritë, personat që janë, detyrat dhe funksionet që kanë, si merren, për shembull, me problemin e sistemimit të tokave, me kullimin e tyre në të gjitha zonat e Shqipërisë etj. Pastaj mbi bazën e këtij studimi analitik të nxirren konkluzione se ç'duhet bërë, ç'duhet përmirësuar, përse nuk ecet, a duhet krijuar ndonjë drejtori apo sektor i ri që të ecin punët përpara etj. Pra, të mendohet një strukturë e re e ministrisë dhe t'i paraqitet Qeverisë për aprovim, sepse kështu mund të zgjidhen problemet. Ne kemi trashëguar disa struktura, të cilat, për atë kohë kur u krijuan, na kanë dhënë rezultate, por stadi i zhvillimit të vendit ndryshon nga një pesëvjeçar në tjetrin. Si i përgjigjemi ne me këto struktura organizimi? Ne nuk themi të ndryshojmë krejt strukturën ekzistuese të ministrisë, por ajo të plotësohet, të përmirësohet, që të mos pengohen zhvillimi dhe realizimi i detyrave. Thuhet që i kemi ndarë kompetencat. Qeveria ka katër vjet që i ka ndarë, në qoftë se nuk gabohem, por edhe këto duhen rishikuar, që kompetencat të japin efekt pozitiv, t'i japin forcë zhvillimit të ekonomisë.

**Kurdoherë ka transformime dhe nuk mund të qëndrohet në një vend. Unë nuk jam i mendimit që rishikimet për çështje të tilla t'i bëjmë çdo ditë. Jo, por ato që na i dikton jeta, t'i bëjmë, ndryshe pengojmë përparimin.**

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar, që gjendet në AQP*

**FRONTI DEMOKRATIK I UDHËHEQUR  
NGA PARTIA ËSHTË ORGANIZATA E MADHE  
E BASHKIMIT, E ORGANIZIMIT DHE E EDUKIMIT  
POLITIK TË POPULLIT**

*Artikull i botuar në gazetën «Bashkimi»*

**3 qershor 1979**

Nesër në Vlorën heroike hapet Kongresi i 5-të i Frontit Demokratik, i organizatës së madhe politike të vendit tonë, që udhëhiqet nga Partia e Punës e Shqipërisë.

Kongresi i Frontit shënon një ngjarje me rëndësi të madhe, pse ai do të shprehë ndjenjat dhe vullnetin e mbarë popullit tonë të bashkuar për një qëllim të lartë e fisnik, për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut e të fitoreve të revolucionit.

Ky kuvend i gjerë, i cili do të diskutojë për të gjitha problemet e mëdha që shtron Partia dhe që interesojnë tërë shoqërinë, merr një kuptim të veçantë, sepse mbledhet në këtë vit jubilar, kur do të festojmë 35-vjetorin e Çlirimit të Atdheut dhe të vendosjes së pushtetit popullor. Kjo fitore, më e madhja, më e lav-

dishmja dhe më e shënuara në historinë shekullore të popullit tonë, u arrit në sajë të luftës heroike të partizanëve tanë trima, të bashkimit të popullit në Frontin Nacionalçlirimtar, të udhëheqjes së sigurt e largpamëse të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Në luftën e madhe për lirinë e atdheut dhe për çlirimin shoqëror, populli shqiptar është ndeshur me armiq të tërbuar, të jashtëm dhe të brendshëm. Në këtë luftë atij i është dashur të mbante parasysh dhe të realizonte dy qëllime kryesore: të siguronte një udhëheqje besnike të interesave të vet dhe të arrinte bashkimin e tij. Pa arritur këto dy qëllime, ai nuk mund të merrte në dorë fatet e veta. Si i arriti populli shqiptar këto dy synime kapitale? Me ndihmën e huaj nga jashtë? Jo! Ai i arriti këto duke u udhëhequr nga vetë eksperiencia e tij e madhe shekullore, si dhe i ndriçuar nga mësimet universale e të pavdekshme të teorisë së Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Sa burra të shquar e të mençur, sa luftëtarë heroj e të sakrificës për lirinë e atdheut ka nxjerrë ky vendi ynë i vogël! Trimëritë e popullit tonë i kanë habitur njerëzit në kohë të ndryshme. Mençuria e burrave të shquar të Shqipërisë ka kontribuar në thesarin e shkencës dhe të diturisë botërore.

Por, me gjithë përpjekjet, me gjithë sakrificat e mëdha të këtyre njerëzve, populli, për të cilin ata dhënë çdo gjë, nuk i realizoi si duhej këto dy qëllime që përfaqësonin shpëtimin e tij përgjithmonë. Megjithatë puna dhe gjaku i të parëve tanë nuk shkuan kot. Ky gjak, që u derdh në truallin e atdheut, i forcoi theme-

let e Shqipërisë, kurse mençuria e tyre la gjurmë të pashlyera në brezat pasardhës. Ata na lanë një mësim të madh: Kush lufton bashkë me popullin dhe për popullin, ai do të fitojë, jo si individ, por do të fitojë populli, mbarë kombi.

Zëri dhe vepra e njerëzve të mëdhenj të Shqipërisë, thirrja e tyre e fuqishme kanë qenë: Shqiptarë, bashkohuni! Kurse klithma e armiqve tanë ka qenë: Shqiptarë, përçahuni! Me këtë gjuhë kanë folur kurdoherë fuqitë e mëdha imperialiste, pse kështu do të na sundonin e do të na shtypnin, kështu do ta skllavëronin kombin tonë për interesat e tyre.

Njerëzit e mirë dhe patriotë shqiptarë kërkonin bashkim për çlirimin e vendit, për mbrojtjen e gjuhës dhe të alfabetit shqip kundër halldupit dhe Fanarit. Ata bridhnin nga një vend në tjetrin me shpresë se mos gjenin jashtë mbrojtje e përkrahje për të drejtat e kombit shqiptar, për çështjen e pavarësisë e të lirisë së tij, por asgjëkundi nuk gjetën mbështetje. Mbështetja e tyre e sigurt ishte vetëm populli, por bashkimi i tij nuk ishte i plotë, pse kishte edhe forca shoqërore nga radhët e pasanikëve, të feudalëve e të borgjezisë, që u shërbenin të huajve dhe e kundërshtonin këtë bashkim. Megjithatë kontributi i patriotëve shqiptarë ishte me vlerë, fara që mbollën ata nuk u kalb. Do të vinte medoemos një ditë që kjo farë të çante tokën, të mbinte e fuqishme dhe të lulëzonte.

Jo vetëm fjala dhe mendimet e të parëve, por edhe maliherët e nagantët e tyre s'kanë pushuar gjithë jetën për lirinë e popullit shqiptar. Të huajt dhe nje-

rëz të ligj brenda vendit, që mbillnin përçarjen, pretendonin se një vend e një popull i vogël si yni nuk mund të rronte dot pa ndihmën e një të madhi. Por njerëzit e mirë që luftonin me shpatë, me pushkë e me penë mendonin ndryshe. Dhe kishin shumë të drejtë.

Bashkim, thërriste plaku i bjeshkëve të Veriut, Bacë Bajrami, i fortë si malet e larta të Shqipërisë që e lindën. Bashkim, o popull, thërriste Avni Rustemi, se kërkojnë të na robërojnë e të na mposhtin bejlerët. Dinte ç'thoshte e ç'mendonte Bajram Curri kur i shkruante Leninit se ti do të na e shpëtosh Shqipërinë. Dinte ç'bënte Avni Rustemi, ai djalë i ri, kur, në mes të Parisit, shkrehu nagantin mbi pashën tradhtar. Dinte ç'kërkonte ai demokrat revolucionar kur në parlamentin e asaj kohe bëri thirrje të ngriheshin në këmbë e të nderohej kujtimi i Vladimir Iliç Leninit, këtij njeriu të madh të Rusisë dhe të të gjithë njerëzimit.

Dhe dita që prisnin këta martirë erdhi. Fara e hedhur prej burrave trima, të zgjuar e të mirë të vendit tonë mbiu në truallin shqiptar. Kjo farë duhej pas-truar, duhej larë që të mbinte e fortë, e shëndetshme, që të mos e rrëzonte asnjë erë e asnjë furtunë. Për këtë qëllim populli shqiptar duhej të ndiqte traditën e tij shekullore të luftës për liri e për bashkim, të ndiqte gjithashtu teorinë e madhe të Karl Marksit e të Vladimir Iliç Leninit, të ndiqte shembullin e Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga Partia Bolshevike dhe nga Stalini. Nga gjiri i klasës punëtore, nga gjiri

i popullit, duhej të dilte Partia Komuniste e Shqipërisë, udhëheqësja e luftës së popullit shqiptar.

Pas 1912-s u krijuan disa parti në vendin tonë, por këto nuk kishin baza, nuk kishin program të qartë, pavarësisht se disa prej tyre udhëhiqeshin nga qëllime të mira. Jeta kërkonte ndryshime të thella sociale dhe kushtet objektive për këtë gjë përgatiteshin çdo vit e më mirë. Por mungonte faktori subjektiv, mungonte udhëheqja, e cila nuk mjaftonte të ishte vetëm një grup njerëzish me disa ide përparimtare, por duhej të ishte një parti që të përfaqësonte të ardhmen, përparimin. Kjo parti nuk mund të ishte tjetër veçse partia e proletariatit, e klasës më të përparuar, më të fortë, më të organizuar e më të interesuar për revolucionin, e asaj klase që kishte teorinë e vet shkencore, e cila e printe atë dhe aleatët e saj në luftë e në revolucion për çlirimin kombëtar dhe shoqëror.

Për formimin e një partie të vërtetë të popullit nuk mjafton vetëm dëshira e mirë e disa personave. Kjo lyp përgatitjen e një terreni të përshtatshëm, lyp hartimin e një programi që të përfaqësojë interesat dhe aspiratat e popullit punonjës, që të mbështetet në ideallet e pastra të këtij populli. Formimi i një partie të tillë lyp besnikëri të pafund ndaj popullit, që shpresat dhe ndjenjat fisnike, trimërore dhe dëshirat e tij të mos tradhtohen kurrë.

Bajram Curri e Avni Rustemi nuk krijuan ndonjë parti që t'i vinin dhe një emër, siç bënë disa intelektualë, elementë të paqartë e të lëkundshëm të feudalizmit e të borgjezisë. Këta intelektualë, që hiqeshin

sikur ishin ata që e bënë revolucionin e 1924-ës, krijuan disa parti në shembullin e partive të borgjezisë evropiane. Kurse Bajram Curri e Avni Rustemi, më parë se të krijonin ndonjë parti, krijuan në Vlorë organizatën politike «Atdheu» dhe më pas shoqërinë «Bashkimi» me degët e tyre në të katër anët e vendit. Këto shoqëri kishin për qëllim pikërisht arritjen e atij bashkimi të të rinjve të varfër, të njerëzve të ndershëm e kurajozë që duhej të hidheshin në luftë për të fituar lirinë e pavarësinë e vërtetë të atdheut dhe të drejtat shoqërore.

Komunistët shqiptarë, në momente më të vështira që kalonte bota dhe atdheu i tyre, u ushqyen me mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit dhe në zjarrin e luftës formuan Partinë Komuniste të Shqipërisë, që do të bëhej, siç u bë, udhëheqësja e vërtetë, besnike deri në fund e klasës punëtore dhe e popullit shqiptar. . .

Pushtuesit nazifashistë na e kishin frikën, ata e dinin se Partia Komuniste, që u krijua, s'do t'i linte kurrë të qetë. Parësia, siç i thoshte populli, që përbehej nga bijtë bastardë të përhershëm të kombit shqiptar, që kurdoherë kanë mbështetur pushtuesit e huaj për interesat e klasës së tyre dhe jo të Shqipërisë, e ndjeu rrezikun e madh që i turrej, u bë një me pushtuesit, dhe së toku morën të gjitha masat që të na shkatërronin. Filloi kështu lufta kundër Partisë Komuniste.

Partia bëri thirrje: Të krijojmë Frontin Nacionalçlirimtar, që të bashkojë gjithë popullin! Dhe ashtu

u bë. Fronti eci përpara dhe fitoi, se kishte rrënjë të thella në popull, se kishte në krye Partinë Komuniste të mençur, të sigurt, të fortë e të pafrikshme përpara demagogjisë dhe gënjeshtërisë, përpara tankeve, topave dhe mitralozave të armiqve.

Thirrje për bashkim, veçse për qëllime të tjera, bëri edhe Balli Kombëtar, por, siç dihet, ai u fundos në batak.

Në Pezën heroike Partia mblodhi përfaqësues të të gjitha shtresave të popullit dhe shtroi nevojën e krijimit të Frontit, që do të ishte një organizatë e madhe politike, e udhëhequr nga Partia, me një program të gjerë ku mund të lenin pjesë pa dallim njerëz të çdo bindjeje politike ose besimi fetar, por të bashkuar për një qëllim, për të luftuar kundër armikut me çdo mënyrë, me armë, me penë, me rezistencë të hapët e të fshehtë, pa u lëkundur e pa u ligështuar. Qëllimet e Frontit dhe detyrat e tij për luftë totale kundër armikut Partia i shprehu haptazi dhe me çiltërsi.

Në këtë mbledhje historike u caktuan edhe format organizative të Frontit Nacionalçlirimtar që do të shtrihej në të gjithë Shqipërinë, e cila lëngonte nën pushtimin e të huajve. Këshillave të Frontit Konferenca e Pezës u caktoi edhe detyra për furnizimin e ushtrisë dhe të Luftës Nacionalçlirimtare me çdo gjë të nevojshme; ajo u jepte këtyre këshillave formën embrionale të pushtetit popullor. Armiqtë përdorën çdo mjet, që nga shpifjet e gënjeshttrat e më në fund edhe armët, por Partia, Fronti Nacionalçlirimtar dhe populli i bashkuar i bënë ata pluhur e hi.

Pse i bënë pluhur e hi? Ç'ishte ky fenomen që po ngjiste në këtë vend të vogël? Ishte fenomeni që provonte se edhe një vend i vogël me një popull të vogël, të pastër e të ndershëm, por i bashkuar fort, me armë në dorë e i udhëhequr nga ide të mëdha revolucionare, mund t'i ruante traditat e tij të mëdha shekullore, mund të luftonte dhe të fitonte lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin, mund të bënte revolucionin e të vendoste pushtetin popullor. Kjo ishte fitorja e idealeve liridashëse të të parëve tanë, të mbrujtura me idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit. Revolucionin në Shqipëri fitoi, sepse ishte Partia Komuniste e Shqipërisë ajo që u vu në krye të masave të popullit dhe realizoi bashkimin e fuqishëm të tij.

Frontin Nacionalçlirimtar u përpoqën ta shtrembëronin, ta çoroditnin, ta dëmtonin dhe ta shkatërronin elementët e shitur të Ballit Kombëtar, të kësaj organizate tradhtare e bashkëpunëtore e pushtuesve. Por më kot. Prej asaj dite historike që u formua, Fronti, i udhëhequr nga Partia, u bë organizata e madhe dhe e gjerë e popullit shqiptar, u bë mjet i bashkimit, i organizimit dhe i edukimit politik të popullit. Në bashkimin monolit qëndronte sekretin e forcës dërrmuese të popullit tonë dhe i fitores së tij mbi armiqtë. E mbështetur fuqimisht në këto forca të gjalla, Partia jonë do të bënte mrekullira, do të udhëhiqte me sukses revolucionin nga etapa demokratike, antiimperialiste, në etapën e revolucionit socialist, në etapën e diktaturës së proletariatit e të ndërtimit të socializmit.

Pasi u fitua liria, vendi kaloi përsëri ditë të vësh-tira. U deshën përpjekje të panumërta, beteja madhë-shtore e veprime të mençura të Partisë sonë heroike për të kapërcyer këto vështirësi. U desh të mobilizo-heshin energjitë e popullit të bashkuar në organizatën e madhe të Frontit dhe në të gjitha organizatat e tje-ra të masave. Brenda dy vjetëve, pa ndihmën e kurr-kujt, ne mundëm të rindërtonim të gjitha objektet që na shkatërroi lufta, e cila na vrau 28 mijë shokë e shoqe nga më të mirët dhe na dogji e na përvëloi gji-thë vendin. Dëmet e pësuar nga lufta ishin të mëdha, por Shqipëria e re nuk u ligështua, se kishte një po-pull vigan e se vigane ishte Partia dhe ideologjia që e udhëhiqte atë.

Forca e bashkimit të popullit tonë kalitej në luf-të të ashpër me armiqtë, të jashtëm e të brendshëm, me mbeturinat e tyre, që përpiqeshin të ngrinin krye e të rivendosnin kapitalizmin. Ato fuqi imperialiste, që deri dje ishin aleate në luftën kundër fashizmit, me mbarimin e saj u kthyen në armiq të rrezikshëm që punonin për të rrëzuar pushtetin tonë popullor. Me-gjithëkëtë ata nuk mundën ta mposhtnin dot popullin shqiptar, klasën punëtore shqiptare dhe Partinë e saj të lavdishme të Punës.

Vendosja e pushtetit popullor dhe ndërtimi i socia-lizmit u bënë një realitet i madh në Shqipëri. . .

Armiq të jashtëm dhe armiq të brendshëm, armiq të hapët dhe armiq të maskuar vazhdimisht do të na dilnin në rrugë. Partia diti t'i zbulonte njërin pas tje-trit, t'i demaskonte dhe t'i bënte të pafuqishme kom-

plotet e tyre kundër socializmit e lirisë së atdheut, pse ishte një Parti e klasës punëtore, një Parti që ndiqte me besnikëri marksizëm-leninizmin, një Parti që mbështetej te masat e gjera të popullit.

Pra, pa një parti marksiste-leniniste me një program të qartë minimal e maksimal, pa bashkuar popullin shqiptar si në luftën për çlirimin e atdheut ashtu edhe për ndërtimin e vendit, fitorja do të ishte e pamundur. Për të çliruar këtë vend të vogël, u derdh vetëm gjak shqiptari. Për ta rindërtuar nga shkatërrimet e luftës e për të ndërtuar socializmin në këtë vend të vogël, u derdh vetëm djersë shqiptari.

Ka njerëz që thoshin e thonë akoma se Shqipëria paska jetuar në sajë të ndihmave të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të tjera ish-socialiste, në sajë të ndihmave të Jugosllavisë titiste kur dihet se kjo e fundit jo vetëm që nuk na ka ndihmuar, por në të kundërtën, na ka grabitur sa ka mundur. Thuhet gjithashtu se Shqipëria paska jetuar në sajë të ndihmave të kinezëve! Kjo është një tjetër gënjeshtëri. Kreditë që ata na kanë akorduar ne i kemi pasë pranuar, duke menduar se kishim të bënim me marksistë-leninistë, megjithatë ato nuk përfaqësojnë veçse një përçindje fare të vogël të investimeve që ka bërë populli ynë.

Shtetet pseudosocialiste, që u demaskuan njëri pas tjetrit, dhe që për këtë luajti një rol me rëndësi Partia e Punës e Shqipërisë, me kreditë që jepnin kishin qëllime imperialiste. Por këto qëllime të errëta ua zbuloi Partia e Punës, e cila ua dogji kartat në duar. Ne nuk i kemi borxh kurrkujt. Kreditë e marra ua kemi shlyer.

«Ndhima» e tyre kishte qëllime të këqija, ata, nëpërmjet «ndihmës», kërkonin që Shqipërinë ta bënin vegël të tyre, ta bënin neokoloni. Por nuk u ndezi me ne. Partia e Punës e Shqipërisë nuk e tradhtoi kurrë popullin e vet, ideologjinë e saj, marksizëm-leninizmin, prandaj triumfoi.

Hrushovianët, titistët, kinezët, eurokomunistët e të tjerë e tradhtuan marksizëm-leninizmin, ata u bënë lakenjtë e borgjezisë, por, pavarësisht nga kjo, marksizëm-leninizmi është e do të mbetet doktrina e pamposhtur e proletariatit që do t'u ndritë rrugën miliona e miliona njerëzve, të cilët janë ngritur e pogrrihen në revolucion për të shkatërruar shoqërinë e kalbur të kapitalizmit.

Shqipëria është e vogël, i vogël në numër është edhe populli i saj, por shembulli i tyre është i madh, pse mbrojnë një kauzë të madhe. Ndonjë përjashta shtron pyetjen: Ku e gjen tash populli shqiptar këtë forcë të madhe shpirtërore, ekonomike, kulturore dhe ushtarake, që t'u bëjë ballë valëve të tërbuara të kapitalizmit e të revizionizmit modern, të imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik e kinez etj., urrejtjes së diktaturave fashiste e reaksionit të jashtëm, që përpiqen ta dëmtojnë e ta shkatërrojnë? Këtë forcë ai e ka gjetur jo në përkrahjen e ndonjë fuqie të madhe, por në veten e tij, në ndjenjat e tij patriotike dhe burrërore, në ideologjinë marksiste-leniniste, në vijën e drejtë të Partisë, në unitetin e çeliktë të tij me Partinë, në përkrahjen e komunistëve të vërtetë dhe të proletariatit e të popujve të botës. Janë pikë-

risht këta faktorë që e bëjnë Shqipërinë të mos ia ketë frikën kurrkujt.

Njerëzit e ndershëm dhe përparimtarë të të gjithë botës shohin te Shqipëria një shembull të gjallë ku një popull i vogël, i rrethuar nga të katër anët nga kapitalizmi dhe borgjezia, qëndron i patundur, i pamposhtur dhe ndërton socializmin me forcat e veta.

Në kohën kur kriza e madhe botërore ka mbuluar vendet kapitaliste, imperialiste dhe socialimperialiste, kur po ngrihen çmimet e të gjitha sendeve të nevojshme për njerëzit, kur miliona punëtorë flaken në rrugë pa punë, vendi ynë ndërton me sukses socializmin. Këtu lulëzon dhe zhvillohet një industri e fuqishme, një bujqësi e përparuar dhe një kulturë thellësisht njerëzore dhe e pastër. Kultura jonë i shërben jo vetëm përparimit të vendit, por jep kontributin e vet edhe në thesarin e madh të kulturës botërore.

Në vendin tonë të pavarur e sovran njeriu rron i lirë dhe nuk ia shtrin dorën kurrkujt. Ne ua kemi nderur dorën të tjerëve për miqësi e marrëdhënie reciproke të sigërta e jo për lëmoshë. Siç që i zoti të derdhë gjakun për çlirimin e atdheut dje, populli ynë është i zoti të derdhë djersën për ndërtimin e socializmit sot.

Tërmeti që ra te ne, para disa javësh, ishte tërmeti më i madh që mbahet mend të ketë rënë në vendin tonë. U shkatërruan fshatra të tëra! Ky dëm i madh do të përballohet me forcat tona. Brenda pesë muajve të gjitha fshatrat e rrënuara do të ndërtohen më

të bukura sesa ishin, ato do të jenë fshatra të reja socialiste. Fshatarët që u dëmtuan nga tërmeti, për të shprehur mirënjohjen ndaj Partisë për kujdesin e saj prindëror, thonë: «Më parë se të na vinte gjitoni na u gjend pranë Partia». Gjithë Shqipëria, si një trup i vetëm, u ngrit në këmbë për të kapërcyer vështirësitë e mëdha që u krijuan. Kështu ka ndodhur e ndodh te ne kurdoherë që e do nevoja. Një për të gjithë, të gjithë për një. Me mijëra njerëz kanë shkuar dhe me dhjetëra mijë të tjerë kanë shprehur dëshirën të shkojnë për likuidimin e pasojave të rënda që u shkaktoi tërmeti vëllezërve e motrave në zonat e dëmtuara. Në linjat tona automobilistike e hekurudhore shikon vazhdimisht vargjet e pafund të kamionëve e të trenave që transportojnë materiale ndërtimi. Popullit që i rëndoi fatkeqësia, sidomos në Veri, në Shkodër, në Lezhë, në Mat, në Mirditë, në Krujë, në Dibër, në Pukë e në Tropojë, që ditën e parë nuk i mungoi asgjë. Me një shpejtësi të rrufeshme u sistemuan njerëzit nëpër çadra dhe ata nuk e ndien veten ngushtë as për sheqer e për kafe, pa lëre pastaj për bukë, mish e zarzavate që i kishin më me shumicë se më parë.

Ka të tjerë që po lypin ndihma anëmbanë. Kanë dhjetë vjet që nuk po i ndërtojnë dot ato fshatra dhe zona që i ka pasë rrënuar tërmeti. Natyrisht, neve na vjen keq për popullatën që vuan, se e dimë që kjo gjendje nuk është për fajin e saj, por për arsye të sistemit shoqëror dhe shtetëror që ekziston atje. Në sistemin socialist çdo e keqe kapërcehet bashkërisht dhe me shpejtësi, kurse në sistemin kapitalist njeriu vuan

jo vetëm në momentet e mjerimit që shkakton një fatkeqësi e natyrës, por gjithë jetën.

Organizata jonë e madhe e Frontit Demokratik ka pasur, ka dhe do të ketë një rëndësi shumë të madhe për ndërtimin e socializmit. Partia që e udhëheq dhe e frymëzon atë, i pajis anëtarët e Frontit me virtytet e larta patriotike të popullit tonë, me mësimet e ideologjisë marksiste-leniniste. Partia e Punës e Shqipërisë punon që Fronti të jetë kurdoherë i fortë dhe vepues, ashtu siç ka qenë deri sot, të vazhdojë edhe në të ardhmen luftën për të kryer me sukses detyrat që cakton ajo për ndërtimin e plotë të socializmit, për ruajtjen e lirisë së popullit dhe të pavarësisë së atdheut, që Shqipëria të jetë kurdoherë një vend sovran, plot dinjitet, i respektuar nga popujt e tjerë.

Partia i mëson komunistët të qëndrojnë si gjithnjë në ballë të çdo pune e të çdo përpjekjeje, të tregojnë gjallëri e vetëmohim për kryerjen e detyrave. Duke qenë anëtarë të Frontit Demokratik të Shqipërisë, ata duhet të jenë nga militantët më të shquar, plot pjekuri politike e të thjeshtë në qëndrime, dashamirës ndaj popullit, të lidhur ngushtë me të, të ruajnë unitetin e Partisë me popullin, të forcojnë organizatën e Frontit dhe të gjitha organizatat e tjera të masave, që e gjallërojnë e u japin vitalitet e forcë aktivitetit dhe mendimit të madh të saj. Sa më shumë të diskutohen në Front direktivat dhe problemet që shtron Partia, sa më shumë kritikë t'u bëhet lëshimeve të palejueshme, veseve të dëmshme që ekzistojnë e që mund të lindin, shfaqjeve të huaja, liberalizmit e burokra-

tizmit, aq më i fortë e më i qëndrueshëm do të jetë socializmi në Shqipëri, aq më i fortë do të jetë atdheu ynë.

Për këtë arsye Partia i jep një rëndësi kaq të madhe organizatës së Frontit. Rruga që i ka caktuar Partia kësaj organizate është e lavdishme. Fronti Demokratik i Shqipërisë ka kaluar nga shumë etapa të vështira e historike dhe i ka kryer me nder detyrat e tij të mëdha. Ai me siguri do të vazhdojë edhe paskëtaj të jetë një organizatë e madhe politike e popullit tonë, e udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Bashkimi» nr. 132 (10729), 3 qershor 1979*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha «Raporte e fjalime 1978-1979», f. 270*

## **FJALA E HAPJES NË KONGRESIN E 5-TË TË FRONTIT DEMOKRATIK TË SHQIPËRISË**

**4 qershor 1979**

**Të dashur shokë e shoqe,**

Jemi mbledhur këtu, në qytetin e bukur e heroik të Vlorës së Ismail Qemalit, në gjirin e popullit të tij trim e bujar, që luftoi heroikisht më 1920 dhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, për të zhvilluar punimet e Kongresit të 5-të të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

Ju keni ardhur në Vlorë nga të katër anët e atdheut për të sjellë dëshirat, mendimet e gjykimet e punëtorëve, të kooperativistëve e të intelektualëve, të grave e të rinjve, dhe për të diskutuar për problemet e detyrat e mëdha që qëndrojnë sot përpara popullit tonë. Të gjithë së bashku do të diskutojmë se si ta forcojmë edhe më shumë Shqipërinë tonë të dashur, si ta bëjmë edhe më të pathyeshëm unitetin e çeliktë të popullit tonë, si ta bëjmë jetën e tij më të lumtur e më të gëzuar, si ta gjallërojmë edhe më tepër jetën e veprimtarinë e organizatës sonë të Frontit Demokratik. Me siguri ju, shokë e shoqe delegatë, do t'i përmbu-

shni plotësisht dëshirat që ju ka shprehur dhe porosinë që ju ka dhënë populli, kur ju zgjodhi për të ardhur në këtë kongres.

Sot, në këtë kongres, nuk ndodhen më midis nesh anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm, Gogo Nushi, Zylftar Veleshnja, Persefoni Dervishi, Sulo Lutaj, Subi Bakiri, Qazim Baftjari, Aishe Doçi, Qibrie Ciu, Ismail Geci, Bilbil Klosi, Vasil Ziu, Kristaq Antoniu, Avdi Mulosmani, Kiço Gliozheni, të cilët, gjatë gjithë jetës së tyre, kanë luftuar e punuar me devotshmëri të pafund për çështjen e Partisë, të lirisë e të pavarësisë së atdheut, për forcimin e unitetit të popullit tonë në Frontin Demokratik të Shqipërisë.

Ju ftoj, shokë delegatë, të nderojmë me një minutë heshtje kujtimin e tyre të ndritur e të paharruar.

Fronti Demokratik është organizata luftarake që, nën udhëheqjen e Partisë, bashkon mbarë popullin shqiptar, që organizon e mobilizon punonjësit në luftën për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë të fituara me gjak e sakrifica, që punon pa u lodhur për ndërtimin e jetës së re socialiste dhe për edukimin e masave të gjera me dashurinë e pafund për atdheun, me idealet e socializmit e të komunizmit.

Fronti Demokratik është bartës i traditave të shquara liridashëse të popullit tonë, është vazhduesi i përpjekjeve të mëdha që kanë bërë patriotët e demokratët përparimtarë shqiptarë, të të gjitha kohëve, për bashkimin e popullit në luftë për Shqipërinë e lirë, për ruajtjen e unitetit të kombit kundër orvatjeve të

fuqive imperialiste e shoviniste që synonin copëtimin e vendit, për një jetë më të mirë e drejtësi shoqërore, për mbrojtjen e gjuhës amtare e të kulturës sonë të lashtë.

Këto tradita e këto ideale të popullit tonë Partia Komuniste i ngriti lart e i pasuroi më shumë, kur krijoi, në zjarrin e luftës heroike partizane, Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar.

Partia me këtë organizatë realizoi bashkimin më të fuqishëm në historinë e popullit tonë, të paparë për gjerësinë e tij, për forcën e organizimit e ndërgjegjen e lartë politike. Lufta kundër pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve të vendit e forcoi dhe e kaliti unitetin e popullit, e bëri atë faktor vendimtar për fitoren historike të 29 Nëntorit 1944.

Ishte ky unitet i popullit rreth Partisë, që u ngrit në një shkallë të re e më të lartë në luftën për transformimin socialist të Shqipërisë, përpara të cilit janë thyer komplotet e sulmet e shumta të imperialistëve e të revizionistëve, përpara të cilit janë dërrmuar e janë bërë thërrime orvatjet kundërrevolucionare të armiqve të brendshëm. Është ky unitet që e bën të pathyeshëm e të pamposhtur Shqipërinë socialiste, që e bën atë të qëndrojë ballëlart e të ecë përpara e lirë dhe e pavarur në rrugën e socializmit.

Ky unitet dhe solidaritet i madh popullor e tregoi përsëri vitalitetin dhe fuqinë e tij, kur tërë njerëzit tanë u ngritën përnjëherë për t'u shkuar në ndihmë vëllezërve e motrave të tyre që u dëmtuan nga tërmeti i rëndë i 15 prillit.

Nga kjo tribunë e lartë e Kongresit të 5-të të Frontit Demokratik të Shqipërisë ne u drejtojmë familjeve të viktimave ngushëllimet më të përzemërta të Frontit Demokratik, të Partisë, të mbarë popullit, të të gjithë ne delegatëve, për humbjet e hidhërimit që u shkaktoi kjo fatkeqësi e rëndë natyrore.

Ne admirojmë guximin dhe heroizmin e të gjithë atyre, të cilët, me gjithë dëmet e mëdha që pësuan nga tërmeti, as u ligështuan, as u dëshpëruan. Ne admirojmë besimin e madh e të patundur që kanë ata te Partia e tyre e dashur dhe te pushteti popullor.

Nga ky kongres u dërgojmë përshëndetjet tona të gjithë vullnetarëve nga tërë Shqipëria, që punojnë me vetëmohim, ditë e natë, për ndërtimin e shtëpive dhe të fshatrave të shkatërruara, për të çuar në vend fjalën e Partisë që më 1 tetor çdo gjë të jetë rindërtuar dhe të jetë ngritur më e bukur se më parë.

Kongresi i Frontit Demokratik mblidhet në një kohë kur populli ynë ka mobilizuar forcat dhe është ngritur i tëri në këmbë për të realizuar vendimet historike të Kongresit të 7-të të Partisë, për të vënë në jetë programin madhështor të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Ai mblidhet në vitin jubilar të 35-vjetorit të Çlirimit të vendit e të vendosjes së pushtetit popullor, të kësaj fitoreje të madhe të Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia jonë heroike. Le të shërbejë ky përvjetor i shënuar për fuqizimin dhe përparimin e mëtejshëm të atdheut tonë të dashur, të Shqipërisë sonë socialiste!

Kongresi ynë, me punimet e vendimet e tij, me

siguri do t'i japë një nxitje të re e të fuqishme punës së Frontit për mobilizimin e punonjësve në luftën për realizimin e planit të shtetit, për të rritur edhe më shumë prodhimin, për të çuar edhe më përpara zhvillimin e kulturës e për të ngritur më tej mirëqenien.

Punimet e këtij kongresi do t'u shërbejnë organizatave të Frontit për të intensifikuar punën e tyre për edukimin patriotik e revolucionar të masave. Duke zhvilluar kurdoherë drejt luftën e klasave, ashtu siç na mëson Partia, të forcojmë edhe më shumë unitetin e popullit e lidhjet e tij me Partinë, të mprehim edhe më tepër vigjilencën, të rrisim gatishmërinë e aftësinë e popullit për mbrojtjen e atdheut.

Për mua është një kënaqësi e veçantë t'ju sjell juve, shokë e shoqe delegatë, përshëndetjet e zjarrra të Komitetit Qendror të Partisë dhe në emër të tij t'i uroj Kongresit të 5-të të Frontit Demokratik që ta përmbushë me sukses misionin e lartë e të rëndësishëm që i është ngarkuar.

Kongresin e deklaroj të hapur.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 133(9621), 5 qershor 1979*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», nr. 133(9621), 5 qershor 1979*

**NDERIN QË NA U BË DO TA SHPËRBLEJME  
ME PUNË, ME VENDOSMËRI, ME NDËRGJEGJE  
TË LARTË**

*Fjala në mbledhjen e parë të Këshillit të Përgjithshëm  
të Frontit Demokratik të Shqipërisë<sup>1</sup>*

**6 qershor 1979**

**Të dashur shokë e shoqe,**

Kjo mbledhje e shkurtër që po bëjmë, ka për qëllim zgjedhjen e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

Në këtë kongres të mrekullueshëm të gjithë delegatët na nderuan pa masë duke na zgjedhur në udhëheqje të Frontit Demokratik dhe në këtë nder që na u bë, do ta shpërblejmë me punë, me vendosmëri, me ndërgjegje të lartë dhe me çdo sakrificë, deri edhe në sakrificën e fundit më të madhe, në qoftë se do të kenë

---

1. Kjo mbledhje u zhvillua në pushim midis seancave të kongresit.

nevojë atdheu, populli dhe Partia që na udhëheq, me jetën tonë.

Por, tok me nderin e madh që na bëri, kongresi na ngarkoi edhe detyra të mëdha, për rëndësinë e të cilave nuk do të flas këtu sepse delegatët që u ngritën në tribunën e kongresit e shprehën atë shumë mirë në diskutimet e tyre. Ishin me të vërtetë diskutime entuziasme, të një entuziazmi revolucionar, të një entuziazmi që ne dhe gjithë popullin, që i ndoqi me vëmendje punimet e kongresit, na bëri të shohim me besim të pafund perspektivën që na ka hapur Partia jonë e lavdishme.

Po ashtu ky kongres na fuqizoi jashtëzakonisht, na rinoi. Mbledhjet tona të çfarëdollojta, e jo vetëm kongreset, nuk janë formale ose mbledhje rutine, ato janë mbledhje pune, ku rrihen probleme me rëndësi jetike për popullin tonë, shfaqen mendime dhe kërkohen e gjenden metoda më të përshtatshme për organizimin e drejtimin e punës. Pra, në këto mbledhje pune komunistët dhe masat e paorganizuara në Parti mësojnë akoma më shumë nga eksperiencia e përgjithshme e madhe e Partisë, që frymëzon organizatën tonë të Frontit se si t'i kuptojmë, si të reflektojmë, të thellohem dhe t'i organizojmë detyrat e rëndësishme që na vihen përpara, për t'i realizuar sa më me sukses. Dhe ato janë të mëdha e të koklavitura, nuk janë të lehta. Në rrugë kemi hasur dhe do të hasim vështirësi, të vogla dhe të mëdha, por asnjë vështirësi që na ka dalë, dhe këtë nuk e themi për mburrje, sado e madhe që ka qenë, nuk na ka penguar dhe nuk do të na pengojë për

të ecur kurdoherë përpara. Përkundrazi, kur kemi hasur vështirësi në rrugën tonë, ne jemi mobilizuar me të gjitha energjitë, e kemi ndier veten më të fortë dhe e kemi kapërcyer. Ky është një tipar i fortë karakteristik që ka rrënjosur Partia në ndërgjegjen tonë, në mendjet e në zemrat tona dhe kjo për arsye të ideologjisë sonë marksiste-leniniste, e cila na armatos dhe na jep atë forcë të madhe për të qenë në gjendje që të kuptojmë dhe të zgjidhim drejt problemet për popullin.

Partia e ka konsideruar kurdoherë Frontin si një nga organizatat më të rëndësishme politike të popullit tonë, pse në të realizohet uniteti i tij rreth Partisë, sepse te bashkimi qëndron forca jonë, prandaj ajo i ka dhënë një rëndësi të madhe. Forumet dhe zgjedhja e udhëheqjes së këtyre forumeve janë me rëndësi, por rëndësi të madhe ka njëkohësisht puna jonë në bazë. Ne që na zgjodhi kongresi dhe të gjithë këshillat që janë zgjedhur në rrethe, në kooperativa, në lagje e kudo, duhet të kemi vazhdimisht parasysh pikërisht atë veprimtari të madhe, atë jetë të shumanshme e të gjallë të popullit me gëzimet e me emocionet e saj, që duhet të punojmë për t'ia siguruar gjithnjë e më mirë, por ne duhet të kemi parasysh edhe të metat e gabimet që vërtetohen, ndaj të cilave kërkohet t'i luftojmë, që të mos zënë vend e të përhapen në jetën e veprimtarinë e popullit tonë. Pikërisht për këtë na cmoi kongresi, na nderoi e na dha këto detyra e përgjegjësi të mëdha.

Partia na qëndron kurdoherë pranë, ajo na ush-

qen dita-ditës me mësimet e saj, me parimet e saj konsekuente marksiste-leniniste dhe me një qartësi të madhe përcakton detyra në të gjitha fushat. Prandaj këto detyra ne duhet t'i zbërthejmë, t'i shpjegojmë e t'i bëjmë të kuptueshme për gjithë popullin, për të mëdhenj e të vegjël. Veçse rëndësi ka që fjalët që themi e do të themi të mos jenë të atilla që t'i marrë era, por të jenë fjalë që të zenë rrënjë në këtë tokë, në këtë tokën tonë të shtrenjtë, që është e rrethuar me armiq, por që si shkëmb graniti qëndron në këmbë e kështu do të qëndrojë në shekuj. Përse? Për arsyen e madhe se Partia na brumos të gjithë çdo ditë me ideale të larta fisnike e me një forcë mendore të madhe, shkencore, teknike, organizative, ideologjike e politike.

Ne kuptojmë çdo gjë dhe gjithçka e realizojmë me forcat tona, duke marrë edhe nga kultura e shkencat përparimtare e popujve të tjerë, por pa marrë kurrë kredi. Asnjëherë ne nuk do të bëhemi raja e të tjerëve. Kurrë shqiptari nuk është përkulur e nuk do të përkulet para të huajve. Ky qëndrim ka bërë që autoriteti i Shqipërisë socialiste dhe i Partisë sonë të Punës të ngrihet shumë lart në botë. Kudo flitet me respekt për Partinë dhe për atdheun tonë socialist. Gjithë popujt, revolucionarët dhe njerëzit përparimtarë në botë shohin te ne pikërisht atë forcë të madhe të marksizëm-leninizmit, në sajë të së cilës një vend i vogël plot male e gërxhe i ka kthyer edhe këto në fusha pjellore; se një popull i vogël, i rrethuar me armiq, ecën përpara pa iu trembur syri kurrë, sepse ka në krye Partinë e tij besnike, e cila ka kalitur e kalit

vazhdimisht njerëz të fortë si çeliku dhe të zgjuar.

Ju dëgjuat këtu për arritjet e mëdha që janë shënuar te ne në zhvillimin e arsimit, të kulturës e të shkencës, në krahasim me analfabetizmin dërrmues të dikurshëm që arrinte shifrën rreth 85 për qind të popullsisë së vendit tonë. Kjo është një kthesë kolosale që në një kohë kaq të shkurtër, s'e ka arritur asnjë vend tjetër që quhet i përparuar.

Bisedonim me shokët dhe thoshim se edhe ata 70 apo 75 vjeçarë që janë sot te ne dhe që mund të kenë mbetur pa mbaruar një shkollë fillore, tashmë kanë një jetë të tërë që punojnë e luftojnë, ata kanë fituar një eksperiencë të madhe e të pasur. Politika dhe puna e Partisë kanë bërë që ata, të aftësohen edhe më shumë dhe me përvojën që kanë mund të përcaktojnë edhe se ku duhet të shkojë një kanal ujitës nëpër Alpe. E tillë është forca e Partisë dhe e marksizëm-leninizmit, e tillë është forca mobilizuese e organizatës sonë të Frontit Demokratik, së cilës duhet t'i japim kurdoherë një gjallëri, një vitalitet të madh.

Më falni se ndoshta u zgjata pak. Dhe tani, duke u mbështetur në çka kemi biseduar me një grup shoqësh, kemi menduar të propozojmë para jush personat që duhet t'i diskutojmë dhe t'i miratojmë bashkërisht për në Kryesinë e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë propozohet të jetë si më poshtë:

Më kanë vënë të parin mua, Enver Hoxha.

Si nënkryetarë: Myslim Peza, Ramiz Alia, Pilo Peristeri, Gjela Biba. Është nga Mirdita kjo shoqe.

Sekretar Xhorxhi Robo, i cili ka qenë edhe më përpara po në këtë funksion.

*Pasi u lexuan dhe u miratuan emrat e anëtarëve të kryesisë, të përbërë prej 25 vetash, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Tani le të shkojmë në sallën e kongresit për të komunikuar kryesinë. Detyra të mëdha na presin të gjithë në terren.

**Punë të mbarë shokë!**

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë mbledhje, që gjenden në AQP*

## **DO TË PUNOJMË PA U LODHUR PËR NDËRTIMIN E SOCIALIZMIT**

*Fjala e mbylljes në Kongresin e 5-të  
të Frontit Demokratik të Shqipërisë*

**6 qershor 1979**

Të dashur shokë e shoqe,

Kongresi ynë po u jep fund punimeve të tij. Këshilli i ri i Përgjithshëm që ju zgjodhët njëzëri, në mbledhjen e parë që bëri, zgjodhi, gjithashtu, njëzëri e me duartrokitje kryesinë e tij.

*Pasi lexon emrat e shokëve të zgjedhur, shoku Enver Hoxha vazhdon:*

Më lejoni, shokë e shoqe, që, në emër të Këshillit të Përgjithshëm dhe të kryesisë së re të Frontit, t'ju falënderoj për besimin që treguat ndaj nesh dhe për nderin e madh që na bëtë duke na zgjedhur në udhëheqje të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

Ne e sigurojmë kongresin, gjithë organizatën e Frontit, mbarë popullin, si dhe Partinë tonë, se do të vëmë të gjitha forcat e nuk do të kursejmë asgjë për

të plotësuar me sukses detyrën e lartë e me përgjegjësi që na ngarkuat. Ju premtojmë se do të punojmë pa u lodhur për të mobilizuar popullin në luftë për ndërtime e socializmit, për realizimin e tejkalimin e planeve të shtetit, të tanishme dhe të ardhshme, për forcimin e mbrojtjes, të lirisë e të pavarësisë së atdheut.

Punimet e kongresit tonë, diskutimet që u bënë këtu, ishin një dëshmi e gjallë e ndërgjegjes së lartë politike që karakterizon popullin tonë, e ndjenjës së përgjegjësisë e të preokupimit të njerëzve tanë për zgjidhjen me sukses të detyrave që shtrojnë zhvillimi i vendit dhe situatat në të cilat jetojmë. Kongresi i 5-të i Frontit Demokratik të Shqipërisë ishte një manifestim i shkëlqyer i unitetit të çeliktë të popullit rreth Partisë, i vendosmërisë së punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve, të të gjithë punonjësve tanë, për ta çuar kurdoherë përpara çështjen e socializmit në Shqipëri.

Problemet që u diskutuan, mendimet që u shfaqën dhe propozimet që u bënë këtu kanë rëndësi shumë të madhe, sepse ato do të ndihmojnë për të ngritur në një nivel më të lartë punën e organizatës së Frontit, entuziazmin e popullit, mobilizimin e gjithanshëm të tij në punë. Detyra jonë, shokë delegatë, është që frymën revolucionare e luftarake, optimizmin dhe besimin që u shprehën këtu t'i çojmë në masat e gjera të popullit, në të katër anët e atdheut, në qytete, në fshatra, në lagje e në çdo familje, që të gjitha punët, në bujqësi, në industri, në arsim, në kulturë, në mbrojtje,

të marrin një hov të ri, që detyrat kudo të plotësohen e të tejkalohen.

Realizimi me sukses i detyrave, plotësimi i planit të gjashtë pesëvjeçar në të gjithë sektorët e në të gjithë treguesit, do të jetë një bazë e fuqishme për planin e ardhshëm pesëvjeçar, të cilin jemi duke e hartuar. Ky plan, që do të jetë më i madh se planet e deritanishme, do t'i hapë vendit tonë perspektiva të reja akoma më madhështore. Do të zhvillohet më tej industria jonë e rëndë dhe e lehtë, do të zgjerohet më tej baza energjetike, do të rriten nxjerrja dhe përpunimi i naftës e i mineraleve, do të shtohet prodhimi i pajisjeve dhe i makinerive në vend, do të ecë edhe më përpara bujqësia, një hov të ri do të marrin arsimit e kultura, do të ngrihet më tej mirëqenia e popullit. Plani i ri pesëvjeçar do të jetë i pari plan që do të mbështetet krejtësisht në burimet tona të brendshme dhe do të realizohet vetëm me forcat tona, pa asnjë kredi e ndihmë ekonomike nga jashtë.

Populli shqiptar, ashtu si deri më sot, edhe me këtë plan pesëvjeçar do t'i tregojë gjithë botës, kujtdo qoftë, se si mund të ndërtohet e të zhvillohet një vend me forcat e veta kur udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi dhe ka në krye një parti besnike ndaj çështjes së socializmit, interesave të atdheut e të popullit.

Realiteti i mrekullueshëm që ekziston në vendin tonë dhe perspektivat e ndritura që na hapen i detyrohen popullit tonë heroik e patriot, klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste, inteligjencies popullore, grave dhe rinisë. Ato i detyrohen vijës së drejtë të

Partisë, që na ka udhëhequr dhe na udhëheq me urtësi nga fitorja në fitore.

Ky realitet e këto perspektiva janë një provë e gjallë e vitalitetit të marksizëm-leninizmit, e fuqisë së pashtershme dhe e epërsisë së padiskutueshme të rendit të vërtetë socialist ndaj sistemit kapitalist, borgjez e revizionist.

Socializmi lufton për emancipimin dhe zhvillimin e gjithanshëm të njerëzve. Kapitalizmi përhap e zhvillon korrupsionin, krimin, drogat, degjenerimin, kurse socializmi të gjitha këto plagë të shoqërisë borgjeze i lufton dhe nuk i lejon të përhapen. Socializmi lufton për lumturinë e njerëzve, kurse kapitalizmi shkakton mjerimin e tyre. Socializmi është kundër luftërave grabitqare, kurse imperializmi i ka në gjak ato. Socializmi krijon unitetin e popullit e dashurinë midis njerëzve, kurse kapitalizmi krijon përçarjen, mëritë e grindjet midis masave. Këto përçarje e këto grindje i shfrytëzon borgjezia kapitaliste e revizioniste për të shtypur klasën punëtore dhe masat e tjera punonjëse...

Populli shqiptar ka qenë dhe do të jetë kurdoherë solidar dhe përkrah popujve, ai ka mbështetur e do të mbështetë fuqimisht luftërat revolucionare e çlirimtare të tyre.

Shqipëria dhe populli i saj duan të rrojnë në miqësi me të gjitha shtetet që nuk ndjekin qëllime armiqësore ndaj vendit tonë. Ne jemi për bashkekzistencën paqësore leniniste, por jo bashkekzistencë ala hrushoviane e revizioniste. Ne nuk duam as shtypje, as grabitje, as ekspansion: ne duam të rrojmë në liri, në pa-

varësi dhe në miqësi të ndershme me të tjerët. Ata që kërkojnë të shkelin parimet e barazisë, të mosdërhyrjes në punët e brendshme dhe të respektimit të sovranitetit, populli shqiptar i urren dhe i lufton.

**Ne nuk i biem në qafë kurrkujt, por kërkojmë që dhe të tjerët t'i mbajnë larg duart nga Shqipëria socialiste. Në rast se ndokush e prek atdheun tonë, ai do ta pësojë keq. Kohët kanë ndryshuar. Shqipëria e sotme ka zot, populli shqiptar është bashkuar si një grusht i fortë e i çeliktë. Ai di të mbrohet politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht.**

Shokë e shoqe,

Tani ju do të ktheheni në rrethet tuaja, në krye të punëve e të detyrave të mëdha që ju presin. Kongresi i Frontit na armatosi, na frymëzoi e na dha fuqi të reja që të luftojmë më me vendosmëri e më me entuziazëm për Shqipërinë tonë të dashur, për popullin tonë të mrekullueshëm, për socializmin e komunizmin.

**Rroftë populli heroik shqiptar!**

**Rroftë uniteti i popullit në Frontin Demokratik!**

**Rroftë Partia jonë e lavdishme!**

**Lavdi marksizëm-leninizmit!**

Më parë se të mbyllim kongresin, në emër të të gjithë juve, shoqe dhe shokë delegatë, më lejoni që t'i dërgojmë falënderimet më të përzemërta dhe mirënjoh-

jen tonë popullit heroik të Vlorës, që na priti me kaq bujari, dashuri e patriotizëm të madh dhe na krijoi kushte shumë të mira për t'i përfunduar me sukses punimet e këtij kongresi.

Kongresin e 5-të të Frontit Demokratik të Shqipërisë e deklaroj të mbyllur.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 135(9623), 7 qershor 1979*

*Botohet me ndonjë shkurtim sipas origjinalit, që gjendet në AQP*

**REALIZIMI RITMIK I PLANIT KËRKON PËRSOSJEN  
E ORGANIZIMIT, TË DREJTIMIT, DISIPLINË  
DHE KONTROLL TË VAZHDUESHËM**

*Nga biseda në takim in ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**11 qershor 1979**

**SHOKU ENVER HOXHA:** Është e rëndësishme dhe na intereson shumë të njohim e të dimë çështjet kryesore të realizimit të planit dhe jo të na bëhen raportime në formë të përgjithshme. Ndodh që nuk realizohet plani në katër muaj dhe pastaj realizohet në muajin e pestë, këtu kemi të bëjmë me një sëmundje të vazhdueshme. Në këtë mes, pra, ka anomali dhe kuptohet se këto bien në kurriz të dikujt. Pastaj, si mbulohen deficitet? Sigurisht punohet me sforcime. Po a na lejohet neve kjo? Do të kujdesemi një çikë më shumë për klasën punëtore apo jo? Ne synojmë që punëtorët të punojnë në ditë vetëm 8 orë jo më tepër. Që kjo të realizohet, duhet të organizohen mirë punët. Mua më duket se elementi njeri sikur neglizhohet dhe kjo ndodh për arsye burokratike. Ja, nuk ka si shpje-

gohet ndryshe fakti që ka deficite në realizimin e planeve mujore dhe këto plotësohen në muajin e fundit të pesëmujorit! Pse? Sepse punëtorit i thuhet të dalë në punë jashtë orarit dhe ai del. Po ai punon edhe për patriotizëm, por edhe për të marrë më tepër para. Badihava nuk punon punëtori mbi 8 orëshin. Kjo atij mund t'i duket e mirë, por të mos harrojmë se punëtori i minierës po të vazhdojë kështu, atëherë nuk mund të punojë dot 30 vjet, por 20 vjet, se pastaj do të preket patjetër nga sëmundje profesionale.

Prandaj të bëhen përpjekje të nevojshme nga të gjithë, nga dikasteret, nga rrethet dhe nga vetë ndërmarrjet e interesuara që ky problem të gjejë rrugë, sepse, ç'është e vërteta, ka vite të tëra që flitet për këtë. Realizimi i rregullt i planit duhet të fillojë që në ditët e para të muajit apo të vitit. Po pse nuk fillon? Sepse nuk ka organizim të mirë, nuk ka disiplinë, nuk ka kontroll, nuk respektohen kontratat, nuk çohen materialet në kohë në vendin e duhur etj. Ka, për shembull, ankesa për transportin, por kur kthehesha pardje nga Vlora pashë që krahas trenit, në ato dy orë, qarkulluan edhe qindra makina, kamionë, gaze dhe zëtorë, pa llogaritur veturat!

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Këto ishin ato që patë ju në lëvizje, shoku Enver. Ju nuk keni parë, fjala vjen, se sa të tjera kishin ndalur në Lushnjë dhe në qytete e stacione të tjera, gjatë udhëtimit që ju po bënit për në Tiranë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duhet parë edhe çështja e pengesave dhe e vështirësive që krijohen ngaqë

nuk vijnë në kohë disa mallra të importit. Por nuk duhen pranuar justifikime për mosrealizimin e detyrave të planit në ato ndërmarrje që e kanë pasur lëndën e parë.

Kur flasim e i kritikojmë ndërmarrjet për mosrealizimet e planeve, të tërë na thonë që kemi të drejtë, po asnjëherë nuk shihet në themel ky problem, domethënë nuk gjenden shkaqet e vërteta të këtyre mosrealizimeve. Unë e kuptoj dhe jam i ndërgjegjshëm se në punën për realizimin e planit ka vështirësi, por duhet të ketë përmirësim të dukshëm në punën për realizimin e detyrave të planit.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Ajo që thatë ju, shoku Enver, qysh në fillim, se plani për katër muaj nuk realizohet, kurse muajin e pestë jo vetëm realizohet, po mbulohen edhe deficitet e muajve të kaluar, është një fenomen që duhet e mund të mënjanohet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ashtu është. E si nuk mund të mënjanohet aritmia! Puna duhet organizuar në mënyrë të tillë që, nëse plani nuk realizohet muajin e parë në një masë, për shembull, prej 10 për qind, atëherë muajin e dytë duhen bërë përpjekje që të realizohet edhe një pjesë e kësaj përqindjeje, po kështu të veprohet me radhë muajin e tretë, të katërt e të pestë. Kjo është një punë normale, ky është një realizim normal i planit që nuk lejon të krijohen deficite të tjera.

*SHOKU PROKOP MURRA:* Studiuam gjendjen e mallrave të prodhuesit. Rezulton se atje ka gjendje mallrash, si artikuj ushqimorë e të veshmbathjes, me një vlerë prej disa milionë lekësh.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po pse të krijohet kjo rezervë te prodhuesit? Mua më shqetëson fakti që këpucët, për shembull, nuk i ndahen rrjetit të tregtisë. Ky është një artikull që nuk duhet të qëndrojë te prodhuesi. Po kështu edhe stofrat, kurse marmelatat, verërat dhe të gjithë artikujt e tjerë ushqimorë, kur janë të paketuar e të vulosur mirë, mund të mbahen edhe një vit ose dy vjet, se nuk prishen, nëse tregu nuk ka nevojë. Në qoftë se mallrat e prodhuara nuk shkojnë te përdoruesi, atëherë çfarë organizimi është ky? Ka plan prodhimi, por ka edhe plan shpërndarjeje; ka mallra në depo, po nuk paska transport; ka kontrata, po nuk zbatohen ato! Si drejtohen e si administrohen këto ndërmarrje kështu? Si të rrinë mallrat në depo?! Si mund të na zërë gjumi kur e kemi të përcaktuar, për shembull, që këpucët nga fabrika duhen çuar drejt e në treg, kurse ato mbeten në fabrikë? Përse veprohet kështu? Duhet ditur shkaku. E ka apo s'e ka fabrika kuotën e transportit? Me siguri që duhet ta ketë, sepse një transport i tillë është planifikuar, pasi ne kemi planifikim të centralizuar etj.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Tregtia, gjithashtu, duhet t'ia marrë mallrat prodhuesit, mbasi ka kontratë me të.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, medoemos. Fabrika e Këpucëve e Tiranës, për shembull, ka kontratë me ndërmarrjet e tregtisë së kryeqytetit, të cilat duhet t'ia marrin mallrat e prodhuara në bazë të kontratës, sigurisht kur ato u përgjigjen kushteve të kontratave dhe standardeve të aprovuara. Këtu del edhe çështja

e drejtuesve të këtyre ndërmarrjeve: çfarë bëjnë ata në këto raste?

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Edhe një gjë tjetër, shoku Enver, që lidhet tamam me këtë. Në qoftë se malli i prodhuar qëndron te prodhuesi, dhe këtu është fjala për disa milionë lekë që nuk janë tërhequr, atëherë si financohen këto ndërmarrje?! Me çfarë i paguajnë ato punëtorët?! Nuk ua japin rrogat?

*SHOKU ENVER HOXHA:* I paguajnë rrogat, si nuk i paguajnë, kurse prodhimi qëndron në depo dhe ndërmarrja prodhuese pret t'ia marrin. Ndërmarrjet konsumatore pretendojnë se nuk kanë kuotë transporti etj., etj. Pikërisht, kjo punë jo e mirë dëmton ekonominë e vendit tonë. U lodhëm duke folur për liberalizëm e megjithëkëtë organet tona shtetërore neglizhojnë në gjërat më elementare. Kjo çështje është fare e thjeshtë: i more tullat, do të japësh paratë. Dihet se Qeveria i ka caktuar fondet, ka vendosur edhe rregullat, ka ligje për marrëdhëniet midis ndërmarrjeve apo dikastereve, gjithashtu ka caktuar rrugët e zgjidhjes së tyre. Të zbatohen ligjet e rregullat, të paguajë paratë ministria së cilës i është bërë puna ose i është dorëzuar materiali dhe ajo tjetra të paraqesë faturat në kohë.

Më thonë se Ministria e Ndërtimit nuk interesohehet për Institutin e Projektimeve, sikur arkitektura nuk bën pjesë në këtë ministri. Bile më ka ardhur një zë, se do të mbyllet dega e arkitekturës, në universitetet, mbasi nuk paska nevojë për arkitektë e se në tunelin e Qafëthanës arkitektët punojnë si teknikë të me-

sëm. Kjo tregon se në Ministrinë e Ndërtimit ka një kuptim shumë të ngushtë për rolin e arkitektëve në ndërtim e gjetkë.

Kjo ministri ose ndërmarrjet e saj si zbatuese, kanë kontrata me investitorë, kanë caktuar afate, prandaj, kur përfundojnë punimet në një objekt të dhënë, dorëzon punën të shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe kërkon paratë. Në qoftë se duhet të krijohet një komision kolaudimi, le të krijohet. Në qoftë se duhet të ngrihet një komision qeveritar, le të ngrihet, në mënyrë që veprat e ndërtuara të merren me kohë në dorëzim. Por ama palët kontraktuese të jenë në rregull me ligjet, urdhëresat dhe rregulloret e shtetit që ekzistojnë prej vitësh. Ju, shoku Prokop duhet t'i ndiqni që të rregullohen të gjitha këto çështje.

Të them të drejtën, unë i kam shtruar shumë herë këto gjëra. Por më duket se ministrinë nuk po ecin siç kërkohet. Prandaj duhet ngritur Partia në këmbë që të mos lejohen shkelje e gabime. Kur organizatat-bazë në ndërmarrje nuk kërkojnë që secili të kryejë detyrat e tij, me qëllim që punimet të përfundojnë mirë e në kohë, që të bëhen preventivat e situacionet, kur ato nuk kontrollojnë dhe nuk mobilizojnë kuadrot e punonjësit, do të thotë se ato i ka zënë gjumi. Po u vazhdua kështu, atëherë organizatat e Partisë në këto ndërmarrje apo dikastere do të flenë mbi gabimet.

Për dobësitë dhe mangësitë në punë përgjegjësi kanë të gjithë, që nga ministri deri tek axhustatori atje në ndërmarrje. Përgjegjësi ka edhe administrata, ku duken më shumë praktikat burokratike. Të mos e

shikojmë çështjen në përgjithësi, se kështu ajo duket sikur është mirë, por duhet që edhe në detaje çdo gjë të bëhet mirë. Po i pamë gjërat vetëm në përgjithësi, na mbulon vetëkënaqësia dhe vijmë përsëri te globali, domethënë te mallrat e mbetura stok në depo. A mos është kjo një gjë e vogël? Jo, përkundrazi, është gjë shumë e madhe. Po a ka shkaqe për këto? Me siguri që ka. Ka edhe përgjegjës për gjithë këto mallra të prodhuara që qëndrojnë nëpër depo; përgjegjësi kanë administrata, komunistët, organizatat-bazë të Partisë. Prandaj me të drejtë shtrohet pyetja: si udhëheqin e si drejtojnë në ndërmarrje organizatat-bazë? A e bëjnë ato si duhet punën me njerëzit? Nëse jo, atëherë t'i vëmë në lëvizje. Kush do ta bëjë këtë? Vetë komunistët, anëtarët më të ndërgjegjshëm të tyre, që përbëjnë shumicën. Në qoftë se në organizatë ka edhe nga ata që janë të plogësht, qofshin këta ministra, zëvendësministra, drejtorë apo punëtorë të thjeshtë, atëherë këta njerëz duhen shkundur fort në interes të punës së përgjithshme.

Kështu e kuptoj unë rolin udhëheqës të organizatës-bazë të Partisë, forcën e saj organizuese, vigjilencën e saj revolucionare. Nuk është puna që në mbledhje të duartrokitet, të bërtitet «urra» e të flitet me parulla e slogane. Këto gjëra nuk janë të mira, mua nuk më kënaqin. Po këto i ndeshim. Megjithatë kjo nuk do të thotë se njerëzit nuk punojnë. Jo, ata punojnë, mallrat që janë në depo, pikërisht këta njerëz, punëtorët, i kanë prodhuar, por puna është përse dhe kush i mban ato mallra në depo? Administrata është përgjegjëse për

këtë, prandaj është ajo që duhet shkundur në radhë të parë. Këto punë t'i vëmë mirë në rrugë. Ne këtu, në Komitetin Qendror, më duket mua, duhet të kërkojmë më shumë nga shokët drejtues të Partisë në dikastere, në rrethe e në bazë.

Mendoj që të analizohet mirë gjendja e këtyre mallrave në depo, të evidentohet me saktësi sasia dhe lloji i tyre, për ç'arsye qëndrojnë aty, sa janë skarco, sa nuk i do populli ose përse është mbushur tregu me to etj. Pasi të na jepet një pasqyrë e gjendjes mbi këtë bazë të na thuhet nëse duhet të vazhdojë ose jo prodhimi i këtyre apo i atyre mallrave dhe me çfarë ritmi. Duhet apo s'duhet, për shembull, të vazhdojë prodhimi i disa lloje këpucësh që ato të mos na rrinë nëpër depo ku thahen e deformohen? Kjo ka rëndësi, sepse lëkura sillet nga jashtë. Përmenda këpucët po mund të ketë edhe ndonjë prodhim tjetër, sepse, duke e parë kështu globalisht, vlefata është shumë e madhe, por mund të jenë aq shumë artikuj, saqë të marrë veç e veç, nuk zënë ndonjë peshë të madhe e stoqet mund të likuidohen. Gjithashtu, është e nevojshme të mbahen parasysht edhe vështirësitë që kemi për qarkullimin e mallrave, si transporti, rrjeti i tregtisë, puna burokratike e administratës etj., për shkak të të cilave, për shembull, disa mijë palë këpucë qëndrojnë në depo. Por me një masë organizative më të mirë, ato mund të hidhen në treg dhe ky mall i mbajtur në depo të likuidohet.

Gjithë puna këtu është te kujdesi që duhet treguar që në planifikim, duke mbajtur parasysht edhe rezervat që rrjedhin nga viti i kaluar, të cilat duhen llogaritur

që të shiten këtë vit, edhe shtesën e prodhimit që duhet bërë në përputhje me kërkesat në rritje të konsumatorëve etj. Pra, plani duhet të bëhet në mënyrë të atillë që edhe rritje prodhimi të ketë, por jo të mbetet ai në depo, se lënda e parë vjen nga jashtë dhe këtë duhet ta përdorim me nikoqirllëk, me efektivitet. Pra e kam fjalën të bëhet plan i studiuar e real dhe jo një planifikim standard, shabllon.

Lidhur me këto çështje, për të cilat po flasim, ç'punë bën Komisioni i Planit të Shtetit në drejtim të kontrollit të zbatimit të kontratave e të problemeve të tjera, apo ka larë duart ai tok me seksionet e planit në rrethe e degët e planit nëpër ndërmarrje?! Është një divizion i tërë ekonomistësh në tërë këtë sistem, çfarë bëjnë të gjithë këta? Për këto mangësi faj ka administrata, dikasteret dhe Komisioni i Planit të Shtetit. Konkretisht Komisioni i Planit të Shtetit që e ka bërë këtë plan, a e ndjek realizimin e tij? Fjalën e kam që ta ndjekë jo vetëm nëpërmjet shifrave, u realizua pesë apo shtatë për qind, dy apo tre për qind, por ta ndjekë në dinamikë nëpërmjet «ushtrisë» së ekonomistëve të vet që i ka të shpërndarë në të katër anët e vendit, duke analizuar realizimin e planit në zëra, në kohë, në cilësi, në sasi. Ose seksionet e planit të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve a e informojnë Komisionin e Planit të Shtetit nëse kjo apo ajo ndërmarrje e ka realizuar planin, kurse kjo tjetra jo, për shkak se nuk i jepet kuota e transportit, një tjetre nuk i jepet kuota e lëndës së parë, sepse ndodh

që edhe pse ajo ka ardhur nga importi, qëndron në depo dhe nuk u vete ndërmarrjeve në kohë.

Këto gjëra, natyrisht, u takojnë ministrive, por edhe Komisioni i Planit të Shtetit është i interesuar dhe duhet t'i shikojë në dinamikë për të ditur si realizohet plani, mirë apo keq nga çdo dikaster apo rreth. Komisioni i Planit të Shtetit ka lidhje me Ministrinë e Financave ashtu si edhe seksionet apo degët e planit në rrethe e ndërmarrje kanë lidhje me seksionet dhe degët e financave përkatëse dhe pyesin nëse i morën apo jo paratë për një punë të kryer ose për një mall të shitur, e kështu me radhë. Gjithashtu Komisioni i Planit të Shtetit duhet të dijë nëse Uzina e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh, për shembull, është vënë në shfrytëzim apo puna ka mbetur për një gjilpërë, sepse nga kjo uzinë varet prodhimi i solarit, i benzinës, i bitumit etj.

Të dhënat që i vijnë për realizimin e zërave të planit, Komisionit të Planit të Shtetit duhet t'i shërbejnë për shumë gjëra, për të parë nëse plani realizohet apo jo, sa për qind nuk realizohet, ku nuk realizohet dhe përse. Në bazë të konkluzioneve që nxirren, ndërhyhet te ministri përkatës për të kërkuar të dhëna ose për të thënë, për shembull, përse lëshohen fondet kot, ose për t'u kërkuar llogari seksioneve të planit në rrethe, përse nuk e mbajnë në korent për realizimin ose mosrealizimin e detyrave të planit.

Për këto gjëra duhet konkluduar dhe duhet vepruar. Kjo lidhet me metodën e punës. Këto janë çështje partie, por janë edhe çështje të organeve shte-

tërora, të cilat duhet të luajnë një rol shumë të madh, sepse vërehet që nuk kontrollohet si duhet zbatimi i kontratave dhe kjo nën pretekstin se nuk paska kohë. Si pa të keq tjetri thotë se nuk i paraqet dot situacionet dhe preventivin për të marrë paratë për punën e kryer! Si mund të ecet kështu? Po Ministria e Financave ç'bën në këtë mes? Sepse këtu fjala, në fund të fundit, është për paratë e shtetit, të popullit. Këto gjëra duhet t'i shohë mirë Qeveria. Në mbledhjet e saj, më duket mua, si në çdo mbledhje tjetër, sigurisht vepohet në bazë të rendit të ditës, por, kur është nevoja, mund edhe të ngrihet e të trajtohet edhe ndonjë problem i veçantë jashtë rendit të ditës, ashtu si ndodh edhe në Byronë Politike, ku nuk mund të ndalohet të bëhen propozime e sugjerime. Mendoj që në disa mbledhje të Qeverisë ndonjëherë mund të marrin pjesë edhe nga sekretarët e Komitetit Qendror të Partisë.

Është e domosdoshme që Qeveria të ndërtojë një metodë pune të shëndoshë, të ketë kërkesë llogarive dhe kompetencë, të nxjerrë mirë përgjegjësitë për mangësitë e të metat në punën e dikastereve, të cilat duhet t'i ndjekin nga afër e në dinamikë punët dhe problemet kryesore të organizimit, të drejtimit, të koordinimit të veprimeve në rreth e në bazë, të zbatimit të ligjeve dhe të urdhëresave nga administratat, çështjet e planit e të kontrollit të realizimit të tij. Për krahas ministrive, këto të ndiqen me kujdes edhe nga Komisioni i Planit të Shtetit, i cili, siç e kam theksuar shumë herë, është një institucion qendror që merret

me ndjekjen e realizimit të planit të shtetit. Ai duhet të jetë informatori më i saktë i shokëve zëvendëskryeministra, të cilët, në bazë të të dhënave të tij, të thërrisin në raport ministrat, t'u kërkojnë atyre llogari për realizimet ose mosrealizimet e detyrave të planit apo të vendimeve të Qeverisë dhe të japin urdhra për marrje masash etj.

Çështja tjetër që më preokupon, është ajo e moszbatimit të rregullave dhe të ligjeve të aprovuara. Ndodh që edhe kur detyrat janë kryer, kur plani është plotësuar, fitimi dhe akumulimi shtetëror nuk realizohen. Kjo është e palejueshme. Një gjë e tillë krijon inflacion.

Gjëra të tilla nuk duhet të ndodhin. Të marr një shembull. Thuhet se iks repart apo ndërmarrje punon me një ndërresë, një tjetër punon me një ndërresë e gjysmë, ndërsa duhej të punonte me tri ndërresa. Mirëpo shohim se këto reparte apo ndërmarrje, edhe pse punojnë me një ndërresë ose me një ndërresë e gjysmë prodhojnë mallra që na mbeten në depo. Atëherë përse ngulet këmbë që ato të punojnë me tri ndërresa? Të punosh me tri ndërresa do të thotë të prodhosh më shumë. Por kur rrit prodhimin duhet pasur parasysh që edhe konsumi të jetë në një sasi më të madhe, domethënë populli të marrë më shumë. Për këtë kërkohet patjetër të dish nevojat e popullit, të cilat janë aq të ndryshme e aq të mëdha në asortime të ndryshme e në sasi. Në qoftë se nuk ka këpucë në treg dhe njerëzit duan këpucë, duhet punuar jo me një ndërresë e gjysmë po me tri, derisa të plotësohen nevojat,

që populli të kënaqet dhe shteti të sigurojë akumulimin. Ose kur është fjala për pjesë këmbimi, si kollo-dokët e traktorëve që kërkohen, le të punohet me tri ndërresa. Por për ato makineri e linja, të cilat prodhojnë mallra që shkojnë në depo e nuk gjejnë blerës, s'ka përse të kërkohet që të punojnë me tri ndërresa.

Komisioni i Planit të Shtetit, me seksionet në rrethe dhe me njerëzit që varen prej tij nuk duhet ta përjashtojë veten nga këto punë. Nuk përjashtohen nga përgjegjësia këtu organizatat-bazë të Partisë të atyre ministrive ose ndërmarrjeve që punojnë si «kali i arabasë» dhe nuk realizojnë cilësinë dhe zërat e tjerë të planit. Fundi i fundit, në rreth, seksioni i planit ka dy-tre-katër veta. Po në ndërmarrje ka shumë komunistë, të cilëve çdo ditë Partia u flet që cilësia dhe sasia e prodhimit kanë rëndësi të madhe, megjithatë këto nuk realizohen. Një gjendje e tillë s'duhet lejuar. Ja, ta zëmë se erdhi një shok i planit dhe kërkoi llogari për të metat. Kjo nuk e zgjidh problemin, sepse drejtuesit e ndërmarrjes do të ngrihen dhe do t'i thonë atij «ke të drejtë», por sapo të ikë ai, puna do të vazhdojë si më parë.

Shoku Hekuran, nuk na dhe akoma ndonjë sihariq andej nga nafta!

Mendoj se për problemet që ju dalin, duhet të konkludoni duke pasur parasysh jo vetëm anën teknike të sondave e mjeteve që kemi, por edhe anën ekonomike, sepse ka edhe ndonjë rast që ana teknike të përdoret për të fshehur mungesën e vigjilencës dhe dobësimin e kontrollit. Kështu, specialistët qahen

se shllami është i rëndë dhe pompa nuk ka fuqinë e duhur për ta pompuar, se tubacioni është një çikë më i hollë, më i ngushtë e duhej të ishte një çikë më i gjerë dhe fuqia motorike një çikë më e madhe etj., etj., pra për çdo gjë thonë: «fajin e ka pompa»! Si rezultat, Qeveria jep urdhër që kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë» t'i prodhojë pompat. Ja, në këtë rast, mendoj unë, nevojitet të punohet me tri ndërresa që të bëhet remonti i motorëve për puset e naftës dhe jo të kërkohen të rinj.

Çdo gjë në sektorin e naftës të bëhet ashtu siç kemi thënë, në bazë të studimeve, ndryshe bëhen parashikime joreale. Për këtë duhet të bisedoni me Institutin e Naftës e të Gazit, i cili ka për detyrë të studiojë ku gjendet nafta dhe për këtë ka në dispozicion dhe nën drejtimin e vet sondat e shpimeve gjeologjike. Drejtoria gjeologjike, që ka edhe sizmikën, duhet të vejë në institut dhe t'i shtrojë atje problemet që i dalin. Pastaj instituti diskuton, përcakton se ku mund të ketë naftë dhe i paraqet çështjet përpara ministrisë, duke i vërtetuar e argumentuar kësaj që aty të bëhen kaq apo aq shpime. Pastaj vendos Drejtoria e Naftës dhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave.

Duhet ta shohim çështjen e një organizimi më të mirë të drejtimit në sektorin e naftës. Nuk mjafton vetëm të forcohet Drejtoria e Naftës në Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave, e cila në fakt është forcuar, por njerëzve t'u mësohen metoda më të mira të punës, të organizimit e të drejtimit. Pra, çështja

është të organizohet mirë puna, të përcaktohen përgjegjësitë.

Në qoftë se organizohet mirë Drejtoria e Naf-tës, duke i dhënë asaj kuadro, siç iu dhanë, në qoftë se ajo i zbërthen mirë detyrat, bashkëvepron mirë në mënyrë të organizuar me drejtoritë e tjera, mua më duket se nuk është nevoja të krijojmë një ministri të veçantë për naftën, siç është shprehur ndonjë mendim. Instituti, siç the ti, Hekuran, nuk është në lartësinë e kërkuar. Ai nuk i njihte kompetencat e veta dhe nuk dinte t'i përdorte ato. Të mos shkojmë më tutje por pa të dhënat e domosdoshme nuk mund të vendoset që të hapen kuturu 40 puse në Hekal e 30 puse më tej etj. Kush i dha këto kompetenca kaq të mëdha? Të vendosë një njeri?! Jo... , nuk bëhen kështu këto punë. Kjo është megalomani.

*SHOKU HEKURAN ISAI:* Sizmika jonë, shoku Enver, i ka mundësitë për të përballuar planin. Këtë e kam thënë edhe herë tjetër. Qeveria është për atë që të bëhet një studim. Kryeministri, bile tha se ishte gati t'i hiqte mjete edhe ushtrisë, vetëm sizmika t'i plotësojë detyrat e saj.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë hovarda qenka Mehmeti! Ushtrisë nuk i duhet hequr asgjë, por të merren masa që këto aparatura sizmike që kemi të përdoren me efikasitet në vendet ku duhet. Për planifikimin e sizmikës duhet të përgjigjen më mirë punonjësit e institutit. Mundet që atje tani të mos ketë punë armiqësore, por prapë ka mbeturina të vjetra,

ka koncepte si: «Të qëndrojmë këtu që është zonë e njohur (dhe këtu vazhdohet me 50 për qind të mjeteve të sizmikës), pasi përgjegjësi do të kemi më pak, se diçka dimë dhe pjesën tjetër të mjeteve i shpërndajmë». Këtu qëndron puna. Por koncepte të tilla duhen flakur dhe duhen parë se, me qëllim apo pa qëllim, ato janë shumë të dëmshme për ekonominë e shtetit, prandaj duhen luftuar.

Po organizata e bashkimeve profesionale atje, si armë e Partisë në gjirin e punëtorëve të naftës, a bën punë lidhur me çështjen e kontrollit, të vigjilencës, të disiplinës, të nevojës për të mësuar, për të zbatuar rregullat etj.? A ndihet për këto gjëra zëri i bashkimeve profesionale, apo merret vetëm me shpërndarjen e flamurëve dhe me agjitacionin figurativ? Këto mirë, por kërkohet punë konkrete. Te sonda punojnë së bashku 40 veta, të gjithë janë anëtarë të organizatës së bashkimeve profesionale dhe disa janë edhe komunistë. Të tërë ata duhet të jenë vigjilentë. Kur diçka nuk ecën mirë, të mblidhen të diskutojnë e të gjejnë rrugët se si t'i kapërcejnë vështirësitë, si ta çojnë punën përpara, si t'i realizojnë e t'i tejkalojnë detyrat e planit, të mendojnë për edukimin dhe ngritjen e tyre tekniko-profesionale. Po kush do t'i mësojë? Njëri nga shokët e brigadës ose nëpërmjet organizatës së bashkimeve profesionale t'u kërkojë ndihmë shokëve kompetentë të një brigade tjetër, e kështu me radhë. Këto gjëra të mos ia lënë të gjitha sekretarit të

organizatës-bazë të Partisë, por të ngrihen të gjithë në këmbë, të forcohet disiplina, kontrolli, vigjilenca për të realizuar detyrat e planit.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseta e  
incizuar, që gjendet në AQP*

## **KUSH BËN GABIME DUHET TË KRITIKOHET SIPAS PËRGJEGJËSISË QË KA**

**Shënime**

**14 qershor 1979**

Në takimin me shokët sekretarë të Komitetit Qendror ngrita disa probleme, të cilat kërkojnë një perfeksionim të mëtejshëm dhe një thellim akoma më të madh për përmirësimin e punës. E kisha fjalën për mbledhjet e Byrosë Politike dhe për problemet që merren këtu në studim, për mënyrën e paraqitjes së tyre, për natyrën e thellimit të tyre, si dhe për vendimet përkatëse.

Mendimi im është se materialet që na paraqiten në Byronë Politike nuk janë në nivelin e duhur dhe faji për këtë është yni, i aparatit të Komitetit Qendror, në radhë të parë, dhe i të gjithë anëtarëve të Byrosë Politike. Anëtarët e Byrosë duhet të kenë parasysh se ky forum, pas Komitetit Qendror, është nga më të rëndësishmit, prandaj në të duhet të merren në shqyrtim probleme të rëndësishme dhe jo të vogla. Mbledhja e Byrosë Politike duhet të ketë një rëndësi të jashtëzakonshme.

Për ngritjen e këtij problemi më dha shkak materiali i mbledhjes së muajit qershor, i cili ishte krejt i panevojshëm të sillej në Byronë Politike. Në të bëhej fjalë për një propozim që kam bërë unë për forcimin e Drejtorisë së Naftës dhe të Drejtorisë së Mekanikës në Ministrinë e Industrisë e të Minierave, gjë që e mori Qeveria në studim, ajo bile mori edhe masa, caktoi njerëzit dhe kjo çështje mbaroi. Atëherë, ç'nevojë ka që kjo çështje të vinte edhe një herë në Byronë Politike? Mua më duket se nuk ka nevojë, pse nuk ka këtu asnjë çështje parimore që duhet të studiojmë, se ne nuk bëjmë asnjë ndryshim qoftë strukturor, qoftë parimor.

Ose i paraqesim Byrosë Politike një plan pune që e hartojnë sekretarët e Komitetit Qendror dhe sektorët që ata mbulojnë në bashkëpunim me Qeverinë, për një sërë problemesh. Sigurisht, këto probleme kanë rëndësinë e tyre, por është e domosdoshme që para se të vijnë në Byronë Politike, ato duhet të studiohen thellë, të merren në analizë në kohën e duhur nga organizmat përkatës dhe po në kohën e duhur të paraqiten e të merren vendime. Këto pastaj do të zërthehen nga ato organe që duhet t'i zbatojnë. Kurse ne do të ushtrojmë kontrollin e zbatimit të orientimeve e të direktivave të Partisë. Në praktikë ndodh që edhe pse dalin probleme të tjera shumë më të rëndësishme sesa ato që janë parashikuar në planet e punës, nuk merret mundimi që këto plane të korrighohen dhe të vihen në to ato probleme që nxjerr jeta, zhvillimi, të cilat nuk i kemi parashikuar, por që dalin përpara dhe që kanë

rëndësi. Kështu, pra, ndiqet një rutinë që nga fillimi e deri në fund të vitit, duke na paraqitur në mbledhjet e Byrosë Politike ato probleme që janë caktuar në plan, megjithëse ndonjë prej tyre edhe mund të zëvendësohet, sepse ose ka marrë zgjidhje, ose për të është diskutuar edhe herë tjetër në Byronë Politike dhe mbetet vetëm të ndiqet zbatimi në praktikë.

Të veprojmë kështu, pra, vetëm pse kemi bërë planin e punës, më duket mua, nuk i japim rëndësinë e duhur Byrosë Politike, këtij forumi të lartë që drejton në emër të Komitetit Qendror gjithë punën e Partisë, të pushtetit, të organizatave të masave etj. Prandaj i këshillova shokët t'i shikojmë me kujdes këto plane, në mënyrë që nga shtatori dhe deri në fund të vitit të parashikohen për Byronë Politike probleme nga më të rëndësishmet dhe pastaj planet e ardhshme të jenë më substanciale dhe të manovrojmë me problemet më të rëndësishme që na dalin përpara, që kërkojnë zgjidhje dhe të lëmë mënjanë ose t'i marrë Sekretariatit ato probleme, që mendohet se nuk janë për Byronë.

Çështja tjetër që u shtrova shokëve është forcimi i disiplinës dhe i kontrollit në punë. Ky është një problem i vazhdueshëm. Kontrolli i punës duhet të bëhet nga ana e Partisë, nga ana shtetërore dhe nga ana e organizatave të masave. Të punohet që të forcohet ndërgjegjja e njerëzve për këtë disiplinë dhe për luftën që duhet zhvilluar kundër lëshimeve dhe shfaqjeve liberale. Për këtë të bëhet kujdes që të zbatohen mësimet dhe orientimet e Partisë, të cilat nuk kanë mu-

nguar, bile janë të shumta, por njëkohësisht të insistohet në zbatimin e ligjeve e të vendimeve të organeve shtetërore, të cilat në shumë raste nuk zbatohen ose shkelen.

Një problem tjetër që më preokupon është edhe tendenca që e vë re nëpër artikuj të shtypit, në fjali-me e diskutime, qoftë në instancat e ulëta, qoftë në ato të lartat, për të përdorur vend e pa vend shprehjen «nën udhëheqjen e organizatës-bazë u bënë këto e ato gjëra» dhe pas kësaj fillojnë kritikën, të cilat, në shumë raste, mbeten në hava dhe prej këtej mund të nxirret fare lehtë konkluzioni se fajin që nuk realizohen detyrat ose që bëhen këto gabime e paskan organizatat e Partisë. Në të vërtetë përgjegjësi për këto kanë disa kuadro e komunistë konkretë, kanë organet e pushtetit dhe organizatat e masave, kanë, gjithashtu, përgjegjësi edhe dikasteret dhe aparatet e drejtoritë e tyre. Prandaj të kihet kujdes që jo për çdo gjë të thuhet «e ka fajin Partia» ose të përdoret vend e pa vend shprehja «Kjo u arrit nën udhëheqjen e organizatës-bazë të Partisë».

Unë nuk jam që të mos kritikohet një direktivë e gabuar e Partisë. Kur ka vend për të bërë kritikë, kjo duhet të bëhet me doemos, por kush bën gabime, duhet të kritikohet me «adresën» e duhur, pa hezitim dhe jo t'i libet për çdo gjë barra Partisë. Po ndalem në këtë, sepse kam ndeshur në shumë shembuj të tillë, por tani së fundi u nisa sidomos nga një artikull që ka botuar gazeta «Luftëtari» me titull «7 pyetje, 7 të rinj», në të cilin, për të gjitha të këqijat fajet i hidheshin orga-

nizatës-bazë, se «kjo e paskësh fajin që s'u bë kjo apo ajo», «organizata-bazë e paskësh fajin që nuk përgjigjet për këto» etj. Në këtë artikull thuhet se komunistët nuk erdhën të gjithë në mbledhje, se një komunist nuk punon mirë, kurse për komandën, për komandantët dhe për shtabet atje nuk flitej fare. Aty nuk bëhej fjalë as për lejet pa arsye që japin komandantët, as për shturjen që shkaktojnë këta duke lejuar moszbatimin e rregulloreve ushtarake etj., etj. Dhe gjoja të gjitha këto bëheshin kur zhvilloheshin mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhjet në Parti.

Dhënia llogari në Parti nuk do të thotë që medomos duhet t'i marrë përsipër të gjitha fajet e dobësitë vetëm organizata-bazë e Partisë, po t'i marrin përsipër ata komunistë që përgjigjen drejtpërdrejt për këto gjëra. t'i marrin ata kuadro që nuk i kryejnë si duhet detyrat që u janë ngarkuar. Nuk përjashtohet që organizata-bazë të ketë gabime e dobësi dhe nuk është e thënë që ajo nuk duhet kritikuar. Por tok me të duhen kritikuar edhe instancat e tjera shtetërore, ushtarake, ekonomike dhe sidomos personat konkretë. Duhet të dalë si duhet dhe mirë çështja që vija e direktivat e Partisë janë të drejta, por në praktikë ato nuk zbatohen si duhet, bëhen shkelje e shtrembërime, zbatohen me mangësi etj., prandaj duhet vënë në dukje se nga kush konkretisht bëhen këto gabime, këto shkelje e shtrembërime.

Pse shkruhet në këtë mënyrë si në këtë artikull që përmenda? Kjo bëhet me qëllim për të thënë se Partia udhëheq. Mirëpo kjo është si thika me dy presa.

Në qoftë se bëhen gabime të shumta, pa vënë gishtin si duhet se kush i bën këto gabime, atëherë njerëzit mund të nxjerrin konkluzionin që «Partia nuk udhëheq e nuk drejton mirë, se ajo nuk lëshon direktiva të drejta». Mirëpo njerëzit mund të mendojnë kështu në rast se lejojmë që ky problem me rëndësi të trajtohet siç thashë më lart.

Më në fund në takim u shtrova shokëve çështjen që Partia, nëpërmjet organit të saj «Zëri i popullit» jep vijën, shtron atje probleme, kritikon forume, kritikon njerëz, kritikon mosrealizimin e detyrave. Unë e ndjek me kujdes këtë gazetë të përditshme të Partisë dhe për këto mendime solla shumë shembuj nga kjo gazetë. Dhe shtrova pyetjen: «A lexohen këta artikuj nga përgjegjësit, nga kuadrot dhe drejtuesit në qendër e në bazë dhe a merren masa menjëherë që këto që lexojnë në gazetë t'i realizojnë ose të organizojnë punën më mirë që të evitohen gabimet e lëshimet që janë lejuar në frontin e në qendrën e punës ku janë ata?».

Kam përshtypjen se në rrethe e në bazë pritet që të flasin vetëm udhëheqësit, pastaj të merren masa. Por nuk është e drejtë të mendohet e të veprohet kështu. Mjafton që edhe një njeri i thjeshtë nga populli të shkruajë një artikull kritik për mosrealizimin, për shembull, të ndërtimit të hidrocentraleve të vogla dhe përnjëherë dikasteri, rrethi apo ndërmarrja që i mbulon këto dhe që i ka lënë pas dore, duhet të vihet në lëvizje. Në qoftë se turbinat kanë ardhur të mos i lërë më të qëndrojnë nëpër depo, por të fillojë ndërtimin e të përfundojë sa më parë hidrocentralet, t'i vërë në lëvi-

zje. Duhet punuar me ritëm të lartë për këtë, aq më tepër tani, në një kohë kur gjithë bota është në një krizë të rëndë energjetike. Kurse te ne ka njerëz e sektorë që punojnë me indiferentizëm, me javashllëk të madh, në vend që të luftojnë për krijimin e sa më shumë mundësive energjetike dhe për shfrytëzimin maksimal të tyre. Për këto te ne edhe studime janë bërë, edhe fonde janë dhënë, edhe makineritë kanë ardhur, por në mjaft raste punët për ngritjen e këtyre hidrocentraleve të vogla janë lënë pas dore, sepse «po bëhen veprat e mëdha». Pra, për arsye të veprave të mëdha, lëmë pa i realizuar «të voglat» dhe harrojmë sa dëm të madh i sjellim ekonomisë. Kështu ngjet në praktikë edhe për shumë probleme të tjera.

Unë kam mendimin se Partisë duhet t'ia vëmë në dukje këtë çështje. Gazeta të mos lexohet si një roman, por të konsiderohet e të studiohet me vëmendje se aty gjenden direktivat e Partisë të cilat janë të bazuara, pse asgjë nuk shkruhet në gazetë pa u kontrolluar më parë faktet dhe vërtetësia e brendisë së kritikës që bëhet në të. Pastaj për zbatimin e tyre duhet të punojnë të tërë, masat, organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **PUNA E PARTISË TË MOS JETË PUNË RUTINË DHE AS BUOKRATIKE**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**18 qershor 1979**

*Në këtë takim u bisedua për konkluzionet e ekipit të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë që ishte për ndihmë e kontroll në rrethin e Dibrës. Në fjalën e tij shoku Enver Hoxha tha:*

Mosrealizimi i planeve influencohet edhe nga faktorë të tillë që u përmendën këtu, si mospjesëmarrja në punë, moskryerja mirë e saj etj., por për secilin nga këta faktorë të shikohen arsyet politike, ideologjike, shëndetësore etj. Për sa i përket problemit të mospjesëmarrjes në punë të kooperativistëve le të shohim arsyet që u përmendën.

Marrim çështjen e oborrit kooperativist. Komiteti ekzekutiv, seksioni i bujqësisë i këtij komiteti dhe komiteti i Partisë a i kanë vënë ndonjëherë detyrë degës së bankës bujqësore që të nxjerrë të dhëna konkrete financiare për të ardhurat që marrin kooperati-

vistët e këtij rrethi nga oborret e tyre dhe për mesataren për ditë-punë të çdo kooperative? Këto të dhëna duhet të jenë nga kooperativa të ndryshme, si nga pikëpamja e zonave, ashtu edhe e pasurive të tyre. Për shembull, sa është mesatarja e të ardhurave të kooperativës së Kalasë së Dodës, sa është ajo e Reç-Dardhës dhe sa është ajo e një kooperative fushore. Këto të dhëna duhet të dalin nga studime të tilla, të cilat të shërbejnë për të nxjerrë disa konkluzione, si, për shembull, a e nxitin kooperativistin të ardhurat që ai fiton jashtë ditëve të punës në kooperativë për të menduar që ai mund t'i lejojë vetes që, në vend që të punojë 200 ditë në vit në kooperativë, punon vetëm 100 kurse 100 apo 150 ditët e tjera, që i mbeten, i përdor për të punuar në oborrin e tij? Ose, nëse të ardhurat që nxjerr nga oborri a i kompensojnë të ardhurat që do të merrte nga kooperativa, apo mund të marrë më tepër? Kjo është e para.

E dyta, është çështja e pjesëtarëve të familjes që punojnë në ndërmarrjet e ndryshme shtetërore. Duhet bërë llogari konkrete se sa veta punojnë në këto ndërmarrje, ka nga një për çdo familje apo jo? Pastaj duhet llogaritur sa janë të ardhurat që i shkojnë familjes nga pjesëtari që ka me punë në një ndërmarrje shtetërore, a është ky një faktor frenues dhe sa influencon tek anëtarët e tjerë të familjes në gjendje pune që të mos dalin në punë.

E treta, është çështja e shpërdorimit dhe e vjedhjeve të produkteve bujqësore. A bëhet ndonjë llogaritje e përafërt se cilat janë humbjet që shkaktohen,

për shembull, te fasulet etj.? Fjalën e kam për një llogaritje një çikë të thellë, që të nxjerrë humbjet që vijnë nga mosrealizimi i rendimenteve të planifikuarra, pastaj edhe nga vjedhjet. Në qoftë se del që merren më pak sesa është planifikuar, atëherë a zbulohet se nga shkaktohet diferenca?

Të tilla studime e analiza, mendoj unë, t'i kërkojnë degës së bankës bujqësore për të ditur gjendjen e vërtetë ekonomiko-financiare të kooperativave të rrethit. Për të metat që kanë të bëjnë me shkeljen dhe moszbatimin e direktivave të Partisë e të shtetit, si dhe të rregullave ekonomiko-financiare e agroteknike në fuqi, përfaqësuesit e Komisionit të Planit të Shtetit, të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Bujqësisë, që ishin anëtarë të grupit e që morën pjesë në mbledhjen e organizuar me shefat e financës, të planit etj. të rrethit, duhet të bënin autokritikë në atë mbledhje për përgjegjësitë që u takojnë vetë atyre dhe jo t'ua hidhnin përsipër shefave të planit e të financës të komitetit ekzekutiv dhe atyre të kooperativave bujqësore.

Në atë mbledhje, para të gjithë pjesëmarrësve, përfaqësuesit e dikastereve që ndodheshin aty duhet të jepnin llogari se sa herë kanë qenë në rrethin e Dibrës dhe a kanë ndihmuar me punën e tyre dhe nëse jo, përse nuk kanë vajtur, çfarë i ka penguar etj. Po ashtu edhe shokët e Komisionit të Planit të Shtetit që nuk kanë vajtur në rreth dhe nuk kanë parë si punon seksioni i planit. Kështu duhet të bënte edhe zëvendësministri i Financave, të fliste nëse i kanë dhënë ndonjë ndihmë degës së bankës bujqësore, nëse e kanë

kontrolluar këtë degë për të parë se si i kryen kjo detyrat që i janë ngarkuar, apo vetëm i kanë dhënë para që ajo t'ua jepte kooperativave bujqësore në mënyrë që, ashtu siç kërkon Ministria e Bujqësisë, kooperativave të rrethit të Dibrës t'u shtyhej afati i shlyerjes së kredive deri në vitin 1995? Dhe, po të mos ishte ngritur kjo çështje në Byronë Politike, ajo do të qe pranuar. Po kështu edhe për shokët e Ministrisë së Bujqësisë.

I them këto gjëra, shokë, sepse në kontrollet që bëhen në bazë, në rrethe, punonjësit e qendrës duhet të shohin e të gjykojnë edhe për efektivitetin e punës së organeve qendrore e jo vetëm për ato të bazës. Nuk është e drejtë që kur i futemi punës së rretheve për çdo gjë faji u hidhet shokëve të bazës, ndërsa ata që janë këtu në qendër të dalin të larë, në rregull sikur janë «koka të pagabueshme». Të mos shkohet me mendimin sikur njerëzit e bazës janë ata që nuk i respektojnë direktivat, që nuk i zbatojnë urdhëresat. Ato duhet t'i zbatojnë të gjithë, organet shtetërore, organizatat e masave dhe organizmat e tjerë, kudo që janë, pra jo vetëm ato të bazës, por edhe ato në qendër, të cilat duhet të përgjigjen deri në një.

Për sa u përket vendimeve që dërgohen nga Qeveria, zbrëthimi i tyre duhet të bëhet atje, në bazë, në ndërmarrje e kooperativa, dhe jo sikurse bëhet në rrethin e Dibrës, që ato zbrëthehen nëpër zyrat e seksioneve të komitetit ekzekutiv, pastaj mbeten nëpër sirtarët e tyre. Kjo nuk është e rregullt, bile është një praktikë pune e gabuar dhe e dëmshme.

Ç'përshtypje dhe ç'konstatime patët për punën e Partisë në këtë rreth, për jetën e brendshme të organizatave-bazë. Pra, cila është tematika e problemeve që i ka preokupuar ato, mbi ç'baza e për çfarë nevojash kanë lindur tematika dhe problemet që janë rrahur në ato mbledhje; cila është forma dhe metoda e punës së tyre, të çfarë niveli janë mbledhjet e Partisë, janë ato të qeta e të fjetura, apo jeta në to është e gjallë, revolucionare? Këtë dua të mësoj më parë. Pra, si është fryma e përgjithshme e jetës së brendshme të organizatave-bazë në këtë rreth, se, kur merr pjesë një udhëheqës në një mbledhje të ndonjë organizate-bazë, kuptohet që komunistët çelen, zënë e flasin. e hapin gojën, bile kritikojnë deri edhe sekretarin e parë të rrethit.

Këtu u thanë mjaft gjëra interesante për rrethin e Dibrës. Mirëpo Partisë i intereson të nxjerrë konkluzion përse kuadrot me arsim të lartë e sidomos specialistët e bujqësisë nuk japin rendimentin e duhur? Ky është një problem kyç e i madh që Partia duhet medoemos ta marrë në dorë, ta studiojë dhe t'i vërë përpara përgjegjësisë të gjithë këta shokë, kolektivisht dhe çështjen e tyre ta shtrojë pastaj edhe në masë. Me këtë problem mendoj se komiteti i Partisë në rreth duhet të merret në mënyrë të veçantë, duke thirrur shefat e seksioneve të komitetit ekzekutiv, kryetarin e komitetit, por edhe specialistët dhe t'u kërkohet llogari përse nuk interesohen si duhet për problemet përkatëse që u janë ngarkuar nga Partia e nga populli.

Të kuptohemi, në këto takime komiteti i Partisë

do të vlerësojë ata që punojnë mirë, por do të vërë në dukje se ka të dhëna që mjaft kuadro e specialistë punojnë dobët, se, për shembull, shoku i seksionit të shëndetësisë rri tërë ditën në zyrat e seksionit dhe nuk njih gjendjen e punëve të sektorit të tij në bazë etj., etj. Prandaj u kërkon edhe mendime, edhe llogari dhe i porosit që kështu të bëjnë edhe në organizatën-bazë. Në mbledhje të tilla, shokët e komitetit të Partisë duhet t'i ftojnë të pranishmit që të diskutojnë hapur e pa druajtje, të flasin hapur për atë që mendojnë e që konstatojnë, pa pasur frikë se mos i pushon njeri nga puna. Po kështu mund të bëhen takime të tilla me specialistët dhe kuadrot e bujqësisë, të shëndetësisë etj.. të cilët duhet të jenë me iniciativë, se nuk i ndalon njeri të thonë fjalën e tyre për kuadrot, për të mirën e punës.

Pra, a organizohen mbledhje të tilla? Mendoj se kështu, në forma të larmishme, duhet ta ndërtojmë punën e Partisë. Ajo nuk mund të jetë një punë rutinë, një punë burokratike, as një punë që merret me probleme anësore. Partia është në udhëheqje kudo dhe ajo udhëheq nëpërmjet vijës e direktivave të saj, nëpërmjet organizatave të Partisë dhe komunistëve, kudo që janë. Edhe vendimi për një problem të caktuar, që dërgohet nga Qeveria, përmban në vetvete direktivën e Partisë. Për zbatimin e saj, sigurisht, do të kërkohej llogari nga komiteti ekzekutiv, por Partia duhet të kontrollojë nëse bëhet apo jo dhe si bëhet ky zbërthim, ose përse këto zbërthime të direktivës qëndrojnë nëpër sirtarët e zyrave të seksioneve dhe si zbatohet ajo.

Jeta e organizatës-bazë ka kuptim kur merret me probleme konkrete, për të parë shkojnë apo nuk shkojnë ato mirë dhe Partia duhet të përpiqet që punët të shkojnë gjithnjë më mirë. Në qoftë se në mbledhjet e organizatave-bazë merren në analizë probleme anësore, kësaj i thonë punë sa për të kaluar radhën, sa për të thënë se po bëhen mbledhje. Në organizatat-bazë të Partisë kudo të luftohet më shumë që një gjë e tillë të mos ndodhë.

Këtu e kam çështjen, pra në ç'nivel është fryma e përgjithshme e organizatave-bazë të Partisë, ndihen apo nuk ndihen ato në rreth? Në qoftë se është ashtu siç thatë, që në organizatën-bazë nuk ka debat, ka familjaritet etj., atëherë, për ta luftuar të keqen, më parë duhet të zbulohen rrënjët e saj, të gjenden faktorët që e zhvillojnë atë fjala vjen frymën e komprometit. Për këtë komiteti i Partisë vepron me organizatën-bazë, duke e orientuar atë të përcaktojë në radhë të parë natyrën e komprometit, nga u vjen ai, a është ky rrjedhim i vjedhjeve, i lidhjeve familjare apo i krushqive, apo ai ka origjinë politiko-ideologjike ose baza armiqësore. Në këtë drejtim Komiteti i Partisë duhet ta orientojë e ta ndihmojë organizatën-bazë që të kërkojë e të zbulojë faktorët që janë bërë shkas për lindjen e këtij fenomeni shqetësues dhe pastaj të konkludojë se ç'duhet bërë që t'i luftojë e t'i eliminojë ato.

Që ta luftosh e ta zhdukësh fenomenin shqetësues që të ka dalë përpara, duhet të zbulosh e të eliminosh, në radhë të parë, njëri pas tjetrit e njëkohësisht të

tërë faktorët që kanë influencuar në lindjen e tij. Nga ana tjetër, për të pasur suksese në këtë luftë është e nevojshme të gjenden metodat dhe format më të përshtatshme e më efikase të punës. Një nga praktikat që duhen ndjekur në këtë çështje është që të mbahen afër ata që nuk janë të infektuar. Për problemin që ka lindur e që është shqetësues atyre u duhet folur vazhdimisht, në formë të organizuar e në formë individuale, në mënyrë që, kur të bëhet mbledhja, ku do të venë edhe drejtuesit e komitetit të Partisë dhe ta ngrenë në çështjen, ata do të ngrihen, do të flasin hapur, ashtu siç na mëson Partia, duke e vënë gishtin mbi plagën, duke thënë konkretisht se aty në organizatën-bazë, midis iksit e ipsilonit ka shfaqje të familjaritetit dhe shpjegon shkaku dhe rrënjët e këtij familjariteti të sëmurë.

Kështu, në një mbledhje të tillë shihet kush mbështet një ide ose një qëndrim të gabuar dhe kush jo. Atëherë lind edhe çështja tjetër: përse, për shembull, këta tre a katër persona e mbështetin atë ide, atë qëndrim ose veprim të gabuar, kurse këta të tjerët nuk e mbështetin? Sepse ka familjaritet. Por duhet parë nëse ky familjaritet i sëmurë i këtyre shokëve ka tendencë politike. Ky fenomen është i rrezikshëm për Partinë dhe për bartësit e tij, sepse mund t'i çojë ata edhe në gabime politike.

Në këtë mënyrë analizohen të gjitha problemet e tjera.

Edhe për luftën kundër besimeve fetare, që duken në disa zona të rrethit të Dibrës, kërkohet të forcohet

puna e Partisë, me një propagandë më të dendur politike, të përgjithshme e individuale, veç e veç, me komunistët, me të rinjtë, me gratë. Mundet që një nuse apo e re fshatare ta heqë hajmalinë, por një tjetër mund edhe të mos e heqë. Për këtë propaganda e Partisë duhet të bëjë sqarimin e nevojshëm se çfarë përfaqëson nuska, se ajo kurrë nuk u ka sjellë njerëzve dobi, se nuk ka asnjë lloj fuqie shëruese etj., etj. Në këtë çështje, ashtu si në çdo gjë tjetër, për të pasur sukses, duhet t'i shohim gjërat realisht e në mënyrë të gjithanshme, se lufta kundër fesë është delikate, ajo nuk është një punë e lehtë. Në Labëri, për shembull, nusja dhe e reja nuk mbajnë nuska, por në Dibër po. Prandaj edhe puna e Partisë t'u përshtatet psikologjisë së njerëzve, traditave, zakoneve e kushteve konkrete të krahinës ose të rrethit. Në rastin konkret mendoj se, përveç punës politike, duhen marrë edhe disa masa të tjera praktike, siç është furnizimi më i mirë i rrjetit të tregtisë në fshat, ta zëmë, me rruaza e disa artikuj të tjerë të bukur që mund t'i mbajnë nuset e të rejat.

Që të zbatohet mirë vija e Partisë, kërkohet të vihen më shumë në lëvizje e përpara përgjegjësisë edhe organizatat e masave, organet e pushtetit etj., të cilat, duhet t'i kryejnë mirë detyrat që u janë ngarkuar.

Kur në ndonjë kolektiv, lagje a fshat, Partia shikon një situatë të përgjumur, kur njerëzit nuk e hapin gojën, sepse ka familjaritet, ka komprometime, kur nuk ka mobilizim frontal në punë dhe fenomene të tjera shqetësuese, atëherë ajo dendëson punën politike me njerëzit. Pranë tyre duhet të shkojnë më shumë edhe

sekretarët e komitetit të Partisë, të cilët t'u flasin për situatën, për problemet, për vëshirësitë etj. Nga ana tjetër, organizatat e Partisë i analizojnë këto fenomene, diskutojnë rreth tyre. Në këto analiza do të dalin në pah ata komunistë e kuadro që qëndrojnë në pozita të shëndosha dhe ata që kanë mbeturina në kokë e që bëhen pengesë për mbarëvajtjen e punëve. Këtyre të fundit Partia u kërkon llogari, por edhe i ndihmon të vihen në pozita luftarake. Punë të veçantë bën ajo me drejtuesit, me drejtorin apo kryetarin e kooperativës, sqaron problemin se ata nuk mund të bëjnë si të duan e të pushojnë punonjësit nga puna, t'u presin ditët e punës ose rrogën etj., etj. Partia vë në dukje se për këto gjëra ka ligje dhe nuk veprohet sipas qejfit të njërit apo të tjetrit. Prandaj ajo kërkon që të bëhet puna, të realizohen detyrat dhe planet, të trajtohen siç duhet punonjësit dhe të zhduken situatat e çrregullta.

Shokët e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste përgatitin tema dhe bëjnë studime për mentalitetin e fshatarëve dhe për psikologjinë e tyre etj., etj. Por Partia në rreth duhet ta njohë më në imtësi psikologjinë e fshatarëve të rrethit, të zonave, e deri të fshatit e të individëve. Partia duhet t'i njohë këto, që të dijë të ndërtojë punën e saj me njerëzit.

Për sa i përket problemit të lëvizjes së shpeshtë vend e pa vend të kuadrit drejtues të kooperativave bujqësore, që doli këtu, aparati i Komitetit Qendror duhet ta ndjekë dhe të mos jetë një organ automat që interesohet vetëm për kuadrot e nomenklaturës së

vet. Ai është i interesuar për zbatimin si duhet të politikës së Partisë për kuadrin në të gjithë vendin, sepse kuadri është monopol i Partisë. Nëse në rrethin e Dibrës shfaqet fenomeni i lëvizjes së shpeshtë e pa vend të kuadrove teknike apo të kuadrove drejtues të kooperativave, atëherë komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të këtij rrethi, që ka në kompetencë lëvizjen e këtyre kuadrove, duhet të thërritet në Komitetin Qendror dhe të vihet përpara përgjegjësisë për lëvizjet e parregullta, të pastudiuara që ka bërë e po bën. Natyrisht, ai mund të sjellë plot arsye për këto lëvizje, por, me këtë rast, edhe instruktori i aparatit të Komitetit Qendror që ndjek dhe e njeh mirë Dibrën, edhe ai i bujqësisë, duhet të thonë fjalën e tyre dhe kështu të tërhiqet vëmendja që lëvizje të tilla pa kriter, si domos të kryetarëve të kooperativave të mos bëhen.

Të kemi parasysh se shkon apo nuk shkon mirë një kooperativë, kjo nuk varet vetëm e thjesht nga kryetari, të cilit ia kanë varur gjithçka në qafë, por nga puna e vetë kooperativistëve, nga puna e organizatës-bazë të Partisë, se kjo drejton dhe udhëheq punën e të gjithëve. Atje ku ka organizatë partie që punon mirë, edhe kryetari drejton më mirë. Prandaj nuk ka pse të ndërrohen kaq shpesh kryetarët e kooperativave, siç ngjet në rrethin e Dibrës. Është organizata e Partisë ajo që e bën të mirë kryesinë e kooperativës, në qoftë se e ushqen me detyrat dhe me direktivat e Partisë dhe këto nuk i mban nëpër sirtarë.

Në qoftë se kuptohet kështu vija e Partisë, atëherë çdo gjë do të shkojë mirë edhe në Dibër. Duhet ta kenë

të qartë të gjithë se nuk mund të luhet me fatin e kooperativave për qejfin e njërit apo të tjetrit. Kompetencat që u janë dhënë për punën e kuadrit, në këtë rreth nuk i kanë zbatuar drejt, prandaj kanë pasur edhe shkelje që e kanë burimin të familjariteti i sëmurë. Ndryshe nuk ka si shpjegohet fakti që një shok e kanë sjellë në një kooperativë pranë shtëpisë së vet, për të qenë rehat, ndërsa një tjetër e kanë hequr që andej pa ndonjë arsye. Këto veprime të padrejta nuk shkojnë, ato nuk i pranon dhe nuk i lejon Partia.

Ky është një problem i madh partie dhe, në qoftë se është kështu, atëherë komiteti i Partisë i rrethit duhet ta marrë mirë në dorë atë, të sqarojë direktivat e Partisë për punën me kuadrin, të shpjegojë përse nuk duhet t'i lëvizin kuadrot vend e pa vend pa arsye, pa asnjë të drejtë, se kjo e dëmton ekonominë. Direktivat e Partisë thonë t'i ndihmojmë kuadrot drejtues, t'i ngremë dhe t'i mbajmë afër. Ndihma do të jetë efektive vetëm atëherë kur të gjitha forcat e afta të dalin në punë dhe të jenë të disiplinuar, kur i çojnë fëmijët në çerdhe e në kopshte, kur plehu të konsiderohet si një element me rëndësi për rritjen e rendimenteve bujqësore. Prandaj të mos harxhohet kot dhe të mos përdoret pa llogari, por të hidhet atje ku duhet e sa duhet etj., etj. Ndihma do të jetë efektive kur kuadrot nuk i lëvizin kohë e pa kohë nga një vend në një tjetër.

Që këto probleme të shkojnë mirë është e nevojshme që organizata e Partisë të jetë mirë në krye të punëve, të gjallërohet jeta dhe veprimtaria e saj. Gjallërimin e punës së Partisë ne e kuptojmë me kryerjen

e detyrave konkrete, me zbatimin deri në një të direktivave që ka dhënë e jep Partia, të cilat duhet të njihen e të zërthehen mirë që të zbatohen. Por për këtë nuk mjafton vetëm puna e aparateve të Partisë. Janë organet e zgjedhura të Partisë, janë organizatat e masave që duhet të kenë në qendër të vëmendjes punën me direktivën. Kur themi që Partia udhëheq, kjo do të thotë që ajo vë në lëvizje të gjitha organet e organizatat e masave e në të njëjtën kohë edhe kontrollon nëse punojnë ato si duhet për zbatimin e direktivës së dhënë apo jo. Kur shikon se nuk punohet mirë, atëherë Partia ndalet në atë sektor ku puna çalon dhe çështjen e shtron para masës, sepse është kjo që e gjykon më drejt edhe punën edhe drejtuesit. Partia nuk i shtron këto probleme para masës që ata që gabojnë t'i shkarkojë menjëherë, por që duke u vënë këta në menden e masës, të ndihmohen të njohin e të pranojnë gabimet e të metat, të bëjnë autokritikë të sinqertë e të ndershme dhe të angazhohen për të punuar mirë, ndryshe do të shkojë puna deri në masa disiplinore, partie e shtetërore, deri edhe në përgjegjësi ligjore.

Partia të punojë sidomos me gratë që bëjnë pak ditë-punë në kooperativë ngaqë kanë të ardhura nga pjesëtarët e familjes që punojnë në miniera dhe nga oborri kooperativist. Me punën e saj politike, organizative e bindëse, edhe këto shoqe, që nuk dalin në punë, Partia t'i bëjë të ndërgjegjshme për të shtuar ditët e punës në kooperativë, se kjo është në të mirën e tyre familjare, ashtu edhe në të mirën e gjithë kooperativës. Duke rritur ditët e punës, forcohet edhe koope-

rativa, por edhe familjes i shtohen të ardhurat, si dhe mundësitë që të rritë mirëqenien.

Partia në rreth, në fshat e në kooperativë duhet të bëjë një punë konkrete, se në çdo krahinë ka fenomene e veçori që ndryshojnë nga njëra-tjetra, kurse vëmë re që propaganda bëhet e përgjithshme, e një-llojtë. Përveç kësaj, psikologjia e njerëzve është diçka e veçantë dhe e ndryshme. Nuk duhet neglizhuar, as duhet lënë në harresë ana politiko-ideologjike dhe ana moralo-shoqërore e problemeve, duke menduar, siç ndodh ngandonjëherë, qoftë nga ana e Partisë, qoftë nga ajo e pushtetit, se me disa leksione ose udhëzime janë shpjeguar dhe sqaruar të gjitha format e ndryshme të mentaliteteve dhe të psikologjisë së njerëzve. Jo, kjo nuk arrihet me disa leksione të përgjithshme, por kërkohet medoemos një punë konkrete e diferencuar në përshtatje me kushtet e veçoritë konkrete të rrethit, të zonës, të fshatit. Pra të dish edhe se si duhet të luftosh edhe mbeturinat fetare, edhe vjedhjet në këtë apo në atë krahinë të veçantë. Pikërisht këtu është edhe vështirësia, pse shpesh anohet më tepër nga masat administrative ose tekniko-organizative, bihet pra në një punë rutinë, shikohet vetëm realizimi i planit dhe neglizhohet puna sqaruese ideopolitike.

Në këtë drejtim duhet të kuptojmë një gjë. Në qoftë se kooperativisti, për shembull, realizimin dhe tejkalimin e planit të drithërave nuk e sheh nga fakti se sa rëndësi ka për Shqipërinë sigurimi i bukës në vend, por në plan të parë vë familjen dhe interesat e tij, oborrin dhe rrogën që merr në ndërmarrje (dhe pjesë-

tarët e familjes nuk dalin në punë që të punojnë për kooperativën), atëherë do të thotë se Partia nuk ka punuar si duhet për edukimin politik dhe ideologjik të njerëzve, nuk e ka shtruar si duhet politikisht e ideologjikisht problemin e realizimit të planit të drithërave të bukës. Nuk mjaftojnë vetëm kërkesat agroteknike që toka të punohet thellë, që fara të jetë e pastër e hibride etj., etj. Të gjitha këto janë të domosdoshme për sigurimin e rendimenteve, por kryesorja janë njerëzit. Prandaj, po nuk u shoqëruan këto me një punë të dendur bindëse, politike e ideologjike me kooperativistët, për një frymë të lartë revolucionare, për sakrificë në punë, për idenë e pronës së përbashkët dhe për nevojën e mbrojtjes së saj, ato nuk do të kryhen dhe planet nuk do të realizohen dhe jo vetëm kaq, por me koncepte e qëndrime antisocialiste ndaj punës e pronës nuk mund të ndërtohet as ajo shoqëri që kërkojmë e për të cilën luftojmë ne.

Këto i them sepse kam parasysh që nuk punohet si duhet as nga Partia, as nga pushteti në rreth. Puna sqaruese ideopolitike nuk është detyrë vetëm e Partisë, por edhe e organeve të pushtetit, e organizatave të masave, e kuadrove dhe e specialistëve. Të gjithë këta duhet të jenë të ndërgjegjshëm politikisht dhe ideologjikisht për direktivën e Partisë, domethënë ta zbërthejnë e ta zbatojnë atë jo vetëm teknikisht e sa për të qenë brenda, por në kuptimin e saj të thellë politik dhe ideologjik.

Duhet parë edhe metoda e punës e instruktorëve të aparatit të Komitetit Qendror. A ecin ata akoma bre-

nda punës me «korniza» apo bëjnë përpjekje të veprone me iniciativë? Ata, kur shkojnë në bazë, duhet të marrin kontakt me komunistët, me masat, të organizojnë mbledhje, t'i dëgjojnë ata dhe pastaj të sjellin që andej mendime e vërejtje rreth një fenomeni që kanë konstatuar. Këtë ata do ta bëjnë mirë kur veprone me frymë masovike partie. Një nga cilësitë më të domosdoshme e më të mira të punëtorit e të udhëheqësit të Partisë, mendoj unë, është që t'u hapë sytë të tjerëve dhe ata të të konsiderojnë si shok, si vëlla. Këtë të gjithë shokët duhet ta kenë parasysh. Kështu, ata do ta respektojnë më shumë, do t'i hapin zemrën, t'i kërkojnë mendim se si të veprone. Po të jetë e drejtë ajo që sugjerojnë ata, u thuhet se keni të drejtë dhe ashtu të bëhet. Kjo është cilësia më e mirë që duhet të ketë një udhëheqës partie, vetëm kështu mund të kryhet puna.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

## **EDHE NJË HERË PËR KUPTIMIN DHE ZBATIMIN E DREJTË TË ORIENTIMEVE PËR PËRBËRJEN E FORUMEVE TË PARTISË**

*Nga biseda në takim in ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**20 qershor 1979**

Dëshiroj të shtroj një problem, për të cilin dua të di edhe mendimin tuaj. E kam çështjen lidhur me zgjedhjet në Partë dhe me përqindjet që caktohen për forumet udhëheqëse të Partisë për çdo kategori, sa punëtorë, sa kooperativistë, sa nëpunës.

Byroja Politike ka dhënë disa orientime lidhur me përbërjen e organeve drejtuese të Partisë. Por, siç jam informuar, këto orientime zbatohen duke u qëndruar strikt përqindjeve, gjë që mendoj se nuk është e drejtë. Kjo do të thotë se nuk bëhen ndryshime edhe në ndonjë rast kur ato i shërbejnë forcimit të Partisë.

Mua më duket se kështu si po veprohet, orientimi zbatohet në mënyrë shabllone. Nuk e di si interpretohet ai në bazë, por mendimi im, siç e theksova më sipër, është ky: e para, që në forumet drejtuese të Par-

tisë të ketë punëtorë; e dyta, të bëjmë kujdes që këta punëtorë të jenë shokë me të vërtetë të aftë e të ngritur dhe jo punëtorë për punëtorë. Në qoftë se këta nuk janë të aftë e nuk kanë nivel për të drejtuar, atëherë do të thotë se zgjedhja e tyre është bërë sa për të qenë në rregull me përqindjen, me një fjalë sa për numër. Për shembull, në qoftë se vëmë një shok punëtor në udhëheqje të një dikasteri, ai duhet të kalojë më parë në kurse dhe në shkolla kualifikimi dhe të mos na ndodhë, siç u tha këtu, që në një dikaster qenka zgjedhur anëtar i byrosë së organizatës së Partisë portieri!

Po kështu, kam marrë vesh se në një komitet partie kishin zgjedhur një punëtorë, që është valltare e grupit artistik të ndërmarrjes dhe, meqë ajo kërcen, e rekomanduan të zgjidhej në komitet që të përfaqësojë atje sektorin e artit! Po si mund të vejë ajo të bisedojë me artistët, që u janë zbardhur flokët në fushën e artit e të kulturës?! Nuk e kuptoj, pse veprohet kështu, kur kemi komunistë artistë të shquar, me autoritet e me kulturë të gjerë në këtë fushë?

Si është e mundur që në forumin udhëheqës të Partisë të një rajoni a rrethi, ku kemi institucione të rëndësishme të artit, të mos zgjidhen nga ata kuadro që i kuptojnë drejt problemet e artit, vetëm sepse mund të shtohet numri i nëpunësve në disa kolona statistike?! Unë mendoj që do të jetë akoma më mirë për punën në qoftë se në këto forume zgjidhet një letrar, një muzikant ose një aktor i teatrit me arsim të lartë.

Nuk paskemi ne anëtarë partie regjisorë, për shembull, që kanë vënë në skenë filma kaq të bukur, të

cilët mund të zgjidhen në komitet?! Vënia në skerrë e filmit është me rëndësi të jashtëzakonshme, ke të bësh me një aktivitet masiv për edukimin e popullit, atëherë ia vlen barra qiranë që në komitetin e Partisë të kemi një nga regjisorët më të mirë të kinematografisë sonë, një shok që është komunist i vjetër, që ka dhënë prova se punon pa u lodhur. Por, jo... atë nuk e zgjedhim, thonë, se është nëpunës, më mirë zgjedhim, për shembull, elektrikistin. Po pse? Se kështu jemi në rregull me përqindjen e caktuar. Elektriciisti ose kaldaisti le ta thonë fjalën e tyre në organizatën-bazë, ku të kritikojnë edhe regjisorin, fjala vjen, që është zgjedhur në komitet, kur shohin se ky nuk punon mirë, të kritikojnë edhe çdo të metë që konstatojnë, por të mos i ngarkojmë njerëzit, komunistët, me detyra që nuk mund t'i kryejnë.

Mekaniku, minatori, axhustatori e të tjerë e të tjerë janë ata që bëjnë bazën e Partisë, por në udhëheqje ne duhet që nga këta të sjellim ata që me të vërtetë të ndihmojnë në sektorin përkatës edhe për ngritjen e nivelit të të tjerëve. Bashkë me këta zgjidhen dhe specialistë me arsim të lartë, që janë bij të popullit punonjës e janë përgatitur kryesisht me djersën e klasës punëtore. Partia i mëson dhe i orienton specialistët që të ecin në rrugën e klasës e aq më tepër këtë e bën dhe e kërkon nga specialisti komunist. Në qoftë se ky nuk e përvetëson ideologjinë e klasës punëtore, në qoftë se ai nuk ecën në rrugën e saj, atëherë Partia e heq nga komiteti. Përse po bëhen këto zgjedhje? Për këtë qëllim bëhen, që puna të analizo-

het me frymë partishmërie dhe në udhëheqje të vijnë komunistët më të aftë. Kur ka punëtorë të tillë që t'i kuptojnë, për shembull, problemet e artit, atëherë do të jetë ca më mirë.

I solla këta dy shembuj sa për të ilustruar çështjen, por kjo duhet parë në përgjithësi. Ndonjëri mund të thotë: «Pse s'ka të drejtë të zgjidhet në byro, për shembull, një portier? Ai është komunist dhe gëzon të gjitha të drejtat si i tillë». Shumë e drejtë, por kjo nuk bëhet nga cilësitë e veçanta të këtij komunisti, por vetëm se ai figuron si punëtor. Jo, nuk duhen kuptuar e interpretuar kështu orientimet e Partisë. Byroja Politike s'ka dhënë orientime të tilla. Orientimi për zgjedhjet ka qenë edhe është që në forumet udhëheqëse të Partisë të mbizotërojë numri i punëtorëve, por është gabim që shokët t'u përmbahen strikt këtyre përqindjeve dhe të lënë jashtë forumeve nëpunës, domethënë të mos zgjedhin fare ose të zgjedhin fare pak komunistë nëpunës në këto forume. Kjo nuk është e drejtë, se edhe ata janë anëtarë të Partisë, janë revolucionarë dhe nuk zgjidhen në udhëheqje për të përfaqësuar një shtresë të caktuar, por që të japin gjithë diturinë dhe eksperiencën e tyre në frontet më të vështira e ku ta lypë nevoja për çështjen e Partisë. Në komitete nuk duhet të zgjidhen nëpunës burokratë e mendjemëdhenj. Jo, aty duhet të zgjidhen njerëz partie, luftarakë, politikisht dhe ideologjikisht të ngritur. Ky mund të jetë edhe nëpunës. Kështu, kryetari i Degës së Punëve të Brendshme duhet të jetë në byronë e komitetit të Partisë, sepse drejton një sektor të tërë

e shumë të rëndësishëm në rreth. Pse, kush do të flasë me kompetencë për gjendjen politike dhe veprimtarinë armiqësore në rreth në forumin drejtues të Partisë, shoferi? Po të nisemi nga ideja «të mos zgjedhim nëpunës», atëherë ç'duhet të bëjmë në ushtri ku i kemi të gjithë anëtarët e forumeve me gjendje shoqërore nëpunës?

Natyrisht, në ushtri dhe në Organet e Punëve të Brendshme, ku zakonisht nuk ka punëtorë, po vetëm nëpunës, problemi shikohet ndryshe. Por këtu e kam fjalën, që në dy nga sektorët më të rëndësishëm të diktaturës së proletariatit ne pranojmë nëpunës dhe këtë e bëjmë pikërisht pse janë komunistë revolucionarë, janë anëtarë të denjë të Partisë. Kurse në terren ne kemi edhe punëtorë, kemi edhe nëpunës. Orientimi është dhënë që në forumet udhëheqëse të Partisë të vihen më shumë punëtorë, por sot ka ardhur koha dhe janë krijuar kushtet që këta të jenë njerëz të arsimuar.

Ne themi që në universitet të dërgojmë djem e vajza të punëtorëve, të oficerëve, të nëpunësve, edhe të kooperativistëve, që janë politikisht më të mirë dhe që dalin më mirë në mësim nga shkollat e mesme. Mirëpo, kur këta mbarojnë studimet e larta, bëhen nëpunës, dikush bëhet inxhinier, njëri bëhet mësues, tjetri ekonomist e kështu me radhë. Nga kjo kategori kadrosh, megjithëse në përgjithësi janë të mirë, energjikë në punë, fare pak propozohen për t'u zgjedhur në komitetet e Partisë. Ky fenomen vërehet edhe kur kemi të bëjmë me një komitet rajoni që drejton një

armatë të tërë nëpunësish, inxhinierësh, artistësh, ekonomistësh e të tjerë.

Nga kjo praktikë ndodh që djali i një punëtori, që me shumë zor mbaron 8-vjeçaren dhe që bëhet punëtor, duke punuar, merr kategorinë e pestë, pastaj të gjashtën dhe menjëherë zgjidhet në komitetin e Partisë, se është punëtor, megjithëse nga pikëpamja ideologjike nuk është i ngritur. Kurse i biri i një punëtori tjetër ose i një nëpunësi, që ka mbaruar shkëlqyeshëm shkollën e lartë dhe është me nivel të ngritur, meqë futet në radhët e nëpunësve, nuk propozohet për t'u zgjedhur në komitetin e Partisë, se nëpunësit në komitet duhet të jenë në një përqindje të vogël. Duhet të kuptohet thellë dhe në mënyrë dialektike orientimi i dhënë nga Partia, si për nocionin punëtor parimisht, ashtu edhe udhëzimet për pranimet në Parti e zgjedhjet në forumet e saj.

Ju thoni se instruktorët tanë, kur venë në bazë, ua kërkojnë shokëve të rretheve me këmbëngulje respektimin e këtyre përqindjeve. Kjo kërkesë e tyre është e gabuar. Unë, edhe pardje, kur u takuam këtu, bëra pyetjen, nëse dalin nga «kornizat» instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror kur venë në bazë për kontroll e ndihmë, se «kornizat» janë shprehje të burokratizmit. Të them të drejtën, mendjen e kam pasur dhe e kam te këto «korniza», se janë një pengesë serioze për ecjen tonë përpara. Ne themi se anëtar i mirë i Partisë është ai që kryen si duhet detyrën që i ka ngarkuar Partia. Kooperativisti, punëtori, në qoftë se nuk e kryejnë mirë detyrën, nuk bëjnë mirë, po kësh-

tu edhe nëpunësi. Po në qoftë se nëpunësi e kryen detyrën në mënyrë revolucionare, ka aftësi drejtuese, jep ndihmë etj., pra në qoftë se tek ai spikatin cilësitë e larta të komunistit, atëherë për ta zgjedhur atë të mos pyetet hiç për gjendjen e tij. Nuk ka rëndësi vetëm fletanketa, por në radhë të parë puna që bën komunisti. Duhet kuptuar mirë kjo, se, bie fjala, në Institutin e Naftës dhe të Gazit nuk është e domosdoshme të zgjidhet si sekretar i organizatës-bazë të Partisë një mekanik. Të zgjidhet ai sekretar atje vetëm se është mekanik, se është punëtor? Po a i njeh ai problemet e shumta shkencore që ka instituti? A mund të ndihmojë e të kontrollojë ai si sekretar punën e Partisë në këtë qendër shkencore kaq të rëndësishme? Në qoftë se po, shumë mirë. Por në qoftë se jo, atëherë vallë s'ka komunistë që do të mund ta bënin mirë këtë punë? Të tillë ka, por ata janë nëpunës! Jo, nuk duhet parë në këtë mënyrë problemi i përbërjes së udhëheqjes së Partisë. Ata, më parë se nëpunës, janë komunistë. Këtë të mos e harrojmë. Për të drejtuar punën e Partisë në këtë institut organizata-bazë, fare mirë, mund të zgjedhë një gjeolog, që t'u kërkojë llogari deri në një petrografëve, fizikanëve, me një fjalë të tërëve, që punojnë në atë institut e në sektorë të naftës.

Pra, kështu siç veprohet, ka raste që vijnë në komitetet njerëz mediokër. Edhe si sekretarë të organizatave-bazë në institucione dhe në dikastere ka raste kur zgjidhen punëtorë për punëtorë. Po pse të mos zgjidhen atje edhe nëpunës, nga ata që janë energjikë e komunistë të ngritur, politikisht e ideologjikisht që do ta

bënin më mirë punën? Ne jemi gjenerata e parë, kurse këta, nëpunësit e sotëm, të cilët në përgjithësi janë nga 30 e nga 35 vjeç, janë gjenerata e dytë. Prandaj unë mendoj se tash, që po bëhen zgjedhjet, duhen parë mirë përqindjet që janë caktuar lidhur me përbërjen e anëtarëve të komiteteve të Partisë, se zgjedhjet bëhen për një periudhë kohe prej dy vjetësh.

Shiko, Hekuran, merr disa të dhëna për të parë se si janë dhënë këto direktiva e udhëzime dhe si janë orientimet e Komitetit Qendror; shikoni edhe përbërjen e forumeve udhëheqëse të Partisë të këtyre dy vjetëve të kaluar dhe dilni me konkluzione kush i jep këto udhëzime kaq strikte, sikur të kishim të bënim me çmime këpucësh, kaq i shes këpucët dhe as më tepër e as më pak?! A... këtu nuk duhet lejuar një gjë e tillë, nuk është punë partie kjo.

Orientimi që në forumet udhëheqëse të Partisë të vijnë, në radhë të parë, njerëz të klasës, punëtorë e kooperativistë, pastaj nëpunës, është i qartë dhe i drejtë. Por, përqindjet që jepen si orientime nuk janë të prera si me thikë. Natyrisht, ne duhet dhe do ta shikojmë origjinën dhe gjendjen shoqërore të komunistëve që zgjidhen, por të shikojmë edhe aftësitë e tyre. Pra, kur njërin apo tjetrin e ngremë në forumin udhëheqës të Partisë, të kemi parasysh që ai të jetë me të vërtetë njeri i përgatitur e me aftësi drejtuese dhe jo sa për numër. Në përgjithësi punëtorët komunistë janë njerëz të vendosur dhe politikisht shokë të mirë. Ata janë edhe energjikë. Një punëtor të tillë të gjithë e dëgjojnë me respekt kur flet dhe kanë simpati për të.

Dhe ky respekt fitohet me punë. Punëtori i zgjedhur në forumin e Partisë s'e ka arsimin e lartë, por ka aftësi. Ai shkon edhe në dikastere dhe e thotë fjalën e tij si duhet. Të tillë punëtorë energjikë me nivel të lartë, që kanë edhe një stazh pune, jemi dakord që të vihen në udhëheqje. Ata medoemos duhen ngritur. Por, kur nuk e ke kështu punëtorin, e kur s'ke si të veprosh ndryshe (sepse nuk ke punuar me perspektivë për ngritjen e punëtorëve në forumet e Partisë), në ndonjë rast, mund të rritet përqindja e nëpunësve në udhëheqje.

Zgjedhjet për forumet udhëheqëse të Partisë në rajonet e Tiranës e në rrethe ne i bëjmë një herë në dy vjet. Gjatë kësaj kohe nuk është në gjendje Partia të shikojë si punon një byro e komitetit të Partisë të rrethit, ku zgjedhjet janë bërë në bazë të përqindjeve që kërkohen? Doemos që është në gjendje. Nga ky shikim mund të dalë që fajin e ka përqindja, por mundet dhe jo. Ka raste që një punëtor tregohet i mefshtë, joenergjik e nuk bën përpjekje për ngritjen e tij. Atëherë si të bëjmë ne, për hir të përqindjes të mbajmë punëtorë të tillë në komitete? Jo, ne duhet të ecim sipas dialektikës, të veprojmë duke pasur parasysh punën që bën secili.

Është tjetër çështje ajo e pranimeve në Parti. Kur bëjmë pranimet, orientimi është që në radhët e Partisë të futen më shumë punëtorë. Pastaj të punojmë që punëtorët të edukohen e të arsimohen, me qëllim që ata të ngrihen e të zgjidhen në udhëheqje. Por jo të ngrihet punëtori i paaftë vetëm se ia ka vënë syrin njëri apo

tjetri. Kështu nuk duhet të ndodhë! Partia do njerëz të zotë që të udhëheqin, njerëz që ta kryejnë mirë punën e saj dhe kjo është shumë e rëndësishme, se, në goftë se komitetin e kemi të dobët, edhe puna në bazë nuk do të ecë si duhet.

Ne, si marksistë-leninistë, e kuptojmë që baza ka rëndësi të madhe, por tash jemi në një stad të atillë që me ndërgjegje të plotë e themi se me këtë bazë duhet punuar akoma shumë në aspektin ideologjik e politik, derisa ajo të arrijë të veprojë vetë energjikisht, me zgjuarsi, me pjekuri dhe me aftësi për zgjidhjen e të gjitha detyrave që dikton zhvillimi ynë. Sot ka akoma raste, siç u vu në dukje këtu, që ka anëtar ple-numi, punëtor ose kooperativist, që, po ta dërgosh të deleguar në një organizatë-bazë partie, nuk është në gjendje të ndreqë situatën kur puna atje s'ecën. Pse? Sepse edhe vetë ai nuk është i ngritur, se po të ishte i ngritur dhe ta kuptonte mirë vijën e Partisë, ideologjinë e saj, ai do të dinte t'i vinte pikat mbi i.

Ky është një problem i madh partie që duhet parë seriozisht, sepse udhëheqja luan një rol të rëndësishëm. Kjo çështje duhet parë jo vetëm rastësisht, por vazhdimisht, në rrethe e në rajone. Për këtë problem kemi biseduar edhe herë të tjera, kemi dhënë edhe orientime që të mos ndodhin raste të tilla, si ato që u përmendën këtu, dhe megjithatë është fakt që këto dukuri, që e dëmtojnë Partinë, vazhdojnë të shfaqen. Kjo ndodh sepse në disa raste harrohet çështja kryesore, që problemi duhet të kuptohet në rrugën marksiste-leniniste.

Kandidaturat për anëtarë të komitetit që propozohen në mbledhjen e përfaqësisë, konferenca e Partisë ka të drejtë t'i rrëzojë, se kjo është e plotfuqishme, është organi më i lartë i organizatës së Partisë në rreth ose në rajon. Këtë gjë nuk duhet ta harrojmë, se ndryshe mund të krijohet jo vetëm kulti i një personi, por edhe i disa personave, si i sekretarëve në rreth, ose i një instance të caktuar, si byroja e komitetit në rreth. Prandaj gjithmonë të mbajmë parasysh parimin e demokracisë së brendshme të Partisë, në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale. Komiteti i Partisë për zgjedhjet në bazë mund të japë një orientim, për arsye se edhe ai i njeh njerëzit në punë, por ai nuk i njeh ata siç i njeh, për shembull, sekretari i organizatës në bazë. Ka dhe raste që propozohet të zgjidhet një njeri që komiteti e ka njohur për të mirë, por që shokët, të cilët punojnë me të, e dinë që ai ka rënie në punë dhe nuk është më ashtu siç njihej. Në këtë rast shokët e bazës duhet të ngrihen në konferencë e të thonë se ky shok për këtë ose për atë arsye nuk duhet të zgjidhet më, prandaj mendojmë për një tjetër, që është njeri i mirë dhe meriton të zgjidhet. Kur është kështu, konferenca e Partisë zgjedh kandidaturën e dytë, që është më e përshtatshme nga ajo që propozojnë shokët e përfaqësisë. Në forumin udhëheqës të Partisë nuk duhen zgjedhur ata që kanë fjalë shumë, por punëtorë, kooperativistë, kuadro që çahen tërë ditën në punë.

Partia jonë, si Parti proletare që është, e ka në dorë ta zgjidhë drejt këtë çështje. Dhe kjo nuk është një çështje sa për t'i bërë zgjedhjet formalisht demo-

kratike. Përkundrazi, kjo duhet të bëhet sepse ekziston e drejta edhe të propozohet, edhe të kritikohet dhe pastaj të konkludohet.

Komunistët dhe sidomos anëtarët e forumeve të Partisë, duhet ta thonë me guxim fjalën e tyre për çdo gjë. Shokët e zgjedhur në byrotë edhe diskutojnë, por fjala është për anëtarët e plenumeve të komiteteve të Partisë. Ka ndonjë shok që gjatë dy vjetëve ka folur vetëm një herë në mbledhjet e plenumit. Ky njeri që nuk hap gojën nëpër mbledhje, ose është zgjedhur vetëm sa për numër, ose, megjithëse në bazë ngre probleme dhe diskuton vazhdimisht, në mbledhjet e plenumit ka njëfarë druajtjeje, sepse mundet që atje të krijohet një atmosferë e tillë që ai nuk e ka të lehtë të flasë.

Të gjitha këto instruktorët tanë i dinë, por edhe organizata-bazë e Partisë i di. Organizatën-bazë ne duhet ta kemi me të vërtetë bazën e Partisë, ajo të thotë mendimin e saj, të japë gjykimin për çdo gjë, të vërë në jetë ligjin e Partisë, ligjin e klasës. Këtu qëndron shkathtësia e udhëheqjes, që aftësinë e saj të dijë ta bashkojë me atë të bazës; atje ajo duhet të marrë eksperiencë, të përfitojë nga fryma e shëndoshë dhe pastaj të dijë të reflektojë në punët e veta.

Nga faktet që u përmendën edhe këtu del se në praktikë përqindjet orientuese nuk shërbejnë si orientim, por zbatohen pikë për pikë, saqë edhe ata shokë komunistë punëtorë që janë energjikë e të aftë, të cilët e justifikojnë emrin e anëtarit të plenumit, sapo ngrihen në përgjegjësi, futen në kategorinë e nëpunësve dhe nuk zgjidhen më në plenum. Po pse të veprohet

kështu?! Atë punëtor plenumi i komitetit të Partisë e zgjodhi dhe e bëri një shok të aftë, e dërgoi edhe në shkollë, pastaj i besoi drejtimin e fabrikës. Duke qenë anëtar plenumi, ai fitoi përvojë si drejtues dhe niveli i tij u ngrit. Por tani si drejtor fabrike është nëpunës, thuhet, prandaj në plenum s'mund të zgjidhet më, se prishet raporti i përqindjeve punëtorë-nëpunës. Kjo s'është aspak e drejtë, bile një gjë e tillë është shumë e rrezikshme, se e dobëson Partinë. Duke vepruar në këtë mënyrë, Partia nuk e luan rolin si duhet, rol luajnë vetëm disa njerëz. Në të vërtetë rol duhet të luajnë jo disa njerëz të zgjedhur në forumin drejtues të Partisë, por të gjithë. Po pse dalin në pah vetëm disa? Mendoj se edhe nga «halli», sepse ata janë më të ngriturit. Prandaj dërgohen të deleguar vetëm disa që e kryejnë si duhet detyrën e të deleguarit.

Ky problem duhet parë me instruktorët tanë, por edhe rretheve u duhet shpjeguar që Partia nuk duhet të lejojë në asnjë mënyrë as sektarizëm, as liberalizëm në zbatimin e orientimeve të saj. Sektarët e dobësojnë Partinë, ashtu si edhe liberalët, që mendojnë: oburra, t'i hapen portat e Partisë çfarëdo nëpunësi apo intelektual që flet bukur dhe mund të dërgohet i deleguar aty e këtu që të thotë disa fjalë të mira, megjithëse nuk ka pjekuri partie.

Këto gjëra janë të rrezikshme për Partinë, t'i luftojmë vazhdimisht me forcë, si shfaqjet e sektarizmit në punët e Partisë, ashtu edhe ato të liberalizmit. Puna e Partisë, e kemi vënë shpeshherë në dukje, është shumë delikate, shumë serioze, nga më seriozet. Në qoftë se

Partinë do ta kemi vazhdimisht të fortë, në qoftë se do të dimë t'i zbatojmë si duhet normat e saj dhe në bazë të këtyre normave të punojmë që të edukojmë çdo njeri, të vëmë në rregull çdo gjë, atëherë të jemi të bindur se punët do të na shkojnë mirë.

Edhe ju, sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve, shoqja Lenka, kurrë mos e lini pas dore këtë gjë. Ju jeni ata që udhëhiqni komitetin e Partisë, por jeni edhe ata që shkoni në bazë, ku ndiqni punët konkrete të saj. Duke shkuar në bazë për të parë konkretisht punën e Partisë, ju shikoni edhe si punojnë njerëzit, si i kryejnë detyrat ata që kanë funksione etj. Kështu ju atje grumbulloni eksperiencë jo vetëm për punën që bëhet lidhur me realizimin e planit, por edhe për njohjen me njerëzit, me karakteristikat e tyre. Dhe kjo eksperiencë është e nevojshme. Natyrisht njerëzit më të mirë do të pranohen në Parti, ndërsa komunistët më aktivë do të zgjidhen edhe në forumin udhëheqës të Partisë, sepse pikërisht këta e forcojnë Partinë.

Kur sekretari i komitetit të Partisë vëren, për shembull, se në një kooperativë bujqësore punojnë pak burra, ndërsa fushat janë mbushur plot me gra kooperativiste dhe në organizatën e Partisë janë dhjetë burra dhe vetëm dy gra, ai bindet se kjo gjendje nuk është aspak e rregullt. Nga ky konstatim, sekretarit i lind pyetja se për çfarë arsyeje duhet të jenë komuniste vetëm dy gra, kur këto përbëjnë një shumicë të madhe në këtë kooperativë e punojnë në frontet e prodhimit.

Përqindjet, qoftë për përbërjen e anëtarëve të Partisë apo të forumeve udhëheqëse të saj, duhet t'i dik-

tojë vetë eksperiencia dhe të mos jepen për to receta nga zyrat. Këtë e theksoj shumë, se, kur veprohet ndryshe, Partia dëmtohet.

Organet e pushtetit shtetëror janë një nga levat e diktaturës së proletariatit. Ne themi që në këtë levë të vijnë për të punuar edhe njerëz të paorganizuar në Parti. Këtë mësim na e kanë dhënë mësuesit tanë të shquar Lenini e Stalini. Këto mësimë ne i vëmë në jetë, se janë teza dhe konkluzione të rëndësishme të nxjerra nga një eksperiencë e madhe revolucionare. Ne ecim në bazë të konkluzioneve të tyre, duke i zbatuar dhe zhvilluar më tej ato në përputhje me kushtet tona. Dhe në fakt në organet tona shtetërore punojnë nëpunës të paorganizuar në Parti më shumë se punëtorë komunistë. Por kur themi që në këto organe të punojnë më shumë jokomunistë, nuk do të thotë që në këtë drejtim të veprimtari shkel e shko. Jo, përkundrazi, atje ne duhet të sjellim njerëz të zotë, me përbërje të mirë politike, të cilëve t'u besohen punë me përgjegjësi e rëndësi të madhe. Edhe anëtarë partie atje duhet të ketë aq sa është e nevojshme, të tjerët të punojnë në bazë, që kjo të forcohet.

Pse duhet të ketë punëtorë komunistë në organet shtetërore? Sepse punëtori e frymëzon nëpunësin e paorganizuar në Parti që ky të ecë në rrugën e klasës. Por edhe eksperiencia e nëpunësit me shkollë të lartë nuk duhet të hidhet poshtë. Njerëzit i mëson edhe shkolla, edhe puna. Edhe djali i atij që nuk është në Parti jeton në shoqërinë socialiste, punon me frymën e Partisë, por nuk është anëtar partie. Ka raste që edhe i ka kushtet,

por në Parti nuk mund të pranohen të tërë njerëzit, se Partinë nuk e bëjmë Front. Ka rregulla, ka përpjesëtime, ka orientime lidhur me këtë çështje. Por ata që i kanë kushtet dhe nuk pranohen në Parti, ne i kemi në konsideratë të veçantë.

Në praktikë, sado që të rralla, ka edhe raste që ndaj nëpunësve nuk mbahen qëndrime të drejta, ata shihen si burokratë në shoqërinë tonë. Ky është kuptimi i vjetër që ka pasë ekzistuar për nëpunësin dhe pikërisht këtu qëndron gabimi. Sot ne nuk kemi nëpunës, «memurë» të dikurshëm, por nëpunës revolucionarë, punonjës të shtetit të diktaturës së proletariatit. Nuk përjashtohet që në veprimtarinë e disa prej tyre të ketë edhe shfaqje të burokratizmit, por shfaqjet negative ne do t'i luftojmë kudo, edhe burokratizmin te nëpunësit, por ata, në veprimtarinë e përgjithshme, janë e duhet të konsiderohen si nëpunës të shtetit të diktaturës së proletariatit, i cili ka një jetë 35-vjeçare.

Për të metat që janë vënë re në këtë drejtim janë dhënë udhëzime. Ato duhet t'i zbatojmë dhe zbatimin e tyre ta kontrollojmë. Kështu, menjëherë çdo gjë do të vihet në vend në kohën e duhur. Jeta zhvillohet dhe dikton medoemos ndryshimin e përqindjeve të dhëna në orientimet e Partisë. Kur themi që jeta zhvillohet, me këtë kuptojmë që njerëzit përparojnë, mësojnë, marrin kulturë dhe nivelin e tyre ideologjik ngrihet. Duke u arsimuar, njerëzit bëhen intelektualë, por një gjë e tillë nuk i ka penguar ata që të bëheshin anëtarë të Partisë duke punuar në frontet e vështira.

Këto probleme, shokë, kanë një kuptim të thellë

e duhen parë në zhvillim. Ne synojmë që të gjithë të kenë mbaruar të paktën shkollë të mesme dhe drejt këtij objekti po ecim me vrull. Iku koha e baballarëve dhe e nënave tona, që në shumicën dërrmuese të tyre ishin analfabetë, do të ikë edhe koha e 50-vjeçarëve të sotëm, për të cilët mjaftonte 8-vjeçarja. Do të vijë koha që të tërë të rinjtë të kryejnë shkollën e mesme, e më shumë se sot shkollën e lartë, sepse zhvillimi ynë do ta kërkojë këtë, por për punëtorin që vazhdon universitetin dhe bëhet inxhinier, do të jetë absurde sikur t'i thuhet: «Mos vazhdo shkollën e lartë, se bëhesh intelektual». Nuk duhet harruar se ky është intelektual me prejardhje punëtorë dhe në këtë njeri duhet ta ngremë, prandaj çështja e përqindjeve duhet kuptuar drejt.

Mua më duket se këto gjëra e kanë burimin te një kuptim jo i drejtë për klasën. Klasa punëtorë është klasë udhëheqëse e shoqërisë sonë. Partia i vë të gjitha forcat që këtë klasë ta ketë të mësuar, inteligjente, revolucionare, luftëtare, sepse kjo ka misionin historik të udhëheqë ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste. Kjo nuk do të thotë se të tjerët nuk janë revolucionarë, nuk janë inteligjentë, nuk janë besnikë e të gatshëm që të japin jetën për interesat e Partisë e të atdheut. Historia jonë ka treguar se nën udhëheqjen e klasës punëtorë, me Partinë në krye, tërë populli është hedhur në zjarr për interesat e Partisë e të atdheut. Prandaj duhet të kemi një kuptim të drejtë të këtij problemi.

Partia Komuniste e Shqipërisë u themelua me 200 veta gjithsej, dhe popullin e udhëhoqi jo numri fizik i

komunistëve, pale i punëtorëve, të cilët përbënin atëherë vetëm një pakicë, por ideologjia e saj, që duhet t'i paraprijë kurdoherë klasës.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, "Ra-  
porte e fjalime 1978-1979",  
f. 286*

*Botohet i plotë sipas tekstit të  
nxjerrë nga biseda e inçizuar  
që gjendet në AQP*

## **ORGANIZATA E BASHKIMEVE PROFESIONALE ESHTË AJO QË DUHET TA NGREJË FORT ZËRIN KUNDËR BUROKRATIZMIT**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**22 qershor 1979**

Në këtë takim, shokë, dëshiroj të shtroj një problem që na shqetëson të tërë, çështjen e Bashkimeve Profesionale. Këtë problem e kemi shtruar edhe herë të tjera dhe kemi dalë me konkluzionin që në to nuk po punohet mirë. Gabohem apo nuk gabohem në vlerësimet e mia, jam i bindur që ato bëjnë punë, por në përgjithësi nuk punojnë mirë. Megjithëkëtë, ne nuk i kemi qëndruar si duhet kësaj çështjeje, nuk i jemi futur thellë për të parë cilat janë shkaqet e kësaj gjendjeje. U përshtatet detyrave metoda e punës që ka përcaktuar prej kohësh organizata e Bashkimeve Profesionale apo mos ka ardhur koha për t'i bërë asaj disa korrigjime e për të vendosur një metodë të re pune? Në ç'drejtime, si, qysh? Kjo gjë ka mbetur.

**I kam thënë njëherë shokut Rita [Marko] se Bash-**

kimet Profesionale nuk mund të ecnin në formën organizative që kishin. Me sa më kujtohet ishte çështja e ngritjes së organizatave profesionale mbi baza sektoriale. Por tash e kam fjalën sidomos për metodat dhe për format e punës të kësaj organizate kaq të rëndësishme.

Organizata e Bashkimeve Profesionale me të drejtë cilësohet, dhe në të vërtetë është dora e djathtë e Partisë, është organizata kryesore e masave që udhëheq Partia. Pse është ajo e tillë?

E para, sepse, duke filluar që nga funksionari më i lartë i Partisë dhe i shtetit e deri te punonjësi më i thjeshtë, të gjithë janë anëtarë të Bashkimeve Profesionale. Në gjirin e saj militojnë të gjithë punëtorët dhe nëpunësit, pra, një shumicë e madhe e anëtarëve të Partisë.

Organizata e Rinisë është gjithashtu shumë e rëndësishme, por ajo përbëhet vetëm nga të rinjtë. Në këtë organizatë nuk bëjnë pjesë shumica e komunistëve, ngaqë e kanë kaluar moshën e rinisë. Edhe në organizatën e Gruas po kështu, se në radhët e saj janë vetëm gra. Ne kemi edhe organizatën e Frontit, e cila është shumë e gjerë. Por Bashkimet Profesionale lidhen me prodhimin në frontet e punës, nëpërmjet tyre përcohen direktivat e saj në masat punonjëse, të cilat luftojnë për t'i zbatuar ato.

E dyta, organizata e Bashkimeve Profesionale ka në gjirin e vet klasën punëtore, nga radhët e së cilës dalin shumë komunistë. Klasa punëtore është baza e shoqërisë sonë, është klasa që e udhëheq këtë shoqëri,

ajo vë të gjitha forcat e veta për të realizuar direktivat e Partisë, të cilat përfshijnë edhe veprimtarinë e organeve të pushtetit, të Bashkimeve Profesionale, të organizatës së Gruas dhe të Rinisë. Prandaj, të gjithë komunistët dhe ata që nuk janë në Parti, kudo që punojnë në organet e në organizatat që përmenda, luftojnë për të zbatuar direktivat e Partisë edhe si anëtarë partie, por edhe si anëtarë të këtyre organizatave.

Kështu, anëtari i Partisë, që është edhe anëtar i Bashkimeve Profesionale, në të njëjtën kohë, për zbatimin e direktivës kërkon dhe jep llogari edhe atje, në organizatën e bashkimeve profesionale.

Pikërisht këtu del çështja se si e kupton dhe si e realizon këtë parim kjo organizatë, që është dora e djathtë e Partisë. Drejtohet apo nuk drejtohet mirë iks ndërmarrje, sigurisht, është problem, por jo vetëm i Partisë, siç kuptohet ndonjëherë. Nuk mund e nuk duhet t'ia ngarkojmë të gjitha Partisë dhe vetëm asaj çdo gjë.

Lexova dje në gazetën «Zëri i popullit» artikullin me titull: «Përse i ndani fjalët nga veprat, shokë të parkut të Laçit?». Në këtë artikull të gjitha të këqijat e parkut automobilistik ia ngarkonin organizatës së Partisë të ndërmarrjes dhe komitetit të Partisë të rrethit. Pse mendohet kështu? Organizata e Partisë e ndërmarrjes dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Krujës kanë dhënë porosi e kanë marrë vendime, zbatimimi i të cilave kërkon që të gjithë, si anëtarë partie dhe si anëtarë të Bashkimeve Profesionale të punojnë për zbatimin e tyre dhe të mbajnë përgjegjësi për to deri në një.

Iksi apo ipsiloni mund të jetë shofer, mekanik, drejtor apo nëndrejtor etj., por nga pikëpamja e anëtarësisë në organizatën e Bashkimeve Profesionale të gjithë janë njëlloj. Prandaj secili, sipas funksionit përkatës, mban përgjegjësi për realizimin e detyrave të ndërmarrjes. Kuptohet, në këtë mes rëndësi ka organizimi dhe metoda e punës, nga të cilat varet edhe suksesi.

Partia ka dhënë direktiva, për shembull, për çështjet e organizimit e të disiplinës në punë etj., por përgjegjësi për këto nuk mund t'i kërkohej vetëm organizatës-bazë të Partisë. Kur në një kolektiv s'ka disiplinë ose kjo thyhet, kur atje mungon organizimi ose normat e punës ngrihen e ulen pa kriter, kur normat teknike diku vendosen e diku jo, kur nga moszbatimi i rregullave të sigurimit teknik aksidentohen njerëzit etj., të bësh përgjegjëse vetëm organizatën e Partisë, do të thotë ta kthesh këtë në një organizëm që dublon tërë punën e organeve të pushtetit dhe të ekonomisë, të Bashkimeve Profesionale, të organizatës së Rinisë e të Gruas, anëtarë të të cilave janë punonjësit e këtij kolektivi. Në këto raste duhet parë se si punojnë jo vetëm organizatat e Partisë, por edhe të gjitha organizatat e masave.

Sigurisht, kudo udhëheq Partia, kjo është e drejtë, por Partia udhëheq me direktivën, me punën e gjerë edukative ideopolitike, me shembullin personal e pararojë të anëtarëve të saj. Përveç kësaj, Partia krijoi kushte për arsimimin e specialistëve, të drejtorit, kryeinxhinierit, kontrollorit të cilësisë etj. Pastaj shteti ynë ka nxjerrë ligje e rregullore që rregullojnë e disipli-

nojnë gjithçka dhe që kanë në themel vijën e direktivat e Partisë. Prandaj ka rëndësi që direktivat e saj të përvetësohen mirë, që pastaj të mund të zbatohen e të kontrollohen mirë. Dhe për këtë janë organizatat e Partisë, por jo vetëm këto. Janë dhe duhet të punojnë për këtë edhe organet shtetërore, organizatat e masave etj. E gjithë kjo punë midis tyre duhet të bëhet mirë dhe e bashkërenduar. Partia, me anëtarët e saj, është kudo.

Anëtarit të Partisë i kërkohet llogari dhe, po të bëhet mirë kjo, ai nuk do të rrijë me cigare në buzë gjatë kohës së punës e t'u japë vetëm urdhra të tjerëve, por do të punojë me mobilizim dhe me disiplinë vetë, në radhë të parë, sepse vendimet janë marrë në organizatën-bazë dhe për to ai do të përgjigjet përpara saj. Puna për zbatimin e vendimeve që merr organizata-bazë bëhet me më shumë sukses, kur shumica dërrmuese e komunistëve të jetë në prodhim. Por edhe ata komunistë që nuk janë në prodhim, kanë detyra të mëdha, që ata të vënë në pozita pune, të udhëheqin e të kontrollojnë punën e administratës së ndërmarrjes, të institucionit që t'i kryejë si duhet detyrat që i janë ngarkuar e që i takojnë, si në çështjet e furnizimit, të administrimit, të organizimit të punës etj. Në këtë mënyrë edhe organizata e Partisë dhe levat e saj do t'i kryejnë si duhet detyrat që kanë.

Çfarë bëhet për përmirësimin e stilit dhe të metodës së punës të organizatave të masave? Për këtë kemi folur edhe herë të tjera. Çështja është se nuk mund të ecet më me forma pune shabllone. Organizatat e bash-

kimeve profesionale, të gruas e të rinisë nga puna e përditshme të nxjerrin konkluzione dhe t'i sinjalizojnë Partisë se eksperiencia e tyre tregon që forma dhe metoda e tanishme e punës në këtë apo në atë çështje, në këtë apo në atë drejtim, nuk ecën, është vjetruar dhe të bëjnë propozime konkrete që ajo të ndryshohet dhe të merren disa vendime të tjera për këtë qëllim.

Por mua më duket se me gjithë përmirësimet që ka në punën e këtyre organizatave, nga ana e tyre nuk mendohet sa duhet për përmirësimin e metodës e të stilit, prandaj dhe nuk na vijnë propozime e sugjerime për përsosjen e tyre. Stili, format dhe metoda e punës dalin nga praktika dhe rezultatet e punës, nga të mirat dhe nga të metat që vërehen në punë. Të mirat mund e duhet të çohen akoma më tej, kurse të metat duhen luftuar që të evitohen, por kjo nuk arrihet menjëherë. Për këtë kërkohet kohë, sepse kemi të bëjmë me një kompleks të tërë faktorësh ideologjikë, politikë dhe organizativo-administrativë. Flitet për një kompleks të tërë faktorësh, sepse i tillë është organizimi ynë shtetëror. Kështu edhe organizatat e bashkimeve profesionale, për të realizuar siç duhet detyrat e tyre, është e nevojshme të përcaktojnë edhe metoda pune të përshtatshme e që e lyp nevoja, të cilat medoemos duhet të shoqërohen me masa organizative që t'u përgjigjen atyre. Këto çështje Partia t'i ndjekë, të vihet në dijeni, t'i marrë në analizë që edhe t'i drejtojë e t'i udhëheqë si duhet.

Pikërisht një punë e tillë na çalon. Me çështje të tilla kapitale, siç janë organizimi dhe drejtimi, stili

dhe metoda e punës, duhet të merren në radhë të parë organet dhe përgjegjësit e këtyre organizatave. Puna e tyre, për sa i përket, ta zëmë, emulacionit socialist, nuk është vetëm se kujt i duhet dorëzuar flamuri. Kjo është vetëm ana formale e kësaj çështjeje. Ajo që ka më shumë rëndësi është që të gjallërojnë emulacionin, të gjejnë forma të tilla që sigurojnë rezultate konkrete në realizimin e planit ose të detyrave të tjera të ngarkuara nga Partia dhe nga pushteti. Pra kërkohet që ato të organizojnë më mirë punën me anëtarët e organizatës për të nxitur mendimin dhe iniciativën e tyre.

Kjo që po parashtroj është vetëm një ide. Të themi të vërtetën kështu siç veprohet sot, që mblidhet kolektivi dhe u flet dikush për një problem dhe kaq, më duket se nuk është një praktikë e përshtatshme. Nuk është puna të mblidhen punëtorët grupe-grupe ose së bashku dhe t'u mbahet atyre një konferencë. Tash gjendja ka ndryshuar, prandaj edhe metoda e punës me punonjësit duhet t'u përshtatet situatave e detyrave të reja që kanë dalë e që dalin vazhdimisht. Këto kërkojnë që të dëgjohet zëri i masave dhe vetë ato të hidhen në veprim, të vihen në lëvizje, se janë masat ato që krijojnë, që realizojnë. Kështu, për shembull, në rast se në një ndërmarrje mungon disiplina, atëherë vetë anëtarët e organizatës së Bashkimeve Profesionale ta marrin në dorë këtë çështje, jo për të grumbulluar të dhëna, por për të vendosur rregull e disiplinë në qendrën e tyre të punës. Po të organizohet mirë një metodë e tillë pune, atëherë kështu ndihmohet edhe Partia në luftën për zbatimin e direktivave të saj. Sepse duke vënë në lëvi-

zje tërë masën, do të zbulohen ku janë të metat, ku ka shkelje të disiplinës, ku ka dobësi etj., etj. dhe vetë organizatat profesionale do të marrin masat e nevojshme për ndreqjen e gjendjes, sepse Partia u ka dhënë edhe orientimet, edhe kompetencat. Po të veprohet në këtë mënyrë, kjo nuk do të thotë se Bashkimet Profesionale po dalin mbi Partinë. Jo, por si një ndër organizatat kryesore që janë, ato duhet ta mbështetin me të gjitha forcat Partinë. Kjo është plotësisht e mundur sepse të gjithë komunistët janë njëkohësisht edhe anëtarë të kësaj organizate dhe direktivat që ka lëshuar Partia, më parë u janë zbërthyer komunistëve në organizatën-bazë, prandaj të parët që duhet ta zbatojnë atë janë anëtarët e Partisë. Në gjirin e organizatës së Bashkimeve Profesionale, komunistët duhet të jenë të parët që të mendojnë dhe të gjejnë forma të atilla pune që ngritja e normave, për shembull, të mos bëhet pse kështu ka thënë drejtori. Këto çështje ata t'i analizojnë, t'i diskutojnë në organizatë dhe në kolektiv.

Po me ç'forma do ta rregullojmë ne këtë gjë? Me forma pune të dhjetë vjetëve të kaluar?

Mua më duket se kjo gjë nuk bëhet kështu. Problemin e Bashkimeve Profesionale ne e kemi marrë vetëm si një çështje agjitacioni e propagande, vetëm si një faktor edukimi. Prandaj edhe organizativisht i kemi lidhur ato me sektorët e edukimit që nga aparati i Komitetit Qendror e deri në aparatet e komiteve të Partisë në rrethe. Pa dyshim që edukimi i klasës dhe i masave ka rëndësi shumë të madhe për Partinë, por mua më duket se ky edukim nuk mund e nuk

duhet të bëhet në sipërfaqe, i shkëputur nga detyrat konkrete të ndërtimit të socializmit. Prandaj duhet studiuar mos është më mirë që organizata e Bashkimeve Profesionale dhe organizatat e tjera të masave të lidhen më mirë edhe me grupin e instruktorëve dhe me sektorët e tjerë të aparatit.

Bashkimeve Profesionale, kuptimit të thellë të detyrave, të përgjegjësisë, të kompetencave të tyre, duhet t'u japin rëndësi, në radhë të parë, vetë anëtarët e Partisë. Me këtë dua të them se, kur anëtari i Partisë del nga mbledhja e organizatës-bazë, duhet ta dijë e ta ketë të qartë se është edhe anëtar i organizatës së Bashkimeve Profesionale dhe e ka për detyrë e duhet të luftojë atje për disiplinën, për rregullin, për normat, për zbatimin e të gjitha detyrave.

Si e në çfarë formash të luftojë ai? Kush duhet të mendojë për këtë? Partia, sigurisht, por ama Partia, për të punuar me organizatat e masave ka ngarkuar anëtarë të saj. Atëherë personat përgjegjës në rrugë shtetërore bashkë me të zgjedhurit kanë për detyrë të gjejnë forma dhe metoda më të përshtatshme pune me masën, me kolektivin e organizatës së Bashkimeve Profesionale, e cila përbëhet nga individë, komunistë e të paorganizuar në Parti. Në qoftë se ka komunistë që nuk janë në rregull me punën, që nuk janë në rolin pararojë, organizata-bazë e Partisë ta shikojë me kujdes punën e tyre dhe t'i kritikojë përse nuk i zbatojnë detyrat, përse nuk vijnë në mbledhjen e bashkimeve profesionale, përse tregohen të padisiplinuar e të tjera e të tjera.

Organizata e Bashkimeve Profesionale është ajo që duhet ta ngrejë zërin e të thotë: «Këtu ka burokratizëm nga ana e ministrisë, nga ana e administratës së ndërmarrjes» etj. dhe të ndalet e t'i thotë drejtorit të ndërmarrjes ose të institucionit: «Partia të ka vënë këtu të drejtosh, por të drejtosh si duhet dhe të kuptosh mirë që edhe ti je anëtar i kësaj organizate dhe, si i tillë, të veprosh e të përdorësh forma e metoda pune që janë në përputhje me direktivat që ka dhënë Komiteti Qendror i Partisë dhe me ligjet e urdhëresat e shtetit. Lenini kur arsyetonte përse i mbante Partia e bolshvikëve Bashkimet Profesionale, sqaronte se i mbante për të luftuar burokratizmin shtetëror, i cili vë në rrezik diktaturën, si dhe zbatimin e direktivave të Partisë. Por kjo të mos kuptohet në mënyrë formale. Prandaj mua më duket se këtë çështje duhet ta shikojmë, ta studiojmë, sepse ndodh që ngrihen probleme, por ato nuk zgjidhen si duhet.

*SHOKU RAMIZ ALIA*: Edhe ne e kemi për detyrë që ta shohim më mirë punën se si duhet udhëhequr organizata e Bashkimeve Profesionale. Pse e them këtë? E them për arsye se e lidh me atë që theksoi shoku Hysni për të parë si i trajton komiteti i Partisë në rreth organizatat e masave, se kemi konstatuar që jo gjithnjë ka një kuptim të drejtë për to.

Për ta ilustruar atë aspekt që thoni ju, shoku Enver, se organizata e Bashkimeve Profesionale është krahu i djathtë i Partisë, po marr një problem konkret. Tani ndodhemi përpara fushatës së korrjeve e shirjeve. Ju me shumë të drejtë folët dhe vazhdimisht po flisni

për problemin e kolaudimit të mjeteve teknike. Kush e bën këtë kolaudim? E bëjnë punëtorët. Pra, është klasa punëtore ajo që duhet t'i merremtojë dhe t'i kolaudojë sa më mirë këto mjete, me qëllim që fushata e korrjeve të përfundojë me sukses. Pikërisht këtë detyrë të ndjekë në këto momente organizata e Bashkimeve Profesionale.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Medoemos kështu. Bashkimet Profesionale në këtë fushatë duhet të vihen në lëvizje dhe, do të thosha unë, kanë shumë punë. Ato, duke siguruar udhëheqjen e organizatës-bazë të Partisë, t'i futen thellë problemit të cilësisë së shërbimeve dhe sigurimit të gatishmërisë së mekanizmave bujqësorë, ta ndjekin atë hap pas hapi, të punojnë me njerëzit, t'i nxitin ata, të nxitin emulacionin që detyra të kryhet me sukses.

Parimi është që Partia udhëheq. Por Partia është pjesë e klasës dhe pararojë e saj. Klasa është kryesorja. Direktivat Partia ia jep klasës dhe masave të tjera punonjëse. Ajo udhëheq, kontrollon dhe edukon nëpërmjet formave e mjeteve të ndryshme, me shkollën, me shtypin, me propagandën, agjitacionin, me format e edukimit, me organizatat e masave etj. Nuk po them këtu ndonjë gjë të re, se këto dihen, por dua të theksoj se çështja e edukimit është diçka që konkretizohet me vënien më mirë në punë të organizatave të masave, të organeve të pushtetit e deri tek organizatat e rinisë dhe ato të pionierit. Komitetet dhe aparatet e Partisë bëjnë përgjithësimin e eksperiencës së madhe të Partisë, por themeli i Partisë është organizata-bazë, e cila e merr

direktivën, e zbaton, nxjerr eksperiencën dhe i propozon udhëheqjes që duhet marrë ose ndryshuar ky apo ai vendim, se ka këto apo ato të meta. Atëherë udhëheqja kur e sheh të drejtë këtë mendim të bazës, bën korrigjimet e nevojshme dhe ia kthen përsëri Partisë, por edhe masave. Kjo ka rëndësi të theksohet, sepse shpesh kuptohet sikur këtë ose atë problem do ta zgjidhë vetëm organizata e Partisë, domethënë 20-30 komunistë, që janë në një ndërmarrje. Në të vërtetë janë masat ato që do t'i vënë në jetë këto orientime të Partisë. Por ngaqë disa kuadro e drejtues kanë kuptim të ngushtë e të cekët për këtë, ndodh që edhe pse flitet e thuhet vazhdimisht që të aktivizohen Bashkimet Profesionale dhe organizatat e tjera të masave, edhe përsëritet shpesh që në drejtim dhe në organet e pushtetit të vijnë edhe nga ata që nuk janë në Parti, përsëri hezitohet. Por ne duhet të bëjmë që të gjitha këto hallka, këto organe, organizata dhe aparate të kryejnë secili detyrat e veta, në bazë të kompetencave që kanë, sigurisht, nën udhëheqjen e Partisë. Ne nuk mund të veprojmë ashtu siç bënte Mao Ce Duni që i bashkonte të tëra, partinë dhe organizatat e tjera, në «komitetin revolucionar». I ngrita këto gjëra që Bashkimet Profesionale, por edhe organizatat e organizmat e tjerë të revolucionarizojnë metodën e tyre të punës.

Çështja tjetër, që dua të vë në dukje, është e lidhur me rezervat e karburanteve. Të gjithë e lexojmë shtypin çdo ditë, që në mëngjes. Ja, në gazetën «Zëri i popullit» sot ishte botuar një artikull për problemin e pikave të furnizimit të automjeteve me karburant, që

nuk janë në ato vende ku është mirë të jenë. Për shembull, shkruhej në artikull, makinat e Përrenjasit të rrethit të Librazhdit duhet të shkojnë në çdo dy ditë në Pishkash për t'u furnizuar me karburant. Pra, për këtë qëllim, makinat bëjnë kilometra të tërë rrugë, duke harxhuar në këtë mënyrë gjithë atë karburant pa vend. Dhe kjo bëhet në një kohë kur Qeveria ka nxjerrë një vendim që të kursehet edhe kombi i naftës, i benzines. E pra, vetëm për t'u furnizuar me karburant të bëhen kilometra të tjerë vajtje e ardhje?! Po si të zgjidhet ky problem? Në radhë të parë Qeveria që ka nxjerrë vendimin për kursimin e karburantit ta mendojë, të vrasë mendjen për të gjetur rrugët më të përshtatshme për vënien në jetë të vendimit të vet. Po mund të them dhe unë mendimin tim. Për shembull, të hapim pika furnizimi të karburanteve në ato vende ku është e domosdoshme, ta zëmë afër stacionit të trenit etj., me qëllim që makinat të mos bëjnë kilometra të tërë rrugë për t'u furnizuar me karburant, pra pikat e furnizimit të jenë sa më afër vendit ku lëvizin makinat. Kështu do të shmanget konsumi i kotë i karburantit.

Të gjithë e dimë se në Evropë e në botë kriza për karburante është e madhe, ajo ka shkaktuar edhe krizën e bllokimit të automjeteve. Stacionet e furnizimit të automjeteve me karburant nuk punojnë dhe autobotet që transportojnë karburantin rrinë pa punë. Në këtë situatë të mendohet që të blihen disa autobote tani, se janë me çmim më të lirë. Një gjë e tillë është me shumë leverdi për ne, sepse, në vend që të vijnë rrotull

me qindra e me mijëra makina pa ngarkesë që të marrin karburantin në pikat e furnizimit, duke harxhuar gjithë atë sasi karburanti, me disa autobote mund të zgjidhet ky problem. Me tërë atë karburant që harxhojnë makinat për vajtje-ardhje në pikat e furnizimit, mund të marrim disa autobote, të cilat do të përdoren për të furnizuar automjetet edhe në fshatra e në zona larg pikave të furnizimit. Atëherë pse të mos e bëjmë këtë gjë? Ne kemi njerëz në përfaqësitë tona tregtare, në vende të ndryshme të Evropës, të cilët shumë mirë mund të kujdesen për blerjen e autoboteve, qoftë edhe të përdorura, me çmime me leverdi. Shpesh interesohemi vetëm për makineri të mëdha, për objekte dhe nuk u vëmë rëndësi gjërave të tilla. Këtë gjë ta kuptojmë mirë. Prandaj të mos e zgjatim shumë këtë punë, por t'i thuhet ministrit të Komunikacionit si mendon të zgjidhet ky problem.

Në këto punë vihet re inkoherencë, mungesë iniciative dhe organizimi. Në artikullin që përmenda vihen mirë pikat mbi i, siç i thonë një fjale, për problemin e kursimit të karburanteve. Është për t'u lavdëruar autori që ka bërë artikullin, por ç'e do që ka shokë, të cilëve në një vesh u hyjnë dhe nga tjetri u dalin problemet që shtron masa. Nuk mund të thuhet se zëri i masës dëgjohet, kur nuk veprohet menjëherë për korrigjimin e kësaj apo të asaj të mete që, me të drejtë, shqetëson masën. Indinjohesh kur mëson se në Korçë uji i pijshëm shfrytëzohet jo me nikoqirllëk, pa llogaritur fare energjinë që harxhohet për të! Po uji është flori! Ka apo nuk ka rregull këtu? Ngarkohet ndërma-

rrja me përgjegjësi për këto apo nuk ngarkohet? Po t'ua ngarkosh dëmin ndërmarrjes, drejtorisë e të gjithë atyre që shpërdorjnë energjinë, do të shikosh pastaj nëse do të harxhohet uji kot.

Të kuptohemi, unë nuk them që për të gjitha këto probleme nuk punohet, por dua të theksoj se ka gjëra që nuk duhen lejuar, që duhen parë, ka edhe të tilla për të cilat duhen marrë vendime e duhet ngulur këmbë kur është e drejtë, e dobishme dhe me leverdi për ekonominë e vendit, duke i bërë llogaritë me laps në dorë. Kështu, për shembull, duhet ngulur këmbë që, më parë se të vijnë makineritë për silicin, të vijnë autobotet, që siç thashë do të bëjnë që të mos na harxhohet kot benzina. Kështu më duket mua duhen parë këto gjëra, sepse janë me rëndësi të madhe për ne.

Në emisionin e lajmeve të Italisë dëgjova të thuhej se atje po mendohet seriozisht që brenda dhjetë apo dymbëdhjetë vjetëve të vihen në shfrytëzim ato miniera qymyri, që kanë qenë braktisur. Tash janë krijuar metoda të reja për të nxjerrë me lehtësi qymyrin, i cili nevojitet medoemos të zëvendësojë naftën. Domethënë ENI<sup>1</sup> për 10 vjet parashikon se do të ketë mungesa në naftë, gazoil etj., prandaj që tash po mendon për t'iu rikthyer e për t'i vënë përsëri në shfrytëzim minierat e braktisura të qymyrit.

Po në vendin tonë, shokë? A do t'u vihet rëndësi qymyreve, hidrocentraleve, naftës e gazit etj., apo nuk

---

1. Ente Nazionale Idrocarbure — Shoqëria Kombëtare e Hidrokarbureve e Italisë.

do t'u vihet?! A e vrasin mendjen të gjithë për të gjetur mjetet dhe mënyrat se si t'i kursejmë këto lëndë, si t'i shesim e si të përfitojmë sa më shumë prej tyre? Ti, Hekuran, të kujdesesh për të kontrolluar se si përdoren lëndët djegëse. Për shembull, për çfarë arsye përdoret në Korçë apo gjetkë uji në mënyrën që thamë, duke harxhuar energji? Po me qymyret ç'bëhet, pse nuk realizohet plani? Për këtë, Hekuran, duhet biseduar me shokët e Qeverisë.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Sot, në orën shtatë, shkova në Minierën e Valiasit, ku mbledha kuadrot kryesorë. Aty na raportoi drejtori për gjendjen në minierë, gjithashtu dëgjua edhe shokët e tjerë, pastaj i porosita që të krijohej një grup pune për ta studiuar këtë problem, duke vënë në krye të tij zëvendësdekanin e fakultetit, i cili më parë ka qenë kryeinxhinier në Minierën e Memaliajt.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë keni vepruar, kështu duhen bërë punët, kështu të veprojmë të gjithë, të mos i zvarritim gjërat, por përnjëherë të marrim masa e të hidhemi në veprime konkrete. Ja, për shembull, ju gjetët mënyrën se si të bashkëpunoni me zëvendësdekanin e Fakultetit të Gjeologjisë e të Minierave, me inxhinierë e punëtorë të vjetër të minierave dhe shpejt e shpejt krijuat grupin për të parë gjendjen në Minierën e Valiasit. Në këtë mënyrë mund të zgjidhen problemet shumë mirë. Nuk duam punë të bëra tërkuzë, nuk kemi nevojë të dëgjojmë historikun e problemit, por kërkojmë që ai të zgjidhet sa më shpejt dhe mirë. Qeveria t'u kërkojë llogari ministrave për detyrat e

ngarkuara, t'i shkundë mirë ata që të mos i zvarritin punët. Kjo është direktiva e Komitetit Qendror. Ministrat të shkunden dhe ta marrin si duhet situatën në dorë. Edhe zëvendësministrat të kryejnë detyrën që u është ngarkuar, edhe komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive, të tërë është e domosdoshme të kryejnë mirë detyrat. Partia jep direktiva, ajo është si kudo edhe në këto organe, udhëheq gjithë veprimtarinë e tyre dhe punon për edukimin e masave, që ato të bëhen të ndërgjegjshme për vënien në jetë të direktivës. Por edhe Qeveria ka ligjet dhe urdhëresat e saj, për zbatimin e të cilave duhet t'u kërkojë llogari të gjithëve nga ana administrative dhe nga ana teknike.

Edhe fushata e korrje-shirjeve, për të cilën u fol këtu, ka rëndësi të madhe, prandaj gatishmëria e mjeteve të mekanizuara të jetë në qendër të vëmendjes. Riparimi i defekteve në kombajna duhet bërë me kohë dhe s'duhet lënë për në kohën e korrjeve. Pastaj pseudozhin kaq defekte kur kombajnat vihen në punë? A kolaudohen ato më parë? Mendoj që komiteti ekzekutiv i këshillit popullor që drejton SMT-në në rreth duhet ta shtrojë këtë problem me forcë në kohën e duhur.

Traktorët ose kombajna të venë në arë të kolauduar. Gjatë punës mund të ndodhin një apo dy defekte, por jo të ngrihen punonjësit e oficinës me gjithë pajisjet dhe të venë në fushë për të bërë nga e para riparimin e tyre.

Çështja nuk është te fakti i të dalit në arë të këtyre mjeteve, por gjatë: punojnë apo nuk punojnë ato në

arë? Në qoftë se riparimet në oficinë janë bërë mirë, s'ka përse të vijnë mekanikët në arë, sepse kombajna do të punojë në rregull. Po të forcohet kërkesa e llogarisë ndaj mekanikëve të SMT-ve, do të rritet cilësia e shërbimeve dhe makineritë bujqësore do të vihen në gatishmëri për punë në kohën e duhur. Ju thoni se në rrethe ngritën edhe problemin e mungesës së karburantit për transportimin e grurit. Po pse «vënë qerren përpara buajve» këta? Pse shtrohet ky problem, kur nuk kanë shirë akoma ose kanë shirë pak? Natyrisht, ky është një problem që duhet zgjidhur, sepse për ta çuar drithin në depot e shtetit nga distanca të mëdha duhen medoemos mjete të transportit automobilistik. Por në distanca të vogla të përdoren për transport edhe qerret, siç tha Hysniu. Pastaj, kur të vijë koha që zgjidhja e këtij problemi të bëhet urgjente, do të marrim masat që drithi të transportohet. Por, nuk më duket se çështja e transportimit të drithit nga kooperativat bujqësore shtrohet tani për të shfajësuar veten, sepse megjithëse shokët e rretheve thonë se janë shumë të shqetësuar, unë nuk shoh të bëhen përpjekje nga ana e tyre për zgjidhjen e problemit. Shqetësimi i vërtetë shkakton impuls për t'u gjetur zgjidhja më e përshtatshme dhe më e shpejtë e problemit. Si u shprehka ky shqetësim, kur nuk korret, kur nuk arrihen normat, kur autokombajnata nuk kolaudohen mirë, ose kur nuk grumbullohet gruri?! Çfarë shqetësimi i thonë këtij?! Në qoftë se ata janë me të vërtetë të shqetësuar, atëherë mekanikën bujqësore që do të shijë grurin do ta vendosin në atë vend, ku distanca është sa më e shkurtër.

tër, me qëllim që të harxhohet sa më pak karburant. Por, në fakt, kjo çështje për ta është si vrima e fundit e kavallit. Ata mund ta kenë grumbulluar grurin, por shumë larg, kështu që makinës shirëse ose traktorit i duhet të bëjë kilometra të tërë deri në vendin e duhur. Po pse t'i bëjë këta kilometra, kur ka mundësi të bëjë më pak?!

E rëndësishme është të evitohen humbjet gjatë korrjeve. Për këtë duhen bërë kontrole e sondazhe se sa del humbja për 1 m<sup>2</sup>. Njerëzit duhet të jenë të shqetësuar për këto humbje, siç the ti, Prokop<sup>1</sup>, dhe të dinë mirë nëse ka ndonjë mundësi për gradimin e pjesës së parë të kombajnës apo jo, nëse kallinjte e gjendur për tokë i ul era apo i lëshon kombajna etj., etj. Në qoftë se kombajnat janë me defekte, mekanikët s'duhet të ankohen, por të fillojnë t'i ndreqin. Përse e kemi ne gjithë këtë bazë mekanike? E dimë që në kohë fushate nuk pret puna, se humbet gruri, prandaj themi që të merren me kohë masat për riparimet e makinerive bujqësore. Na thuhet se kombajnave u kanë caktuar komisarë, kjo është vetëm në letër, se komisarë që të rrinë prapa kombajnës nuk ka.

A e kuptojnë këta njerëz që gruri për ne është flori?

Edhe në një fermë kapitaliste fermeri nuk lejon të humbasë asnjë kokërr grurë. Aq më tepër nuk duhet

---

1. Në këtë takim shoku Prokop Murra, në atë kohë sekretar i KQ të PPSH, informoi për punën që bëhet në rrethet Fier, Lushnjë. Berat në periudhën e korrje-shirjeve dhe të grumbullimit të të lashtave.

të lejojmë humbje ne që e bëjmë bukën vetë me forcat tona e jo si revizionistët, për të cilët rrofshin kreditë që marrin dhe kontratat që nënshkruajnë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për drithërat e për shumë produkte të tjera.

Prandaj, në qoftë se nuk vëmë disiplinë të fortë dhe rregull kudo, në arë, në transport, në depo, do të kemi humbje të mëdha. Kombajnat duhet të futen që në fillim në normë. Ose kur themi që të vihen komisarë në çdo kombajnë, kjo do të thotë që ata ta kryejnë si duhet detyrën, të kontrollojnë çdo proces të punës së kombajnës. A i thonë ndonjëherë ata kombajnierit ta ndalojë kombajnën sepse nuk e ka në rregull, ose t'i shtrëngojë vidhat etj.? Në qoftë se kombajnat janë me defekte, mekanizatorët tanë a nuk mund t'i ndreqin dot? Po qe se ventilatori i kombajnës merr edhe kokrrën e grurit, nuk mund të bëjnë ata diçka që kokrrën ai ta kthejë dhe bykun ta nxjerrë matanë? Për këto e për të tjera probleme të tilla duhet të shqetësohen komisarët e kombajnave, drejtuesit e kooperativave e të ndërmarrjeve bujqësore dhe të marrin masat e nevojshme e të mos kapen që tani pas karburantit.

Po të themi që nuk do të ketë firo në shirjen e grurit, nuk jemi realistë. Ose të kërkojmë që edhe traktorët, edhe kombajnat që janë amortizuar të punojnë siç kanë punuar në fillim, edhe këtë nuk mund ta kërkojmë. Veçse gjatë fushatës së korrjeve dhe shirjeve të bëjmë kujdes më shumë. Çështja e pakësimit të firove është mbi të gjitha. Pra, qenka gruri i rëndë, s'qenka gruri i rëndë, firo duhet të ketë sa më pak. Kjo ka rën-

dësi dhe duhet mbajtur kurdoherë parasysht. Komiteti i Partisë dhe komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të çdo rrethi t'u kushtojnë gjithë vëmendjen problemeve që dalin gjatë kësaj fushate, të shqetësohen seriozisht dhe të marrin masa të gjithanshme që asnjë kokërr gruri të mos na shkojë kot.

Në qoftë se një nga shokët e udhëheqjes vete për problemin e këtyre fushatave të bujqësisë në rreth, në radhë të parë do të thërresë për të biseduar shefin e seksionit të bujqësisë dhe sekretarin e komitetit të Partisë që merret me këtë sektor që të informohet për planin e kooperativave, për sasinë e sipërfaqes së mbjellë me grurë, për numrin e kombajnave, të makinave korreëse, të drapërinjve që janë në gatishmëri për punë, për shpërndarjen e këtyre makinerive bujqësore etj. Po në të njëjtën kohë ai do të interesohet edhe për punët e tjera në bujqësi, si, fjala vjen, për ujitjen, për grafikun e ujitjes, si zbatohet ky grafik etj.

Por kur shkohet në rrethe, duhet biseduar edhe me specialistët që punojnë atje, të cilët i njohin mirë problemet e bujqësisë, ashtu siç duhet të merren kontakte edhe me masat. Kjo do të ndikojë që edhe drejtuesit e rrethit, të kooperativave të lënë zyrat e të shkojnë kooperativë më kooperativë, sektor më sektor, brigadë më brigadë, për t'i ndjekur konkretisht dhe nga afër punët që bëhen atje. Pra jo drejtim nga zyra, por atje ku punohet e prodhohet.

Këtë organizim e metodë pune, këtë kontroll dhe shqetësim të vazhdueshëm duhet ta ketë tërë komiteti i Partisë, komiteti ekzekutiv dhe veçanërisht kryetarët

e kuadrot e kooperativave bujqësore. Ndryshe nuk do të na ecin si duhet punët. A do të përdorim ne një stil revolucionar në drejtim, që të shkojë duke u përsosur, që të mund të përballojmë detyrat dhe punët që kemi përpara? Ne jemi një vend që kemi absolutisht nevojë për një sistem të lartë organizimi, për një metodë pune e drejtimi sa më frytdhënëse e për një kontroll të vazhdueshëm. Edhe sikur të kishim teprica të mëdha prodhimesh bujqësore, shumë mirë do të ishte për ne, sepse për to gjendet kurdoherë treg i jashtëm. Prandaj, krahas kujdesit për grurin, vëmendje i duhet kushtuar edhe misrit, veçanërisht atij hibrid, t'i bëhen të gjitha shërbimet, me qëllim që të marrim rendimente të larta. Për këtë çështje duhet dhënë alarmi në Ministrinë e Bujqësisë, sepse misri plotëson një deficit jashtëzakonisht të madh në ushqimet tona. Por tani, hëpërhë, vëmendja të përqendrohet në korrjen e shirjen e grurit, në dorëzimin e tij shpejt dhe pa firo.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

## **TE ORGANIZOHET ME MIRE PUNA PER MENJANIMIN E HUMBJEVE NE QYMYRET**

*Nga biseda ne takimin ditor te sekretarëve  
te KQ te PPSH*

**28 qershor 1979**

Partia prej kohësh ka dhënë direktiva që të ndërmerren studime për përcaktimin e rrugëve për kursimin e lëndëve djegëse. Tash që e shohim shumë qartë krizën energjetike të botës, të hapim sytë për të bërë kursime seriozisht në këtë fushë. Abdyl Këllezi ishte armik, ai na sabotoi edhe në prodhimin e naftës, por edhe nëpërmjet konsumit të tepërt të lëndës djegëse.

Tashti kërkohet të veprojmë menjëherë për të ndryshuar gjendjen. Mua më duket se kjo punë është nga më të rëndësishmet që duhet bërë sa më parë, se kemi shumë nevojë të kursejmë energjinë, që të jemi në gjendje të eksportojmë.

Raportimi<sup>1</sup> që na bëre ti Hekuran, flet për humbje

---

1. Në këtë takim shoku Hekuran Isai informoi për përdorimin e qymyreve dhe gjendjen në Minierën e Valiasit.

të mëdha të lëndës djegëse, kjo provon se nuk po merren masa. Këtu nuk është puna që të formohen ose jo komisione e stërkomisione, ne duam që kjo gjendje të marrë fund sa më shpejt e jo të zvarritet. Kur vendoset që të ndryshohet diçka, ndryshimi të bëhet jo pas dy ose tre vjetësh, por brenda një kohe shumë të shkurtër. Zvarritjet janë një sëmundje alarmante. Askush nuk duhet të kënaqet kur njerëzit thonë «do ta bëjmë» dhe në fakt punët zgjaten e stërzgjaten për shumë kohë pa u përfunduar. Kur për një gjë na thuhet se «do ta bëjmë», më përpara është e domosdoshme të vritet mendja se si «do ta bëjmë». Veç kësaj, të mos mendohet që gjithçka do ta bëjë shteti. Ky është një problem me rëndësi të madhe. Qymyret i kemi në vend, por ato na humbasin dhe për këtë nuk bëhet llogari. Vetëm me vleftën që llogaritet nga humbjet e qymyrit në Korçë, mund të ndërtohen hangare për të mbrojtur nga lagështira qymyret në gjithë Shqipërinë, lëri pastaj të tjerat.

Mendimi im, Hekuran, është që t'i bëhet një raport Qeverisë ku t'i thuhet se Sekretariati është shumë i shqetësuar për humbjet e mëdha të qymyrit për të cilat kanë raportuar komitetet e Partisë. Në raport të thuhet se problemi u diskutua me specialistët e qymyreve dhe u arrit në disa konkluzione dhe të shënohen të tëra ato që janë vërejtur. Pastaj të vihet propozimi që Qeveria të bëjë një studim po kaq serioz dhe, pa e zvarritur, ai t'i paraqitet Byrosë Politike në një kohë sa më të afërt.

Për sa i përket zbatimit të detyrave që i dalin Qe-

verisë, kjo le të marrë masa, se është përgjegjëse përpara Byrosë Politike dhe Komitetit Qendror, ashtu siç jemi përgjegjës edhe ne si Sekretariat përpara Komitetit Qendror të Partisë.

Mua më duket se të gjitha këto konstatime që kemi bërë ju, janë shumë të drejta.

Në të ardhmen ne do të prodhojmë pjesën dërrmuese të veglave të ndërrimit dhe një pjesë të mirë të pajisjeve të plota. Kjo detyrë është e lehtë për ta thënë me gojë, por, në qoftë se nuk drejtohet dhe nuk organizohet puna si duhet, ajo nuk do të shkojë përpara me atë intensitet dhe me atë përqendrim forcash që kërkojmë. Kur themi të krijojmë një organizëm që do të drejtojë tërë industrinë mekanike që kemi, kjo nuk do të thotë se do të bëjmë ndërtesa të tjera, fjala vjen, për Kombinatin e Autotraktorëve apo për Uzinën Metalike të Gjirokastrës. Ato do të qëndrojnë atje ku janë, por do të drejtohen nga e njëjta qendër, që do të ketë një plan, do të mendojë që t'i shfrytëzojë të gjitha makineritë. Ne nuk mendojmë që, tani, oburra të bëjmë investime dhe t'i braktisim makinat ekzistuese. Përkundrazi, çështja shtrohet për shfrytëzimin sa më të mirë të tyre. Në qoftë se dy makina metalprerëse shfrytëzohen vetëm në një ndërresë, kur nevojat e punës e lypin në dy ndërresa, atëherë këto makina duhet të përqendrohen në një dorë dhe të shfrytëzohen me dy e me tri ndërresa. Kështu mund të themi edhe për kooperimin dhe specializimin sipas planifikimit. Specializimi në prodhim nuk mund të bëhet kur pajisje apo mallra prodhojnë të gjithë dhe vetëm nga një copë dhe aq. Krahas orienti-

meve të drejta, specializimi dhe kooperimi kërkojnë edhe organizim e drejtim të fortë. Më parë se të kryejmë disa procese a prodhime të specializuara kërkohet të përcaktojmë format e organizimit, të përsosim drejtimin. Pastaj kooperimin, specializimin, normimin, modernizimin etj., etj., i bëjmë hap pas hapi duke menduar pastaj, gjatë kësaj kohe, edhe për stampat, për temperimin dhe për procese të tjera me radhë.

Për këtë qëllim të shfrytëzojmë me kapacitet të plotë, me efikasitet dhe në mënyrë racionale makineritë ekzistuese. Veçse nuk mund të vendoset për diçka në një uzinë, herë si thotë njëri e herë si thotë tjetri. Është e domosdoshme që më parë të dëgjohen specialistët, ata që punojnë në atë uzinë, të cilët, duke pasur haber nga specialiteti, ndihmojnë të gjykohet drejt se ç'duhet bërë në perspektivë.

Ne nuk vajtëm në bazë tok me Hekuranin, por i thamë atij të shohë problemin e përdorimit të qymyreve. Kur ai ua shtroi këtë problem specialistëve, ata diskutuan, arsyetuan, shprehu edhe Hekurani mendimet e tij dhe bashkërisht dolën me konkluzione të vlefshme.

Këto gjëra nuk i shtrojmë sot për herë të parë. Ne, pavarësisht nga kriza e madhe energjetike, e kemi shtruar çështjen e kursimit të lëndës djegëse vazhdimisht, por Qeveria nuk ka marrë masat e duhura, siç thamë këtu.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Kjo që thoni ju, shoku Enver, është e lidhur me zbatimin e vendimeve që janë marrë. Vendimet janë të qarta, puna është te zbatimi i tyre.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, te zbatimi i ve-

ndimeve me punë e jo me fjalë. Se rrethet apo dikasteret shpeshherë dalin me pretekstin «s'kemi fonde», por në fakt fonde ka. Shfrytëzimi i tyre është bërë në masën 92 për qind. Atëherë pse nuk përdoren ato, po thuhet «s'kemi fonde»?

Na është thënë me kohë se qymyri i Drenovës ka një përqindje të vogël mineralesh të rralla. Po kështu edhe për mineralin e kromit në minierën e Tropojës na thonë se është i përbërë nga polimetale. A po mendohet të bëhen analiza për këto? Nëse vërtetohet që në përbërjen e tyre ka minerale të rralla dhe po vendosëm ta shesim edhe këtë krom, atëherë në bazë të analizës së përbërjes metalike ta shesim me një çmim më të lartë e të leverdishëm. Meqenëse blerësit e huaj kanë industri për veçimin e mineraleve të rralla, ofrojmë këtë lloj kromi, por me çmim më të lartë. Në qoftë se blerësi i huaj do krom tjetër, atëherë i shesim tjetrin. Pra, në çdo rast duhet të shohim leverdinë që del e të mos veprohet me sy mbyllur. Nuk drejtohet ekonomia pa bërë llogari, se ekonomia është shumë e koklavitur.

Një vendim që merret, sidomos për çështje ekonomike, duhet të shikohet me kujdes, të studiohet mirë. Vendimi merret që të zbatohet dhe zbatimi kërkon organizim, disiplinë, kontroll edhe nga Partia, edhe nga organet shtetërore dhe ekonomike. Por mendoj se një hallkë kyç është veçanërisht forcimi i disiplinës në punë.

Tash, Hekuran, po të kesh mundësi, na thuaj ndonjë gjë të re për gjendjen në sektorin e naftës.

*Pasi shoku Hekuran Isai informoi për disa proble-*

*me në këtë sektor e mori përsëri fjalën shoku Enver Hoxha, i cili tha:*

Në mbledhjen e Byrosë Politike ju, shokë sekretarë, duhet të ngrini në diskutimet tuaja problemet dhe të metat që na pengojnë në sektorin e naftës; mund të flisni, gjithashtu, për çështjen e kursimit të energjisë nëpërmjet përdorimit racional të qymyreve, se ky është një problem i madh. Po nuk u morën masa shtetërore dhe partie në këtë drejtim, ne do të vazhdojmë të kemi humbje në qymyret. Këto janë çështje kapitale, për të cilat duhet të zhvillohen diskutime në Byronë Politike. Për këtë, vetë ne, në radhë të parë, t'i japim tonin e vërtetë diskutimit, që, nëpërmjet rrahjes së mendimeve, të gjendet rruga revolucionare, marksiste-leniniste e zgjidhjes së problemeve, të bëhen përpjekje për të ndër-tuar një metodë të drejtë pune, ndryshe nuk mund të punohet e të ecet si duhet në këtë sektor.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

## NË PUNË SECILI TË MARRË PËRGJEGJËSINË QË I TAKON

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

30 qershor 1979

*Gjatë diskutimit rreth raportit të paraqitur, shoku Enver Hoxha ndërhyri dhe e mori fjalën disa herë. Ndër të tjera ai tha:*

Problemët, shokë, duhet t'i zgjidhim një e nga një, se në qoftë se i mbledhim të tëra në një shportë, atëherë nuk do të dalim dot, kështu nuk do t'u japim dot udhë punëve.

Natyrisht, në realizimin e planit një rol të rëndësishëm luajnë organizimi i punës, sigurimi i materialit etj., por më parë duhen bërë projektet, pastaj shikohet çështja e sigurimit të materialeve dhe organizimi. Por mua më preokupon fakti që, edhe pse kemi nevojë për

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi zbatimin e detyrave të planit të gjashtëmujorit të parë të vitit 1979, në mënyrë të veçantë në bujqësi, në industrinë e naftës dhe në tregtinë e jashtme».

projektues e arkitektë, përse lejojmë që këta të punojnë si teknikë të mesëm, siç u tha këtu. Po të veprohet në këtë mënyrë, atëherë si do të bëhen projektet, kush do t'i bëjë ato?

Po të bëhen më shumë përpjekje, me siguri që materialet që i paraqiten udhëheqjes për problemet e ndryshme do të dalin më të mira. Ç'është e vërteta ne konstatojmë që materialet janë të një standardi dhe një gjë e tillë tregon se nuk ka shumë përpjekje nga ana e shokëve që i përgatitin ato. Ata, bile duhet edhe të shkruajnë në shtyp për këto probleme. Është këtu shoku Agim Popa<sup>1</sup>? Po, këtu qenka! Të ka ardhur në redaksinë e gazetës ndonjë artikull substancial nga shokët e Komisionit të Planit të Shtetit, ty Agim?

Unë kam diçka lidhur me rolin që duhet të luajë Drejtoria e Punës. Edhe herë tjetër e kam shpjeguar gjerë e gjatë rëndësinë e kësaj drejtorie, por fakti që në kryerjen e detyrave nga ana e saj ka akoma të meta më bën që ta ritheksoj një gjë të tillë. Shpërndarjen e forcave të punës të qytetit dhe të fshatit, por sidomos të qytetit duhet ta bëjnë zyrat e punës pranë komiteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve nën drejtimin e Drejtorisë së Punës në Komisionin e Planit të Shtetit. Dhe që shpërndarja e forcave të punës të bëhet si duhet, është e nevojshme që zyrat e punës të bëjnë studime shkencore. Ato të dinë mirë sa forca të lira kanë këtë vit, fjala vjen, dhe sa do të kenë vitin e ardhshëm, të çfarë seksi dhe të ç'moshe i kanë këto

1. Në atë kohë kryeredaktor i gazetës «Zëri i popullit».

forca, të çfarë profili etj. Në qoftë se zyrat e punës bëjnë një punë të tillë për sot dhe për perspektivën, atëherë edhe Komiteti Qendror do t'i japë orientime Partisë në rrethe që të bëhet një punë politike e efektshme dhe e diferencuar sipas veçorive të çdo rrethi e zone, sepse tjetër mentalitet kanë të rinjtë vlonjatë që nuk venë të punojnë atje ku ka front pune, tjetër ata të Librazhdit. Kështu duhet të veprojnë edhe zyrat e punës, t'i njohin këto veçori e koncepte, ndryshe këto probleme, pa organizim dhe pa drejtim politik e organizativ, nuk zgjidhen. Jo të na flitet këtu sikur edhe mobilizimin me rastin e tërmetit, kur e gjithë Shqipëria u ngrit në këmbë, e bënë zyrat e punës. Jo, plot të rinj shkuan për të punuar në zonat e dëmtuara nga tërmeti vetë me iniciativën e dëshirën e tyre. Ose kemi rastin e Tiranës: ata që u dërguan për të punuar në Minierën e Valiasit, i dërgoi komiteti i Partisë apo zyra e punës? I dërgoi komiteti i Partisë.

Me këtë dua të them secili të bëjë punën e tij, nën udhëheqjen e Partisë. Shpeshherë drejtuesit e dikastereve e mënjanojnë byronë e organizatës-bazë të Partisë. Ata mbledhin kolegjiun, por byroja e Partisë që udhëheq punën në ministri, as nuk ftohet, as pyetet, as nuk vihet në dijeni për atë që diskutohet e vendoset. Këto gjëra kanë rëndësi parimore, prandaj t'u kushtohet vëmendja e duhur. Partia nuk drejton me letra, por efektivisht. Prandaj ministri, pasi kthehet nga mbledhja e Qeverisë, ku merren vendime të rëndësishme, duhet, në radhë të parë, të takohet me byronë e Partisë dhe pastaj të vejë në kolegjiun, ku të tho-

të që Qeveria vendosi kështu për këtë apo për atë problem, kurse byroja e Partisë e dikasterit vendosi të veprojë në këtë apo në atë mënyrë. Por a bëhet kjo? Unë jam informuar se nuk veprohet kështu.

Lidhur me studimin për kursimin e karburantit, për të cilin u fol këtu, unë them se ç'del nga ai kur automjetet lëvizin vend e pa vend dhe harxhohet karburanti pa hesap. Çështja është se për këtë ka vendime, por as Qeveria, as ministrat nuk e kanë situatën në dorë që të zbatohet vendimi i drejtë që është marrë për kursimin e karburantit. Qeveria e mori këtë vendim, ministrat në mbledhje ngritën dorën, por në praktikë... vjen pastaj Themija<sup>1</sup> këtu e na thotë që më mbetën traktorët pa punë se nuk ka benzinë, se kështu e ashtu. Fakt është se sasia e benzinës që u jepet dikastereve për qëllime pune, harxhohet nga autoveturat duke çuar fëmijët, hallën apo tezen andej-këtej ose duke vajtur në krushqi. Kështu që kur vjen puna për të realizuar planin, s'kemi benzinë, thonë.

Për zbatimin e këtij vendimi të Qeverisë, nuk them se duhet të luftosh vetëm ti, Adil [Çarçani]<sup>2</sup>, jo, kështu nuk bëhet kjo punë. E gjithë Partia, i gjithë pushteti dhe të gjithë njerëzit që i përdorin automjetet duhet të luftojnë për të zbatuar vendimin e Qeverisë për kursimin e karburantit. Ndryshe si do ta kontrollojmë ne vënien në jetë të vendimit? Këto probleme është e do-

---

1. Themije Thomai, në atë kohë ministre e Bujqësisë.

2. Në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të RPSSH.

mosdoshme t'i kuptojmë pak thellë në mënyrë që të ecim përpara.

Këto unë i ngre për të theksuar një gjë: të gjithë ne mund të bëjmë gabime në punë dhe shokët mund të na kritikojnë e duhet ta bëjnë këtë. Nga ana jonë kritikata ne duhet t'i marrim me seriozitet dhe të mos kemi frikë të pohojmë hapur: «Ja që e bëra këtë gabim, more shokë». Në këtë rast shokët do të thonë bravo dhe do të të ndihmojnë. Por që të mos e marrësh përsipër gabimin, nuk është e drejtë, përkundrazi, është shumë e gabuar, sidomos për një udhëheqës.

Tash vjen çështja tjetër, për të cilën fola dhe pak më parë. Unë u kam thënë të tërë shokëve të tjerë që, kur kanë ndonjë problem të rëndësishëm, mund të vijnë edhe drejtpërdrejt tek unë. Jemi anëtarë të Byrosë Politike dhe unë jam Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë. Ju mund të mendoni se «e zgjidhni problemin me kryeministrin, prandaj ç'të shkojmë te shoku Enver». Unë nuk them se ju nuk i zgjidhni problemet, por përse të mos vish ti, shoku Pali<sup>1</sup>, për shebull, të më informosh? Natyrisht nuk do të më informosh për të tëra problemet, se edhe sektorët janë të ndarë. Pa le ministrat, asnjë nuk duket tek unë.

Takimet që bëni çdo ditë ju shokët e Kryesisë së Këshillit të Ministrave, do të thoja se kanë rëndësi të madhe. Ato në vetvete, në fakt, janë mbledhje Kryesie, megjithëse nuk bëhen me rend dite. Edhe ne shokët

---

1. Pali Miska, në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave.

sekretarë takohemi çdo ditë, një orë ose një orë e gjysmë, ku trajtojmë probleme nga më të ndryshmet. Ndërsa në mbledhjen e rregullt të Sekretariatit, që bëhet një herë në muaj, marrim në analizë një ose dy probleme. Këto takime, ku diskutojmë e rrahim mendime për gjëra nga më të ndryshmet, në fakt, janë mbledhje të vërteta.

Edhe ju zëvendëskryeministrat nuk do të takoheni për të bërë muhabetë, por për të dhënë mendime se si qëndron ky apo ai problem. Prandaj them që këto takime që bëni çdo ditë duhen vlerësuar si mbledhje të Kryesisë, në kuptimin që secili para se të vejë atje, përgatitet, sistemon ato gjëra që ka ndeshur ato ditë, apo bën edhe ndonjë konsultë a diskutime me disa ministra për problemet e sektorit që mbulon. Këto ndihmojnë që ju vetë t'i keni më të qarta problemet dhe t'i parashtroni siç duhet. Natyrisht, këto nuk janë mbledhje zyrtare, por kurdoherë takimet tona i shërbejnë qartësisimit e konkretizimit të këtij apo atij problemi.

Në materialin që na është paraqitur, thuhet se plani për prodhimin e pjesëve të ndërrimit është realizuar 96 për qind. Atëherë unë bëj pyetjen, kur është realizuar në atë masë plani, përse na mungojnë pjesët e ndërrimit? Çështjen e kam në paraqitjen e gjendjes. Pra, nga njëra anë thuhet se plani realizohet, kurse nga ana tjetër na thonë nuk ka vegla ndërrimi.

Situata është e tillë që do të na duhet të kapërcejmë mjaft vështirësi. Për këtë të gjithë duhet të jemi të qartë. Byroja Politike ta kuptojë mirë këtë situatë se në masat punonjëse ka vërtet vullnet e dëshirë

të madhe, bëhet edhe punë, por në praktikë vihen re edhe plot mungesa, dalin edhe vështirësi gjatë realizimit të detyrave. Ne do të bëjmë çdo përpjekje, por mundet që edhe të mos realizohen dot të tërë objektivat në kohën e parashikuar.

Problem është veçanërisht respektimi i afateve dhe kryerja e detyrave që kanë dikasteret për eksportin. Për këtë të kërkohet edhe të jepet më shumë llogari nga dikasteret. Kështu duhet vepruar, se ndryshe nuk mund të ecë kjo punë. Pra në qoftë se është kontraktuar që do të japim gazoil, do të japim medoemos. E jo kur të vijë tankeri atje në port, atëherë të thuhet që nuk ka, se nuk është realizuar plani. A... kjo gjë është e palejueshme. Qëndrime të tilla nuk janë korrekte, ato bëjnë që në të ardhmen i huaji të mos ketë më besim te ne.

Secili të bëjë detyrën, të merret me ato probleme që duhet të merret, të mbajë përgjegjësinë që ka dhe jo t'ua lërë të tjerëve. E keni lexuar shkrimin që për të bërë një palë mobilie ata të shtëpisë së kulturës në Fier (e cila ka fondet e veta për këtë) venë i thonë drejtuesit të ndërmarrjes përkatëse na bëj këto ja ku i ke edhe paratë? Jo, i përgjigjen atje, ik merr nga seksioni i komitetit ekzekutiv një shkresë, pastaj hajde këtu të bisedojmë. Kurse ai i seksionit të komitetit ekzekutiv i përcolli në ministri, e cila i kthen përsëri te seksioni i komitetit ekzekutiv në rreth. Dhe më në fund një «bujari e madhe»: kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit firmos urdhrin.

Ç'është kjo punë, kështu xhanëm?! Si të vejë pu-

na deri në ministri për disa frona e ku ta di unë se për çfarë mund t'i nevojiten një shtëpie kulture?!

Lidhur me dhënien e devizës, për të cilën u fol këtu, unë, shoku Adil, mendoj se parimi që kemi vendosur që Qeveria të jetë e shtrënguar për të dhënë devizë, është i drejtë. Kjo nuk ka diskutim. Mirëpo ka disa degë të industrisë apo ku di unë se çfarë, për të cilat duhet medoemos të sjellësh pjesë këmbimi nga jashtë. Për këtë Qeveria i ka dhënë Ministrisë së Tregtisë së Jashtme fondet e caktuara, sepse mbahen parasysh vështirësitë e brendshme dhe të jashtme. Prandaj kur bëhet një kërkesë për valutë të huaj duhet të merren parasysh të tëra këto situata. Se ja ç'ndodh, që, siç më kanë thënë, fondet për elektrodën e ferro-kromit mund të jepeshin më përpara.

Për sa i përket problemit të evadimit të grurit duhet pasur kujdes që ai të mos na dëmtohet. Prandaj të forcohet puna me njerëzit për ruajtjen e pronës.

Theksi duhet vënë te realizimi i detyrave nga të gjithë. Shembullin do ta japë klasa punëtore dhe organizatat e bashkimeve profesionale ta luajnë mirë rolin e tyre. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për ecjen përpara. Ku kemi qenë e ku jemi tash. Pa dyshim që kanë ndodhur ndryshime të mëdha, kolosale. Pra, nuk themi se nuk punohet. Por Partia kërkon që të realizohen vendimet e direktivat deri në një. Ja, ç'po themi ne, këtu, që po bëjmë këto kritika të forta? Mos vallë mendojmë që nuk punohet? Jo, në asnjë mënyrë. Sot realizohen gjëra të mëdha, që nuk na i merrte mendja, por këtu diskutojmë që të bëhen edhe më mirë. Pra-

ndaj këtë situatë është e domosdoshme ta kuptojmë një cikël më mirë, që në praktikë të ketë sa më pak shkelje të disiplinës, sa më pak mungesa në punë etj., etj. Çështja shtrohet t'i zvogëlojmë këto të meta, prandaj po luftojmë që të gjejmë forma dhe metoda më të përshtatshme.

Më duket se në mbledhjen e sotme, që u zhvillua në frymën e një kritike me të vërtetë konstruktive, u shtruan mjaft probleme të rëndësishme. Mendoj se për këto tash duhet të reflektohet mirë nga Partia, nga pushteti dhe nga të gjitha organet dhe organizatat e tjera që të arrijmë përmirësime në zbatimin e detyrave të planit në gjashtëmujorin e dytë. Suksese kemi, por kemi edhe të meta, të cilat duhet të na preokupojnë, prandaj t'i shikojmë në sy, si i thonë fjalës, mbasi shkaqet e tyre janë të shumta. Të metat që vihen re janë edhe të mëdha, janë edhe të vogla. Të mëdhatë s'ka dyshim që prishin punë, por edhe të voglat prishin punë, se, po t'i lësh të kalojnë, bëhen një tog i madh që pengojnë punën.

E theksova se shkaqet që shfaqen këto të meta në punë janë të shumta, por dy janë kryesoret: të brendshme, subjektive; janë edhe të jashtme, objektive. Do të përpiqemi që shkaqet e brendshme, e si pasojë edhe të metat që rrjedhin prej tyre, t'i luftojmë dhe t'i drejtojmë, se e kemi në dorë vetë. Por, gjithashtu, do të bëjmë përpjekje edhe në drejtimin tjetër.

Ashtu si në mbledhjet e plenumit të Komitetit Qendror, edhe në mbledhjet e Byrosë Politike duhet të ndjekim praktikën që të mos merremi me shumë

probleme, por, fjala vjen, me dy ose tre më të rëndësishme, sepse kështu edhe u shkohet më thellë atyre, por i lëmë mundësinë Qeverisë të merret edhe ajo me probleme të një nomenklature të rëndësishme. Ne këtu, duke i analizuar këto probleme, japim orientimet bazë dhe pastaj kërkojmë llogari për zbatimin e tyre. Kjo praktikë pune është më e mirë sesa të analizojmë nga pak të tëra problemet.

Kjo, më duket mua, kërkon një bashkëpunim e bashkëveprim më të ngushtë me njëri-tjetrin, kërkon të punohet jo në mënyrë burokratike. Pra, për probleme të ndryshme të marrim kontakte të vazhdueshme me njëri-tjetrin, duke diskutuar së bashku e jo të komunikojmë nëpërmjet letrave e shkresave. Pse themi unë me diskutime? Se këto janë shumë të efektshme. Një nga shokët, për shembull, mund të vijë të më ngrejë mua një problem. Diskutimi që do të bëjmë rreth këtij problemi mund të na marrë edhe një orë kohë, por gjatë kësaj kohe mund të na dalin edhe dy-tre çështje të tjera që i ka ai ose i kam unë në kokë dhe, meqenëse jemi duke diskutuar e meqë ne mund të mos takohemi përditë, atëherë shtrojmë edhe problemet e tjera, diskutojmë si është kjo çështje e si duhet të jetë. Kurse vetëm me letra dhe pa kontakte me njëri-tjetrin, më duket se nuk zgjidhen këto punë. Një praktikë e tillë të ndiqet deri në bazë që nga ministria e në ndërmarrje etj., sepse konstatoj se për zgjidhjen e shumë problemeve me rëndësi të madhe ministritë, drejtoritë e tyre veprojnë me shumë letra e me shumë

shkresa me rrethet. Natyrisht, kur them kështu, nuk kam parasysh kritikën që bën revista «Hosteni», por kryesisht ato çka shkruan organi zyrtar i Komitetit Qendror të Partisë, gazeta «Zëri i popullit» dhe organet e tjera. Prandaj të luftojmë për ta çrrënjësuar një metodë të tillë pune.

Me këtë rast doja të thosha se është mirë t'i mësojmë njerëzit në bazë që të reflektojnë menjëherë kur lexojnë në gazetën «Zëri i popullit» ose në organ tjetër një artikull kritik për ndonjë ndërmarrje, për ndonjë drejtor a përgjegjës etj. Ata, të cilëve u drejtohet artikulli, përnjëherë ta marrin në studim këtë dhe jo vetëm t'i dërgojnë një letër redaksisë ku t'i shkruajnë se e gzykuan të drejtë kritikën që u bëhet, por ta studiojnë mirë dhe të reflektojnë menjëherë, duke marrë masa në vend që të mos përsëritet më ajo për të cilën kritikohen. Por t'i mësojmë, gjithashtu, njerëzit që artikulli kritik t'u shërbejë edhe të tjerëve, dhe jo të mendohet se meqë ai nuk është për ta, por për një ndërmarrje tjetër, për një rreth tjetër, nuk kanë pse ta diskutojnë. Jo, unë mendoj se në tëhun e asaj kritike duhet ta shohin veten edhe ndërmarrje të tjera që nuk janë në rregull me zbatimin e detyrave. Kjo gjë më duket mua nuk bëhet mirë.

Direktivat e Partisë nuk duhen dhënë vetëm me vendimet ose me buletinet, por edhe nëpërmjet shtypit. Prandaj kur pyeta këtu për shokët a shkruajnë ndonjë artikull, e kisha fjalën që jo t'ua kërkojë «Zëri i popullit», por vetë ata që kanë dijeni të gjera për çështjet e planit ose për probleme të tjera që ndjekin,

e dinë ku na dhemb e ku i kemi vështirësitë, prandaj t'u thonë shokëve të sektorëve të tyre ose edhe vetë të shkruajnë artikuj në gazetë. Në këta artikuj të vënë në dukje pikat e dobëta ku duhet përqendruar puna. Pra, të mos mendohet që ky ose ai shok është një autoritet prandaj duhet që atij t'ia kërkojë artikullin «Zëri i popullit». Jo, nuk është kështu. Ai vetë ta ndiejë si detyrë që të shkruajë për shtypin. Kjo tregon interesim dhe flet për atë që kuadrot, specialistët nuk i zë gjumi. Pra, po të jetë kështu që nuk na zë gjumi, atëherë duhet vrarë mendja si të veprohet për zgjidhjen e një problemi. Duke organizuar mbledhje? Po pse të bëhet çdo gjë me mbledhje? A ka më mirë kur ia bën të njohur gjithë popullit atë çështje nëpërmjet shtypit? Pra, duke shkruar një artikull, komunikohet drejtpërdrejt me masat, me shumë nga ata që janë të interesuar për zgjidhjen e atij problemi. Partia të kujdeset që masat dhe komunistët ta lexojnë shtypin, ta lexojnë artikullin në fjalë, të diskutojnë dhe të marrin masa. Mirëpo sa ndiqet një praktikë e tillë? E theksoj që të mos mbetemi vetëm me diskutime, por të marrin konkretisht masa, se në këtë mënyrë duhet ta kryejmë punën edhe ne këtu.

Mua më duket se kritikak që bëjmë këtu na ndihmojnë, na forcojnë. Ne jemi anëtarë të Byrosë Politike apo anëtarë të Qeverisë, prandaj të gjithë t'i presim me çiltërsi ato kritika që janë të drejta. Për këto ne këtu diskutojmë së bashku, siç diskutuam, për të arritur në konkluzione të drejta.

Mënyra e diskutimit dhe vënia në dukje e të meta-ve në asnjë mënyrë të mos kuptohet se punët nuk ecin. Punët ecin dhe ecin në një mënyrë të kënaqshme edhe pse ndodhemi në vështirësi, në kushtet e këtij rrethimi politik, ideologjik dhe ekonomik. Duhet t'i kuptojmë këto gjëra se janë reale, megjithatë përpjekjet po bëhen që popullit t'i plotësohen nevojat, sepse ai duhet të gjejë çdo gjë në treg. Është e vërtetë se duhet të luftojmë që të ketë më shumë këpucë për fëmijët dhe të jenë edhe më të bukura, po sidoqoftë, megjithëse ne nuk jemi të kënaqur në këtë drejtim, prapë ata pa këpucë nuk janë. Edhe me zarzavate gjithashtu furnizohet populli, po do të ishte shumë mirë sikur të kishim edhe për të eksportuar, sepse do të krijonim devizë. Kështu duhet të mendojmë për të gjitha gjërat, që edhe në këto situata t'i kapërcejmë vështirësitë dhe të ecim përpara.

Është e vërtetë që vështirësi kemi, megjithatë inflacion nuk kemi, ngritje çmimesh jo e të tjera, por të punojmë më mirë që t'i përgjigjemi nevojave të popullit tonë patriot dhe kaq heroik, i cili ka kaq besim te Partia.

Kam besim se kjo mbledhje do të na shërbejë neve, do t'i shërbejë edhe Partisë dhe kam bindjen se situatën në gjashtëmuorin e dytë do ta përmirësojmë. Për këtë unë kam bindje që do të bëhet.

Rëndësi ka që secili duhet t'i marrë detyrat një nga një dhe të studiojë ç'detyra ka Partia, ç'detyra ka

pushteti, q'detyra kanë bashkimet profesionale, organizatat e rinisë e të tjera. Të gjithë e një nga një të marrin përgjegjësinë që u takon.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# **KRONIKA E NGJARJEVE TË KËTYRE DITËVE DHE ÇFARË KONKLUZIONESI MUND TË NXJERRIM PREJ TYRE**

**Shënime**

**19 korrik 1979**

## **Kriza e naftës dhe ndikimi i saj në botë**

Detyra jonë e madhe është të vigjilohet dhe ta ruajmë atdheun tonë socialist nga pasojat që mund të shkaktojnë turbullirat e mëdha e të thella që po ngjasin në botë. Për këtë arsye po ndjek vazhdimisht me kujdesin më të madh situatat ndërkombëtare dhe përpiqem, aq sa mund të gjykoj, t'u jap disa shpjegime ngjarjeve të veçanta dhe të përgjithshme, reperkusioneve që këto kanë në botë dhe rrezikut që mund t'i vijë vendit tonë nga përplasjet e mëdha, nga kontradiktat e thella dhe nga kriza shumë e madhe që po e bren përbrenda botën kapitaliste.

Është fakt i padiskutueshëm që kriza ekonomike po thellohet dhe ka mbërthyer në grykë gjithë botën kapitaliste, pa përjashtim, e në radhë të parë imperia-lizmin amerikan.

Siç e kam shënuar në Ditarin tim, imperializmi amerikan mendoi se arriti një sukses «të madh» me marrëveshjen që bëri me Kinën. Marrëveshja Ten Hsiao Pin-Karter u trumbetua si një fitore «e madhe» kino-amerikane. Nuk mund të themi se për Shtetet e Bashkuara të Amerikës kjo ishte një fitore e vogël, kurse për Kinën kjo marrëveshje ishte një fiasko, në kuptimin që ky vend i rraskapitur, i dobësuar e në krizë të odollojtë, tash u fut në robërinë e kapitalizmit botëror dhe kryesisht të atij amerikan, japonez dhe gjermanoperëndimor. Mirëpo megjithëse e arritën këtë të ashtuquajtur sukses, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e ndiejnë veten të pasigurt. Vetë Karteri në fjalimin që mbajti kohët e fundit<sup>1</sup>, pohoi se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ekziston një mosbesim i madh në vetvete i kombit amerikan, një mosbesim në zhvillim, pra një tronditje e thellë në fuqinë ekonomike dhe në rrezatimin e mënyrës së jetesës amerikane.

Natyrisht, fjalët e Karterit pasqyrojnë realitetin dhe ai nuk i tha këto nga e mira, po nga e keqja, sepse ndodhet në pozita shumë të vështira. Imperializmit amerikan ia kanë vënë këmbët në një këpucë, në radhë të parë, vendet prodhuese të naftës e partnerët e tij në NATO, si dhe vende të tjera në të gjithë botën mbi të cilat ai bënte ligjin, investonte dhe zhvillonte ekonominë e tij në të gjitha fushat, industriale, bujqësore dhe

---

1. Fjalim drejtuar kombit, i mbajtur në televizionin amerikan më 15 korrik 1979, pas kthimit nga Kemp Dejvidi.

ushtarake, duke rënduar, në radhë të parë, mbi kurri-  
zin e popujve që shfrytëzonte.

Kriza e naftës, ose, siç e quajnë më gjerësisht, kri-  
za botërore energjetike, që lidhet me pakësimin e pro-  
dhimit dhe me rritjen e vazhdueshme të çmimit të shi-  
tjes së naftës nga vendet prodhuese, është një nga fak-  
torët themelorë, e cila i rëndon ose i pakëson pasojat e  
krizës së përgjithshme ekonomike. Në shumë ngjarje  
politike, kriza qeveritare, rënie të prodhimit të përgji-  
thshëm industrial, luhatje apo zhvlerësim të papërmbaj-  
tur të kësaj apo të asaj monedhe, çrregullime kolosale  
në transportet e të gjitha llojeve, rritje të çmimeve apo  
mospërballim të pasojave të rënda të dimrave të më-  
dhenj, nafta ka ndikimin e saj, është, si të thuash, çelësi kryesor i keqësimit ose i përmirësimit të gjendjes,  
i kalimit ose i thellimit të vështirësive. Për vënien në  
dorë ose jo të naftës, ngrihen e bien monopole e banka  
të mëdha, qeveri e parti të ndryshme të borgjezisë ka-  
pitaliste e revizioniste.

Efektet tronditëse të mungesës së naftës, të kësaj  
lënde të parë me rëndësi jetësore për ekonominë dhe  
për makinën e luftës të shteteve imperialisto-revizionis-  
te, u dukën në mënyrë shumë të mprehtë në vitin 1973,  
kur arabët shpallën bojkotimin e vendeve perëndimore  
që përkrahnin Izraelin. Kjo bllokadë, mendoj unë, u  
tregoi vendeve arabe, prodhuese të naftës, se nëpër-  
mjet kësaj arme mund të gjunjëzojnë Izraelin, padro-  
nët e tij, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe çdo ar-  
mik tjetër të tyre. Por, për këtë ata duhet të hedhin  
poshtë presionet e gjithanshme ekonomiko-politike e

ushtarake, si dhe intrigat që luhën nëpërmjet vendeve grevëthyesë prodhuese të naftës.

Kriza e naftës e tronditi në një mënyrë të atillë imperializmin amerikan sa që fjalimi i Karterit, pavarësisht se, sikurse u tha, mundi të kishte aprovimin e një përqindjeje relativisht të mirë të shtresave të mesme të popullsisë amerikane, shkaktoi kundërshtimin e korporatave dhe të trusteve të mëdha, të cilave Karteri u cenoi të ardhurat jo vetëm për arsye të mungesës së naftës dhe të moszhvillimit të industrisë (sigurisht të pjeshme) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për një periudhë krize, por edhe sepse imperializmi amerikan kërkon të dalë nga situata e rëndë në të cilën ndodhet, i kredhur në detyrime të mëdha që arrijnë miliarda dollarë, sidomos ndaj Japonisë dhe ndaj Republikës Federale të Gjermanisë. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të dalë nga kjo situatë dhe për të mbajtur disi të palëkundshme vlerën e dollarit, i ngarkoi me taksa të reja trustet dhe koncernet e mëdha amerikane. Por, natyrisht, po t'i prekësh ato në kallo, menjëherë hidhen përpjetë dhe kjo «dansë» u vërtetua me dorëheqjen e gjithë kabinetit të Karterit. Tash ka dy ditë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës s'kanë qeveri; i gjithë kabineti dha dorëheqjen. Kjo tregon për një krizë të madhe dhe, me aq sa njohim, është e para krizë e këtij lloji, që i tërë kabineti i një presidenti amerikan të japë dorëheqjen. Këtë e bënë jo vetëm pjesëtarët e kabinetit, por edhe shumë funksionarë të lartë të Shtëpisë së Bardhë. Me siguri atje do të ngjasë ashtu siç thotë francezi: *Prendre les com-*

*mandes*<sup>1</sup>. Edhe Karteri do të marrë përfaqësues të tjerë të trusteve, do të bjerë në ujdi me ata që janë të revoltuar dhe do të formojë një kabinet tjetër, i cili do të vërë në zbatim çfarë tha ai, në qoftë se ia pranon Senati Amerikan. Ndryshe do të fillojë «dansa» edhe për vetë personin e Karterit, i cili mund të fluturojë në mos aktualisht, por në zgjedhjet e ardhshme, duke puthur prapun e Shtëpisë së Bardhë, për të mos u kthyer më atje.

Kriza e naftës u shkaktoi Shteteve të Bashkuara të Amerikës një gjendje të rëndë ekonomike, që, natyrisht, ka edhe rrjedhime politike. Kështu, atje po ngrihen çmimet, po shtohet papunësia, po shtohet inflacioni. Këto dy ditë nga mbikëqyrjet që i janë bërë kursit të dollarit, shihet se ky vazhdon të bjerë në krahasim me monedhat e tjera të Evropës Perëndimore. Merret me mend deri ku ka arritur puna, sa edhe lireta italiane ngrihet e dollari amerikan ulet. Konkluzioni është se lideri i imperializmit, imperializmi amerikan, po pëson një disfatë të madhe politiko-ekonomike.

Mungesën e naftës imperialistët amerikanë dhe kapitalistët e tjerë e ndiejnë si mungesën e «gjakut». Natyrisht, kur mungon «gjaku» duhet luftuar që të fitohet ky «gjak», pra duhet fituar nafta, prandaj edhe situata ndërkombëtare bëhet akoma më e rrezikshme, shtohen kërcënimet e një lufte botërore ose të luftërave lokale. Mirëpo pa naftë është e pamundur që të zhvillohet lufta botërore në atë shkallë e me ato pasoja

---

1. Frëngjisht — merrni frenat në dorë.

si e mendonin imperialistët amerikanë e të tjerë si dhe socialimperialistët sovjetikë njëkohësisht.

Edhe nënshkrimi i Traktatit Egjiptiano-Izraelit u duk se ishte një sukses për imperializmin amerikan. E kam theksuar se ky traktat u realizua nën patronazhin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat duan të kenë në Lindjen e Mesme jo një po dy kobure, për të ruajtur krahët e pellgut të naftës nga një invadim politik-ekonomik e më vonë ushtarak i sovjetikëve. Megjithatë duhet theksuar se armiqësia e imperializmit amerikan me vendet arabe mbetet. Natyrisht, kjo është armiqësi e diferencuar për arsye se mungon ai unitet që duhet të ekzistojë midis vendeve arabe për t'iu kundërvënë intrigave të mëdha të imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik. Sidoqoftë Traktati Egjiptiano-Izraelit i zemëroi shtetet e tjera arabe, të cilat e kundërshtonin këtë traktat kush më nxehtë e kush më ftohtë, por ne të gjithë mund të themi se ky kundërshtim ishte mesatar. Ky kundërshtim u shfaq natyrisht, më me forcë në Iran ku u rrëzua shahu dhe u ngadalësua nxjerrja e naftës dhe shitja e saj, në radhë të parë, tek amerikanët. Por edhe tek të tjerët u reflektua e si pasojë u ngritën çmimet e naftës. Edhe Arabia Saudite u bashkua në këtë veprim, megjithëse është mike, si me thënë, e amerikanëve; ajo veprimi pa e prishur, por edhe pa e shfaqur këtë miqësi në mënyrë të hapët. Këto situata shkaktuan që brenda në vendet arabe të nxiten mosmarrëveshjet midis tyre dhe është e kuptueshme që këto mosmarrëveshje vijnë si rezultat i politikës së përgjithshme të imperializmit

amerikan, të kapitalizmit botëror dhe të socialimperializmit sovjetik, duke futur këtu edhe socialimperialistët kinezë, të cilët në këto situata duan të përfitojnë.

Në këto kushte u bënë përpjekjet për bashkimin e Sirisë me Irakun, mirëpo ky bashkim rezultoi me dorëheqjen e Al Bakrit dhe të kryetarit të partisë «Baas» dhe me ardhjen në fuqi të një zëvendësi tjetër të Al Bakrit e të kryetarit të kësaj partie. Kjo duhet të ketë ndodhur jo pse Al Bakri ishte plak. Jo, Al Bakri s'është plak, porse nuk dihet mirë se sa ishte i lidhur ai me sovjetikët. Unë mendoj se në Irak sovjetikët i luajnë të dyja kartat, edhe të kurdëve, edhe të Al Bakrit. Tash, në këto turbullira, sovjetikët kanë vënë në lëvizje kurdët, të cilët po ngrihen në Irak, në Siri, në Iran. Natyrisht, një gjë e tillë është në favorin e sovjetikëve dhe në disfavorin e amerikanëve. Kështu që CIA, e cila pësoi një disfatë të madhe në Iran, tash po përpiqet të fitojë terren. Sa dhe si do t'ia arrijë kësaj, ne duhet të vëzhgojmë.

Për të dalë nga gjendja në të cilën ndodhen, popujt dhe vendet arabe duhet të arrijnë të krijojnë një unitet të vërtetë veprimi kundër imperializmit amerikan dhe reaksionit në fuqi. Prandaj tash çështja shtrohet se si këta popuj e këto vende do t'i rezistojnë prisionit të imperialistëve të jashtëm e reaksionit të brendshëm dhe si do të manovrojnë me dy problemet e rëndësishme që unë mendoj se u takojnë edhe Lindjes së Mesme, edhe luftës ose paqes botërore: çështja e të drejtave të popullit palestinez dhe çështja e naftës. Këto e them sepse amerikanët, me masat që morën dhe

me masat e tjera që do të marrin, brenda 10 apo 15 vjetëve, për të prodhuar benzinën sintetike dhe për të futur në shkallë edhe më të gjerë në shërbim të energjetikës qymyret dhe fuqinë diellore apo atë bërthamore, i bëjnë presion ekonomik OPEK-ut. Me këtë ata duan t'u thonë shteteve prodhuese të naftës se nuk do të kenë më fitime të mëdha nga nxjerrja e saj, kurse, në fakt, vendet arabe, megjithëse e kanë shitur naftën si me thënë për pesë grosh, përsëri kanë pasur fitime kolosale, natyrisht, jo populli, por shahu, mbretërit, sheikët.

Në fjalimin që mbajti këto ditë Karteri i kërcënoi vendet arabe edhe me thikë, kur tha se OPEK-u qëndron me thikë hapur kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Natyrisht, me këto fjalë ai donte të tregonte që edhe Shtetet e Bashkuara do ta ngrenë thikën kundër OPEK-ut. Zaten thikën e kanë mbajtur kurdoherë jashtë këllëfit Shtetet e Bashkuara të Amerikës, aq më tepër do ta mbajnë tash kur u rrezikohen interesat.

Pra, të dyja superfuqitë manovrojnë shumë në Lindjen e Mesme. Begini dhe Sadati po bëjnë vazhdimisht takime e po forcojnë «miqësinë» e tyre. Në parlamentin egjiptian Sadati propozoi dhe parlamenti ia aprovoi që Egjipti t'i japë strehim shahut. Ky është një kërcënim i drejtpërdrejtë për revolucionin iranian. Populli i Iranit vihet para alternativës: ose ky të nënshtrohet e të vijë në ujdi me imperializmin amerikan, ose do të kërcënohet me kthimin e shahut në Iran. Nëse ky do të rikthehet apo jo, kjo varet nga populli iranian, por hëpërhë është e zorshme.

Çështja e naftës është bërë epiqendra e intrigave dhe e makinacioneve të mëdha botërore, sepse me këtë janë të ndërlikuara të gjitha vendet.

Edhe Bashkimi Sovjetik është i ndërlikuar në këtë problem kaq të madh, sepse edhe ky, tok me imperializmin amerikan, ka hyrë në një krizë të papërshtatshme, për të mos folur pastaj për Kinën e Hua Kuo Fenit e të Ten Hsiao Pinit, e cila është në një rrëmuje të madhe.

Kriza e naftës i ka prekur edhe vendet e «Evropës së Bashkuar», të cilat janë alarmuar dhe kanë marrë masa, bile masa drakoniane, natyrisht, në kurriz të popujve të tyre, sepse nuk ka akoma shenja që të duket se trustet, kartelet, shoqëritë shumëkombëshe evropiane po e ndiejnë si duhet krizën e madhe që i ka mbërthyer. E gjithë pesha e kësaj krize ka rënë në kurrizin e punonjësve të këtyre vendeve të «Evropës së Bashkuar». Çdo ditë miliona prej tyre hidhen në grevë. Kjo dëshmon për keqësimin e situatës në këto shtete kapitaliste dhe për përpjekjet që bëjnë regjimet e tyre për të hedhur poshtë kërkesat e masave punonjëse, për të shtypur revoltat dhe kryengritjet që mund të shpërthejnë atje. Sidoqoftë, në këto vende vazhdon të rritet me të madhe papunësia, çmimet po ngrihen në qiell, inflacioni është i madh, pasiguria në punë dhe pasiguria e jetës së njerëzve s'kanë të mbaruar; janë zhvilluar në shkallë të gjerë banditizmi, vrasjet, vjedhjet, grabitjet.

Kur Kina i hapi portat e saj edhe për kapitalistët evropianë, u mendua se deri në njëfarë shkalle tregu

kinez do të sillte një lehtësim të krizës edhe në Evropë. Kinezët i bënë shumë reklamë vetes, dërguan dhe shumë delegacione në të katër anët e kontinentit evropian, firmuan edhe kontrata, të cilat që të gjitha u rrëzuan, sepse ishin pa baza. Kur erdhi çështja të konkretizimi i pretendimeve të Kinës, imperialistët amerikanë, japonezë, po ashtu edhe ata të Evropës Perëndimore panë se Kina nuk kishte të paguante dhe nuk ishte e zonja të merrte në duar teknologjinë moderne, pra, nuk ishte e mundur të realizoheshin fitimet që ëndërronin të nxirrnin kapitalistët e ndryshëm nga investimet e bëra atje. Kështu që të dyja palët ranë nga fiku. I pari ra Ten Hsiao Pini, i cili pësoi një disfatë brenda në Kinë, ku Asambleja e madhe Popullore Kombëtare e Kinës u detyrua të ndryshojë politikën e «katër modernizimeve» e të bëjë rirregullimin e ekonomisë nga e para. Rirregullimi i ekonomisë do të thotë të mos bëhen investime të mëdha në industrinë e rëndë, të mbështeten gjoja në forcat e veta, të zhvillohet industria e vogël private, të lejohen privatët të kenë punëtorë dhe të vazhdojë prodhimi i artikujve për konsumin e gjerë dhe për eksport.

Këto masa të reja u morën në asamble, pa miratimin e Komitetit Qendror dhe të kongresit, por me aprovimin e rrëmujës dhe të disfatës së brendshme politike dhe ekonomike. Li Hsien Nieni deklaroi se ligji që u aprovua nga Asambleja Popullore Kombëtare, për sa u përket mbështetjes dhe sigurimit të investimeve të huaja, «nuk është i përsosur» dhe se praktika ndërkombëtare prej 51 për qind dhe 49 për qind, nuk do

të mbahet në këtë shkallë, por të huajt, — tha ai, — mund të kenë aksione edhe më të mëdha nga kinezët, veçse drejtori kinez do të ketë të drejtën e vetos. Me fjalë të tjera, ata u thonë investitorëve të huaj: mos u trembni se ne do ta përmirësojmë ligjin.

Nga ana tjetër, Li Hsien Nieni tha se Kina do të mbështetet në forcat e veta dhe kjo u vërtetua me anulimin e një sërë kontratave për investime të mëdha si, për shembull, kontrata e lidhur me francezët për tre gjeneratorët e mëdhenj bërthamorë. Dje apo pardje ministri i Industrisë i Francës shkoi në Pekin për të biseduar lidhur me këtë çështje dhe lajmet tregojnë se ambasada franceze në Pekin është e alarmuar për këto qëndrime të Kinës. E kanë kot që alarmohen francezët se ata e kanë nxjerrë vetë shprehjen: «Shih e mos vri». Kinezët kurrë nuk e kanë mbajtur fjalën, qoftë edhe me kontratat e nënshkruara. Ashtu siç bënë me ne, do të bëjnë edhe me të tjerët, s'duan të dinë ata se kush jemi ne dhe kush janë të tjerët, ata shikojnë vetëm interesat e vet, mirëpo këto nuk dinë t'i mbrojnë as si kapitalistë që janë, por e tregojnë hapur pazotësinë e tyre.

Për të kundërbalancuar këtë disfatë të brendshme e të jashtme, nga 20 korriku a më vonë flitet se do të vejë në Moskë një zëvendësministër i Punëve të Jashtme i Kinës dhe nga Bashkimi Sovjetik do të caktohet Firjubini ose një zëvendësministër më i rëndësishëm. Firjubini është «miku» ynë i vjetër, burri i Furcevës, i cili, sipas mendimit tim, nuk ka shumë tru në kokë. Koka e tij është me lakra, por janë të tjerë nje-

rëz ata që do t'i hedhin një çikë vaj lakrorit me lakra të kokës së Firjubinit. Sidoqoftë, sovjetikët janë djaj të mëdhenj dhe do të dinë që në këto situata të përfitojnë nga dobësitë dhe nga marazi i madh ekonomiko-politik që ka mbuluar Kinën e Hua Kuo Fenit.

Natyrisht të dy këto vende i luajnë kartat ndaj Perëndimit: Kina për t'u bërë presion atyre që u ka kërkuar kredi dhe, nga ana tjetër, Bashkimi Sovjetik po ashtu i bën presion Perëndimit për t'i treguar se Kina nuk është në gjendje të luajë rolin e partnerit në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve të «Evropës së Bashkuar», e se nuk mund të jetë në gjendje ta ngacmojë ose t'i shpallë luftë Bashkimit Sovjetik. Kina nuk po përrallis më për luftën iminente, për të cilën tashti flitet pak, sepse po flitet më shumë për të mbushur barkun me bukë dhe për të kërkuar lëmosha.

Agjencitë e lajmeve thonë, dhe kjo mund të jetë e vërtetë, se shoqëritë e mëdha të vajgurit: japoneze, amerikane, angleze dhe gjermanoperëndimore, bashkë me to edhe shoqëritë italiane, kanë nënshkruar kontrata për të bërë kërkime në detin e Kinës Jugore dhe për të nxjerrë naftë. Natyrisht, nxjerrja e naftës nga deti do të kushtojë shumë, sidomos për Kinën, sepse të ardhurat në naftë bruto do të shkojnë në favor të huadhënësve dhe Kina do të marrë fitimin minimal. Pra, do të vepohet ashtu siç kanë bërë imperializmi amerikan dhe partnerët e tij për një kohë shumë të gjatë me vendet arabe që prodhojnë naftë dhe me OPEK-un.

Situata e vështirë në Evropë, në Bashkimin Sovjetik, në Kinë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka bërë që vendet e Azisë Juglindore të përfitojnë e të lëvizin disi, delegacione të tyre venë e vijnë, shkëmbejnë mendime etj. Me fjalë të tjera, mendoj që këto vende, për t'u vënë fre pretendimeve të mëdha që kanë superfuqitë, përpiqen të përfitojnë nga këto situata, megjithëse përfitimet do të jenë të pakta.

Ne shohim që Kina vazhdon presionet ndaj Vietnimit, bile tash ajo ka vënë një kusht të ri: në bisedimet vietnamezo-kineze duhet të diskutohet çështja e Kamboxhias. Se si do të diskutohet kjo çështje, është një pikëpyetje. Tash po duket se Sihanuku, që ndodhet në Phenian, nuk është në akord me kinezët. Ai deklaroi se do të shkojë në Francë, në qoftë se kjo do ta lejojë, ose në një vend tjetër, ku do të formojë një qeveri në vend të huaj kundër qeverisë së Pol Potit dhe kundër qeverisë aktuale të Kamboxhias. Me fjalë të tjera, ai do të krijojë frontin e bashkuar të Kamboxhias me veten e tij në krye, bile Sihanuku u shpreh: «Unë jam mbreti i Kamboxhias».

Unë mendoj se kinezët do të pranojnë më mirë Sihanukun sesa vietnamezët dhe partnerët e këtyre, që qëndrojnë në Kamboxhia. Por çështja, natyrisht, nuk është e zgjidhur, varet shumë nga qëndrimi në unitet i vietnamezëve, i kamboxhianëve dhe i laosianëve për të përballuar hegjemoninë kineze, varet po ashtu edhe nga gjendja ndërkombëtare, veçanërisht nga qëndrimet e sovjetikëve, të cilët janë gati të sakrifikojnë edhe Vietnamin, edhe Kamboxhian, deri në njëfarë shkalle,

por të hedhin Kinën në dorë dhe ta bëjnë këtë të paktën një gjysmësatelite të tyre. Megjithatë, nuk them se sovjetikët do ta lënë pas dore Vietnamin. Në bisedimet që sovjetikët do të zhvillojnë me kinezët çështjet nacionale të Indokinës nuk duhet të preken, por, edhe në qoftë se ngjet e kundërta, se sa duhet të preken, këtë e ka merak vetë Bashkimi Sovjetik. Ky di të shesë, të blejë dhe të luajë në kurrizin e të tjerëve; pastaj, kur ka luajtur në kohën e luftës vietnamezo-amerikane, pse të mos luajë edhe tash në luftën vietnamezo-kineze?

Duhet të kemi parasysh që edhe Bashkimi Sovjetik, gjithashtu, po kalon një krizë shumë të rëndë brenda, krizë ekonomike, por edhe krizë politike, bile atje nuk ekziston më as uniteti në mes kombësive, ai mbahet me forcat e ushtrisë. Flitet se Brezhnjevi është sëmurë dhe s'është çudi që të jetë sëmurë, sepse në televizor shohim që mezi hedh këmbët dhe mezi flet, po, se kur do të vdesë, këtë nuk e dimë, dimë vetëm një gjë: se ajo që dominon në Bashkimin Sovjetik është forca e ushtrisë sovjetike, e mareshalëve, dhe aspak forca e partisë, forca e parimeve. Partia dhe parimet e saj janë përtokë, janë vetëm sa për emër, sa për të maskuar veprimtarinë e një diktature të tmerrshme imperialisto-fashiste.

Bashkimi Sovjetik ka mosmarrëveshje të rënda edhe në gjirin e së ashtuquajturës bashkësi socialiste. Kohët e fundit u bë një mbledhje në Berlin, e cila kishte karakterin e unifikimit dhe të shtimit të propagandës kundër propagandës borgjezo-kapitaliste. Kjo

mbledhje, ku secili mbajti nga një fjalim, i nisur vetëm nga interesat e tij, në fund doli si bishti i peshkut. Jepnin përshtypjen gjoja sikur po e ndanin në mes tyre punën e agjitacionit e të propagandës. Fjalimi i përfaqësuesit sovjetik i dha tonin e përgjithshëm se ata do të merrnin përsipër luftën kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit kinez. Kurse Rumania nxori zërin e bilibilit të ngjirur duke thënë se nuk ishte e drejtë që në një mbledhje si ajo e Berlinit të atakoheshin parti «komuniste» që nuk merrnin pjesë në të. Dhe me kaq mbledhja mbaroi. Puna do të vazhdojë si më parë. Ashtu si më parë revizionistët do të bëjnë një propagandë revizioniste, e cila nuk do të ketë asgjë as kundër imperializmit, as kundër kapitalizmit perëndimor. Do të ketë vetëm disa fraza boshe stereotipe, kurse nga ana tjetër do të ketë marrëveshje, lutje, kërkesa për investime, lajka e fërkim krahësh për të marrë ndonjë kësht ose për të shtyrë afatet e borxheve që i kanë mbuluar këto shtete.

Shtetet aleate të Bashkimit Sovjetik, anëtarët e Traktatit të Varshavës, janë kredhur në borxhe dhe janë lidhur ngushtë e me zor me zinxhirët e Bashkimit Sovjetik, i cili i furnizon me lëndë të para dhe me lëndë të përpunuara, duke u kërkuar çmime të larta. Në rast se këto vende dëshirojnë ta përmirësojnë një çikë situatën, si për lëndët e para, ashtu edhe për ato të përpunuarat, duhet të investojnë shuma kolosale në Siberi, ku gjenden këto lëndë të para, duhet të investojnë kapitale, të dërgojnë makineri moderne dhe specialistë, të inkuadruara gjoja të tëra këto në rregullat

e KNER-it, për arsye se këto janë lëndë të «fushave të betejës» (strategjike). A do ta hanë këtë hile të Bashkimit Sovjetik vendet anëtare të KNER it, kjo varet nga thellësia e krizës, por sidomos varet edhe nga përkrahja dhe nga ndihma konkrete me investime ose me lëndë të para që mund t'u japin atyre perëndimorët.

Rumania është një vend i falimentuar, një vend i shitur te sovjetikët, të cilët aktualisht kanë përfituar nga bankëruta dhe e kanë hedhur plotësisht Çaushekun në xhep. Pavarësisht se ç'thotë ai, është fakt se atje janë futur oficerë sovjetikë, kanë vërshuar armatime të reja sovjetike, fillojnë ligjet e Traktatit të Varshavës të veprojnë dhe Çaushesku të këndojë me bilbilin e tij të një shteti gjoja të pavarur.

Ne shohim se aktualisht gjermanolindorët, polakët, po ashtu çekët i janë vërsulur Afrikës gjoja për të ndihmuar çlirimin e popujve afrikanë, por ata venë atje për të shitur armë dhe për të siguruar tregje. Në këto situata të gjithë kërkojnë të peshkojnë në ujë të turbullt.

Jugosllavia ka mbetur si peshku pa ujë, ekonomia e saj është përtokë, një miliard e gjysmë dollarë në vit i duhen që të paguajë borxhet dhe 20 për qind e industrisë nuk punon. Edhe pjesa tjetër e industrisë nuk punon me rendiment të plotë dhe mallrat jugosllave nuk kalojnë dot në tregjet e Evropës dhe të botës, për arsye të konkurrencës së madhe që u bëjnë shtetet e mëdha kapitaliste. Kështu që në Jugosllavi po shtohen papunësia e inflacioni dhe çmimet janë ngri-

tur aq shumë sa të vësh duart në kokë, aq sa jugosllavi po shtrëngon rripin. Emigracioni jugosllav po mbulon Evropën. Tash, e detyruar nga krizat, Evropa po mbyll fabrikat e po hedh në rrugë punëtorët e saj, aq më tepër pastaj mbetet pa punë emigracioni jugosllav, i cili do të detyrohet të kthehet në vendin e tij, ku e pret mizerja.

Kontradikta dhe një armiqësi e egër ekzistojnë në mes republikave të ndryshme të Jugosllavisë, të cilat brehen nga një ideologji antimarksiste, shoviniste, kapitaliste dhe nga sistemi vetadministrues i ashtuquajtur socialist, i cili ka krijuar borgjezinë e re dhe nivelin e standardit të jetesës në republika dhe në krahina. Kështu është gjendja në Jugosllavi, një gjendje e tendosur lufte të vazhdueshme.

Thuhet se atje gjoja mbahet situata pse qenka Titoja në këmbë, por ai është i pafuqishëm për ta nxjerrë nga kjo gjendje. Bëri ç'bëri, ai e shkatërroi Jugosllavinë dhe tash që është plak ky vend po vazhdon të shkatërrohet akoma më thellë, kontradiktat po shtohen, dhe më kot Bakariçi bërtet e mban fjalime për të thënë se duhet t'i jepen kompetenca më të mëdha partisë që ta drejtojë më mirë Jugosllavinë, më mirë bashkim-vëllazërimin dhe unitetin në mes republikave. Por Bakariçi, i cili është kroat, ka frikë nga serbomëdhenjtë dhe, nga ana tjetër, Kroacia, në qoshe të Veriut të Jugosllavisë, ka standardin më të lartë të jetesës në Jugosllavi dhe bën ç'bën mendon se fundi i fundit një shkëputje e saj do ta ruajë këtë standard që ka krijuar.

Ç'do të ngjasë në Jugosllavi pas vdekjes së Titos, natyrisht, ky është një problem që na preokupon edhe ne, por ne kemi qenë, jemi e do të jemi vigjilentë për sa i përket zhvillimit që mund të marrin ngjarjet në këtë vend.

Edhe Italia gjendet në një krizë të përhershme dhe vazhdon të jetë pa qeveri. Demokristianët nuk i lënë socialistët të formojnë qeverinë dhe me miliona grevistë janë nëpër rrugë. Anjelët, Montekatinët e të tjerë, nuk lëshojnë asnjë grimë nga pasuritë e tyre, kapitalët italiane vërshojnë jashtë, investohen, sepse kështu sigurojnë fitime.

Pra, kjo është gjendja në pellgun e Ballkanit e rreth nesh, prandaj ne duhet të jemi shumë vigjilentë, për arsye të gjendjes shumë kritike politike, ekonomike dhe ushtarake.

Ne do të mbajmë këtë politikë aktuale, e cila është një politikë e drejtë, ndaj Jugosllavisë, ndaj Rumanisë edhe ndaj Greqisë. Ne do të përpiqemi që me Greqinë të zhdukim qoftë edhe mosmarrëveshjen më të vogël. Grekët duhet të heqin dorë nga gjendja e luftës me ne, sepse kjo është anakronike, anormale, në një kohë kur ne po zhvillojmë marrëdhënie miqësie me popullin grek. Duhet të shtojmë marrëdhëniet tonë ekonomike dhe kulturore, të cilat nuk shkojnë keq, e jo vetëm me Greqinë, por edhe me Jugosllavinë e me Italinë.

Në pikëpamjet ideologjike, ne me këto vende nuk do të puqemi kurrë.

Në politikën ballkanike të shteteve të Ballkanit ne

shohim që kanë futur hundët fuqitë e mëdha, të cilat po bëjnë përpjekje për të krijuar gjoja marrëveshje në mes këtyre shteteve. Kjo gjë jam i mendimit që nuk do të arrihet kurrë, për arsye se ne nuk futemi në këto hile të kapitalizmit dhe të revizionizmit botëror. Gjithashtu ekzistojnë kontradikta të mëdha midis Jugosllavisë dhe Bullgarisë, midis Greqisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë, të pahapura, dhe midis Greqisë e Turqisë, aq, që janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Aktualisht, meqë Greqia futet në krahun jugperëndimor të NATO-s, amerikanët përpiqen që komandanti i këtij krahu të mos jetë as turk, as grek, por të jetë amerikan dhe zëvendëskomandantët të jenë njëri turk e njëri grek, me fjalë të tjera, këta t'ia varin në qafë mëlçitë e tyre ujkut amerikan.

Sidoqoftë politika e Turqisë si edhe ajo e Greqisë është një politikë e varur dhe shumë delikate. Prandaj ka mundësi që të acarohen më tej kontradiktat në mes tyre dhe ne duhet të bëjmë kujdes sepse acarimi i situatave në mes këtyre dy shteteve mund të sjellë një dobësim të kufirit greko-bullgar dhe jugosllavo-bullgar.

Bullgaria dëshiron që Maqedoninë ta ketë për vetë të saj dhe e quan tokë të popullit bullgar, kurse jugosllavët pretendojnë të kundërtën, ekzistencën e një kombi maqedonas, bile kërkojnë që edhe bullgarët të njohin minoritetin maqedonas irindas.

Regjimi titist në Jugosllavi po falimenton krejtësisht. Aktualisht po dëgjoj në radio se në Beograd ndodhet për vizitë Maknamara dhe se bankat ameri-

kane i akorduan Jugosllavisë një kredi prej 130 apo 150 milionë dollarësh, për arsye se ajo do të falimentojë në qoftë se nuk ia japin këtë kredi. Pra, Jugosllavia është krejtësisht e shitur tek imperializmi amerikan, por nuk mungon të hedhë «valle mbi litar», të luajë edhe kartën e sovjetikëve; këtë «valle mbi litar» Titoja e quan si një politikë të zgjuar, kurse në realitet s'është veçse politikë e falimentuar.

Në përgjithësi në Evropën Perëndimore socialdemokracia është krahu i fortë dhe mbështetës i së djathtës tradicionale reaksionare, qoftë kjo si e djathta franceze, apo siç janë demokristianët në Itali, kristiano-demokratët në Gjermani, apo konservatorët e Theçerit në Angli. Pra, socialdemokracia llogaritet në përbërjen qeveritare të këtyre vendeve. Monopolet e mëdha dhe shoqëritë e përbashkëta, që sundojnë dhe bëjnë ligjin në të gjitha këto pseudorepublika demokratike, i përdorin partitë e socialdemokracisë me emra të ndryshëm për të qeverisur, ose më mirë me thënë për të zbatuar urdhrat e tyre, për të krijuar përshtypjen se qeveritë «e zgjedhura» janë qeveri të popullit, janë përfaqësuesit e shumicës në parlament, si rezultat i zgjedhjeve të lira. Këto parti, natyrisht, kanë influencën e tyre dhe manipulojnë në interes të monopoleve masa mjaft të gjera, masa me nuanca të ndryshme. Vetëm në raste të veçanta midis tyre e monopoleve shfaqen disa kontradikta, por, kur vjen çështja e krizës, ato bien në ujdi duke i lëshuar diçka njëra-tjetrës, me fjalë të tjera, duke i bërë një trust tjetrit disa lëshime në kurriz të popullit të këtyre vendeve.

Kurse partitë socialiste, që përpiqen të përfaqësojnë një pjesë të klasës punëtore dhe të hiqen si krahu i majtë i socialdemokracisë në këto vende, aktualisht po futen në rreshtat e influencës amerikane. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të fuqishme ekonomikisht e ushtarakisht, dhe vendet perëndimore sidomos, pranojnë që partitë socialiste të mund të marrin pjesë edhe në qeveri, bile të formojnë edhe qeveri, por me kusht që të mos arrihet «bashkimi i majtë», domethënë të mos bëhet bashkimi me «komunistët», pse amerikanët akoma nuk kanë besim te partitë revizioniste, sido që këto i kanë braktisur të gjitha pa përjashtim marksizëm-leninizmin, revolucionin, luftën e klasave. Megjithëkëtë, amerikanët nuk kanë arritur në atë shkallë dhe monopolet e vendeve perëndimore nuk kanë atë besim që revizionistët, të cilët mbahen për komunistë, të mund të marrin pjesë në qeveri dhe bëjnë çdo përpjekje që uniteti elektoral për pushtet në mes partive socialiste dhe «komuniste» të dështojë kurdoherë.

Kjo ngjet në Itali midis partisë së Kraksit dhe të Berlinguerit, apo në Francë midis partisë së Miteranit dhe të Zhorzh Marshesë. Më kot Zhorzh Marsheja me Miteranin përpiqen të bashkohen dhe të formojnë një qeveri të majtë. Ata arrijnë deri në njëfarë shkallesh të merren vesh, pastaj kjo përpjekje e tyre për bashkim dështon. Kështu fillojnë përsëri polemikat kundër njëri-tjetrit.

Në Angli vazhdon politika e balancës midis partisë laburiste dhe partisë konservatore. Aktualisht Thatcheri është në fuqi, kurse Kallagani në opozicion. Do

të vijë koha që, kur ta shikojnë se situatat do të ndryshojnë, domethënë në qoftë se klasa punëtore angleze do të lëvizë disi për të kërkuar me forcë disa të drejta ekonomike, atëherë do të ndryshojë edhe ai trup elektoral, balanca do të rëndojë nga laburistët dhe do të vijë një Kallagan i ri t'i zërë vendin Theçerit. Pra, në Angli luhet karta e dy partive.

Në këtë situatë politike, siç paraqitet dhe siç u përpoqa ta përmbledh shkurtimisht, politika e Partisë dhe e shtetit tonë socialist dallohet katërcipërisht nga politika e të gjitha shteteve të lartpërmendura dhe është në kundërshtim të hapët me të gjitha rrymat e ndryshme të tyre në ideologji, në organizime shtetërore e në luftë të papajtueshme me shfrytëzimin kapitalisto-revizionist që rëndon mbi popujt e ndryshëm.

Për sa u përket vendeve revizioniste, informatat janë të tilla që, kur ne atakuam Kinën, ato, me Bashkimin Sovjetik në krye, kishin shpresa të na afronin pas vetes. Por pas luftës së gjatë dhe të rreptë që bëmë ne dhe qëndrimeve të prera e të palëkundshme kundër tyre, ata mendojnë se «ne do ta paguajmë gabimin» e mosrealizimit të ëndrrës së tyre. Ata s'duan t'i acarojnë situatat me ne, por ne do t'i demaskojmë politikisht dhe ideologjikisht në çdo hap që do të bëjmë. Bota, miqtë, e gjejnë të drejtë politikën tonë, e gjejnë kurajoze. Miqtë e kuptojnë deri diku pse është kaq e qartë e kaq e guximshme politika e një partie të vogël dhe e një vendi të vogël, siç janë Partia dhe vendi ynë. Kurse kapitalistët e revizionistët nuk e kuptojnë dot politikën tonë, për arsye se nuk arrijnë të kon-

ceptojnë dot se është pikërisht marksizëm-leninizmi ajo shkencë që e udhëheq Partinë tonë në politikën e vendosur e të drejtë të saj.

Natyrisht, shtypja shekullore na ka mësuar shumë gjëra, por ajo që është kryesore dhe na udhëheq ne në rrugën tonë është marksizëm-leninizmi, i cili i ka forcuar këto tradita të lavdishme dhe e ka ruajtur Shqipërinë nga ndikimet e kapitalizmit botëror, të feudalizmit, të borgjezisë dhe të kapitalit vendës.

Lufta Nacionalçlirimtare ishte një luftë e ashpër antiimperialiste, ajo ishte njëkohësisht një luftë sociale. Me këtë luftë, duke çliruar atdheun, ne likuiduam feudalizmin dhe shfrytëzuesit e ndryshëm dhe vendosëm pushtetin e popullit. Por është marksizëm-leninizmi që krijon atë forcë të madhe, që i bën aq të qarta e të zhdërvjellëta pikëpamjet tona politike, shikimin e drejtë të problemeve të ndërtimit të socializmit në Shqipëri, të ndërtimit organizativ, politik dhe kulturor, në kushtet konkrete të vendit tonë, të cilat nuk kanë qenë aq të lehta, bile kanë qenë shumë të vështira dhe mbeten përsëri të vështira. Natyrisht, vështirësitë e mëdha janë kapërcyer, por ekzistojnë akoma të tjera dhe lindin vazhdimisht vështirësi të reja, sepse Shqipëria, pavarësisht se ka fituar autoritet në botë, ka armiq të shumtë që e presin në pusi për ta goditur. Vetëm se vigjilenca e Partisë dhe e popullit është e tillë që çdo dru i vënë në rrotat e zhvillimit tonë socialist do të thyhet e do të dërrmohet.

Këtë politikë dhe këto ide ne duhet t'i mbrojmë me forcë të madhe, me kurajë, në mënyrë të zhdër-

vjellët, me një shpejtësi të madhe, të prekim sa të jetë e mundur më thellë e më gjerë zemrat e punëtorëve e të njerëzve përparimtarë në botë dhe të çarmatosim ata që kërkojnë ta dëmtojnë e ta zvogëlojnë jehonën e politikës së drejtë të Partisë sonë. Kjo është arma jonë e madhe, të cilën duhet ta përdorim me efektivitet.

Njerëz nga vende të ndryshme të botës vijnë në vendin tonë për të parë se ç'do të thotë ndërtim i socializmit, ç'do të thotë një shoqëri e re pa klasa antagoniste, një shoqëri e re ku zhvillohet lufta kundër mbeturinave të klasave sunduese e shfrytëzuese, ku është vendosur mirëqenia për mbarë popullin, ku nuk ngrihen çmimet, ku nuk ka papunësi, ku arsimi e kultura po lulëzojnë e do të lulëzojnë vazhdimisht. Ky vend i vogël me në krye këtë Parti të vogël, por të vendosur, marksiste-leniniste, di të zhvillojë ekonominë e vet, të mbrojë kufijtë e atdheut, të thotë fjalën e tij në arenën ndërkombëtare dhe jo vetëm të bëhet i paprekshëm nga armiqtë, por edhe më tepër t'i demaskojë këta dhe të krijojë në botë një miqësi sa më të gjerë e sa më të thellë me popujt.

Pasojat e krizës ekonomike, pra edhe të asaj energjetike, janë ndier e po ndihen në mënyrë shumë të dukshme me zhvillime politike e ekonomike edhe në vendet fqinje me vendin tonë. Tërthorazi ato mund të ndikojnë edhe te ne në qoftë se humbasim vigjilencën. Në këto kushte është e domosdoshme që ne të vazhdojmë politikën parimore të deritanishme, të va-

zhdojmë të zhvillojmë tregtinë reciproke me shtetet kapitaliste dhe me shtetet revizioniste.

Ne duhet të përpiqemi që këto shkëmbime të jenë me leverdi reciproke dhe pa u bërë atyre shteteve asnjë koncesion politik dhe ideologjik, përkundrazi, t'i luftojmë ato me këmbëngulje në të dy këto drejtime vendimtare dhe kardinale. Nga ana tjetër, politika jonë ekonomike e kulturore duhet të jetë një politikë e ndershme, parimore. Ne jemi një shtet i vogël, një shtet pa forcë ekonomike të madhe, një shtet të cili! edhe mund t'i krijohen vështirësi në drejtimet që theksova më lart, por shteti ynë socialist është një shtet unikal, i paprekshëm. Të tillë atë e ka krijuar Partia jonë, sepse ka ditur dhe di t'i shfrytëzojë edhe kontradiktat e mëdha që ekzistojnë në mes shteteve të ndryshme kapitalisto-revizioniste.

Pra, është e domosdoshme që ne të ndjekim hap pas hapi zhvillimin e situatave në jetën ndërkombëtare dhe të dimë të shpjegojmë rrënjët dhe arsyet e këtyre ndryshimeve, të këtyre kontradiktave, të këtyre goditjeve që të mos biem kurrë në kurthin e tyre, të mos bëjmë kurrë një politikë koniunkturale, por të hedhim në çdo rast hapa të matur, të ndjekim shprehjen e popullit tonë: «Mat shtatë herë dhe pre një herë!». Kjo do të thotë të jemi të matur e vigjilentë.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ne duhet të rrimë duarlidhur, përkundrazi duhet të jemi kurdoherë në ofensivë. Sulmi ynë politik dhe ideologjik kundër armiqve është forca tjetër jona, asnjëherë këtë të mos e ndalojmë, se, po e ndaluam ofensivën kundër

armiqve, po nuk i demaskuam deri në fund manovrat, strategjinë dhe taktikat e tyre djallëzore, atëherë ne do të humbasim, po do të humbasë edhe revolucioni dhe kështu nuk do të jemi në gjendje t'u japim atë ndihmë që duhet shokëve tanë marksistë-leninistë në botë.

**Marrë nga libri:**

**Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 12, f. 775**

## **KURSIMI I NAFTËS NUK DUHET LËNË NË DËSHIRËN E SECILIT**

**Shënime**

**20 korrik 1979**

Sot erdhi në Pogradec shoku Hekuran Isai, i cili na raportoi shkurtimisht mua dhe Hysniut [Kapo] lidhur me detyrën që i kishim ngarkuar për të kontrolluar si harxhohej karburanti në rrjetin rrugor, hekurudhor dhe detar.

Vendimi i marrë nga Qeveria për kursimin e karburantit dhe të energjisë elektrike natyrisht ka bërë njëfarë efekti, por unë mendoj se ky vendim nuk është detajuar si duhet nga ministritë dhe nga baza. Këtë fakt e theksoi edhe Hekurani në raportin që kishte përgatitur, të cilin na e lexoi. I thashë të shkojë në Qeveri, t'ua japë raportin dhe t'u thotë nga ana ime që të merren masa më të rrepta për kursimin e karburanteve, të energjisë elektrike dhe të qymyreve.

Nga leximi i shtypit kam konstatuar dhe konstatoj çdo ditë se, nga njëra anë, bëhen përpjekje për kursim, kurse, nga ana tjetër, harxhohet shumë mbi normat; atë që kursen një ndërmarrje e harxhon ndërmarrja

tjetër. Por kursimi nuk mund të bëhet në global dhe nuk mund t'i lihet dëshirës së një dikasteri ose të një ndërmarrjeje. Përkundrazi, për kursimin e këtyre lëndëve kaq të rëndësishme të industrisë sonë, duhet vepruar deri në detaje. Në qoftë se kjo punë nuk bëhet në mënyrë të detajuar dhe nuk merren të gjitha masat e përshtatshme për zbatimin e këtij detajimi, jo në teori por në praktikë, ne do të gënjenim veten duke thënë se bëjmë kursime.

**I** thashë shokut Hekuran që masa të tilla duhet të konsistojnë së pari, në pakësimin e numrit të kamionëve të panevojshëm që qarkullojnë paralelisht me trenat. Lëvizje të tilla të panevojshme të ndalohen absolutisht. Ndërmarrjeve që e kanë të domosdoshme, t'u lihet një numër kamionësh, me një tonazh të caktuar. për të cilët kanë nevojë të transportojnë mallra e materiale që nuk mund të transportohen me hekurudhë, dhe vetëm në qoftë se krijohet një situatë e domosdoshme për të përdorur automjete mbi numrin e caktuar, atëherë, me urdhër të ministrisë, mund t'u jepet leje përkohësisht.

**E dyta**, duhet të llogaritet me ton-kilometër udhëtimi i çdo kamioni që qarkullon dhe këtë ta bëjë jo vetëm Ministria e Komunikacionit, por të gjitha ndërmarrjet që kanë automjete.

**E treta**, automjeti të ketë patjetër rimorkio pa të cilën nuk duhet lejuar të qarkullojë. Pra, që të realizohet kjo, brenda një kohe sa më të shkurtër të ndërtohen rimorkio.

**E katërta**, karburanti që do të harxhojë çdo auto-

mjet për ton-kilometër duhet dhënë i llogaritur deri në pikën e fundit, asnjë gram më shumë apo më pak. Për këtë të bëhen tallona të tjerë për të marrë karburant në mënyrë që të ketë diferencim midis automjeteve të komunikacionit, automjeteve me rimorkio, pa rimorkio dhe automjeteve të ndërmarrjeve.

**E pesta,** duhet të krijohen ose të shtohen forcat e kontrollit për ruajtjen e karburantit nga shpërdorimi, gjë që nuk kushton dhe s'është burokratizëm. Duke llogaritur sa naftë harxhohet kot e duke nxjerrë vlerën e humbur, do të shohim se shuma për rrogat e policëve ose të nëpunësve të kontrollit do të jetë shumë-shumë më e paktë në krahasim me vlerën e karburanteve të harxhuara.

Për sa i përket qarkullimit të gazeve dhe veturave mendoj se duhet të rishikohet edhe një herë kjo çështje. Të hiqen nga qarkullimi veturat dhe gazet e pa-nevojshme, ose që janë në shërbim të personave apo ndërmarrjeve që nuk kanë nevojë të domosdoshme për to e që fare mirë mund të përdorin trenin.

Është e nevojshme të merren edhe masa të tjera, por për këto, sigurisht, ka specialistë të komunikacionit, që, po të vrasin mendjen e të kenë ndërgjegje socialiste, si dhe po ta kenë kuptuar politikisht e ekonomikisht këtë problem kaq të madh, jo vetëm për vendin tonë, po për gjithë botën, do të gjejnë forma e mënyra të tjera për kursimin e karburanteve.

Kursimi i karburantit ka të bëjë jo vetëm me ndërgjegjen e punonjësve, por edhe me masat e rrepta

për organizimin e punës dhe kontrollin që duhet ushtruar.

Për sa u përket trenave, Ministria e Komunikacionit të lejojë përdorimin e naftës për qarkullimin e tyre, por të shtojë numrin e vagonëve për transportimin e mallrave, që në vijat tona hekurudhore të mos ketë një apo dy trena mallrash në ditë, por më tepër dhe me më shumë vagonë. Nuk duhet lejuar që vagonët të kthehen në depozita mallrash, përkundrazi ata të konsiderohen të ngarkuar dhe të qëndrojnë nëpër stacione aq orë ose aq ditë sa të vijë treni t'i marrë. Prandaj, në vend të vagonëve depozitë, siç ngjet aktualisht, të ndërtohen patjetër depo në stacionet ku do të ngarkohen e do të shkarkohen mallrat. Këto stacione të rrethohen me mure e kangjella. Është shumë më e nevojshme të bëhet atje një gjë e tillë sesa në një fabrikë ose ndërmarrje. Në qarkullimin hekurudhor, meqenëse ky po shtohet shumë, duhet të ketë rregull, disiplinë, ndershmëri dhe kontroll të fortë.

Për sa u përket mjeteve detare, këto të përdoren në mënyrë racionale. Unë nuk e kam pëlqyer që vaporit me kapacitet prej 16 000 tonësh, siç më tha Hekurani, udhëton me 1 000 tonë ngarkesë! Kjo është një humbje katastrofale për ne, humbje nafte dhe amortizim makinerie. Neve na duhen vaporë të tonazhit të vogël, siç kemi një numër anijesh; na duhen, gjithashtu, edhe vaporë të një tonazhi akoma shumë më të vogël që të transportojnë mallra e pasagjerë nga një port në një port tjetër të vendit tonë. Ndryshe do të kemi humbje,

si në makineritë që harxhohen, ashtu edhe në naftë, ose në lëndë të tjera djegëse, si qymyr etj.

Prandaj e porosita Hekuranin t'u thotë shokëve të Qeverisë që sa më parë të merren masa kontrolli për kursimin e energjisë elektrike, të karburanteve dhe të qymyreve. Të krijohen komisione dhe të vendoset çfarë do të kontrollohet. Kjo punë të bëhet sa më qartë, sa më në detaje dhe sa më me rigozitet.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **TË VLERËSOJMË ME OBJEKTIVITET, SI MANGËSITË, ASHTU EDHE ARRITJET**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**22 gusht 1979**

Unë nuk kam mundësi dhe kohë të merrem me leximin e të gjitha raporteve që i vijnë aparatit të Komitetit Qendror, por për disa probleme që paraqesin interes e që mendohet se janë me rëndësi duhet të informohem.

Çështje interesante mund të jenë ato të fushës organizative të Partisë ose të sferave të tjera. Në qoftë se brenda në Parti vërehet ndonjë prirje që ka të bëjë me probleme politike, ekonomike e financiare të vendit, unë duhet të vihem në dijeni, ashtu sikurse informohem, fjala vjen, për problemin e pranimeve në Parti. Mirëpo shoh se informacione të tilla nuk po më jepen rregullisht. Nga gjithë problemet mund të përmbledhen çështje kyç, po ato të më paraqiten në mënyrë të kuptueshme e jo të bëhet përmbledhje për përmbledhje, siç ka ndodhur në ndonjë rast.

Tani që jemi në përfundim të fushatës së korrjes dhe shirjes së grurit dhe në kohën e shërbimeve që po u bëhen bimëve të tjera bujqësore, ka rëndësi të më informoni, për shembull, nëse realizohen apo tejkalohen fondet e pagave, realizohen apo janë tejkaluar normat që janë caktuar për emetimin e monedhës etj.

Pra, ka disa probleme kyç në ekonomi në Parti, në sektorët e punës që mbuloni ju, për të cilat nuk janë të mjaftueshme bisedat që bëjmë këtu. Që edhe unë të kem mundësi të them diçka më të frytshme që të shërbejë për punët e Partisë, më parë është e domosdoshme të jem në korent, i mirinformuar për to ashtu si edhe ju.

Instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror, pikërisht kur bëhen mbledhje me rëndësi të organizatave të Partisë, jo vetëm duhet të asistojnë në to, por edhe të bëjnë analiza dhe të nxjerrin prej tyre konkluzione për problemet kyç që na përkasin neve t'i ngremë. Dhe probleme në rrethe e në bazë ka plot, po midis tyre ne të dimë të dallojmë kryesoren nga ajo që është e dorës së dytë.

Prandaj, kritikata që mendohet të bëhen, të jenë të adresuara. Kritika në bazë do të bëhen me domosdo, bile ato duhen inkurajuar nga Partia. Është e qartë se ai që thyen disiplinën, patjetër do të kritikohet që të ndihmohet.

Në praktikë ka edhe shfaqje që nuk janë tipike, por të rastit. Këto nuk duhen përgjithësuar e mbivlerësuar, kurse disa shfaqje që e kapërcejnë rastësinë, meritojnë të bëhen problem e të shqyrtohen me shumë

vëmendje nga Partia. Sidomos kur një shfaqje vihet re në disa vende, ajo duhet bërë problem dhe të gjenden rrugët e mënyrat më efikase të shërimit. Dhe mënyra e shërimit nuk mund të jetë e njëjtë kudo, nuk mund të përcaktohet në vija të përgjithshme, por duke marrë parasysh veçantitë dhe aspektet në të cilat problemi paraqitet më delikat dhe më shqetësues, gjendet dhe forma më e përshtatshme për ta ndrequr atë.

Për këtë arsye kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe çështjet organizative të Partisë dhe ato të jetës së saj të brendshme. Këto probleme i kemi theksuar dhe herë të tjera, por jeta e brendshme e Partisë kurrë nuk duron rutinë, ajo zhvillohet krahas me jetën e mbarë vendit, me jetën e popullit, që përmban realizime, punë të mira, por edhe dobësi, zvarritje e mbe-turina, të cilat ndikojnë edhe brenda në Parti.

Natyrisht, kur Partia i shikon mirë këto shfaqje pozitive ose negative dhe gjen se ku e kanë burimin, të parat i merr si shembull dhe i përhap, kurse për të dytat merr masat e nevojshme për t'i mënjanuar. Kjo shërben për forcimin e Partisë, për zhdukjen e të metave dhe për rrënjosjen e anëve pozitive.

Një gjë duhet të kemi kujdes në këto takimet tona të përditshme. Shumë herë bisedojmë për të metat e dobësitë që vërehen, por fare pak për sukseset. A duhet të përmenden kryesisht mangësitë kur dihet që jeta jonë ka shumë më tepër anë të mira e suksese? Në takimet tona ne nuk i diskutojmë anët e mira, por këto janë pika të mëdha mbështetjeje për ne.

Mund dhe duhet të diskutohet, për shembull, ose u kalbën 50 quintalë domate që nuk duhej të kalbeshin, po nuk duhet injoruar edhe fakti tjetër që eksporti i këtij prodhimi është realizuar në mënyrë të kënaqshme. Ne tani kemi kaluar në prodhimin e madh, prandaj është e pamundur që të mos ketë edhe dëmtime. Këto gjëra edhe do të ngjasin, por të mos harrojmë të përgjithshmen, pozitiven që është sunduese në jetën e veprimtarinë tonë. E kam fjalën që në vlerësime, në analiza e në konkluzione të jemi realistë, të vëmë në dukje edhe të metat, po të mos lëmë pa përmendur anët e mira. Kjo metodë e analizës mundet që praktikohet edhe në forumet, edhe në organizatat-bazë të Partisë. Sipas mendimit tim, kjo të shërbejë edhe si një inkurajim për komunistët. Kur në organizatën-bazë vihen në dukje se kemi këto ose ato dobësi, por kemi edhe këto e ato anë të mira e suksese, komunistëve u përtërihen forcat për një përparim më të shpejtë drejt sukseseve. Prandaj të ndiqet me kujdes puna e Partisë. Të mos evidencohen vetëm anët e zeza.

Pastaj kjo «e zeza», anët negative duhen parë mirë, duke gjetur nga vijnë e përse vijnë. Po çështja është të mos shohim vetëm këtë, se atëherë do të na krijohet një situatë e vështirë, një frymë e përgjithshme pesimizmi. Edhe ata që kanë rezultate të mira si individë dhe si ndërmarrje, kur shohin se çekani rreh vetëm te dobësitë, do të thonë: «në drejt të vejë puna, se, sido që të punojmë, s'na dëgjuan veshët një herë një fjalë të mirë».

Në numrin e sotëm të gazetës «Zëri i popullit»

ishte botuar një vëzhgim me titull «Duke lexuar një kënd emulacioni dhe duke pritur një tren...». Gazetari kritikon stacionin hekurudhor të Durrësit, i cili këndin e emulacionit e ka ndarë në katër kolona: «Kush na nderon si individ», «Kush na nderon si brigadë», «Kush na turpëron si individ» e «Kush na turpëron si brigadë». Në dy kolonat «Kush na nderon» ishin shënuar emra, kurse në dy të tjerat «Kush na turpëron» emrat mungonin, ankohet gazetari. Parimisht ai e shtron drejt problemin, kur shkruan se tabelat e emulacionit duhet të jenë dinamike dhe operative që të pasqyrojnë jo vetëm sukseset, por edhe të metat.

Në shtyp mund të bëhet problem një çështje që vërtet ndikon në mbarëvajtjen e punës së hekurudhave, po jo çdo e metë që mund të vërehet. Nuk duhet kërkuar që krahas publikimit të sukseseve të paraqiten doemos edhe të metat, me arsyetimin se atje ku ka suksese, nuk përjashtohen edhe gabimet. Sipas këtij gazetari duhet gjetur me zor dikush që nuk punon mirë për t'u publikuar përbri atyre që janë të dalluar, ndryshe këndi i emulacionit u dashka hequr fare. Sipas kësaj logjike, do të duhej të konkludohej se në stacionin hekurudhor të Durrësit mungon kritika, për sa kohë që është kështu atje mungon edhe autokritika dhe, kur mungojnë këto të dyja, do të thotë se nuk ka as drejtim partie. Mirëpo realiteti nuk është i tillë. Sigurisht në stacionin hekurudhor janë mbledhur për të analizuar kritikën e botuar në gazetë. Thelbi i kuptimit materialist dialektik të zhvillimit është kontradik-

ta si raport i caktuar midis prirjeve ose anëve të kundërta që ekzistojnë kudo, në të gjitha sendet e fenomenet, prandaj të pretendosh arritjen e sukseseve pa u ndeshur me të meta e dobësi, s'është tjetër veçse utopi.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Në përgjithësi, shoku Enver, ata që shkruajnë e kanë më lehtë të kapin anën negative të një fenomeni ose të një procesi në shoqëri. Por është vështirë të kapet fenomeni pozitiv dhe ky pastaj të përgjithësohet dhe të afirmohet, prandaj edhe instruktorët tanë shpeshherë kapen te shfaqjet negative.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk është një kuptim i drejtë dhe i shëndoshë ai, sipas të cilit mund të ecet përpara vetëm kur Partia në çdo rast vë në dukje dhe publikon të gjitha të metat që konstaton. Partia nuk është luftarake vetëm sepse zbulon e godet të metat, por ajo është e tillë, sidomos, sepse organizon, udhëheq e drejton jetën e vendit, realizon planet e ndërtimit socialist etj. Kur planet nuk realizohen plotësisht për shkak të rrethanave objektive të paparashikuara që krijohen, kjo nuk do të thotë se atje nuk punohet, nuk do të thotë se organizata e Partisë atje nuk është luftarake. Ku ka të meta, t'i konstatojmë, të ndeshemi me to, të përpiqemi t'i mënjanojmë, por Partia dhe kuadrot e saj të mos e teprojnë ndikimin e tyre në atë shkallë sa të errësohen sukseset e të dekurajohen punonjësit. Kur raportohet për punën, të flitet patjetër edhe për sukseset, se këto përbëjnë pjesën kryesore të saj.

Ka rëndësi që instruktorët e aparatit, në bazë të ek-

speriencës së Partisë, të orientohen mirë për këto çështje. Ne nuk mund të japim receta se si do të flasin njerëzit, po eksperiencën e zhvillimit të luftës së Partisë për plotësimin e detyrave ta bëjmë të njohur. Shumë herë nuk është sa duhet e përshtatshme puna jonë me situatën që krijohet, prandaj të bëjmë përpjekje për ta ngritur më lart nivelin e saj.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

## **ÇDONJËRI TË PËRGJIGJET PËR DETYRËN E TIJ**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**24 gusht 1979**

Lexova një informacion për çështjen e energjisë elektrike, nga i cili krijon mendimin që te ne ka njerëz të zotë, por që nuk dinë të organizojnë, që nuk marrin ose nuk kërkojnë të merren masa që situata të përmirësohet. Atëherë pyes: për këto gjëra që këta i dinë dhe për të cilat na informojnë me hollësi, pse nuk marrin masa që t'i ndreqin? Nga informacioni nuk e mëson një gjë të tillë. Unë jam në dijeni të problemit dhe mendoj se energjia duhet përdorur mirë e me kursim etj., etj. Që kablli ynë, fjala vjen, është i vjetër, këtë nuk e mësoj sot, se ka vite të tëra që na ka dalë ky problem. E dimë që kemi defekte në rrjetin elektrik për shkak të kabllit të vjetër, mirëpo, që ai të zëvendësohet me kabëll të ri, kërkohej fonde, të cilat, natyrisht, duhen gjetur. Prandaj mendoj që shokët të cilët drejtojnë në këtë sektor sikur të kishin filluar me

etapa ta bënin këtë punë, me siguri që deri më sot do të ishte përmirësuar rrjeti ynë elektrik.

Dihet që problemi i kursimit të energjisë nuk është kaq i lehtë. Duhet kursyer energjia elektrike dhe këtë nuk e them vetëm unë, por gjithë Partia dhe mua më duket se për këtë po punohet nga shokët e Qeverisë, por duhet të punohet edhe këtu. Sepse ekonomia jonë, sidomos për çështjen e sigurimit të elektrogjeneratorëve të centraleve, të motorëve etj., shpresat i ka tek importimi i tyre. Industria jonë është zhvilluar, por në disa sektorë edhe është zvogëluar; diku «oreksi» i një ndërmarrjeje ka qenë i madh dhe, në vend që ajo të merrte 2 elektromotorë, ka marrë 15 dhe tash nuk i lëshon. Prandaj të bëhet një plan shpërndarjeje i studiuar. Duhet parë me kujdes jo vetëm sasia e elektromotorëve, por edhe fuqia e tyre në përputhje me nevojat e ekonomisë. Kjo është njëra vështirësi.

Vështirësia e dytë është se edhe kur thonë, që mua, fjala vjen, më duhet çereku i sasisë së energjisë që më është caktuar, nga njerëzit e ngarkuar me këtë punë nuk merren masat e duhura. Që të përmirësohet gjendja, nuk mjaftojnë vetëm konstatimet. E rëndësishme është që problemit t'i hyhet thellë, që të arrihet në konkluzione të sakta, të drejta, se si do të bëhen këto ndryshime, si do të kombinohen këto gjëra. Pastaj bëhen llogaritë (të cilat në disa raste janë të gabuara) dhe del që në energjinë elektrike kemi humbje të mëdha. Me të vërtetë kështu është, por kjo humbje e madhe ndodh se kemi pikërisht këtë situatë, për të cilën fola e që ne duhet ta kuptojmë, ndryshe nuk bëhet gjë. A duhet

vepruar siç u veprua në Korçë? Jo, në asnjë mënyrë. TEC-i të mos e ndërpresë punën. Këtë ne e bëmë për të furnizuar me avull Fabrikën e Sheqerit dhe Kombinatit e Trikotazhit. Duheshin investime që avulli i TEC-it të Korçës të përdorej për familje, se për këtë duheshin tuba. Ne kemi vuajtur për tuba, për ta po vuajmë edhe sot. Mundet që edhe më tepër energji elektrike t'i japim Korçës, por vetëm duhen tuba dhe të instaluar. Prandaj ky është një problem shumë kompleks.

TEC-i i Tiranës mund të mjaftojë për industrinë këtu, bile mund të jetë edhe i madh, por ka edhe vende të tjera ku energjia mund të jetë e tepërt dhe nuk ke çfarë ta bësh. Vetëm duke i studiuar një nga një masat e caktuara për konsumin e energjisë elektrike, atëherë do të dalësh me konkluzionin sa energji ke, sa duhet të konsumosh, sa duhet të kursesh dhe, në situatat tona, më duket se kursimi duhet të jetë i barabartë me përdorimin, sepse nuk kemi energji të madhe, nuk kemi energji të mjaftueshme. Ky është mendimi im. Pikërisht kjo energji e pamjaftueshme nuk përdoret në mënyrë të studiuar. Natyrisht, një gjë e tillë nuk bëhet me dashje, por se kështu kanë rrjedhur situatat, kanë qenë disa kushte të atilla, kur nuk mund të bëhej puna me një motor me kaq kuaj-fuqi, por kërkoheshin dhjetë, pesëmbëdhjetë, të cilët duhej të viheshin patjetër të gjithë në punë në një kohë. Kurse tash kemi motorë të mëdhenj që i zëvendësojnë të tërë ata të vegjlit, por ata nuk përdoren me efektivitet dhe me nikoqirllëk, sepse i kanë vendosur në vende ku duhet më pak energji. Po ka gjëra që nuk mund të bëhen menjëherë; nuk

është gjë e lehtë të transferosh motorët andej-këtej, se, kur është bërë rrjeti, ky është llogaritur për transportimin e një energjie të madhe. Ti tani heq motorin, mirëpo duhet ta harmonizosh edhe me rrjetin e të gjitha të tjerat. Pra zgjidhja e këtij problemi ka vështirësi të mëdha.

Është e domosdoshme të merren masa dhe të kryhen plotësisht e si duhet punët që hiri i qymyrit të TEC-it të Tiranës të çohet në Krujë për prodhimin e çimentos. Këto gjëra duhet të bëjnë objektin e disa diskutimeve të rrepta pa bërë lëshime dhe duke marrë vendime të sigurta, me qëllim që problemi të zgjidhet plotësisht. Kështu mendoj unë të veprohet, ndryshe krijohet konfuzion.

Unë konstatoj se ata që bëjnë informacione të tilla janë njerëz që i kuptojnë këto gjëra, por pse nuk marrin masa për të vënë çdo gjë në vend, këtë nuk e marr dot me mend. Një thotë se harxhoj shumë energji elektrike për arsye se kam këto makina e pajisje elektrike të tepërta. Po mirë, pse nuk merr vetë ky njeri masa në këtë drejtim dhe të thotë: urdhëro, merri këta elektrogjenë të tepërt? A je komunist, a je patriot, a e kupton rëndësinë e këtij problemi që shtron Partia? Atëherë pse nuk merren masa që tërë hirin e TEC-it ta çosh atje ku duhet për të prodhuar çimento? Për këtë është ndërtuar një linjë e posaçme hekurudhore, atëherë pse nuk e bën këtë gjë? Kësaj i thonë t'i lësh punët në mes të rrugës.

Këto, më duket mua, janë edhe probleme të udhëheqjes, edhe të ministrisë, të zëvendësministrit e të

drejtorit. Pse të ndodhin gjëra të tilla, kur dihet që kemi tërë këta kuadro me arsim të lartë dhe me disa vjet stazh në punë? Kjo duhet të na preokupojë, se, siç mësojmë, bëhen disa veprime që nuk janë në vijën e Partisë. Ja, mora një letër nga një shok, që është luftëtar dhe besnik i Partisë, të cilin e kishim transferuar si drejtor i drejtorisë së kuadrit në një dikaster. Në letër ai më shkruante se zëvendësministri dhe sekretari i Partisë së dikasterit, pa e thirrur e pa biseduar fare me të, e kishin pushuar nga puna, në kundërshtim me të gjitha normat e pa marrë parasysh as punën, as biografinë e tij. Bile në letër më dërgonte edhe karakteristikën që i kishte bërë atij organizata-bazë. Kurse ata të ministrisë e heqin, se me siguri kanë dashur t'i bëjnë hatër ndonjë tjetri. Menjëherë sa e mora vesh këtë gjë, porosita që të viheshin gjërat në vend dhe personi të vazhdonte punën ku qe.

E kam fjalën këtu, që këta njerëz që i bëjnë këto veprime, i kuptojnë mirë këto gjëra, por megjithatë i bëjnë. I bëjnë, se, me sa duket, ndaj njerëzve të tillë që shkelin normat e Partisë, nuk merren masa dhe punëve të tilla nuk u shkohet deri në fund. Se për ç'arsye nuk merren masa, siç thashë pak më parë, nuk e kuptoj, por kjo medoemos duhet gjetur për çdo rast konkret.

Partia vazhdimisht ka folur për kompetencat dhe për frymën e iniciativës. Po a mbahet qëndrim ndaj atyre që i shkelin ose nuk i zbatojnë kompetencat që kanë? Kush do ta dënojë drejtorin e një uzine në rast se ai do të thotë: «Nga këta motorë elektrikë që kam

me këtë kapacitet, më duhet vetëm gjysma e tyre, prandaj të tjerët merrini?» Përkundrazi, atë do ta lavdërojnë. Masat të merren brenda ndërmarrjes, por edhe në kooperim me ndërmarrjet e tjera; në qoftë se për këtë do të duhet ndërhyrja e Qeverisë, atëherë të ndërhyjë, që problemi të zgjidhet.

Prandaj mendoj se duhet luftuar që të jepen urdhra duke i gjykuar mirë problemet. Urdhrat mund të jepen edhe të prera, të shkurtra, si në kohë lufte, kur nuk të pret koha për muhabete të gjata. Komandantit të nënrepartit apo repartit i thuhet se do të marrësh atë kodër dhe asgjë më tepër. Ai do të bëjë planin vetë si e qysh ta marrë kodrën brenda ditës. Në qoftë se duhet të jepen disa shpjegime më shumë për udhërin e dhënë, atëherë të jepen. Kështu edhe në jetën civile. Urdhra duhen dhënë edhe me shpjegime kur është nevoja, pastaj duhet konkluduar se ç'masa të merren për zbatimin e tyre.

Vëmendje të veçantë kërkon edhe prodhimi i kuarcit, që ai të nxirret në një periudhë të shkurtër sa më i pastër dhe i ndarë sipas kualiteteve. Ai që importohet për industrinë e qelqit të zëvendësohet me kuarc të vendit. Kjo është faza e parë. Ne duhet të nxjerrim kuarc sa më shumë. Dhe, në qoftë se nxjerrim më tepër nga ç'i duhet fabrikës së qelqit, atëherë pjesën tjetër ta depozitojmë. Pastaj, të mos mjaftohemi me kaq, por të vihemi në lëvizje për pasurimin e kuarcit, se kjo mund të lidhet edhe me tregun e jashtëm.

Sidoqoftë, gjatë kësaj kohe, të fillojë puna studimore për shndërrimin e kuarcit në një mineral më të

pasur. Për këtë çështje të marrim vendim sepse s'po bëhet gjë.

Mbrëmë në Shtëpinë e Partisë, ku ishte edhe Adili [Çarçani] midis të tjerash biseduam edhe për çështjen e fabrikës së përpunimit të kuarcit, për të cilën ai më tha se kushton shumë dhe për këtë as që është vendosur gjë në Qeveri.

Atëherë si do të bëhet kjo?! Çështja t'i paraqitet Byrosë Politike, po të jetë se bëjmë një fabrikë që kushton kaq shumë. Pastaj, që të bëhet kjo fabrikë, duhen disa vjet. Përveç kësaj, është e nevojshme të dërgohen me kohë specialistët jashtë shtetit për t'i përgatitur<sup>1</sup>.

Sigurimit të lëndës që na duhet për qelqin t'i kushtohet shumë vëmendje. Për këto gjëra të diskutohet me kuadro kompetentë, të kërkojnë edhe të dhëna, me qëllim që, kur të vijë këtu në mbledhjen e Byrosë Politike për veprat që propozohen, të diskutohen lidhur me tërë planin pesëvjeçar. Ne, sigurisht, çdo vepër do ta shohim kështu, lidhur me planin pesëvjeçar, por në të njëjtën kohë duhen pasur parasysh edhe disa punë që mund të kryhen qysh më parë, qoftë edhe në mënyrë artizanale.

Kujdes kërkon edhe puna e ndërmarrjeve të tregtisë së jashtme që këto të mos ngarkohen me porosi që duhen kryer me nxitim, por t'u lihet edhe atyre koha

---

1. Në bazë të kësaj porosie u vu detyrë dhe u ngrit impianti për përpunimin e rërës së xhamit në Shishtavec të Kukësit dhe Kërnajë të Tropojës.

e nevojshme për të kryer veprimet në tregun e jashtëm. Po ashtu të jemi më të kursyer në dërgimin e njerëzve jashtë shtetit, sepse si më kanë thënë përveç specialistëve, paska vajtur edhe një inxhinier arkitekt në tri-katër vende të Evropës për të parë pularitë moderne. Sikur këtë paskemi mangët ne, arkitekturën e pularive. Po ashtu të jemi të kujdesshëm edhe për specialistët e huaj që vijnë këtu, sepse, siç na thuhet, sillen edhe nga ata për të cilët nuk është nevoja. Përse ndodh kështu? Sepse, me sa duket, ne nuk informohemi si duhet. Ne nuk kemi nevojë të na jepet informacion për informacion, por për të atillë që të na shërbejnë për të dhënë mendime, që të diskutojmë dhe të dalim me konkluzione të drejta nëse duhet apo nuk duhet të bëhet kjo apo ajo gjë.

Mësojmë nga shtypi që kolektivat punonjës të rrethit të Durrësit kanë arritur objektivat e vitit 1980, pra kanë realizuar detyrën që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë për prodhimin në vend të 95 për qind të pjesëve të ndërrimit deri në fund të vitit 1980. Konkluzioni, sipas artikullshkruesit: nuk duhet të jemi të kënaqur!! Po si nuk duhet të jemi të kënaqur kur ka rezultate të tilla? Ç'duhet të bëjmë tash? Të qajmë që detyrën e realizojmë një vit e ca më përpara?! Nuk ka të drejtë ai të dekurajojë njerëzit duke shkruar në këtë mënyrë! Artikullshkruesi të vërë në dukje që duhet të jemi të kënaqur për këtë rezultat, por ama që puna që solli këtë kënaqësi, të vazhdojë, pra, të mos na rritet mendja. Por, sipas tij, kur duhet të jemi të kënaqur?! Asnjëherë! Problemi nuk mund të shtrohet kështu. Kri-

tikë të ketë, por edhe kur ka suksese të thuash të mos jemi të kënaqur?! Pse? Sepse, sipas artikullshkruesit po të pohohet kjo, njerëzit do të na i mbuloka vetë-kënaqësia, pra do ta bëjnë si ajo lopa, që kur e përkëdhel shumë, i jep një shqelm kovës me qumësht dhe e derdh!

Në realitet nuk ndodh kështu, sepse njerëzit punëtorë nuk mendojnë si ky gazetar. Përderisa ata i kanë realizuar objektivat për vitin 1980 qysh tash, ata kanë bërë një punë shumë të mirë dhe kanë ecur përpara, kurse ky nuk na paska besim! Kjo do të thotë se artikullshkruesit i është rrënjosur në kokë mendimi se, po i the tjetrit atë që meriton, ai do të «flejë», pra nuk do të mobilizohet si më parë. Ky mendim, më duket mua, nuk është i drejtë.

Kisha dhe një gjë tjetër për gazetën. E kam thënë edhe herë tjetër, por prapë shikojmë që gazeta «Zëri i popullit» del me letër të një cilësie të dobët. A duhet të dalë «Zëri i popullit» me këtë letër? Në qoftë se nuk kemi letër, të përpiqemi të gjejmë. Të nxjerrësh 100 mijë kopje të kësaj gazete me një letër të tillë kur dihet që «Zëri i popullit» nuk duhet vetëm për sot. Gazetat do të rrinë në arkiva për shumë e shumë vjet. Kështu bën gjithë bota, i ruan ato si një thesar. Më rëpo, në qoftë se gazeta është me letër të cilësisë së ulët, atëherë ajo dëmtohet brenda një kohe të shkurtër. Këtë gjë nuk e mendojmë ne?

A do të vazhdojnë shokët e fabrikës së letrës dhe komisionet që janë krijuar për cilësinë e saj, të nxjerrin prodhim me cilësi të ulët? Letra është me cilësi

të dobët. Prandaj pyes: a do të përmirësohet teknologjia e prodhimit në fabrikë apo nuk do të përmirësohet? A mendojnë punonjësit atje që kjo lloj letre do shumë material? Le cilësia e saj që është e dobët, por një prodhim i tillë na harxhon dhe shumë lëndë të parë, na kushton shtrenjtë. Prandaj duhet menduar seriozisht që të rregullohet kjo punë. Të shikohet edhe organizimi. Le të jetë ajo në varësi të Ministrisë së Industrisë dhe të Minerave, por të shikohet çështja e përmirësimit të procesit teknologjik të prodhimit të letrës. Çdo gjë duhet të gjejë vendin e saj, sepse Ministria e Industrisë dhe e Minerave nuk interesohet sa duhet për cilësinë e letrës. Ajo ka gjithë ato aktivitete: ka industrinë mekanike, kimike, ka minierat e metalurgjinë. Ç'është industria e letrës përpara këtyre? Por përpunimi i drurit ka rëndësi të bëhet mirë, se druri është lënda e parë për prodhimin e letrës dhe nga ana tjetër është lëndë deficitare. Prandaj të punohet që të përmirësohet teknologjia e prodhimit të letrës.

Për ta zgjidhur problemin është e domosdoshme që njerëzit t'u venë deri në fund problemeve në sektorët që u përkasin, të mbajnë përgjegjësi kur ato nuk zgjidhen, por, në radhë të parë, të përpiqen, të marrin të gjitha masat, që detyrat të realizohen. Pastaj brenda një problemi ka shumë çështje të tjera, por po të jenë njerëzit në krye të punëve edhe atyre u jepet rrugë-zgjidhje.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

# **ÇDO DIREKTIVË E POROSI TË SHTROHET E TË ZBËRTHEHET MIRË ME GJITHË PUNËTORËT E PUNONJËSIT**

*Nga biseda me shokun Rita Marko<sup>1</sup>*

**28 gusht 1979**

*Pas përshëndetjeve të rastit, shoku Rita Marko bëri një ekspozitë të punëve e të problemeve të Bashkimeve Profesionale. Pastaj ç' mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Në radhë të parë dua të theksoj mendimin tim se Bashkimet Profesionale, natyrisht, duhet të punojnë më mirë. Ekspozitja që më bëre për problemet e shumta me të cilat merren Bashkimet Profesionale më shërben mua si një informim që më ndihmon të jap ndonjë mendim për probleme të ndryshme të kësaj organizate. Për këtë është e nevojshme që herë pas here të më raportohet jo për shumë probleme njëherësh, por për një ose dy çështje që gjykohet se janë më të rëndësishme e më preokupante dhe për të cilat duhet të merren

---

1. Në atë kohë, president i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.

masa politike, organizative dhe administrative për zgjidhjen e tyre.

Nga informimet që kam dhe nga gjykimi i përgjithshëm i punëve, konstatoj se ekziston një karakteristike e përgjithshme: shokët, të cilët raportojnë, rregullisht janë shumë të informuar, dinë shumë gjëra. Kjo tregon se kuadrot tanë shkojnë në bazë, konstatojnë, japin edhe mendime për përmirësimin e gjendjes kur kjo është e pakënaqshme. Veçse, në përgjithësi, mendoj unë, mbizotëron konstatimi dhe nuk luftohet që problemet të zgjidhen në vend. Për shembull, unë kërkoj një ide të përgjithshme për kursimin dhe përdorimin e energjisë elektrike dhe të qymyreve. Për këtë problem kërkova të më informonin. Dhe më bënë një raport konkret plot konstatime, ku thuhej se këtu mund të kursehet kaq etj. Por nuk thuhej gjë përse nuk merren masa për t'i bërë rregullimet e domosdoshme për kursimin e energjisë elektrike. Kjo është një e metë që e hasim shpesh, konstatojmë shumë dhe nuk nxjerrim konkluzione e nuk përcaktohen masat e rrugëzgjdhjet e problemeve.

Tash nuk do të zgjatem më për këtë problem. Kjo që përmenda ka karakter të përgjithshëm, se merren edhe masa, por desha të theksoj idenë se qoftë ai që bëri këtë raport ose informacion për konsumin e energjisë elektrike, qoftë ata që ia dhanë këto të dhëna, duhej ta kishin vrarë një çikë mendjen se ç'masa mund të merren që të përmirësohet gjendja në këtë fushë. Për këtë nuk duhen vetëm konstatime, por propozime konkrete.

Tash të vijnë te puna e Bashkimeve Profesionale. Në radhë të parë ato duhet të luftojnë burokratizimin e aparateve shtetërore, të administratave e të kuadrove. Por duhet thënë se shfaqje të burokratizmit ka edhe në vetë këtë organizatë. Këtë ta dini mirë.

Bashkimet Profesionale, siç na ka mësuar Lenini, siç na kanë mësuar, gjithashtu, Partia dhe praktika jonë, nuk duhet të ushqejnë burokratizmin. Këtë mësim, veçanërisht ju kuadrot drejtues, ta keni kurdoherë parasysh. Pra, një nga detyrat kryesore të Bashkimeve Profesionale është lufta kundër shfaqjeve të burokratizmit, që pengojnë zbatimin e direktivave të Partisë, në aparatet dhe në ndërmarrjet shtetërore. Ato të luftojnë që t'u vënë fre veprimeve burokratike që kryejnë njerëzit tanë.

Kjo detyrë kryesore që kanë Bashkimet Profesionale lidhet me njohjen e problemeve dhe të punëve, në të cilat shfaqet dhe ndikon burokratizmi. Pra punonjësit e aparateve e të administratave duhet të njohin mirë ligjet ekonomike, normat politike dhe ato organizative që janë vendosur për realizimin e kësaj apo të asaj detyre partie dhe shtetërore. Këto të njihen mirë, me qëllim që edhe të zbatohen mirë nga aparatet shtetërore, të cilat duhet të jenë jashtëzakonisht korrekte ndaj klasës dhe punonjësve. Sepse janë këta, në radhë të parë, që krijojnë dhe realizojnë. Dhe pikërisht këta janë shumica dërrmuese në prodhim, ndërsa pakica janë punonjësit e administratës.

Mirëpo administrata ka tendenca burokratike, bile i ka të theksuara këto, me gjithë luftën që kemi bërë

e vazhdojmë të bëjmë. Kjo që them është më se e vërtetë. Shembujt tregojnë qartë se ka burokratizëm. Një mijë e një pengesa të nxjerr një drejtues ndërmarrjeje apo uzine që të mos heqë tre elektrogjenë, megjithëse nuk i duhen e megjithëse aspak nuk i dëmtohet puna me heqjen e tyre.

Ti, shoku Rita, merr pjesë edhe në mbledhjen e Qeverisë. Unë mendoj se problemet që shtrohen aty dhe në Byronë Politike duhet të përpunohen nga ti, me qëllim që ato t'u shkojnë organizatave të bashkimeve profesionale. Ato të përpunohen në bazë të vijës që caktojmë atje, në bazë të orientimit të veçantë apo të përgjithshëm ose të ndonjë kritike që bëjmë për probleme të ndryshme, si dhe duke u mbështetur edhe në të dhënat që keni ju për ecjen e punëve në praktikën e përditshme. Dhe me sa di unë, te ju në Bashkimet Profesionale vijnë shumë të dhëna, shumë konstatime. E rëndësishme është që problemet që shqetësojnë Partinë, pushtetin të përpunohen e l'u jepet rrugë në përputhje me këto të dhëna. Kjo do të jetë më instruktive dhe më e frytshme. Pra, duke ditur parimet e duke u mbështetur në praktikën e gjerë, në të dhënat nga praktikat e zbatimit të orientimeve në një numër të madh rastesh, atëherë di të përcaktosh se ku është pika e dobët dhe në ç'drejtim duhet të këmbëngulet më shumë që puna të ecë më mirë. Kështu të përpunohen problemet dhe jo duke folur në vija të përgjithshme për çështjet që shtrohen në mbledhjet e Byrosë Politike. Kjo nuk është as e mjaftueshme, as e frytshme. Orientimet, direktivat, mendimet apo vërejtjet e udhëheqjes,

më parë duhen përpunuar lidhur me gjendjen konkrete të punëve, duke ditur se ku të dhemb e ku të ther, siç i thonë një fjale. Kjo është e domosdoshme të bëhet edhe për faktin se një problem që analizohet e trajtohet në Byronë Politike ose në Qeveri e ka një shkak, se, fjala vjen, në atë fushë ka prapambetje, të meta, mangësi të ndryshme etj. Duke i parë këto lidhur me praktikën konkrete, në bazë të përvojës, zërthehet e përpunohet direktiva dhe u shtrohet masave.

Çështja tjetër, që duhet të keni parasysh, është se punët e Bashkimeve Profesionale nuk duhet të zgjidhen vetëm nga forumet. Në Bashkimet Profesionale forumet, sipas mendimit tim (nuk e di nëse puqet kjo me praktikën), nuk janë si forumet e Partisë për sa i përket asaj që ato nuk marrin vendime, por orientojnë se si duhet të trajtohet ky ose ai problem në organizatën e bashkimeve profesionale.

Në radhë të parë synimi i punës së forumeve të Bashkimeve Profesionale duhet të jetë ky: t'i vënë kufi çdo veprimi që duket se është i kundërligjshëm. Forumet e Bashkimeve Profesionale janë për t'i dhënë shkas një pune politike të gjerë, zgjerimit të horizontit të klasës punëtore; frymëzimit të një disipline dhe patriotizmi të madh në punë të klasës punëtore, sipas mësimëve të Partisë, për të realizuar planin. Këtë funksion kanë këto. Pastaj nuk është e mjaftueshme, përkundrazi, është një mungesë e madhe, në qoftë se mendohet që e shtruan problemin në forumet këtu në qendër dhe në bazë e me kaq mbaroi puna. Jo, nuk është kështu.

Ky është vetëm fillimi i punës. Të paktën unë kështu e mendoj.

Çështja është që çdo direktivë e porosi të shtrohet e të zërthehet mirë me gjithë punëtorët dhe punonjësit. Çdo kategori njerëzish, bile dhe çdo ndërmarrje ka problemet e veta dhe këto janë të shumta, por midis tyre disa janë më të rëndësishme. Dhe këto më të rëndësishmet, natyrisht, Partia t'i shohë dhe t'ua vërë në dukje Bashkimeve Profesionale, Bashkimit të Grave dhe Bashkimit të Rinisë. Dhe direktiva e Partisë nuk duhet të zërthehet e të zhvillohet në mënyrë burokratike, por në mënyrë demokratike me masat. Këtë gjë e kemi theksuar vazhdimisht.

Prandaj është plotësisht e drejtë edhe ajo që the ti, shoku Rita, për pjesëmarrjen e komunistëve në format e edukimit të bashkimeve profesionale. Komunistët në asnjë mënyrë, nga asnjë aktivitet nuk duhet të përjashtohen, nga format e edukimit jo e jo, por absolutisht nga asnjë aktivitet. Partia i bën një edukim të veçantë komunistit, prandaj ai të vejë në formën e edukimit të bashkimeve profesionale për ta ndihmuar që të kuptohen sa më mirë direktivat e problemet e ndryshme. Ç'do të thotë kjo që komunisti të mos marrë pjesë fare në këto forma edukimi? Ç'tregon një gjë e tillë? Kjo tregon se komunisti nuk ka kuptimin e vërtetë se ç'janë Bashkimet Profesionale për Partinë. Komunisti duhet të shkojë në formën e edukimit të bashkimeve profesionale se atje diskutohet, fjala vjen, për forcimin e disiplinës, për çështjen e ngritjes së rendimentit etj. dhe të thotë fjalën e tij për këto probleme. Ai medoe-

mos duhet të marrë pjesë në këto forma. Nuk e kuptoj si largohet komunisti nga forma e edukimit të bashkimeve profesionale, ai duhet të jetë aty që të japë shembullin dhe tonin në mbledhje.

E theksoj përsëri, që komunistët duhet të marrin pjesë jo vetëm në formën e edukimit, këtu po e po, por në të gjitha aktivitetet masive ose në grupet që krijojnë për një çështje organizata e Bashkimeve Profesionale. Komunistët të jenë vazhdimisht tok me masën e paorganizuar në Parti. Atje komunisti duhet të luajë rolin udhëheqës ndaj atij që s'është anëtar partie, por me një thjeshtësi të madhe, ai të nxitë ndjenjën e iniciativës, të diskutimit, kërkesën e llogarisë nga klasa punëtore ndaj cilitdo që nuk i përmbush detyrat.

Çështja është që udhëheqja e Bashkimeve Profesionale, duke filluar që nga ti e deri tek të gjithë të tjerët me radhë, t'u hyjë thellë problemeve të kësaj organizate, që janë të shumta e të rëndësishme.

Kur shtrohet çështja kush nuk e realizon planin, përgjigjja të jetë: punëtorët nuk e realizojnë sepse drejtorja nuk merr masat e nevojshme që të mos mungojë lënda e parë, sepse ka menefregizëm, moskokëçarje nga ana e drejtorisë dhe e administratës për sigurimin e saj etj., etj. Ose nuk u realizua plani, sepse disiplina nuk është në shkallën e duhur. Për këto ka përgjegjësi Partia, në radhë të parë, por kanë edhe administrata, bashkimet profesionale etj. Organizatat-bazë të Partisë në ndërmarrje janë ato që do t'i vënë në lëvizje të gjithë organizmat, duke marrë parasysh gjithë këtë gamë të gjerë të problemeve që kanë Partia dhe pushteti ynë

i proletariatit. Bashkimet profesionale, që ne i kemi ngritur kudo, përveçse në kooperativat bujqësore dhe në ushtri, po të bëjnë një punë të mirë dhe të shfrytëzojnë eksperiencën e madhe që ka çdo organizatë profesionale në ndërmarrje e në qendra të ndryshme pune, mendoj unë, do t'i çojnë punët përpara. Duke u kapur më shumë pas shembullit pozitiv ato të ndërtojnë punën për të luftuar anët negative që konstatojnë.

Forumi është zgjedhur jo për të bërë një punë burokratike, por për një punë të zgjuar dhe për t'u dhënë një orientim të shëndoshë mobilizues masave të gjera. Kjo është kryesorja. Pra forumi i Bashkimeve Profesionale të shohë ku janë të mirat dhe ku janë të metat dhe këto pastaj t'ua ngrejë masave që këto të hidhen në veprim. Në asnjë mënyrë forumi të mos e quajë veten si një organ konstatues, që vetëm konstaton dhe ia komunikon organizatës së Partisë dhe kaq. Organizata-bazë ka dhënë orientimin, detyrën dhe organizata profesionale, që e ka të qartë atë, vepron me iniciativë, pa pritur që për çdo gjë t'i diktojnë nga lart. Drejtuesi i organizatës profesionale për ta zbatuar direktivën bën mbledhjen e forumit, vendos se si t'i bëhet e qartë çështja masës dhe në emër të punëtorëve ulet e bisedon me drejtorinë e ndërmarrjes, së cilës i kërkon llogari për mangësitë në organizimin e në drejtimin e punëve që pengojnë realizimin e planit. Po ashtu bashkimet profesionale i kërkojnë drejtorisë së ndërmarrjes se ç'bën ajo me propozimet e punëtorëve për racionalizime e novacione. Bile edhe t'i kërkojë përgjigje deri në një për këto. Ndryshe bashkimet profesionale nuk e luf-

tojnë burokratizmin. Se drejtori mund ta marrë propozimin e ta lërë në dollap, duke thënë se nuk ka fonde. Në realitet fondet janë, por nuk do kokëçarje. Megjithatë edhe kur mungojnë fondet, drejtori i ndërmarrjes duhet ta ndiejë që e ka për detyrë të merret me propozimet e punëtorëve, se e ka vënë pushteti i proletariatit në krye të uzinës a fabrikës që t'i gjykojë e t'i drejtojë mirë punët. Po e kuptoi në këtë mënyrë, për vënien në jetë të atij racionalizimi që do të sjellë shumë fitime, ky drejtor e administrator, në qoftë se nuk është burokrat, menjëherë ngrihet e shkon në ministri dhe ngul këmbë që t'i jepet udhë zgjidhjes së problemit që i kanë ngritur punëtorët, se ndryshe, u thotë, nuk vete dot në fabrikë. Kësaj po, i thonë të luftohet burokratizmi, t'i hapet rrugë e gjerë iniciativës së klasës punëtore. Kësaj i thonë, gjithashtu, të zhvillohet prodhimi, të forcohet kontrolli, të vendoset kudo rregull e disiplinë e fortë.

Këto gjëra i the edhe ti dhe ekzistojnë. Edhe punë të mira bëhen, pse të gjitha këto realizime që janë arritur në vendin tonë nuk janë bërë me frymën e shenjtë, por me punën e masave, me përpjekje, me punën politike të Partisë, të Bashkimeve Profesionale, të Gruas, të Rinisë, të pushtetit etj. Por për asnjë moment nuk duhet të na shkojë në mendje sikur çdo gjë e kemi të përsosur. Ka detyra që kryhen me vështirësi, por ka edhe mjaft gjëra serioze subjektive që pengojnë realizimin e detyrave. Për eliminimin e tyre kërkohet një punë gjithnjë e më e shëndoshë nga ju e nga të gjithë.

Unë kam vënë në dukje se edhe për bashkimet

profesionale duhet menduar për të gjetur forma pune sa më frytdhënëse. Këto forma, shoku Rita, na i jep praktika e përditshme. Vetë ju, bashkë me shokët e forumit jeni në gjendje të gjeni forma e metoda pune sa më revolucionare dhe masive për të ndryshuar një situatë. Të marrim, për shembull, çështjet e indiferentizmit, të mungesës së disiplinës, të humbjes së kohës së punës etj., etj. Këto ekzistojnë. Por të themi që Bashkimet Profesionale nuk bëjnë punë politike dhe propagandë kundër këtyre shfaqjeve negative, këtë nuk e themi dot. Veçse fjala është që të përpiqeni të gjeni një formë, një metodë tjetër pune më të frytshme, e cila mund të sjellë më shumë rezultate se ato që janë përdorur deri tash.

Unë jam dakord me ty kur thua se përnjëherë nuk mund të zhduken këto, se natyrat e njerëzve janë të ndryshme, por me një punë të mirë shfaqjet e huaja vijnë duke u pakësuar, pasi njerëzit edukohen; ai që thyen disiplinën, ta zëmë, është i ri, është një çikë më i hedhur, i merr më lehtë gjërat, se edhe preokupime në përgjithësi nuk ka. Ose një tjetër është indiferent, nuk mobilizohet sa duhet për kryerjen e detyrave, por duke u rritur, fiton pjekuri dhe i kupton më mirë direktivat e Partisë, edhe këshillat, edhe punën politike që zhvillohet, bëhet aktiv e i përvishet më mirë punës. Pse thonë: «Është axhami ai». Kjo që thotë populli ka një kuptim, sepse i riu nuk i sheh problemet ashtu siç i shohim ne. Të riu në ndërmarrje, ia shtron politikisht problemin, por forma e punës që përdor nuk e ka atë efekt që duhet, ai nuk e kupton çështjen në atë shka-

llë që është e nevojshme. Atëherë duhet gjetur një formë pune tjetër për edukimin e tij. Po kush do ta gjejë, Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale? Jo, mënyrën e formën më të përshtatshme do ta gjejë vetë ai i bazës që i njuh më nga afër njerëzit, se shumë varet nga karakteri i njerëzve, nga edukata e përgjithshme e kolektivit. Ca kolektiva janë në pararojë, ca të tjerë nuk janë në pararojë; disa njerëz kanë mbeturina të së kaluarës më tepër nga të tjerët etj., etj., prandaj, duke pasur parasysh realitetin konkret, duhet vrarë mendja për metodën.

Konstatohet që në disa rrethe që kanë qenë më të prapambetura nga ana e zhvillimit, ka një hov më të madh, për shembull, në ato të Veriut. Kurse në rrethe si Korça e në ndonjë tjetër, që kanë qenë me kohë të përparuara, nuk vihet re një gjë e tillë. Pse ndodh kështu? Sepse në Korçë mund të ekzistojë mendimi «Hë more, i dimë këto gjëra». Korçari e ka harruar tërmetin e madh të vitit 1931 dhe kënaqet me gjërat e bukura që shikon sot, e sikur nuk mobilizohet si duhet. Ndërsa ky i Veriut tash sheh një botë të re, e shikon me sy ç'bëhet në një rast fatkeqësie, siç ishte tërmeti i 15 prillit. Në fakt të tërë i kanë të gjitha mundësitë e duhet të mobilizohen jashtëzakonisht shumë, dhe kështu ndodh, në tërë vendin ka vrull e mobilizim.

Puna e Partisë dhe e organizatave të masave është shumë e gjerë, shumë e ndërlikuar. Duke pasur parasysh këtë, unë këshilloj që këtë punë ta shikojmë një çikë më në detaje, të zbulojmë ku janë problemet kyç pas të cilave të kapemi më fort për të ecur më mirë, ndry-

she në gjithë këtë gamë të madhe problemesh mund të humbasim. Në përgjithësi kjo është një e metë e organizatave të bashkimeve profesionale. Të gjitha i shihni dhe thoni janë këto apo ato të mira e të meta, por organizatat atje në bazë shpërndahen në morinë e tyre, ndërsa forumet këtu në qendër e në rrethe nuk janë në gjendje të nxjerrin se problemet në disa zona nuk janë të njëjta me problemet e një zone tjetër, që në bazë të këtij diferencimi dhe të orientimeve të Partisë të ndërtojnë punën. Ju mund të merrni një vendim të përgjithshëm, por ajo që ka rëndësi është që ky vendim të bëhet zakon të zërthehet jo në mënyrë të përgjithshme, por në përshtatje me kushtet jo vetëm të rrethit, por edhe të ndërmarrjes ku vepron një njësi e bashkimeve profesionale. Kështu, më duket mua, mund të kemi rezultate më të mira në punë.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## **PUNA ME KUADRIN ËSHTE ME PËRGJEGJËSI. SE KE TË BËSH ME NJERËZIT**

*Nga biseda në takim in ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**5 shtator 1979**

Më duket se nuk po shihet me kujdes çështja e kuadrove, jo vetëm e të vjetërve, por sidomos e atyre të rinjve dhe, si pasojë, disa prej tyre humbasin profilin për të cilin janë përgatitur.

Ne kemi vendosur që kuadrot e rinj, pasi mbarojnë shkollën, të bëjnë stazhin. Gjithashtu kemi theksuar që ata duhet të mbushin tre ose pesë vjet punë në një vend në bazë pastaj, po lindi nevoja, mund të merren në ndonjë institucion qendror, ku të punojnë sipas profilit. Kështu u thuhet edhe atyre. Natyrisht, këto vendime nuk janë marrë pa qëllim. Mirëpo shihet se ato zbatohen në mënyrë aq burokratike, saqë ka raste që kuadri merret nëpër këmbë. Ky është një qëndrim shumë i dëmshëm për Partinë dhe për shtetin. Sipas disave, këta kuadro i jepen bazës se «duhet t'i jepen», meqë kanë mbaruar shkollën e lartë. Pa se ç'bëjnë,

ç'thonë e si punojnë atje, për këto s'e vret mendjen njeri, nuk interesohet kush, nuk i ndjekin në punë e në jetë, lëre pastaj për ankesat për padrejtësitë që u bëhen atyre dhe punës, që nuk i dëgjon askush.

Këto nuk i them teorikisht, por janë fakte të vërtetuara në praktikë. Ja, për shembull, në kombinatin e materialeve të ndërtimit «Josif Pashko» një inxhinier arkitekt nuk është caktuar në vendin që i takon, por bën punën e një punëtori. Si ky mund të ketë edhe të tjerë që merren me punë të thjeshta dhe që janë duke e humbur profilin e arkitektit.

Vihet pyetja: na duhen neve apo jo arkitektë? Po si nuk na duhen? Si të mos ketë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës asnjë arkitekt në aparatën e saj? Ajo ndërton çdo vit gjithë këto shkolla, muze, vatra kulture, terrene sportive dhe objekte të tjera dhe nuk ka një arkitekt në dispozicion të vet! Kur vendoset të ndërtohet një shkollë, muze etj., punëdhënësi, që në këtë rast është Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, do të bëjë porosi për përgatitjen e projekteve përkatëse me kërkesat e nevojshme, që objekti t'i përgjigjet anës funksionale dhe estetike. Po kush do ta bëjë atje këtë punë? Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, së cilës Qeveria i jep një fond për të ndërtuar shkolla, i duhet arkitekti, sepse këtë fond ajo do ta ndajë e do ta përdorë, pasi ajo e di sa nxënës do të ketë kjo ose ajo shkollë që do të ndërtohet, sa klasa duhen për secilën shkollë, sa nxënës mund të nxërë një klasë, sa dritare dhe nga ç'anë duhet t'i ketë, si do të bëhet, vendi ku do të ndërtohet etj. Kush i sheh tani të gjitha këto? Po

në realitet si ndodh? Thuhet t'i marrë këto kërkesa Instituti i Projektimeve, por këto atje grumbullohen të papërpunuara, sepse nuk kanë njerëz. Po ku janë gjithë këta arkitektë që janë diplomuar? Ata janë vënë në këto apo ato vende, ku të munden. Bile Ministria e Ndërtimit arkitektët i cakton të punojnë shpesh edhe si inxhinierë ndërtimi, gjë që nuk është e drejtë. Këto shqetësime, ka vite që i kam shtruar, bile me hollësi.

Mbarojnë studentët shkollat e larta e universitetin dhe Komisioni i Planit të Shtetit, në mënyrë automatische, ua ndan me radhë ministrive si kontingjent. Ministrinë, nga ana e tyre, kur u dërgohen kuadrot e rinj, nuk bëjnë një punë të studiuar që të dinë se ku t'i çojnë dhe ku t'i vendosin. Pse? Sepse nuk kanë koncepte të drejta për kuadrin, jo vetëm drejtuesit e Komisionit të Planit të Shtetit që merren me këtë punë, por edhe drejtorët e drejtorive të kuadrit nëpër ministri e ndërmarrje. Kush i udhëzon këta për këto punë dhe a mbli-dhen ndonjëherë? U vihen vallë në dukje tërë këto të meta të përgjithshme që po dalin, ky trajtim që u bëhet kuadrove?

Ata që punojnë me kuadrin kanë përgjegjësi të madhe për këto çështje dhe duhet të jenë shumë të kujdesshëm me njerëzit. Këtë e them se më vijnë të dhëna që flasin për sjellje dhe qëndrime të palejueshme nga ana e drejtorëve dhe e kuadrove poshtë, të cilët bëhen pengesë për zbatimin e normave të Partisë për sa i përket politikës së kuadrit. Kam marrë vesh që bëhen gjëra të tilla, bile që kuadrit i thuhet: «Shko, se nuk kam kokën tënde unë» ose «Do të vesh apo jo në

punën që të kemi caktuar? Në mos, po lëri çelësat dhe shko!»<sup>1</sup>. Po të isha unë, në vend të atij që i thuhet kështu, do t'i thosha shefit të kuadrit: «Dorëzoi ti çelësat!» dhe do ta bëja çështje të madhe në Parti. Mirëpo kuadrot nuk e bëjnë kështu.

Ne themi që njerëzit duhet të flasim e të kritikojnë pa druajtje. Kur bëhen mbledhje dhe rezultojnë të meta e dobësi në punë, atyre që ngrenë probleme e bëjnë vërejtje, u thuhet: «Pse, more shokë, nuk i keni thënë më parë këto?». «Neve na ka vajtur gjuha prapa, — përgjigjen ata, — mirëpo s'po na e vë veshin njeri, prandaj ç'të flasim?».

Në qoftë se do të vazhdohet të veprohet kështu, shokë, mund të vijë një ditë që do të shfaqen pakënaqësi të mëdha te njerëzit dhe, si pa u kuptuar, në një moment kritik, këto pakënaqësi nga sasia do të kthehen në cilësi, pra do të kalojnë nga pakënaqësi kundër disa njerëzve që nuk zbatojnë drejt politikën e Partisë, në pakënaqësi ndaj pushtetit popullor. Atij që mbaron universitetin apo një shkollë tjetër të lartë, ti si organ pushteti duhet t'i japësh punën që i takon, pra, t'i japësh mundësinë të ushtrojë profesionin për të cilin ka mbaruar shkollën.

Në gazetën «Zëri i popullit» lexova sot një artikull<sup>1</sup>, ku flitet për ndërtimin e objekteve ose të shtëpive me panele, pra, për banesat me parafabrikate. Po të shikosh edhe fotografinë që është botuar për ta ilustruar këtë

1. Është fjala për shkrimin me titull «Banesat e parafabrikata dhe detyrat e arkitektëve».

shkrim, objekti duket si një kazermë e madhe! Artikulli është shkruar mirë nga ana teorike. Arkitektit që e ka përgatitur, nuk ke ç'i thua, të tëra ashtu si shkruan ai janë, por kam frikë se nuk do të zbatohet asnjë nga ato që thotë ai, sepse realizimi i tyre krijon kokëçarje për ata që do t'i zbatojnë. Sipas teknologjisë që përdoret për këto parafabrikate, ndërtesa të tilla në dimër janë akull fare, kurse në behar të nxehta. Në këto kushte përdorimi i kësaj teknologjie nuk nxjerr punë të cilësisë së kërkuar në ndërtime, sepse është një teknologji e vjetër, e njëllojtë për të gjitha vendet dhe klimat. Kurse sot kërkohet të merren parasysh kushtet konkrete, për arsye se ashtu si është klima në Tiranë, nuk është në Kukës; si është në Korçë, nuk është në Elbasan. Mirëpo ne bëjmë kudo të tilla lloje ndërtimesh. Veç kësaj, ne nuk duhet të bëjmë një ose dy tipa. Për arsyet që thashë, na duhet të përgatisim shumë tipa. Por që të arrihet një gjë e tillë, duhet të bëhen shumë forma, kallëpe, ashtu siç kemi kallëpet e këpucëve, të prodhimeve plastike etj.

Në fotografinë e botuar në gazetë të bie menjëherë në sy se ndërtesa nuk ka asnjë ballkon. Mirëpo këto shtëpi ngrihen jo për pesë ose dhjetë vjet, por për njëqind bile edhe për më shumë vjet, se ato janë krejt beton dhe nuk prishen. Prandaj duhet menduar mirë qysh në fillim: do ta bëjmë mirë punën, apo do të vazhdojmë kështu siç e kemi nisur, se eksperiencia tregon që e fillojmë një punë, por nuk marrim mundimin më të vogël që t'i bëjmë më vonë një ndryshim të domosdoshëm që kërkon koha.

Artikullshkruesi e trajton ndërtimin e banesave të parafabrikuara në të gjitha aspektet. Ai prek edhe çështjen e temperaturës që duhet të sigurohet brenda, shfaq mendimin se ndërtesat duhet të vishen me pllaka qeramike, të ruajnë disa karakteristika të vendit, t'u jepet forma kombëtare nëpërmjet dekoracioneve popullore e të tjera, në mënyrë që këto lloj ndërtesash me pjesë betoni të parafabrikuara të mos bëhen uniforme. Drejt i thotë ai këto, por duhet të shikohet më me kujdes kjo punë, se ka rrezik të vazhdohet si gjer tani.

Po kush duhet t'i realizojë këto kërkesa? Kuadrot e profilizuar, arkitektët. Dhe jo vetëm ata të drejtorisë së kësaj apo të asaj ndërmarrjeje, por edhe ata të ministrive. Arkitekti i ndërmarrjes punëdhënëse kërkon që ndërtesa të bëhet sipas projektit, por duhet të kemi parasysh që edhe qytetit të mos ia prishim bukurinë, përkundrazi të kujdesemi që t'ia ruajmë. Prandaj në këto raste të manovrohet e të mos lakmohet të bëhen ndërtime vetëm e vetëm që të strehojmë sa më shumë familje, por të shihet edhe urbanistika e qyteve, që ndërtesat të bëhen të bukura dhe jo uniforme, siç kam parë në Elbasan.

Shtëpitë, siç thashë, nuk ndërtohen për një vit apo për dhjetë vjet, prandaj duhet menduar me shumë kujdes, se ato po u montuan, nuk çmontohen më, që t'u bëhen ndryshime. Ka qenë ca kohë përpara një mendim që, «Oburra, t'i zhdukim ballkonet, se na zënë vend» etj., etj. Jo, nuk është ashtu, ballkonet nuk na zënë hiç vend, ato janë të nevojshme se shërbejnë për ajrimin e hyrjes, janë një ndihmë për familjen, në to mund të

nderësh rrobat e lara etj. Ne i shikojmë se si mbushen ballkonet e shtëpive tona rreth e rrotull plot me plaçka, se nuk kanë vend tjetër ku t'i thajnë.

Pra, duhet parë mirë puna e kuadrove. Më parë të bisedohet me punonjësit e kuadrit këtu, në aparatën e Komitetit Qendror, që këta të punojnë seriozisht me drejtorët e kuadrit të ministrive. E dimë se tani janë ndarë me nomenklaturë kategoritë e kuadrove dhe duhej bërë kjo ndarje, por nga këta të shikohet e të ndiqet vazhdimisht se si po zbatohet politika e Partisë me kuadrin nga drejtori i kuadrit në ministri, si i ndan kuadrot Komisioni i Planit të Shtetit, ku i çon ministria këta kuadro etj. Për zbatimin e normave të Partisë për këtë problem ata të japin llogari. Po ku do ta japin llogarinë? Këtu, në Komitetin Qendror, mbasi politikën e kuadrit e bën Partia, prandaj ne duhet ta shohim si e bën këtë politikë ky drejtor apo ai shef kuadri i ministrisë ose i ndërmarrjes, se nuk mjafton vetëm të themi me fjalë që këtë politikë e bën Partia.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

## **PUNA E PARTISË PLEKSET ME PUNËN E PUSHTETIT, POR JO TË DUBLOHET**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**10 shtator 1979**

Problemet e Partisë, në mënyrë të veçantë, ju i diskutonit vazhdimisht me shokun Hysni [Kapo], i cili ju ndihmonte për zgjidhjen e tyre, ashtu siç na mëson Partia. Ai ka një përvojë të madhe në këtë drejtim, por tash që është sëmurë dhe nuk ndodhet këtu, mirë është që rreth tyre të diskutojmë së bashku.

Siç e kemi vënë në dukje edhe përpara, që të realizohen detyrat shtetërore, që na shtrojnë Komiteti Qendror dhe Byroja Politike, duhet të ngremë Partinë në këmbë, ndryshe është e zorshme t'i zgjidhim si duhet të gjitha problemet e mëdha që i dalin përpara vendit. Suksese kemi dhe këto janë të mëdha, por duhet njohur se kemi edhe dobësi.

Nuk mjafton vetëm që dobësitë t'i konstatojmë, por të marrim edhe masa për t'i zhdukur. Dhe për këtë është e domosdoshme të gjejmë shkaqet e vërteta që i lin-

din ato. Këto dobësi, përveç faktorëve objektivë e kanë bazën edhe te moskuptimi kurdoherë me partishmëri nga gjithsecili i detyrës shtetërore që i ngarkohet.

Me partishmëri duhet ta kuptojë detyrën komunisti që punon në organet e Partisë, por kështu ta kuptojë edhe ai që merret me punë teknike. Prandaj si për ne, në radhë të parë, por edhe për gjithë të tjerët, çështja shtrohet që ta njohim problemin nga ana shtetërore. Në kryerjen e detyrave shtetërore do të duket fryma e partishmërisë e komunistëve ose e atyre që janë të paorganizuar në Parti, do të duken, gjithashtu, edhe të metat në zbatimin e detyrave. Edhe në veprimtarinë kolektive për zbatimin e një detyre ndodh që ka cektësi, mangësi organizative, veçanërisht nga ana e individëve. Pra që të arrihen rezultate më të mira në kryerjen e detyrave shtetërore, po e ritheksoj, nuk mjafton vetëm t'i konstatojmë dobësitë, por të përpiqemi të gjejmë shkaqet që i linden ato dhe ta ndreqim gjendjen. Pra të nxjerrim shkaqet më kryesore, të cilat t'i përpunojmë për atë organizatë partie ku shkojmë të japim ndihmë dhe të bëjmë që një situatë jo e mirë të rregullohet.

Për të dhënë një ndihmë sa më efektive, është e domosdoshme t'i njohim në përgjithësi si karakteristikat e rrethit ku shkojmë, ashtu edhe ato të të gjitha rrethëve. Po për ç'karakteristika është fjala këtu? Për karakteristikat e punës së Partisë, me të mirat dhe me dobësitë e saj. Veçanërisht, kur shkojmë në një rreth, sidomos për të ndjekur një ose dy probleme (se problemet nuk duhet t'i marrim të tëra bashkë, sepse po të

veprohet kështu, nuk zgjidhim dot gjë dhe nuk do të japim dot ndihmën që duhet), është mirë që t'i njohim këto karakteristika, të mira ose negative, që të dimë përse do të vemë e në ç'drejtime të ndihmojmë.

Këtë gjë e kam thënë edhe herë të tjera, po pse e përsëris? Sepse themi që në rrethe, komitetet e Partisë shpeshherë tërhiqen pas problemeve me të cilat janë ngarkuar organet e pushtetit e nuk thellohen për të bërë, në radhë të parë, një punë partie me themel. Puna e komiteve të Partisë plekset me punën konkrete të pushtetit, domethënë me realizimet e planeve, me punën teknike. Por shpesh disa nga punonjësit e komitetit të Partisë, veçanërisht disa nga anëtarët e byrosë, jepen më shumë pas problemeve shtetërore dhe, duke mos e kuptuar si duhet rolin udhëheqës të Partisë, marrin vetëm me anët teknike, thjesht ekonomike të problemeve, se këto janë më të prekshme. Mirëpo në këtë mënyrë ata nuk bëjnë gjë tjetër veçse dublojnë organet e pushtetit.

Dublimi i organeve të pushtetit do të thotë që punonjësi i Partisë nuk i ka kuptuar mirë mësimet e Partisë për rolin udhëheqës të saj dhe nuk ka parasysh që edhe në organet e pushtetit punojnë njerëz të Partisë. Ai nuk ka bërë përpjekje që, duke i njohur problemet shtetërore, të vejë në bazë dhe të punojë në rrugë partie për zhdukjen e të metave që ekzistojnë ose për përgjithësimin e përhapjen e anëve të mira që shfaqen në punë; të vërë në dukje politikisht, ideologjikisht, organizativisht rëndësinë e tyre, të udhëzojë për kuptimin e çështjeve të ndryshme dhe disa herë të informojë si ndihmohen

anëtarët e Partisë në funksionet e tyre shtetërore, si e organizojnë ata punën etj., etj. Kjo është një ndihmë konkrete. Mirëpo kjo gjë nuk bëhet si duhet, bile edhe instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror, që venë në rrethe me një program të caktuar, për të cilin përgatiten mirë, shpeshherë nuk përgatiten si duhet politikisht dhe ideologjikisht.

Nga kontaktet me sekretarët e Partisë, konstatoj se ata, më parë se për çdo gjë tjetër të flasin për çështjet ekonomike. Është vështirë të gjesh një sekretar që ta fillojë bisedën nga çështje politike, të flasë për probleme të kulturës ose për ndonjë problem tjetër, për shembull, të fushës së arkeologjisë së rrethit ku drejton, ose të shpjegojë disa situata moralo-politike që kanë dalë në rreth në atë moment kur diskutojmë etj. Edhe kur ndodh, në ndonjë rast, këto çështje paraqiten shkurtimisht, me pak fjalë.

Kur një shok i udhëheqjes së Partisë shkon në një rreth, ai në radhë të parë, ka nevojë të dijë për gjendjen e Partisë në atë rreth, si punohet atje dhe cila është situata politike. Prandaj sekretari i komitetit të Partisë të rrethit, që di gjithë ato hollësi nga jeta shoqërore e moralo-politike e punonjësve të rrethit, me anët pozitive që kanë, me mbeturinat e tyre etj. duhet t'i bëjë atij një pasqyrë të qartë të kësaj situatë. Sekretari ta informojë udhëheqësin që në këtë apo në atë rajon të rrethit ka një nivel politik më të mirë, ka më pak shfaqje mikroborgjeze, kurse në krahinën tjetër ka më shumë shfaqje të tilla etj. Në këtë mënyrë ai i bën shokut të udhëheqjes një pasqyrë të përgjithshme të situatës

moralo-politike që e ndihmon atë të kuptojë më mirë pse ndodh kështu apo ashtu në këtë krahinë dhe, në bazë të këtyre informatave, të gjykojë për masat që duhen marrë. Kështu shoku i udhëheqjes do të arrijë në përfundimin se si janë zhvilluar e si duhen zhvilluar seminarët dhe bisedat politike, si janë punuar materialet e Partisë etj., etj. dhe i jep ndonjë këshillë sekretarit të komitetit të Partisë të rrethit, duke i kërkuar punë partie me cilësi më të lartë.

Kam në dorë një informacion të përgatitur nga shokët e zyrës së letrave dhe të ankesave në aparatën e Komitetit Qendror, ku tregohet se si janë zgjidhur problemet e letrave e të ankesave të popullit në rrethin e Shkodrës. Në faqen e parë të këtij informacioni thuhet se si janë bërë mbledhjet, si është pritur populli etj., etj., gjëra që nuk kanë aq rëndësi sa kanë problemet që ngrihen atje. Pra dhe nga ky informacion dalin disa probleme.

Një pjesë e letrave dhe e ankesave, drejtuar organizatave të Partisë etj., etj., në rrethin e Shkodrës, janë për çështje që i takojnë punës së Partisë. Kjo do të thotë se një përqindje e mirë e njerëzve ankohen kundër veprimeve të padrejta të kuadrove tanë, gjë që nuk duhet të ndodhë.

Sinjalizimet për gjendjen e punëve në disa ndërmarje e kooperativa, për sjelljet e qëndrimet e padrejta të disa komunistëve e kuadrove, tregojnë, ndër të tjera, se kemi të bëjmë me marrëdhëniet kuadër-masë, me kuptimin dhe zbatimin e luftës së klasave, me qëndrimet

oportuniste e liberale dhe herë-herë sektare ndaj njerëve e të tjera.

Ai që i shkruan letrën dhe i ankohet komitetit të Partisë, ka të drejtë ta shtrojë aty çdo problem dhe ta trajtojë atë siç e gjykon. Nuk përjashtohet që ai të jetë prekur në mënyrë sentimentale, sepse vërejtjen e njerit ose të tjetrit e ka gjetur disi arrogante ose kur i është kërkuar llogari nuk i ka ardhur fort mirë dhe për këto arsye i drejton letër komitetit të Partisë. Shfaqje të tilla ekzistojnë, por këto veç krijojnë shqetësim për Partinë. Prandaj ajo që dua të theksoj është se për zgjidhjen e problemeve nga Partia, metoda e komandimit është e huaj. Partia nuk duhet të përdorë as arrogancën, as komandimin. Në këto raste komandim do të thotë vrazhdësi, mungesë argumentimi, mungesë aftësie për ta bindur njeriun. Edhe arroganca është një sëmundje që ne, vazhdimisht, e kemi luftuar dhe gjithmonë përpiqemi t'i edukojmë shokët të jenë dashamirës dhe të ndjekin rrugën e bindjes me njerëzit. Të mbash qëndrim dashamirës nuk do të thotë të jesh liberal. Nuk ka kurrfarë liberalizmi kur tjetrit i flet hapur e në mënyrë shoqërore, kur ia thua të vërtetën në sy, kur nuk i fërkon krahët dhe nuk mban hatër ndaj njerit ose ndaj tjetrit, kur i jep të drejtën atij që i takon.

Natyrisht, qëndrimet sektare janë një shkak për prishjen e unitetit si në qytete, dhe në fshatra. Kur ka familje që nuk flasin me njëra-tjetrën, kjo është shqetësuese. Dhe shfaqje të tilla ka edhe në disa organizata-bazë, ku mungon uniteti, për shkaqe që duhej t'i zgjidhte me shumë kujdes komiteti i Partisë i rrethit,

të cilat kalojnë pastaj edhe në familje, përhapen edhe midis fiseve.

Për këto arsye është e domosdoshme që Partia në rreth të nxjerrë konkluzione për çështje politike, ideologjike dhe morale, për njohjen e mentalitetit dhe të shkallës së zhvillimit intelektual, moral e politik të njerëzve, me qëllim që të luftohen mbeturinat që ekzistojnë. Për asnjë moment të mos mendohet se mbeturinat janë zhdukur. Kur disa familje të një fshati mbajnë mëri, kjo duhet ta shqetësojë seriozisht organizatën e Partisë, se këto mund të jenë konflikte brenda vetë familjes, por mund të jenë edhe midis dy familjeve ose mund të shtrihen më gjerë, brenda një fisi të tërë. Natyrisht, puna tani nuk arrin deri në përleshje me armë, siç ndodhte më përpara, kur ishin të shpeshta rastet e hakmarrjes, por ndërlikime ekzistojnë. Këto ndërlikime mund të lindin për çështje morale, për çështje martesë etj., ka shumë fenomene që mund të pleksen këtu dhe të tëra këto janë probleme themelore ku duhet të ndalet organizata e Partisë.

Në qoftë se një organizatë-bazë e Partisë nuk i shikon në thellësi problemet, por shqetësohet vetëm nëse dalin apo jo njerëzit në punë, duke lënë pas dore faktorët që dobësojnë unitetin e Partisë e të popullit, organizimin e punës, atëherë ajo nuk punon mirë.

Puna e Partisë duhet të theksohet pikërisht në këto drejtime e jo në përgjithësi. Instruktorët e Komitetit Qendror duhet të dinë t'i gjykojnë problemet sipas kushteve të çdo rrethi, të njohin cilat janë pro-

blemet shoqërore shqetësuese të tij, se kështu do të zbulojnë edhe shkaqet e të metave, që mund të vijnë nga dobësi të punës organizative, të organizatës së Partisë, ose nga zhvillimi i pamjaftueshëm i punës politike me njerëzit.

Në informacionin që përmenda bëhet fjalë edhe për shumë gjëra të tjera. Shokët që kanë përgatitur këtë material, duke e analizuar mirë çështjen e strehimit, nxjerrin në pah një problem të rëndësishëm lidhur me të. Aty vihet në dukje se në Shkodër ka shumë shtëpi private. Mirëpo ato po prishen, prandaj për meremetimin e tyre, duhet të merren masa. Punonjësit e sektorit të letrave e kanë parë gjendjen në vend dhe kanë plotësisht të drejtë që e shtrojnë çështjen kështu. Por edhe Partia me organet e pushtetit në Shkodër e kanë parë këtë gjendje, atëherë pse nuk marrin masa në kohë për meremetimin e tyre?

Ai që ka shtëpi private dhe ka, për shembull, tre-katër rroga të ardhura nuk mendon t'ia ndreqë shtëpinë shteti, pse e di që ky s'ka asnjë detyrim për të. Por shteti është shumë i interesuar që shtëpia e njërit apo e tjetrit, të merremtohet, të bëhet e re, që pronarët e saj, të cilët janë punonjësit tanë, të banojnë e të rrojnë rehat brenda në këtë shtëpi. Atëherë çfarë duhet të bëjë shteti? Së pari, të organizojë mirë punën komunale dhe, së dyti, t'u sigurojë pronarëve të shtëpive materialet e nevojshme për meremetim. Natyrisht, pasi të sigurohen materialet, do të sigurohen edhe punëtorët. Po të merret kjo masë, do të hapet

edhe një front i gjerë pune në qytet, sepse, të meremetosh shtëpitë private të qytetit të Shkodrës, do të thotë që komunalja të grumbullojë një forcë të madhe pune në dorën e vet.

Ndërtesat e reja nuk kanë probleme, se të gjitha këto i ka bërë shteti. Sidoqoftë edhe për këto shtëpi shteti duhet të kujdeset që të mirëmbahen. Kurse, në fshat, këtë punë e bëjnë vetë fshatarët, pra këta vetë paguajnë për mirëmbajtjen e shtëpive. Kooperativat bujqësore kanë formuar skuadra me muratorë, të cilat paguhen nga fondi i përbashkët i kooperativës. Cilido anëtar që ndërton shtëpi, paguan paratë dhe këto skuadra shkojnë ia ndërtojnë shtëpinë të re ose, sipas nevojës, ia meremetojnë anëtarit. Ndërsa në qytete kemi ndërmarrjen komunale për këto punë. Ajo duhet të ketë «ushtrinë» e saj me muratorë në çdo qytet të pajisur me mjete, materiale me të tëra ç'i duhen, për t'i kryer punët me kohë e jo të zvarriten ato me vite. Tani mund t'i lutesh komunales të të dërgojë një njeri për të të rregulluar apo për të të ndërtuar një mur, çatinë apo një dritare dhe ajo të mos e vërë ujin në zjarr. Kështu nuk duhet të ecet. Këto janë punë shtetërore, por në këtë sektor, duhet të ndihet e fortë fryma e Partisë.

Mund që nga organet e pushtetit puna e komunales të konsiderohet si joproduktive. Ky është një mendim i gabuar. Kjo punë duhet konsideruar produktive për arsye se po iu prish shtëpia njërit, ai do të kërkojë patjetër të strehohet, pra do të kërkojë shtëpi të re nga shteti, i cili është i detyruar t'i japë, se nuk mund ta

lërë punonjësin pa strehë. Çdo pronar shtëpie është në gjendje të përballojë shpenzimet për një meremetim të vogël, po në rast se nuk bëhet kujdes në këtë drejtim dhe lihet t'i rrëzohet një kënd i tërë i shtëpisë. atëherë përballimi i shpenzimeve bëhet më i vështirë për pronarin, por edhe shtetit kjo nuk i intereson. Me këtë rast, sa të jetë e mundur, të shikohet edhe për rabate më të ulëta, më të arsyeshme për t'i lehtësuar të interesuarit.

Strehimi nuk është një problem me rëndësi vetëm ekonomike, por edhe politike. Shtëpi e apartamente të reja me aq sa mundim po ndërtojmë, por në të njëjtën kohë duhet të kujdesemi që edhe shtëpitë private t'i mirëmbajmë. Ky është parimi i përgjithshëm, veçse kur vjen puna në praktikë, ai nuk zbatohet si duhet.

Sektorin komunal ne e kemi analizuar herë pas here, sepse është një sektor i domosdoshëm që kryen shërbime të shumanshme. Ndërmarrjet komunale shërbejnë në shumë drejtime te ne, deri për rregullimin e sahatit. Dikujt i duhet një sëpatë, dikujt një sapllak te neqeje, një dollap apo karrige etj., etj., dhe të tërë drejtohen në sektorët e komunales. Më kujtohet se në Gjirokastër, para 20 vjetëve përballë ndërtesës së komitetit ekzekutiv që është tashti, drejtuesit e bashkimit të kooperativave të artizanatit kishin ndërtuar ca «foleçka», disa dyqane të vogla. Në njërën prej tyre ndreqeshin sahatet dhe punonte djali i dy pleqve që njihja. Tash ato «foleçka» me siguri janë ndryshuar ose zhdukur fare, se shërbimet i ka marrë komunalja në varësi.

Drejtorisë së Përgjithshme të Ekonomisë Komunale duhet t'i vëmë rëndësi të madhe. Këtë vërtet nuk e quajmë ministri, por, në fakt, për punët që përballohen, ministri është. Ky dikaster ka një detyrë shumë të komplikuar, se ka të bëjë përditë me njerëzit, me parqet, me rrugët, me hallet e popullit, që mbase duken të vogla, por kanë shumë rëndësi për jetën e çdo njeriu, të çdo familjeje. Se një pikë në çati, fjala vjen, po të mos meremetohet në kohë, i prish jo vetëm mobiliet të zotit të shtëpisë, po tërë murin. Sigurisht kjo ngjall pakënaqësi dhe njerëzit pastaj fillojnë të ankohen. Pra, për ndërtimet po e po që duhet bërë kujdes, por duhet kujdesur edhe për instalimet e ujit, të cilat ka raste që vazhdojnë të bëhen akoma pasi ndërtohet muri e kështu edhe për çështje të tjera.

Pushteti të marrë masa, të sigurojë materialet që duhen për meremetime, si: gozhdë, gëlqere, llaç, tulla, dërrasa e të tjera materiale të nevojshme si këto. Po mund të thuhet se këto na mungojnë. Po ata punëtorë të komunes që shkojnë e punojnë privatisht e fshehurazi nëpër shtëpitë private ku i gjejnë materialet? Sigurisht në shtet i gjejnë, i marrin andej-këtej, pra, i vjedhin, i grumbullojnë dhe kështu u prishet ndërgjegjja njerëzve. Kjo ndodh sepse në vend që të organizohet mirë kjo punë lihet shteg për përhapjen e të tilla praktikave të huaja për rendin tonë socialist.

Pse na ndodhin këto? Se mbledhja e bashkimeve profesionale me punëtorët e komunales bëhet në formë të përgjithshme, jepet në të një raport me disa shifra, pastaj vazhdon puna rutinë. Dhe organizata e Partisë

atje, që ka kontakte me masat e popullit, me organizatat e masave, është në dijeni të problemeve, të ankesave e të kërkesave të masave, pra e njeh situatën, por nuk merr masa të menjëhershme. Ky qëndrim është shumë i dëmshëm. Ajo kur shikon se është e domosdoshme të zgjidhet ky apo ai problem, duhet të veprojë menjëherë, pa vonesë dhe të mos presë kohën kur është vënë në plan. Si mund të zgjidhet, për shembull, mirëmbajtja e shtëpive private? Për këtë mund të krijohet një komision dhe të shikohet se ç'duhet për këto shtëpi që kanë nevojë të meremetohen, të bëhen llogari sa kushtojnë materialet, nga duhet të vijnë ato etj., etj. Me një fjalë, të vihet në lëvizje komiteti ekzekutiv etj. dhe, në qoftë se çështjet nuk marrin rrugë, të kërkohet ndihmë edhe nga Qeveria. Kështu duhet të bëhet, pra, të veprohet në mënyrë dinamike, se është e zorshme t'i përballojë shteti me shtëpi, me investime gjithë ato familje.

Për zgjidhjen e problemeve të ndryshme Partia gjykon gjithmonë me pjekuri dhe vë përpara përgjegjësisë ata që u sjellin shqetësime njerëzve. Por ka raste që disa organizata të Partisë nuk mbajnë si duhet qëndrim ndaj veprimeve arbitrare. Në të tilla raste e nga të tilla qëndrime njerëzit e ndershëm dhe me karakter fyhen. Po nga kush? Në fillim nga kryetari dhe nga këshilltari si persona, por tërthorazi ata krijojnë një mendim jo të shëndoshë edhe për organizatën-bazë të Partisë që i lejon këto shfaqje. Në rast se vërtetohet një vjedhje, vjedhësi duhet të dënohet, dhe të tërë janë dakord për këtë, por jo t'i kontrollohet.

për shembull, shtëpia edhe një njeriu të ndershëm. Mund të gjenden mënyra më të përshtatshme për të zbuluar të vërtetën.

Kam marrë vesh se një punonjës nuk u pranua 6 ditë në punë, sepse nuk kishte shkuar të punonte një të diel. Po ku e gjejnë këtë të drejtë drejtuesit e kësaj qendre pune të veprojnë në këtë mënyrë, të japin të tillë urdhra?! Në qoftë se merret ana ligjore e çështjes, drejtori nuk ka të drejtë t'i kërkojë punëtorit të vijë të punojë edhe të dielave. Megjithatë kur është nevoja, punëtori punon edhe të dielën, edhe natën, sepse ai e ndien dhe e kupton që duhen transportuar, fjala vjen, mallrat e kooperativës se prishen, veçse nuk ka asnjë ligj te ne që ta pushojë për këtë rast punëtorin 6 ditë nga puna. Ky është arbitraritet, që tregon arrogancën e disa kuadrove dhe mungesën e frymës së kontrollit të shëndoshë të organizatës së Partisë mbi veprimet e tyre.

Komiteti i Partisë, ashtu siç thamë, duhet të jetë vigjilent për të parë se si kuptohet, si punohet e si zbatohet vija, por ajo që duhet ta vërë në jetë këtë vijë është baza e Partisë, janë organizatat-bazë të saj. Atje njerëzit duhet të jenë të ndërgjegjshëm për të luftuar arrogancën e prepotencën, për të mos lejuar që të shkelen ligjet dhe kur lind një situatë që na rrezikohet prodhimi, duhet bindur, për shembull, zëtoristi të mos e lërë prodhimin në mes të arës ditën e diel. Po të flasim me punëtorin me ton shoqëror, ai edhe në qoftë se nuk ka mundësi të dalë në punë të dielën, do ta bëjë atë punë të hënën dhe po të jetë

do të punojë edhe natën e së hënës. Bile po të mos mbarojë puna të hënën, do të punojë edhe të martën natën, do të rrijë edhe 24 orë pa gjumë. Kuadrot drejtues t'u flasin njerëzve në frymë partie. Duhet menduar se njerëzit kanë edhe halle, prandaj do të ketë raste që të mos vijnë për të punuar të dielën.

Ja edhe një rast tjetër. Përgjegjësi i ndërmarrjes së ndërtimit refuzonte pranimin e një punonjësi në punë, sepse, kur ishte në kantierin e ndërtimit të Kukësit, ky ishte martuar me një vajzë pa pëlqimin e prindërve të tij! E ç'hyn këtu martesat?! Ata që veprojnë kështu udhëhiqen nga pikëpamje konservatore, patriarkale, vajza ose djali, sipas tyre, nuk kanë të drejtë të martohen pa lejen e prindit. Çështjen e dashurisë dhe të martesës me një vajzë, pa lejen e prindit, këta njerëz e konsiderojnë krim, ashtu si njëherë e një kohë. Megjithatë, po të shkosh në rreth, besoj se sekretari i Partisë do të të flasë për çështje ekonomike, për rendimentin, për koston, për asortimentet etj., etj., kurse për probleme shoqërore të tilla zor se të flet.

Këto janë çështje partie, janë probleme të marrëdhënieve shoqërore, ku duket shkalla e përparimit të njerëzve. Që në Kukës ka shkuar përparimi, për këtë s'ka asnjë dyshim. Zhvillimi edhe atje si kudo është i madh, por mbeturinat patriarkale janë ndryshe në atë rreth, ndryshe në Vlorë, ndryshe në Përmet, ndryshe në Gjirokastrë; zhvillimi politik dhe moral-ideologjik ka veçoritë e tij, ashtu siç ka veçoritë e veta edhe zhvillimi ekonomik nga njëri rreth në tjetrin.

Ka njerëz që i kuptojnë politikisht thellë proble-

met, ka të tjerë që i kuptojnë përciptas, ka edhe nga ata që nuk i kuptojnë, po ecin si të mundin. Prandaj puna e Partisë duhet të bëhet e thelluar, e diferencuar sipas nivelit të njerëzve. Niveli ideologjik dhe politik i njerëzve tanë është rritur, progresi në këtë drejtim është i dukshëm, por akoma ka edhe të meta që nuk duhen nënvleftësuar, se mund të shndërrohen në sëmundje. Ja, për shembull, nga statistikat e krimeve, konstatojmë se një përqindje të madhe të tyre e zënë vjedhjet. Nuk mund të themi se shkak i vjedhjeve është fukarallëku, se varfëri nuk ekziston te ne, siç ekzistonte në të kaluarën, ose në vitet e para të Çlirimit të vendit. Te ne të gjithë janë në punë dhe niveli i jetesës së njerëzve është ngritur në mënyrë të pakrahasueshme me të kaluarën. Ka familje që marrin dy-tri rroga, ka që marrin edhe katër, edhe pesë. Përveç kësaj e drejta e pensionit është shtrirë kudo, arsimi e mjekimi për të gjithë janë falas, qiratë e shtëpive janë të ulëta, shtëpitë e punonjësve janë të zbukuruara, në arkat e kursimit shumë punonjës kanë depozituar lekë etj., etj. Atëherë përse ka persona që vjedhin? Vjedhin se nuk kuptojnë akoma rëndësinë e pronës së përbashkët shoqërore, se nuk kuptojnë rrezikshmërinë politike, sabotuese dhe gërryese të vjedhjeve për pushtetin tonë popullor, sepse me këta njerëz nuk është bërë punë intensive edukuese. Kush nuk bën kujdes për ruajtjen e pronës që i përket gjithë shoqërisë, kryen një veprim antisocialist. Një shitës që jep mallra me hatër, krijon pakënaqësi në masat e popullit. Në këtë mënyrë shitësi ose shitësjat dë-

mtojnë dhe me këtë tregojnë se nuk e kanë kuptuar politikisht drejt rolin e tyre.

Po a ka arsye vallë që të na ngjasin këto gjëra? Jo, nuk ka, megjithatë duhet t'i vlerësojmë mirë këto probleme që të mënjanohen sa më shumë. Vlerësimi i tyre bëhet me shpjegime të qarta, parimore. Që këto probleme të kuptohen thellë dhe të zgjidhen drejt, duhet bërë një punë e dendur politike nëpërmjet të gjitha formave dhe aktiviteteve, nëpërmjet seminareve, diskutimeve të artikujve të gazetave, librave, gjithmonë lidhur me praktikën. Këto është e nevojshme të bëhen si duhet, me qëllim që t'i shërbejnë punës e jo të trajtohen në mënyrë formale, sa për të kaluar radhën.

Zbërthimi i direktivave dhe kontrolli i zbatimit të tyre kanë rëndësi të madhe. Këtë gjë Partia duhet ta ndiejë dhe t'i kushtojë shumë kujdes dhe, kur them Partia, kam parasysh që nga organizatat-bazë deri te komitetet e Partisë. Prandaj në takimet me shokët drejtues të Partisë në rrethe, t'u theksohet që këto probleme të mos i lënë pas dore. Çdo komunist, kudo ku punon, duhet ta lidhë punën e Partisë me punën shtetërore dhe kjo do të kurorëzohet me rezultate më të mëdha se këto që kemi arritur.

Unë jam i sigurt se kjo punë bëhet, por fakt është se ka edhe mjaft probleme. Në qoftë se secili do ta lidhë mirë punën e Partisë me punën shtetërore, kudo ku punon, rezultatet do t'i kemi akoma më të mëdha. Po shokët e Partisë, me sa duket, akoma nuk po i gërshetojnë mirë e si duhet këto detyra. Nuk ka gjë të

keqe që sekretari i organizatës-bazë të Partisë, të jetë, për shembull, inxhinier gjeolog. Por në këto raste duhet bërë kujdes që puna e tij si punëtor partie të mos shkojë në terrenin teknik dhe të gjeologjisë, kështu që puna e Partisë të mbetet vetëm një slogan. Partia drejton, dhe ashtu duhet, por në organizatën ku është ky sekretar, mund të ndodhë që të mos drejtojë Partia, se në plan të parë ai mund të vërë çështje thjesht teknike. Në qoftë se diku çalon puna për arsye teknike, atëherë kjo duhet bërë problem partie. Po si të bëhet një gjë e tillë? Duke komunikuar mirë me njerëzit, duke u futur në botën e brendshme të tyre, në ndërgjegjen e atij që e ka lejuar këtë të metë, ose të atyre njerëzve që kanë qenë neglizhentë në këtë çështje. Në këtë mënyrë do të jemi në gjendje të ngremë lart ndërgjegjen e njerëzve, që ata çdo gjë ta shohin të lidhur me punën, me interesat e popullit.

Një çështje të tillë parimore duhet t'ua bëjmë të qartë gjithë shokëve drejtues të Partisë në rrethe. Sekretarët e Partisë mund të jenë edhe teknikë, edhe inxhinierë, agronomë e të tjerë, dhe ne kemi e duhet të kemi njerëz të mësuar në drejtimin e punëve të Partisë. Në qoftë se sekretari i organizatës së Partisë në një kooperativë bujqësore, për shembull, është agronom, e njih mirë edhe vijën e Partisë, atëherë ai do të jetë në gjendje ta lidhë si duhet punën e Partisë me atë të shtetit. Kjo ka rëndësi, sepse, kur sekretari i një të dy, edhe profesionin, edhe vijën e Partisë, ka mundësi të gërmojë edhe nga ana profesionale, por edhe të gjykojë pse nuk del në punë filani e filani, pra ësh-

të në gjendje të zbulojë cilat janë arsyet subjektive që njëri nuk del në punë, që tjetri nuk i bie shatës sa duhet në prashitje.

Natyrisht, kur dëmtohet prona e përbashkët në vëmë në lëvizje organet e pushtetit, por kjo nuk e përjashton aspak punën e Partisë, përkundrazi, kjo punë duhet t'u paraprijë edhe organeve ekonomike e shtetërore, të cilat do të punojnë e duhet të punojnë në bazë të vijës së Partisë. Në bazë të vijës së saj ndërtohet edhe ligji, dhe në bazë të tij bëhet edhe hetimi. Hetimi duhet të bëhet, kemi thënë, në frymë partie, jo për t'u kallur frikën fajtorëve, por për të zbuluar të vërtetën me forma dhe me metoda të ligjshme, me pyetje të zgjuara etj., etj. Pse e kemi zhdukur në kërbaçin kundër atyre që bëjnë faje? Sepse në vendin tonë s'ka nevojë për kërbaç, përdorimi i tij dhe i presioneve psikologjike është i dënueshëm te ne. Çështjen e hetimit pra e kemi vendosur në një platformë të drejtë, në qoftë se veprohet në kundërshtim me të, atëherë merren masa ndaj atyre që shkelin ligjin.

Kudo duhet të jetë dhe është e pranishme Partia, jo formalisht, po realisht e në mënyrë efektive, duke bërë një punë edukative frytdhënëse me njeriun tonë të ri, komunist ose i paorganizuar në Parti. Prandaj këtë problem ta kemi kurdoherë mirë parasysh në punën tonë, sepse është e nevojshme të bëjmë më shumë në këtë drejtim.

Partinë e kemi të fortë dhe nuk mund të themi se ajo nuk i shikon të metat në punë. Jo, Partia i shikon, merr edhe masa e bën korigjime, ndryshe ven-

di ynë nuk do të kishte ecur përpara; mirëpo është fakt që akoma ekzistojnë të meta, prandaj çdo komunist duhet të punojë e të luftojë më shumë për t'i korrigjuar.

*Botuar për herë të parë me  
ndonjë shkurtim në librin:  
Enver Hoxha, «Për Parti-  
në» (Përmbledhje veprash),  
vëll. 3, f. 474*

*Botohet sipas tekstit të nxjer-  
rë nga biseda e incizuar, që  
gjendet në AQP*

## **PËR NJË BASHKËRENDIM MË TË MIRË TË PUNËS SË PARTISË ME ORGANET SHITETËRORE**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**14 shtator 1979**

*Pas informimit që u bë për disa probleme që do-  
lën në mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje në rre-  
thin e Lushnjës, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Për ngritjen e ndërgjegjes së kooperativistëve du-  
het punuar më shumë e në mënyrë sistematike nga të  
gjithë, që kooperativistët ta kuptojnë me partishmëri  
disiplinën, politikën e Partisë e të luftojnë për zbatim  
e detyrave, me qëllim që puna e gjithsecilit të  
mos shkojë kot, por të jetë frytdhënëse. Kjo do të  
thotë që të ardhurat kooperativisti t'i fitojë me djer-  
së, jo në kurriz të të tjerëve, duke iu shmangur kryer-  
jes së detyrës.

Kjo detyrë e madhe partie bie jo vetëm mbi bri-  
gadierët, por edhe mbi organizatat-bazë. Gjithë ko-  
munistët të shqetësohen që punët në kooperativë të  
shkojnë si sahat. Këtë, me fjalë e pranojnë të tërë,

por, kur vjen puna në praktikë, vëmë re se nuk bëhet si duhet në mënyrë të organizuar. Ky është mendimi im. Nuk them se kjo punë nuk bëhet as në ato brigada ku çdo gjë shkon mirë dhe ka disiplinë e rendimente të larta në prodhime. Në të tilla brigada pa dyshim që bëhet mirë puna e Partisë, por çështja shtrohet për të tjerat, ku vërehen dobësi. Pra, në ato duhet të shikohet si punojnë konkretisht komunistët dhe organizatat-bazë për eliminimin e këtyre të metave, për këtë mungesë partishmërie, se të tillë mund ta quajmë gjendjen në një brigadë kur anëtarët e saj nuk dalin në punë, kur disa bëjnë punë me cilësi të dobët, ca të tjerë abuzojnë në njërin ose në tjetrin drejtim etj. Prandaj është me interes të dimë si i trajtojnë në brigadë të tëra këto probleme.

Brigadieri, edhe sikur të mos jetë anëtar partie, aq më tepër kur është, mund t'u kërkojë komunistëve që ka në brigadën që drejton, që ata vetë, në radhë të parë, të mobilizohen dhe njëkohësisht të flasin e të bisedojnë me pjesëtarët e tjerë të brigadës më konkretisht, duke i vënë më mirë në dukje këto dobësi, duke i ballafaquar anëtarët e mirë të brigadës me ata që bëhen pengesë për përparimin e saj etj., etj.

Një metodë e tillë pune, apo leximi e zbërthimi i një direktive a vendimi të Partisë, ose i ndonjë fjallimi të një udhëheqësi, duke tërhequr vëmendjen e të gjithë anëtarëve, praktikohen në brigadë? A marrin komunistët iniciativa të tilla në ato brigada ku shfaqen dobësi të kësaj natyre?

Problemi që po ngre ka të bëjë me metodën e pu-

nës së Partisë. Ne këtu bisedojmë shpesh për këto çështje, sidomos për atë se si duhet të gërshetohet më mirë puna e Partisë me punën e organeve shtetërore. Ne themi që kooperativisti me të vërtetë e ka kuptuar dhe e zbaton vijën e Partisë, në rast se e kryen si duhet detyrën e tij si kooperativist, kur grurit ia bën të gjitha shërbimet e nevojshme, misrin e prashit, e ujit si duhet dhe, si rezultat, merr rendimente të larta. Të tëra këto kërkojnë disiplinë, ndërgjegje, ndershmëri në punë. Këtu reflektohet puna e Partisë.

Çështja është se puna e Partisë, nga disa kuptohet ngushtë, sikur ajo është punë e një personi të vetëm, ndërsa, në të vërtetë, punë partie bëjnë të gjithë, edhe komunistët, edhe ai që është në krye të brigadës, edhe përgjegjësi i sektorit e të gjithë punonjësit. Për shembull, në iks brigadë ka kooperativistë që nuk dalin në punë. Për këtë përgjegjësia nuk i lihet vetëm brigadierit, por fjala është që të tërë duhet të punojnë frontalisht që njerëzit tanë të bëhen të ndërgjegjshëm, me qëllim që kudo në frontin e punës e të luftës të dinë të punojnë e të luftojnë.

Për këtë kërkohet një punë politike e menduar mirë me anëtarët e brigadës. Natyrisht, këtë nuk e bën vetëm sekretari i organizatës-bazë, as vetëm brigadieri, por gjithë komunistët. Kjo arrihet kur problemet e brigadës patjetër diskutohen në brigadë me anëtarët e saj, se ka raste që konfondohen prepotenca, dëshira e sekretarit ose e dy apo e tre komunistëve, të cilët, duke dalë me emrin e Partisë, kërkojnë

të shkarkohet brigadieri pse dy-tre veta nuk dalin në punë. Ne kërkojmë që në këtë rast kooperativistët të ngrihen me kurajë e t'i thonë sekretarit të organizatës: «Pa dale, pse thoni ju që ta heqim këtë brigadier?! Brigada e drejtuar prej tij ka marrë kaq grurë, kaq misër, ka pasur rendimente të larta në pambuk e në prodhimet e tjera bujqësore. Pse nuk dalin tre veta në punë, u dashka ta shkarkojmë këtë nga detyra?! Po pse nuk vete ti, shoku sekretar i organizatës-bazë, në familjen e filanit dhe të filanit që bëjnë mungesa në punë, të bisedosh e të punosh me ta që të mos na bëhen pengesë në brigadë?».

Mirëpo, siç e thashë, ka kooperativistë, edhe anëtarë partie atje që nuk e kanë këtë kurajë, të cilën Partia duhet ta krijojë e ta nxitë me punën e saj te çdo komunist, te çdo punonjës i thjeshtë. Puna e Partisë me njerëzit duhet intensifikuar edhe për të rrënjosur qëndrime të drejta ndaj pronës, që të mos ketë abuzime e vjedhje, siç ndodh sidomos me fasulen, lulediellin etj. Është detyrë e zakonshme e drejtuesve të rrethit që të kujdesen në këtë drejtim e t'i thonë vetes: «Tërë vitin punuam për të pasur prodhim sa më të mirë në fasule, prandaj të jemi vigjilentë, ndryshe fasulja do të na shpërdorohet, se ekzistojnë mbe-turina të theksuara te disa njerëz». Natyrisht, po të ketë vigjilencë e të veprohet me shpejtësi për korrjen, grumbullimin dhe dorëzimin në një kohë sa më të shkurtër të prodhimit, nuk do të ketë shpërdorime. Prandaj, në kohë fushatash, kur e gjithë Partia në rreth e në bazë, bashkë me organet e pushtetit duhet të jenë

në këmbë, në krye të masave e bashkë me masat, detyrohet udhëheqja e Partisë apo e shtetit të bëjë telegrame e urdhëresa që këtej, për arsye se në disa rrethe nuk u vihet rëndësi disa problemeve që rrjedhin nga puna e dobët për mobilizimin dhe edukimin e njerëzve.

Kjo, sigurisht kërkon edhe që kuadrot drejtues të Partisë në rreth e në bazë të ngrenë nivelin e tyre ideologjik, të lexojnë e të studiojnë vazhdimisht.

Mbrëmë në shtëpi po shfletoja një libër, Vepra të Zgjedhura, nga të miat, që përfshijnë edhe shkrime të vitit 1942. Po e shikoj si e kanë përkthyer në frëngjisht. Përkthimi ishte bërë në mënyrë të shkëlqyer. Duke shfletuar këtë libër, konstatova që, megjithëse aty flitej për vitin 1942 e për vitet e para të Pasçlirimit, të dukej sikur disa gjëra thuheshin tani, sidomos pjesët që bëjnë fjalë për luftën kundër mbeturinave, të cilat, në atë kohë, ishin më të theksuara; për luftën e klasave, që në ato vite ishte më e acaruar, për arsye se ishin në këmbë kulakët, tregtarët e të tjerë, kishte gjithashtu edhe vështirësi të tjera. Në materialet e asaj kohe të bie në sy fryma e kritikës dhe e autokritikës, kritikoni kuadrot, mungesën e ngri-tjes së tyre etj. Tani, natyrisht, situata dhe forca e Partisë kanë ndryshuar, edhe kuadrot kanë ndryshuar, mirëpo akoma ekzistojnë shfaqje të vjetra, mbeturina të së kaluarës.

Dua të theksoj që shokët komunistë, kur i marrin këto materiale t'i studiojnë e të përpiqen të gjejnë format dhe mënyrat për përvetësimin e thellë të

tyre. Kur studiojnë një material të Partisë, ata nuk duhet ta heqin lapsin nga dora dhe në një bllok shënimesh të shkruajnë jo tekstualisht çfarë kanë lexuar në këtë shkrim ose fjalim, por disa ide që t'u shërbejnë për veprim në punën konkrete. Pastaj komunisti t'i lexojë herë pas here këto dhe t'i bëjë pyetje vetes: Si po ecim në këtë çështje ne, unë dhe shokët që kam përreth? Këtë gjë komunisti ta bëjë vazhdimisht.

Çështjen e kam këtu që udhëheqjes së Partisë duhet t'i lini mundësi të interesohet për probleme më të mëdha, kurse për probleme të tilla, siç është lufta kundër abuzimeve etj., të keni iniciativë ju, shokët e rretheve, ju jeni në gjendje të veproni vetë në drejtim të tyre, mbasi i njihni forcat dhe i keni mundësitë t'i mobilizoni njerëzit me të gjitha format.

Këto duhet t'i ndjekë e t'i drejtojë mirë Partia në rreth. Por krahas këtyre ajo do të ndjekë edhe probleme të tjera të rëndësishme që ka bujqësia në rrethin tuaj, siç është përfundimi në kohë i objekteve të mëdha që janë filluar, fjala vjen, bonifikimi i Karavastasë së Vogël, ngritja e hidrovorit, sigurimi i pompave etj. në rrethin e Lushnjës. Në qoftë se thuhet që pompat do t'i bëjë Korça, atëherë kjo duhet vendosur dhe të fillojë prodhimi i tyre që të marrë fund kjo punë, se Karavastaja na i zbardhi flokët, kaq shumë kohë ka kaluar me këtë objekt dhe akoma nuk po shohim fryte prej saj. Shokët e Ministrisë së Bujqësisë, për çështjen e Karavastasë, duhet të japin llogari e të thonë me afat se kur do të jenë gati të tëra pompat. E kam fjalën që duhet t'i jepet rrugëzgjdhje kë-

tij problemi. Të llogaritet mirë çdo gjë, sa pompa duhen, ç'kapacitet kanë, sa ujë do të tërheqin në sipërfaqen që do të mbillet etj.

Këtu u tha se atje kanali i madh lidhet me kanale anësore, disa prej të cilave, në një sektor të caktuar, kanë mundësi të ndihmojnë që atë ta thajmë më përpara. Mendoj që këto kanale që futen në kanalën e madh duhet të kenë njëfarë pjerrësie dhe duke e njohur kapacitetin thithës të pompave për ujërat që vijnë nga kanalet anësore në kanalën e madh, të aktivizohet tharja e një pjese të Karavastasë. E kështu sektor pas sektori, duke i pastruar herë pas here kanalet nga mbushjet, duke vënë në punë pompat e tjera, të vazhdohet tharja e kënetës. Nuk e di nëse e kam të drejtë këtë mendim, se e them pa qenë në dijeni dhe pa e njohur mirë gjendjen. Por besoj se ekziston një planifikim i tërë për këtë punë.

Por kjo punë duhet parë mirë, se edhe ato pompa që janë vendosur nuk po shfrytëzohen. Mirëpo Partia thotë vazhdimisht të jemi racionalë, veçanërisht në këto situata. Po ç'konstatojmë? Megjithëse Partia këtu e rreh çekanin dhe në teori të gjithë shprehën për një metodë të tillë pune, në praktikë nuk vepronhet kështu. Këtë e them jo në përgjithësi, po edhe konkretisht. Ja kështu në mënyrë racionale të vepron në inxhinierët e ujërave, të cilët të ndalen fort në këtë punë, t'i bëjnë një studim problemit të bonifikimit të Karavastasë së Vogël dhe, siç thashë, të konkludojnë që në mungesë të pompave që nevojiten, ta organizojnë punën për tharjen e saj pjesë-pjesë. Një

shembull tjetër: ne kemi zbuluar kuarcite në vendin tonë, të cilat mund të përdoren që sot në industrinë e xhamit, se rërën për ta prodhuar këtë artikull e sjellim nga jashtë në vend që ta sjellim nga Kukësi. Thuhet që kuarci është një mineral me rëndësi të madhe, që duhet pasuruar e për këtë duhet të bëjmë një fabrikë të madhe etj., etj. I dimë këto, po pse nuk transportohet në fabrikat e qelqit rëra e Kukësit, me qëllim që të mos e importojmë? Ta shfrytëzosh që tani këtë lëndë, do të thotë të mendosh e të veprosh në mënyrë racionale.

Si paraqitet çështja e sistemimit të tokave në rrethin e Lushnjës? I ka hyrë rrethi kësaj pune? A është bërë planifikimi i këtij sistemimi? Unë mendoj se puna për sistemimin e tokave duhet të ecë progresivisht me afate të caktuara dhe të kontrollohet për të parë nëse respektohen këto afate. Kjo të bëhet me qëllim që sistemimi të vazhdojë frontalisht në të gjitha tokat e rrethit, sipas një plani. Partia për këtë jep orientimin por në praktikë, sigurisht punët për zbatimin e tij do të ndiqen nga komiteti ekzekutiv, nga seksioni i bujqësisë etj. Sigurisht, edhe Ministria e Bujqësisë duhet të interesohet, sepse edhe ajo ka të detajuar për çdo rreth planin për këtë detyrë kaq të madhe, siç është sistemimi i tokave. Zbatimin e këtij plani, fjala vjen, për rrethin e Lushnjës, ajo së bashku me organet e pushtetit në rreth, duhet ta ndjekë kooperativë më kooperativë, për çdo vit, me qëllim që të respektohet afati i caktuar i përfundimit të sistemimit, të mos lejohen zvarritje të kësaj pune.

Natyrisht këto gjëra nuk bëhen në mënyrë të përsosur, po fjalën e kam këtu: a bëhen përpjekje dhe a ushtrohet kontroll që të realizohen në afatet e caktuara? E bëj këtë pyetje se kemi një eksperiencë jo të mirë në këtë drejtim.

Për probleme të tilla një ndihmë të veçantë duhet të japë Ministria e Bujqësisë. Si i ndihmon rrethet ajo? A bën ndonjë konsultë? A dërgon ajo ndonjë ekip për të parë në vend dhe për të ndihmuar konkretisht për sistemimin e tokave, për ujitjen etj.?

Këtu u tha se nga shokët e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë është bërë një konsultë në rrethin e Lushnjës. Unë dua të di nëse ajo u bë për çështje teknike, duke zëvendësuar kështu Ministrinë e Bujqësisë apo për të parë si punon Partia për vënien në jetë të kësaj detyre në sektorin e bujqësisë, gjë që ne e theksojmë vazhdimisht. Apo e bëri Ministria e Bujqësisë këtë konsultë dhe konstatoi se edhe nga ana teknike, edhe nga ana e Partisë nuk ka mobilizim në shkallën e duhur?

Këtu u përmend edhe problemi i traktorëve. Mirëpo kjo çështje është një punë që më parë se kujtdo i takon Ministrisë së Bujqësisë. Partia në rreth ka punë me traktoristët, me ndërgjegjësimin dhe edukimin e tyre. Për çështjet teknike që nuk ecin, ministria le të marrë masat përkatëse. Nëse ajo nuk vepron dhe nuk i ndihmon rrethet, atëherë duhet të bisedohet me drejtuesit e saj që t'u përgjigjen për zgjidhjen e problemeve që dalin në rreth.

Po për sistemimin e prodhimeve bujqësore, për

përqendrimin e tyre a punohet në mënyrë sistematike, në mënyrë shkencore në kooperativat e rrethit të Lushnjës? Po bëhet gjë atje për përhapjen e eksperiencës së kooperativës së Plasës? Ja, për shembull, këtu u tha diçka për misrin në Hysgjokaj. Po të bëhet sistemimi i bimëve, mundet që mjaft nga tokat e malësisë të ndërrojnë bimët. Aktualisht, si paraqitet në Lushnjë studimi për përqendrimin e bimëve dhe zbatimin e tij? Fjalën e kam këtu: a bëhet studimi i këtij problemi në mënyrë shkencore? Apo veprohet në këtë drejtim si t'u vijë nëpër mend atyre që merren me problemet e bujqësisë, heqin këtë bimë prej këtej dhe e mbjellin andej? A bëhen llogari sa na kushton kjo lëvizje e bimëve, kemi humbje apo fitime, ku i kemi mundësitë më të sigurta, ku jo, duke e parë humbjen ose fitimin edhe veç e veç, sipas tokave, pastaj edhe në kuadrin e përgjithshëm të ekonomisë? Pra, para se të vendoset, të studiohet mirë nëse ekonomia e përgjithshme me këtë strukturë që po ndërtojmë ecën përpara, qëndron në vend apo bie. Çështja është të zgjidhen ato struktura që favorizojnë ecjen përpara dhe në përputhje me këtë të bëhet kjo ose ajo lëvizje e bimëve nga një tokë në tjetrën.

Në qoftë se të gjitha rrethet e bëjnë një gjë të tillë, atëherë Ministria e Bujqësisë nuk do të merret me cikërrima, por me probleme të mëdha, me koordinimin e këtyre gjërave në shkallë vendi, do të bëjë studime, përgjithësime etj. Mirëpo që të bëhet kjo punë mirë nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, kjo sigurisht duhet të interesohet e të njohë gjendjen në çdo

rreth, por nga ana tjetër, çdo rreth, nga ana e tij, ta kryejë këtë detyrë në mënyrë shkencore me studime e analiza të argumentuara. Kjo, natyrisht nuk bëhet dot në një ditë.

Çështjes organizative unë i vë rëndësi të madhe. Por edhe me atë çka është bërë deri tani në këtë drejtim, nuk duhet të vetëkënaqemi. Grupe pune kemi formuar, por çështja është se a kontrollohen këto grupe se si e zbatojnë ato detyrën që u ngarkohet. Kjo na intereson. Më parë se t'i futesh kësaj pune, duhet me doemos të vësh në lëvizje njerëz të zotë, specialistë të aftë, si gjeologë, inxhinierë të ujërave, pedologë, agronomë e të tjerë. Me fjalë të tjera, njerëz të aftë e të profileve të ndryshme, që të merren seriozisht me problemin e tokës, të strukturave të mbjelljeve etj., se ata e njohin rrethin, tokën, përbërjen e saj, mundësitë etj. Sigurisht, që të merren me këto studime, ata mund edhe të shkëputen për një kohë nga puna që bëjnë.

Për përhapjen e eksperiencës së Plasës janë ngritur grupe, por s'dimë a punojnë ato në mënyrë sistematike dhe se ç'po bëjnë konkretisht. Ka dy vjet që kemi marrë vendim për këtë çështje dhe për kaq kohë duhet të ishte kuptuar problemi nga të gjithë dhe të ishin shënuar disa realizime në zbatimin e tij. Rëndësi ka zbatimi i vendimit. Po si organizohet puna në rreth për këtë? Çështja shtrohet që të ndiqet e të kontrollohet mirë se si zbatohet orientimi apo vendimi. Për këtë të vihen në punë kuadrot e specialistët e rrethit, të zërthehet problemi me ta dhe të ngarkohen

konkretisht për të ndjekur se ç'po bëhet në praktikë për zbatimin dhe përhapjen e eksperiencës së Plasës dhe të vendimit që është marrë për këtë problem. Kështu do të ndihmohen konkretisht ata që punojnë për zbatimin e këtij vendimi.

Dhe kjo nuk bëhet një herë, por vazhdimisht. Punët të kontrollohen rregullisht, ata që janë ngarkuar me këtë punë të mblidhen herë pas here dhe t'u kërkohet llogari. Në këto mbledhje e takime dalin edhe probleme, por kështu zgjidhja e tyre nuk i lihet spontaneitetit. Për bimët që do të mbillen, në radhë të parë duhet të vendosë rrethi, ai duhet t'ia japë të dhënat ministrisë, e cila nuk duhet të vendosë vetë arbitrarisht që të punohet për ato bimë që ka caktuar ajo në plan, por në bazë të vendimit të Byrosë Politike, ajo duhet ta dëgjojë më me vëmendje bazën, të bëjë studimet e nevojshme dhe të koordinohet kjo punë, të sistemohen si duhet bimët bujqësore, jo vetëm në shkallë rrethi, por edhe në shkallë republike. Kështu që, kur të vijnë të dhënat nga rrethet do të shihet levertia e reduktimit të sipërfaqes së mbjellë me misër në një rreth dhe zëvendësimi i tij me grurë etj. ngaqë kështu do të ketë edhe rritje të rendimenteve, edhe rritje të prodhimeve bujqësore, por edhe të të ardhurave për çdo ekonomi, rreth e në shkallë vendi. Duke u bërë i studiuar mirë grumbullimi, përqendrimi i këtyre apo atyre bimëve në këtë apo në atë rreth, realizohet në përshtatje me llojin e cilësinë e tokave, me mundësitë e ujitjes së saj, me numrin e forcave të punës, me sasinë e mekanikës bujqësore. Po ashtu, në ba-

zë të mundësive që ka një tokë kaq pjellore siç është ajo e Myzeqesë, për rendimente të larta, do të duhet t'i jepet më shumë pleh, se aty merr dyfishin e prodhimit, ndërsa gjatë merr më pak etj. Kështu, duke i studiuar që më parë tërë këta faktorë, mundësitë që ekzistojnë, leverdinë ekonomike etj. do të arrihet në përcaktimin e në ndërtimin e strukturave të tilla të mbjelljeve e të përqendrimit të bimëve bujqësore sipas rretheve e brendapërbrenda rretheve që sigurojnë rritje të prodhimit bujqësor e të të ardhurave.

Ky, më duket mua, është një problem i madh, problem kyç. Për këtë arsye, të ngulet këmbë që komisionet ose grupet e ngritura për sistemimin e përqendrimit të bimëve bujqësore ta kryejnë mirë detyrën nën një kontroll rigoroz dhe në një kohë relativisht të caktuar.

Ngrihet çështja e traktoristëve, e SMT-ve, e mekanikës së tyre, e punës së uzinave mekanike etj. Ky është një problem vërtet i lidhur ngushtë me problemin e sistemimit të tokës e të bimëve bujqësore dhe bëhet mirë që ngrihet. Por më parë ne duhet të studiojmë e të zgjidhim sistemimin e tokës, pra të kemi gati, si të thuash, fushën e luftës, se për këtë do të na duhen edhe armët, në këtë rast mekanika bujqësore.

Por këto çështje janë të lidhura edhe me forcat njerëzore të punës. Prandaj kur të bëhet planifikimi, ky faktor, çështja e demografisë, duhet të merret parasysh. Lushnja, për shembull, nuk ka mundësi që të marrë përsipër të kultivojë bimë prashitëse me shumicë, ndryshe duhet t'i japim shumë mjete prashitëse.

Por duke bërë sistemimin dhe përqendrimin e këtyre bimëve në atë rreth që ka forca pune më shumë, kjo gjë rregullohet. Prandaj ministria ta zgjidhë këtë problem një herë në shkallë rrethi, pastaj në shkallë republike.

Kështu e kuptoj unë organizimin, jo organizim për organizim, por që ai t'i shërbejë sa më mirë qëllimit. Organizim duhet të ketë edhe në shkallë rrethi, por në fund të fundit edhe në shkallë kooperative të bashkuar, pra, organizim-piramidë.

Byroja Politike e ka ngritur me kohë çështjen e sistemimit e të përqendrimit të bimëve bujqësore. Por grupet e krijuara për këtë problem duhet të punojnë e të funksionojnë në rregull. Kjo është ana teknike e çështjes. Por këto duhen ndjekur edhe nga ana e Partisë, sepse punën e bëjnë njerëzit. Vërtet janë organet shtetërore, komisionet e ngritura për këtë problem etj., por kur shihet në këtë drejtim se ka zvarritje, liberalizëm, menefregizëm, mungesë kontrolli, mungesë disipline, atëherë menjëherë çështja kapet e shtrohet edhe nga organet e organizatat e Partisë. Këto orientojnë dhe kontrollojnë punën që bëhet për zbatimin e orientimeve nga këto komisione. Gjithashtu merren e duhet të merren edhe më mirë me edukimin e njerëzve, që këta të punojnë seriozisht e sistematikisht për realizimin e detyrave.

Në rrethin e Lushnjës a janë prishur gjë zarravate për mungesë transporti, për mostërheqje në kohë të prodhimeve dhe për çështje të tjera si këto? E di pse pyes për këtë? Sepse në raste të tilla, kur është

fjala për prodhime që prishen, të merren masa të menjëhershme dhe të veprohet kurdoherë me iniciativë. Qeveria ka lëshuar një urdhëresë për zarzavatet, ku theksohet se ka tri rrugë për sa i përket përdorimit të zarzavateve: furnizimi i popullit, eksportimi i tyre dhe përpunimi në fabrika ose në punishte. Për këtë rrethet duhet të bëjnë përpjekje që asgjë të mos shkojë dëm.

Ja, mbrëmë më treguan për një veprim skandaloz në këtë drejtim. Në Elbasan, andej nga Shirgjani, 500 kuintalë qepë i kanë groposur, megjithëse kooperativa kishte kërkuar disa herë me radhë nga seksioni i tregtisë pranë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit që të shkonin t'i tërhiqnin. Mirëpo u thuhej: nuk kemi çfarë t'i bëjmë! Këto që u kalbën ishin një lloj qepe e bardhë, që nuk duron shumë. Kështu, kooperativa, e ndodhur përpara kësaj vështirësie, duke mos ditur ku t'i shpinte e çfarë t'i bënte qepët, i la derisa u kalbën dhe së fundi i groposi. Dhe justifikohen për këtë, duke thënë se nuk kanë kuotë transporti! Po në qoftë se nuk kishin kuotë transporti, pse nuk u lajmërua Ministria e Tregtisë së Brendshme që ta zgjidhte këtë problem? T'u thuhej shokëve të kësaj ministrie të vinin t'i merrnin qepët. Nëse ministria nuk do të vepronte, të çohet problemi deri në Kryeministri. «Po, ja që unë nuk e bëra këtë», kishte thënë kryetari i kooperativës.

Sikur ushtrisë, për shembull, t'ia shpërndanin ato qepë për t'i bërë gjellë, do të ishte zgjidhur ky problem. Kurse kryetari i kooperativës gjeti rrugën më

të shkurtër e më të gabuar, i groposi. Ky është një veprim me të vërtetë skandaloz.

Prandaj në Lushnjë shumë mirë është vepruar që kanë hequr mjetet e transportit nga destinacionet e tjera dhe i kanë përdorur për transportin e domateve. Pastaj ministria, kur të kërkojë llogari për mosrealizimin e detyrës sipas planifikimit, duhet ta ketë parasysh që me ato makina nuk u bënë shëtitje, por u transportuan domatet. Kjo është një arsye e bazuar. Në qoftë se nuk do të ishte vepruar siç u veprua, atëherë do të bëhej një gjë tjetër: do të kërkohej nga Qeveria të dërgonte makina për transportimin e perimeve, siç i është thënë të dërgojë forca për korrje, se rrethit nuk i mjaftonin për këtë punë ose për të prashitur nëpër ferma, dhe në këtë rast i është dhënë ndihmë nga ushtria.

Pra, duhet të kenë iniciativë kuadrot tanë, se burokratizmi na dëmton shumë dhe në këtë mes ka burokratizëm.

Kisha dhe diçka tjetër për të pyetur: ka në Lushnjë një fabrikë letre, atje duhet të ketë dhe ka pajtjetër edhe inxhinierë, edhe kimistë. Kimistët dhe teknologët që punojnë në atë fabrikë duhet të bëjnë përpjekje, duke lexuar e studiuar, për të mësuar se si mund të përmirësohet cilësia e letrës sonë. Teknologjia e fabrikës që na kanë dhënë kinezët është e vjetruar, prandaj specialistët tanë duhet të vrasin një çikë mendjen që të gjejnë rrugët për përmirësimin e teknologjisë së prodhimit të letrës. Dihet se letra bëhet prej druri ose

prej kashte, por ata të shikojnë se cili lloj druri e cila lloj kashte jep letër të cilësisë më të mirë. Pastaj të shohin nëse makinat që kemi mund ta përpunojnë këtë dru apo jo. Këto mendime unë i shpreh këtu pa ditur gjë konkretisht për teknologjinë e letrës, por si doqoftë, fjalën e kam këtu që specialistët tanë që punojnë në fabrikën e letrës duhet të vrasin mendjen për përmirësimin e teknologjisë, që letra të prodhohet më e mirë. Për këtë inxhinierët, kimistët e teknologët të ndërmarrin studime konkrete për përsosjen e teknologjisë, për prodhimin e disa lloje letrë. Kur të ketë përfunduar ky studim, i kërkohet Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave që të marrë masat për sigurimin e lëndës së parë që nevojitet për këtë teknologji të re, për prodhimin e llojeve të ndryshme letrë.

Mirëpo këto gjëra nuk shikohen si duhet as në organet drejtuese të rrethit, as në bazë, në fabrikë, as në Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave dhe në atë të Bujqësisë, që të bëhen studime për të parë mirë mundësitë, nevojat dhe kërkesat për përdorimin e letrës. Prandaj në këtë drejtim duhet nxitur mendimi krijues. Këtu duhet të ndihet më fort roli i Partisë në rreth e në bazë, për të vënë më mirë në lëvizje mendimin dhe iniciativën e njerëzve, për të çuar më tej zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor, që vazhdimisht po e theksojmë.

Po kështu edhe për Fabrikën e Plastmasës që është në Lushnjë. Natyrisht, puna e kësaj fabrike është e lidhur me PVC-në e Vlorës. Në qoftë se prodhon PVC-

-ja, do të punojë edhe Fabrika e Plastmasës. Megjithatë, unë mendoj se kimistët dhe teknikët e Fabrikës së Plastmasës duhet të mendojnë, për shembull, që me mundësitë aktuale dhe me ca përmirësime të tjera të zgjerojnë gamën e prodhimeve sintetike, si t'i bëjnë ato më të mira, më të bukura dhe më të lira. Mirëpo për këtë nuk mjafton ose nuk është shumë e përshtatshme lënda e parë që merret nga uzina e Vlorës. Në qoftë se ka mundësi të dalin prodhime të tilla me leverdi, atëherë do të ishte me vend që shteti të sjellë lëndë të parë nga jashtë. Shteti importon një pjesë të lëndës së parë, se sheh leverdinë, sheh nevojat dhe kërkesat e brendshme e të jashtme. Ja, pse sjellim pambuk nga jashtë ne? Sepse dërgojmë edhe jashtë manifaturë dhe sa më i mirë e më i gjatë të jetë pambuku që blejmë, aq më të mira do të jenë dhe prodhimet prej tij në kombinatet tona.

Pra kështu duhet vepruar edhe për prodhimet e plastmasës. Tani Fabrika e Plastmasës bën tuba uji për njëfarë presioni, se ata janë të nevojshëm, gjithashtu bën mbulesa për tavolina. Po sa lloje mbulesash tavoline do të prodhohen? Se edhe për prodhime të tilla ka një kufi, ndryshe ndodh si me Uzinën e Gomë-Plastikës në Durrës që prodhoi aq shumë shoshone, sa u mbush vendi me to. Kështu, njerëzit kërkonin të blenin govata, legenë, shporta e artikuj të tjerë, por nuk gjenin. Atëherë ajo filloi të prodhonte artikuj të tillë, u shtua gama e tyre, kështu do të shtohet edhe gama e prodhimeve të Fabrikës së Plastmasës në Lushnjë. Mu-

ndësitë që të prodhohen edhe artikuj të tjerë janë. Por për këto gjëra duhet vrrarë mendja, duhen bërë studime.

*Botohet për herë të parë sipas  
teksttit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

## **TË ZBULOJMË E TË SHKËMBEJMË EKSPERIENCËN E MIRË EDHE PËR METODËN E STILIN E PUNËS**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**17 shtator 1979**

Kur flasim për punë kolegjiale, duhet kuptuar se kjo ka një domethënie të thellë. Puna kolegjiale nuk duhet reduktuar vetëm në marrjen e vendimeve bashkërisht, por edhe në përcaktimin e rrugëve dhe në organizimin e mirë të punës në Parti ose në pushtet, në ndërmarrje ose në kooperativë etj. për zbatimin e tyre. Pasi merret vendimi nga Kongresi, nga Plenumi i Komitetit Qendror, ose nga komiteti i Partisë i rrethit, për zbatimin e tij gjithçka varet nga stili dhe nga metoda e punës, pra varet nga fakti se si do të mobilizohen njerëzit për zbërthimin e detyrave, si do të organizohet e do të kontrollohet puna.

Nuk them se po të zbatohet kjo metodë pune, që natyrisht të gjithë e dinë, çdo gjë do të ecë si sahat, se të pretendosh një gjë të tillë, do të thotë të kërkosh

idealen, gjë që s'ka si arrihet, sepse këtu ndërhyjnë shumë rrethana, sidomos faktorët objektivë dhe subjektivë. Drejtuesi ua cakton dhe ua bën të qartë detyrën punonjësve që ka nën drejtimin e vet, pastaj secili duhet të mendojë e të marrë masa që ta organizojë mirë punën që i takon. Sidoqoftë, duke e marrë problemin në parim, meqenëse flasim dhe bëjmë kritika në parim, punë kolegjiale nuk duhet të ketë vetëm në marrjen e një vendimi, por edhe në zbatimin e tij.

Megjithëse në parim njerëzit e kuptojnë një gjë të tillë, në praktikë nuk e bëjnë si duhet dhe sa duhet. Ka njerëz që nuk e kuptojnë se puna kolegjiale nuk konsiston vetëm në marrjen kolegjiale të vendimit, por edhe në shkëmbimin reciprok të eksperiencës, për zbatimin e detyrës së caktuar. Kjo punë duhet të bëhet në mbledhjet e byrosë së komitetit të Partisë ose në mbledhjet e komitetit ekzekutiv.

Mbledhjet e byrosë së komitetit të Partisë, kur është e nevojshme, mund të bëhen edhe dy herë në muaj, edhe një herë në javë. Megjithatë, pavarësisht nga numri i mbledhjeve, çdo gjë varet nga konceptimi i metodës së punës. Ndodh që në rendin e ditës të një mbledhjeje të byrosë, që do të bëhet pas shtatë muajsh, është caktuar të merret në shqyrtim çështja e bujqësisë, prandaj i thuhet atij që e ndjek këtë problem që të përgatitet të raportojë. Thuhet vetëm kaq dhe më tej atë as e kontrollon dhe as e ndihmon njeri. Nga ana tjetër, edhe shoku i ngarkuar për këtë çështje nuk e ndjek si duhet punën, nuk kërkon ndihmën dhe

prandaj kur raporton nuk sjell eksperiencë në byronë e komitetit të Partisë.

Ka raste që të tërë anëtarët e byrosë qepen pas një problemi që është caktuar të diskutohet në mbledhjen e komitetit të Partisë. Të tërë bëjnë diskutime të përsëritura rreth po asaj çështjeje, kurse unë mendoj që ai problem mund të ezaurohet shpejt, për arsye se është bërë edhe raporti dhe mund të diskutojnë e shumta tre veta, kurse të tjerët, në qoftë se kanë, mund të shprehin ndonjë mendim konstruktiv, pa rënë në përsëritje, në mënyrë që ta bëjnë problemin më të qartë dhe t'i japin rrugëzgjdhje realiste.

Kur në këtë mbledhje, i deleguari i Komitetit Qendror ose një anëtar i byrosë së komitetit të Partisë të rrethit, që ndjek atë sektor, e ndien të nevojshme të shtrojë disa probleme, që kanë të bëjnë me vështirësitë që dalin gjatë zbatimit të detyrës, ai mund t'i shtrojë, duke arsyetuar, fjala vjen, se këto vështirësi mund të vijnë për arsye objektive, teknike, organizative etj. Këtu ai mund t'i bëjë një kritikë edhe sekretarit që merret me çështjet organizative të Partisë që nuk punon si duhet për të bërë të ndërgjegjshëm, në radhë të parë, sekretarët e organizatave-bazë dhe të kontrollojë më mirë punën e tyre, që të shohë si i drejtojnë ata organizatat-bazë. Kështu ai mund të kritikojë edhe sekretarin që merret me propagandën, që zbatimin e këtij vendimi nuk e ka shoqëruar me një punë të shëndoshë politike në Parti. Sekretari i komitetit të Partisë, që merret me propagandën, nuk është për të parë vetëm si punohet në estradë, po të shikojë edhe arsi-

min e kulturën në fshat, të shikojë si kuptohen politikisht dhe si zbatohen vendimet e Partisë për këta sektorë.

Ka raste kur edhe anëtari i byrosë së komitetit të Partisë që ka punuar mirë, bën autokritikë vetëm se është bërë zakon të bëhet autokritikë nëpër mbledhje. Në qoftë se ky ose ai shok e kryen mirë detyrën, përse u dashka të bëjë autokritikë?! Në asnjë mënyrë nuk duhet bërë një gjë e tillë! Natyrisht, edhe ai që ka punuar mirë, mund të thotë që përpjekjet e tij kanë qenë të mëdha në këtë drejtim, se ka bërë këtë e atë gjë, pastaj mund të thotë që këtë punë duhet ta bëja më mirë etj., por jo të bëhet autokritikë «e planifikuar».

Ndodh që në mbledhjet e byrove të komiteteve të Partisë të rretheve të bëhet një autokritikë e përgjithshme. Kurse unë mendoj që autokritika ka efekt kur ajo bëhet për probleme esenciale, konkrete dhe të veçanta që ngrihen. Këto probleme duhet të sillen në byro jo për të dhënë llogari për to në vija të përgjithshme, po për të thënë si janë zbatuar e si do të zbatohen detyrat e caktuara brenda muajit, meqë mbledhja bëhet një herë në muaj, ku i gjejnë dobësitë dhe kujt i përkasin këto dobësi, këtij apo atij sektori, duke vënë para përgjegjësisë ata që i drejtojnë këta sektorë.

Nëpër mbledhje shpesh flitet për stilin dhe për metodën e punës që duhen përdorur për kryerjen e detyrave. Unë nuk them se organi kolegjial dhe drejtuesit e Partisë nuk bëjnë përpjekje për përmirësimin e

metodës së punës dhe të organizimit të saj, por mendoj se disa nga shokët janë më shumë të zotë të flasin me terma të përgjithshëm sesa t'i futen konkretisht dhe të këqyrin në praktikë nëse jep apo nuk jep rezultate kjo metodë ose ky organizim pune që është vendosur. Në qoftë se jep rezultate, atëherë të vazhdojmë të punojmë për përmirësimin e mëtejshëm të metodës së punës dhe, në qoftë se nuk jep rezultate, ta ndryshojmë këtë metodë. Në qoftë se në sektorin e një kooperative e kemi organizuar punën politike dhe edukative në këtë mënyrë dhe konstatojmë se kjo metodë dhe ky stil pune në këtë fshat nuk po na japin rezultate, në këtë rast duhet vrarë mendja që të gjendet një metodë tjetër. Si do të gjendet kjo metodë? Duke u konsultuar, duke vrarë mendjen. Sekretari i organizatës-bazë të Partisë në sektor, për shembull, të vejë te sekretari i komitetit të Partisë të rrethit për propagandën dhe t'i thotë se me këtë organizim që kemi vendosur puna politike njerëzve u hyn nga një vesh dhe u del nga veshi tjetër, se duke e lexuar gazetën në këtë mënyrë dhe në këtë formë, siç po bëhet, nuk kemi rezultate. Si mund ta bëjmë më mirë këtë punë? — pyet sekretari, dhe kështu shkëmbehet eksperiencia dhe përmirësohet metoda e punës.

Unë mendoj se, për sa i përket gjetjes së metodës më të përshtatshme, kërkohet që puna e sekretariatit, e sekretarit dhe e anëtarit të byrosë të jetë sa më shkencore. Dobia e kësaj metode vërtetohet me praktikën, me rezultatet. Natyrisht, rezultatet e mira që mund të arrihen nuk duhet të na bëjnë që ta flemë

mendjen. Kur ndodh diçka dhe shokët shkojnë shpejt atje, situata stabilizohet, po mendja nuk duhet fjetur, jo se nuk është ndrequr gjendja, po se ngritja politike dhe ideologjike e të gjithëve nuk është në atë nivel që kërkohet, mbeturinat dhe mentaliteti i vjetër nuk janë zhdukur dhe, pavarësisht se njerëzit që deri dje ishin në grindje, i pajtoi Partia, duhet bërë një punë politike e vazhdueshme dhe e zhdërvjellët nga organizata-bazë e Partisë, e lidhur ngushtë kjo me gjithë punët e tjera, që gjendja të shëndoshet plotësisht. Në goftë se flemë mendjen, fenomeni i mëparshëm do të na shfaqet prapë, por në forma dhe me mënyra të tjera. Dy shokë, për shembull, që deri dje ishin në grindje, tani u pajtuan, por vjen një moment dhe njëri i flet tjetrit me inat. Atëherë ky e lidh përnjëherë këtë qëndrim me grindjen e dikurshme, prandaj, në goftë se i pari nuk vete t'i thotë shokut që të mos ia marrë për keq atë që i tha dhe se bëri gabim, grindja do të trashet e do të shtrihet më tej. Dhe këtë duhet ta kenë parasysh të gjithë, duke filluar nga drejtuesit kryesorë.

Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi midis njerëzve e shpion kurdoherë punën përpara. Prandaj te ne, që kemi një popull patriot, ku çështjet trajtohen për të mirën e tij, për të mirën e kolektivit, e kur në krye janë komunistët që i gyykojnë problemet në frymë dashamirëse, bashkëpunimi duhet të bëhet një metodë dhe një stil pune i vazhdueshëm, i përshtatshëm dhe në vëzhgim.

Në përgjithësi, kur bëjnë autokritikë, shokët leh-

tësohen. Kjo, natyrisht, është e mirë, por të lehtësuarit nuk duhet të bëhet qëllim në vetvete. Nuk mjafton vetëm të lehtësohesh, por, në radhë të parë, është e domosdoshme të reflektosh mirë për autokritikën që bën. Duke reflektuar të gjithë mirë për autokritikën, atëherë do të përmirësohet puna në praktikë, domethënë në drejtim, në organizim, në punën politike, në qëndrimet revolucionare, do të luftohet më mirë kundër të gjitha shfaqjeve që pengojnë ecjen tonë përpara.

Është një kompleks i tërë jeta e njerëzve që rrojnë në shoqëri të përparuar socialiste si jona, por ku ka akoma të meta, liberalizëm, inate, mëri dhe ndjenja të interesit personal. Te një individ këto mund të jenë më shumë të theksuara, te një individ tjetër më pak, pra ato ekzistojnë në persona dhe në sektorë të ndryshëm të jetës e shfaqen në forma të ndryshme. Meqenëse bartës të këtyre fenomeneve negative janë shumë elementë, ata, natyrisht, ndikojnë në jetën e përditshme të kolektivave, prandaj vetëm një njeri, sado përpjekje që të bëjë, nuk mund ta ndryshojë dot gjendjen. Në qoftë se dikush mendon se mund ta bëjë vetëm këtë gjë, atëherë nuk ka bërë gjëkafshë. Ai që është zgjedhur në udhëheqje, ka për detyrë të mobilizojë dhe të ndihmojë mbarëvajtjen e punëve të Partisë. Për këtë, në radhë të parë, drejtuesi të bëjë përpjekje që të ngrihet vetë më lart nga komunistët e thjeshtë dhe nga masat e popullit dhe t'i studiojë të gjitha këto fenomene për të gjetur dhe për t'u këshilluar njerëzve atë metodë, atë stil dhe ato njohuri, që do të shërbejnë

për të përmirësuar gjendjen. Pastaj këtë eksperiencë drejtuesi ta sjellë në komitetin e Partisë. Të gjitha këto kërkesa në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë formale, e sidomos në udhëheqje.

Këto që thashë nuk janë gjëra që zihen në gojë për herë të parë, por i kemi thënë e i përsëritim vazhdimisht. Përparime ka, njerëzit tanë dhe shokët drejtues tani kanë eksperiencë dhe mobilizohen, mirëpo ja që na del kurdoherë si problem nevoja e përsosjes së metodës dhe të stilit në punë.

Për metodën dhe stilin në punë ka edhe eksperiencë pozitive, por a shkon kjo eksperiencë e mirë për metodën dhe stilin e punës në organet drejtuese të Partisë? Byrosë së Komitetit të Partisë të Lushnjës, për shembull, nuk i mjafton vetëm që fshati Këmishtaj realizoi planin, por i duhet të dijë edhe se si u punua në këtë drejtim, ose Byroja e Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit të dijë çfarë bëri Donofrosa që e realizoi planin e lulediellit. Ky plan nuk u realizua më kot, ngaqë fshatarët e Donofrosës janë, si të thuash, ndryshe nga ata të Lapardhasë. Jo. Ata njëjloj janë, por në Donofrosë organizata-bazë e Partisë, kryesia e kooperativës, brigadierët kanë gjetur disa forma e metoda të atilla pune që kanë krijuar e kanë rrënjosur politikisht te kooperativistët ndjenjën e përparimit ekonomik, kështu që ata e kanë përqafuar këtë metodë pune dhe çdo vit e përmirësojnë atë gjithnjë më tej. Kjo është një eksperiencë e mirë, e cila është pasuruar vazhdimisht dhe rezultatet janë të dukshme.

Është parë çështja e lulediellit për tërë rrethin e

Beratit, natyrisht, në ato vende ku mbillet, por ka dälë se rezultatet nuk janë si ato të Donofrosës. Po kë-shtu edhe rrethet e tjera, duke i krahasuar me Bera-tin, nuk po i arrijnë rezultatet e këtij rrethi. Pse? Kë-tu pengon e meta në stilin dhe në metodën e punës, të cilat çalojnë. Është marrë eksperiencë e mirë në këtë drejtim, është duartrokitur, është çuar në Lezhë, por ky rreth është akoma atje ku ka qenë, ose ka bërë vetëm një përmirësim fare të vogël. Ka shumë arsye, qoftë objektive ose subjektive, që e kanë pen-guar Lezhën, komitetin e Partisë ose atë ekzekutiv, që t'i kapërcejë të metat dhe ta zbatojë mirë këtë ek-speriencë që e mori gjatë. Eksperienca pozitive atyre nuk u mungon as në rrethin e tyre.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Ra-porte e fjalime 1978-1979», f. 303*

*Botohet sipas librit: «Për Partinë» (Përmbledhje veprash), vëll. 3, f. 487*

## **TË ZGJEROJME SHKËMBIMET TREGTARE ME VENDET E TJERA**

*Nga biseda me shokun Nedin Hoxho<sup>1</sup>*

**17 shtator 1979**

*Pas përshëndetjeve të rastit, biseda nisi rreth vizitës që do të bënte në Republikën e Irakut dhe në Republikën e Turqisë një delegacion tregtar qeveritar i RPS të Shqipërisë.*

Më shumë rëndësi sesa marrëveshjet tregtare me këto vende kanë lidhjet miqësore me to. Prandaj duhet vepruar në kompleks, domethënë të mos mbetemi vetëm në kuadrin e marrëveshjeve tregtare, po duke i shfrytëzuar këto, në takimet që do të bëni me personalitetet dhe me njerëz të ndryshëm, të shfrytëzohet rasti për t'u shprehur atyre ndjenjat e miqësisë që kemi ne për vendin e popullin e tyre, të vini në dukje traditat e lashta të kësaj miqësie midis popujve tanë.

Në bisedat e ndryshme që do të bëni, është mirë

---

1. Në atë kohë ministër i Tregtisë së Jashtme.

t'u thoni që Bagdadi ka qenë qendra e kulturës myslimane, ku gjyshërit e stërgjyshërit tanë, që kanë pasur admirim për kulturën e tyre, pikërisht atje kanë studiuar; se ne shqiptarët dimë mjaft për historinë e Irakut e të popullit të tij, për fushën pjellore të Mesopotamisë, që ndodhet midis lumenjve Tigër dhe Eufrat, e cila ka qenë objekt i madh i eposit të Gilgameshit.

Me pak fjalë, bisedimet që do të zhvillojë të mos kufizohen vetëm në probleme me karakter tregtar, por të kenë edhe karakter politik, bile të flisni me bashkëbiseduesit, që do të keni rast të takoni, edhe për historinë e vendeve tona, edhe për kulturën e lashtë të dy popujve tanë, por edhe për qëndrimet politike të shtetit tonë etj. Nuk ka asgjë të keqe t'u flitet e t'u bëhet atyre e qartë se vendi ynë është i rrethuar nga të gjitha anët me armiq, por të gjithë popujt, të afërt e të largët, i duam dhe i respektojmë. Me popujt arabë, me gjithë largësinë gjeografike që kemi, na duket sikur na lidh diçka. Prandaj dëshirojmë të njohim zhvillimin e madh të vendeve të tyre. Ne dëshirojmë gjithashtu që edhe nga Iraku të vijnë të vizitojnë vendin tonë, që të shikojnë ndërtimin socialist, zhvillimin e ekonomisë sonë, të shkëmbejmë eksperiencë në fusha të ndryshme, si në atë të tregtisë, të kulturës etj. dhe ne do t'i presim ata me kënaqësi. Ne edhe më parë kemi dashur që të kemi shkëmbime me vendet arabe, por këtej e tutje dëshirojmë që ato të jenë më të shpeshta.

Ne e dimë se vendet arabe kanë një armik të

përbashkët, Izraelin dhe të gjithë ata që bashkëpunojnë me të. Populli ynë e mbështet e do ta mbështetë me të gjitha forcat luftën e drejtë të tyre kundër këtij armiku të përbashkët, që është bashkëpunëtor dhe vegël e imperialistëve amerikanë. Ne i përkrahim ata, pa u përzier kurrë në punët e tyre të brendshme.

Ju mund t'u kërkonti bashkëbiseduesve atje të marrni kontakte edhe me kuadro të universitetit, me profesorë, me rektorin, ndoshta edhe me ndonjë shkrimtar irakian etj., sepse, me sa di, ju do të keni në përbërjen e delegacionit edhe njerëz të kulturës, të artit e të shkencës.

Sigurisht këto takime duam t'i bëjmë, sepse dëshirojmë ta forcojmë miqësinë e popullit shqiptar me popujt arabë, të zgjerojmë kontaktet e shkëmbimet jo vetëm në fushën e tregtisë, por edhe në atë të kulturës, të artit, të shkencës, me Irakun, si dhe me vendet e tjera të Lindjes së Mesme, të Afrikës etj. Kështu do të krijohen kushte të favorshme që popujt, përfaqësues dhe elementë përparimtarë të këtyre vendeve të njohin më mirë Shqipërinë e të bëhen gjithnjë e më të interesuar për politikën e saj, për kulturën e popullit tonë, të shohin e të kuptojnë se ç'forcë ka një popull që edhe pse i vogël, ndërton jetën e tij me forcat e veta, i lirë dhe i pavarur. Kështu ata do të kuptojnë më mirë pikëpamjet e qëndrimet e drejta që mban vendi ynë për problemet e ndryshme të zhvillimit botëror; do të shikojnë se ato që themi janë të drejta dhe se ne shqiptarët eojmë në rrugë të drejtë. Kështu dalngadalë te njerëzit përparimtarë atje do të bëhet gjith-

një e më e kuptueshme dhe më e qartë rruga që ndjekim ne, do të kenë dëshirë të mësojnë më tej, fjala vjen, si është ndërtuar jeta e bujqësia në fshatin tonë, si është organizuar e si zhvillohen tregtia, arsimi, kultura etj. në vendin tonë. Pra, e kam fjalën që t'u shprehim dëshirën për një afrim midis tyre e nesh dhe për këtë me siguri që ata do të përpiqen t'i gjejnë vetë rrugët.

Tani më konkretisht diçka për programin e delegacionit. Ju duhet të përcaktoni qartë se çfarë mallrash mund të çojmë ne në Irak, si për shembull, duhan, tela bakri, konfeksione të pambukta etj.

Neve na intereson mjaft zgjerimi i shkëmbimeve tregtare edhe me vendet e tjera, sidomos me vendet fqinje. Ju thatë se së shpejti do të vijë këtu delegacioni jugosllav i tregtisë, më pas ai austriak, grek etj. Në këto kontakte ne duhet të vëmë mirë në dukje se ne dëshirojmë të zhvillojmë tregti dhe marrëdhënie kulturore midis vendeve tona. Përparime në këto fusha janë bërë. Ja, një sukses është marrëveshja për ndërtimin e hekurudhës së përbashkët me Jugosllavinë. Por ky bashkëpunim mund të zgjerohet më tej. Jugosllavët kanë fabrika të pasurimit të kromit, prandaj kanë interes ta marrin mineralin tonë, i cili përmban një përqindje platini. Po ashtu, edhe me italianët ka shumë mundësi për të bërë tregti. Me vendet e Perëndimit ne do të bëjmë këmbime tregtare, se kjo është me interesa reciprokë dhe se është e qartë për të gjithë që tregtia është tregti. Po ashtu edhe me vendet e Evropës Lindore. Përveç se me polakët dhe

me rumunët, me të cilët kemi më shumë këmbime, këto duhet t'i zgjerojmë edhe me të tjerët.

Duhet synuar që të eksportojmë me devizë, sidomos në Perëndim, jo vetëm mineralet, duhanin, por edhe prodhime të tjera, si ato bujqësore, konfeksionet etj. Veçse duhet punuar shumë për rritjen e cilësisë, sidomos të duhanit. Se, siç e thatë edhe ju, këtu çalojmë. Por dikasteri që e ka industrinë e përpunimit të duhanit duhet të bëjë më shumë për këtë. A është menduar për të përmirësuar procesin teknologjik të prodhimit të duhanit dhe a janë përgatitur kuadrot e nevojshëm për një gjë të tillë, sidomos për harmonizimin?

Kështu të mendohet e të veprohet edhe për mallra të tjera, si qilimat e sixhadetë që, siç thatë ju, i preferojnë shumë në Perëndim. Ju duhet të punoni shumë për të njohur se në ç'vende janë klientët e mallrave tona. Veçse këtu kërkohet jo vetëm cilësi, korrektesë, por edhe një punë më me kulturë për paraqitjen e mallrave jashtë, sidomos me ambalazhet. Këto vërtet janë shumë të dobëta, prandaj duhet parë çështja se kush bëhet shkak për vazhdimin e kësaj dobësie. Ky problem duhet parë dhe zgjidhur.

Më shumë të bëjmë edhe për eksportimin e karburanteve, se është me leverdi. Por këtu lypset një regjim i rreptë kursimi në përdorimin e tyre në vend, me qëllim që të eksportojmë më shumë. Duhet konkretizuar gjithë ajo propagandë që bëhet për kursimin e naftës, dhe konkretizimi më i mirë bëhet duke çuar në depo të gjitha ato sasi karburantesh që kursehen.

Në këtë drejtim duhen marrë patjetër disa masa, sepse unë kam konstatuar diçka, kur shëtis ose udhëtoj. që kalojnë me dhjetëra automobilë bosh, me gjithë masat që janë marrë për të mos lejuar qarkullimin e automjeteve pa ngarkesë. Kjo do të thotë se makina shkon e ngarkuar në destinacion, por, kur kthehet, duke mos gjetur ndonjë mall për ta ngarkuar, udhëton bosh, në një kohë kur në këtë stinë ka plot prodhime, si shalqinj, perime e të tjera. Kjo do të thotë se njerëzit nuk merakosen shumë për ta shfrytëzuar në maksimum me rendiment të plotë transportin shtetëror. «E kemi për tjetër punë këtë makinë» justifikohen ndërmarrjet që i kanë dhe një administrim i tillë jo-ekonomik bën që të na groposen me qindra kuintalë prodhime për «mungesë transporti», në një kohë kur sa e sa makina kalojnë rrugëve fare bosh. E pse të ndodhë një gjë e tillë kur nuk ka te ne ndërmarrje që të mos ketë makinë? Pa le pastaj për makinat që transportojnë mallra jashtë shtetit! Pra, ka një mori problemesh që kërkojnë zgjidhje. Duhet kontrolluar fort puna e lëvizjes së automjeteve.

Është e domosdoshme të kemi një organizim e kontroll më të mirë, se kështu siç e kemi, duket si shumë rudimentar.

Më kujtohet se si ngriheshin para Çlirimit që me natë Sako Berberi, Xhemali Shtinoja e të tjerë në Gjirokastrë, zinin këmbën e urës dhe prisnin atje deri sa të vinin fshatarët herët në mëngjes me zarzavate që t'i merrnin këto sa më të mira e të freskëta dhe ua zgjidhnin. Theme Shkrepi kishte bile edhe tezgë,

po edhe Xhemali Shtinoja kishte tezgë ku i ekspozonte bukur mallrat që do të shiste. Kështu duhet vepruar, u duhet bërë yzmet mallrave.

Kështu duhet vrarë mendja edhe për probleme të tjera, pse ja, ti the për lëkurën e këpucëve që na vjen me cilësi të dobët. Pse ngulim këmbë gjithnjë te lëkurët ne? Pse të mos prodhojmë edhe me materiale sintetike këpucë e sende të tjera që sot i bëjmë prej lëkure? Jashtë prodhojnë disa lloje këpucësh edhe me lëkurë, por prodhojnë edhe të tjera me lëndë sintetike, që edhe paraqitjen e kanë shumë të mirë, edhe kush-tojnë shumë më lirë. Pse nuk punojmë edhe ne me këto lloje materialesh, që të shkurtojmë importin e lëkurëve? Për këto kërkohen studime, por edhe iniciativë, jo zvarritje. Nuk është koha tani për fjalë.

Lidhur me bilancin e eksport-importit. Ne do ta diskutojmë mirë këtë problem për pesëvjeçarin se, pa e rregulluar këtë, nuk dilet. Dy rrugë janë për një gjë të tillë:

**E para**, që planet e ekonomisë të realizohen në të tërë treguesit dhe sidomos në disa objekte të ketë rritje plani me qëllim që të sigurohen të ardhura për pagesat e makinerive që do të blejmë.

**E dyta**, çështja është që ne duhet të përqendrojmë forcat më shumë në drejtim të uljes së importit. Domethënë ato mallra që mund të prodhohen në vend, të mundohemi t'i prodhojmë vetë, siç janë rërat, tullat shamot, koksifikimi nga bitumet e të tjera. Këto duhet medoemos t'i bëjmë, me qëllim që devizën që do të kursejmë prej tyre ta ruajmë për të blerë maki-

neritë që na nevojiten. Ne duhet të bëjmë ç'është e mundur e të nxjerrim në vend lëndët e para të nevojshme për industrinë tonë. Industria dhe bujqësia është mirë të përdorin sa të jetë e mundur makineritë tona, me qëllim që të hollat që do të kursehen të përdoren për të përballuar blerjen e makinerive e të pajisjeve për veprat që kemi në plan të ndërtojmë.

Të mos ngopemi me lugë të zbrazët. Veprat që kemi në plan ne do t'i blejmë, por duhet të realizojmë paratë për blerjen e makinerive e të pajisjeve. Kjo është e para. E dyta është çështja që paratë për të përballuar blerjet, të mos i jepen tregtisë në fund të vitit siç bëhet, bile edhe atëherë nuk i jepen tamam. Nga ana tjetër, të bëhen përpjekjet që me kohë të gjejmë treg për të shitur mallrat tona brenda vitit, se ai që do të na prodhojë turbinat ose makineritë e tjera do garanci. Mirëpo kështu si veprohet, mund të ngjasë që të na krijohen vështirësi dhe pengesa të tjera.

Këto janë probleme me rëndësi të madhe financiare. Në këtë drejtim ne kemi eksperiencë dhe shembuj të mirë, por kemi edhe shembuj shumë të këqij, që në realitet kanë edhe anën objektive, por edhe anën subjektive. Mund të mos e realizosh planin e grurit një vit, por kur ke krijuar një fond rezervë, e përballon gjendjen. Për të blerë mallra nga importi duhen caktuar fondet dhe me to të realizohet plani dhe të mos bëhen vegla ndërrimi për të krijuar rezerva për katër-pesë vjet.

Këto probleme duhet të shtrohen e të zgjidhen me përgjegjësi. Nuk mjafton vetëm të shtrohet çështja, por

edhe të kuptohet mirë kjo nga ministritë, nga drejtoritë nëpër ndërmarrje, në minierë etj. Për këtë të bëhen mbledhje e takime ndërdikasteriale, ku duhet të marrësh pjesë edhe ti. Atje të diskutohet e të jepen shpjegime pse nuk realizohen nga ndërmarrjet e dikasteret produktet që figurojnë në planin e eksportit, se kontraktimet me jashtë duhen zbatuar me rigorozitet e korrektësi. Këtë gjë do t'ua kërkoni prodhuesve dhe ata në këto mbledhje të marrin angazhime. Mbledhje të tilla duhet të bëni pa pritur mbledhjen e rregullt të Qeverisë. Edhe me zëvendëskryeministrat përkatës, ministrat, sipas nevojave e problemeve, të bëhen mbledhje operative dhe të zgjidhen në to shumë probleme. Puna të shkojë deri aty sa t'u thuhet dikastereve e ndërmarrjeve të ndryshme që, po nuk realizuan eksportin, nuk do t'u jepen mallrat e importit që ato kërkojnë. Kështu të veprohet. Më jep, që të marrësh. Po nuk dhe, nuk ke për të marrë gjë. Këtu kemi të bëjmë me import-eksportin, nuk mund të manovrojmë dot me botën e jashtme ashtu siç bëjmë brenda vendit që mund t'ia marrësh kësaj ose asaj ndërmarrjeje një mall e t'ia shtosh një tjetre që nuk e ka realizuar planin. Të tilla manovrime mund të bëhen brendapërbrenda, kurse, kur kemi të bëjmë me të huajt, s'lëviz dot. Prandaj, në qoftë se një ndërmarrje ka nevojë për çelik, duhet të realizojë patjetër edhe planin e prodhimeve që i janë caktuar për eksport.

Ju thatë se peshën më të madhe të këmbimeve në marrëdhëniet tona tregtare me jashtë e kemi me vendet e Evropës Lindore dhe të Evropës Perëndimore,

ndërsa me vendet e Amerikës Latine, të Lindjes së Mesme dhe të Afrikës bëjmë shumë pak këmbime.

Unë mendoj se me vendet e Amerikës Latine ka mundësi të rregullohen më mirë marrëdhëniet. Për këtë atje ku ka mundësi të krijohen kushte për të bërë tregti, veçanërisht me ato vende nga të cilat importojmë plot artikuj të nevojshëm për ekonominë e vendit, si lëkurë, kafe dhe mallra të tjera. Vetëm se për qëllime tregtare andej, të mos kufizohemi vetëm në kontaktet që bën ambasadori, por në qoftë se duhen shtuar njerëz edhe për tregtinë, le të shtohen. Puna është të hapet rruga për marrëdhënie tregtare, pastaj më vonë mund të dërgojmë atje edhe ekipe tregtare.

Duhet të mendojmë që në tregti edhe të bëjmë lëshime, por të kërkojmë që edhe të tjerët të na bëjnë gjithashtu lëshime. Kemi të bëjmë me tregti këtu. Qëllimi është të fitojmë sa më shumë. Edhe të huajt këtë punë bëjnë me njëri-tjetrin, pra, palët kështu veprojnë në ndërmjet tyre. Prandaj drejt e ke ti, ne duhet të mendojmë me kujdes më parë se të veprojmë.

Mirë, mirë, Nedin, të falemnderit. Më dhe një ide të qartë me këto që më raportove. Ti mund të vish herë pas here për të më informuar për problemet e tregtisë së jashtme.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

**TË ORGANIZOHET E TË BASHKËRENDOHET MË  
MIRË PUNA PËR TË PRODHUAR NË VEND  
DISA MALLRA QË IMPORTOHEN**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**20 shtator 1979**

*Pasi shoku Prokop Murra informoi për mbledhjet e byrosë e të plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës, për nevojën e bashkërendimit më të mirë të punës midis organeve të Partisë, të pushtetit e të organizatave të masave, për dobësitë që vëreheshin për dhënien e shembullit personal të komunistëve e të familjeve të tyre në pjesëmarrjen në punë, si edhe për shqetësimet që lindnin në disa familje në rastin e martesave të të rinjve pa pëlqimin e prindërve, e mori fjalën*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në ç'kuptim shtrohet problemi, që të rinjtë të marrin pëlqimin e prindërve për martesë?! Si ta lërë djali vajzën e mirë që do, për arsye se ajo nuk i pëlqeka babait?! Jo, Partia duhet të punojë me prindërit që këta të mos bëhen pengesë

në dashurinë e bijve e bijave të tyre. Në qoftë se në një fshat një prind nuk dashka që dy të rinj të mar-tohen me dashuri, sekretari i komitetit të Partisë apo dhe çdo komunist e punëtor partie duhet të punojnë me të që të bindet se ai i kundërvihet, pa të drejtë, dashurisë së djalit të tij me një vajzë dhe t'i shpje-gojë atij se vajza është e mirë, është punëtore, e nder-shme etj.

*SHOKU PROKOP MURRA:* Një shoqe, anëtare e plenumit të komitetit të Partisë, në mbledhje, përveç të tjerave, trajtoi problemin e ngritjes së shoqeve në përgjegjësi dhe të organizimit të kurseve për përga-titjen dhe aftësimin e brigadiereve.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në qoftë se duhet, atë-herë të ngrihen kurset për brigadiere. Ato të aftëso-hen edhe në shkollat pa shkëputje nga puna. Bile, edhe kur gruaja është shtatzënë dhe merr lejen e para dhe paslindjes, atë duhet ta zëvendësojë në detyrën e brigadieses një shoqe tjetër. Ka plot gra të tjera që mund t'i zëvendësojnë përkohësisht shoqet drejtuese. Edhe në qytet, kur gratë janë me leje lindjeje, për shembull drejtoreshat ose shoqe të tjera me përgje-gjësi përkohësisht zëvendësohen dhe u ruhet vendi i punës. Po çështja është se për ç'arsye nuk bëhen kur-se? Pse nuk përgatiten më tej, pavarësisht se kanë mbaruar shkollën? Mendoj që rrethi duhet t'i organi-zojë kurset dhe Ministria e Bujqësisë të japë ndihmë për mbarëvajtjen e tyre. Përgjegjësit e sektorëve, za-konisht, duhet të jenë agronomë. Ata që s'janë agro-nomë, se natyrisht, nuk kemi mundësi t'i vendosim të

tërë të tillë, duhet të jenë me shkollë të mesme ose me një eksperiencë të madhe në punë. Puna e brigadierit kërkon aftësi drejtuese e organizuese, prandaj ai të jetë i ngritur nga ana profesionale, ndryshe nuk ka si i jep udhëzimet teknike për brigadën.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Në plenum u shtrua nga një diskutant problemi i transportit me mjetet e SMT-së. Deri dje, tha ai, edhe dy bidona i ngarkonte e i transportonte një zetar! Kurse tani që u shtrëngua çështja e karburantit, i rregulluam dhe i pajisëm me që e me kuaj të gjitha qerret e karrot që i kishim të prishura e të braktisura, duke ulur kështu shpenzimet.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Medoemos kështu duhej të vepronin. Kjo është rekomanduar vazhdimisht, prandaj të mos e marrin zbatimin e këtij rekomandimi sikur po bëjnë ndonjë mrekulli, por të bëjnë autokritikë që i kishin hedhur poshtë karrot dhe qerret e punës. Vetëm në Këmishtaj dukej ky fenomen, për sa u përket shpenzimeve të SMT-ve, apo edhe në kooperativat e tjera?

**SHOKU PROKOP MURRA:** Ai defekt është i përgjithshëm, shoku Enver, shpenzimet e transportit në kooperativat bujqësore, sidomos në ato fushoret, zënë një peshë goxha të madhe.

**SHOKU ENVER HOXHA:** I kanë ulur tani këto shpenzime? Po ndonjë vendim konkret mori plenumi për këtë çështje?

**SHOKU PROKOP MURRA:** Po, plenumi vendosi që të veprohet kështu në çdo kooperativë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Çështja është që të kufizohen lëvizjet e traktorëve. Në qoftë se gjer tanë, për shembull, 25 për qind të shpenzimeve i kanë bërë me traktorë, ta zbresin shumë më poshtë kuotën dhe punët e tjera t'i bëjnë me që. Po nuk u bë kështu, nuk do të kenë gjë në vijë.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Unë, shoku Enver, bashkë me shokët e rrethit shkova e pashë edhe punimet për bonifikimin e Karavastasë së Vogël. Çështja e pompave ishte ashtu siç u tha në takimin e kaluar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pse, vlera e pompave nuk përfshihet në 40 milionëshin? Gjëja kryesore për bonifikimin është që të hapet kanali dhe të vihen pompat. Prandaj këto duhet të jenë të përfshira në bonifikim. Ne kemi edhe eksperiencën e bonifikimit të fushës së Maliqit, por, me sa duket, nuk zbatohet si duhet eksperiencia e fituar. Edhe në Maliq ka pasur periudha të tëra që toka mbante ujë, por më së fundi ajo u tha. Unë mendoj se në Korçë ka mundësi që të prodhohen pompa të mëdha. Ne që bëjmë sondën për 5 000 m thellësi, si është e mundur të mos bëjmë pompa uji me kapacitet 5 m<sup>3</sup>/sek?! Pse të mos i prodhojmë këto? Çështje tubash dhe fuqie elektrike e motorit është kjo!

Kongresi i 7-të i Partisë dhe Komiteti Qendror kanë vendosur që t'i jepet prioritet i madh përmirësimit të tokave dhe tharjes së kënetave, me qëllim që të fitojmë sa më shumë sipërfaqe toke dhe të përmirësohen tokat moçalishte. Për të hapur kanalet duhen edhe mjetet e nevojshme e për t'i zbratur nga uji duhen edhe pompat. Unë them që zvarritja e vënies nën

kulturë të mijëra hektarëve tokë për mungesë të pompave, është e gabuar dhe medoemos duhet të ndreqet. Kemi kaq vjet që po flasim për këtë gjë, prandaj nuk është e drejtë të trajtohet çështja e pompave në këtë mënyrë. Në një kohë kur Partia kujdeset që njerëzit të hapin toka të reja edhe në Vërzhezhë të Skraparit, në gjithë këtë tokë «bakllava» të Karavastasë zvarritet puna! Ky është një qëndrim i gabuar.

Në goftë se duhen 200 apo 300 forca, më mirë t'i heqim këto nga vendet malore, ku po hapen toka të reja dhe t'i sjellim këtu. Të vijjnë forca pune nga fshatra të ndryshme, tre nga një fshat, pesë nga një tjetër, shtatë nga një tjetër dhe të stabilizohen aty me banim të përhershëm, të hapin toka dhe pa humbur kohë, të rregullohet Karavastaja. Këtij i thonë organizim i punës në mënyrë racionale në bujqësi dhe, kur themi racionale, do të thotë që puna të bëhet mirë dhe shpejt.

Ne vuajmë në sektorin e importit që na është bërë një sëmundje kronike, e cila nuk ishte bërë e padurueshme, kur ne nuk kishim ende uzina mekanike, por tani që këto i kemi, s'ka përse të mos e shërojmë këtë të keqe.

Është e domosdoshme të fitojmë përvojën e duhur për të prodhuar jo vetëm pompa, por edhe fabrika, siç ndërtoam Fabrikën e Sheqerit në Maliq. Në Korçë ka jo një, por disa vjet që prodhohen pompa, prandaj të vritet mendja e të mos qëndrohet në vend, të prodhohen pompa me kapacitet edhe më të madh. Uzina Elektromekanike e Tiranës që bën elektromotorë pse të mos bëjë tani edhe elektromotorë me 20 kuaj fuqi?

Ka gati 18 vjet që është ngritur kjo uzinë. Ajo ka specialistë të mirë, që janë në gjendje të bëjnë shumë punë si këto. Unë nuk e di mirë se çfarë prodhojnë ata sot, por dua të them se kemi shumë nevojë për një organizim të fortë, për një punë më të sistemuar e të bashkërenduar, sidomos për disa prodhime që kërkohen me prioritet.

*SHOKU PROKOP MURRA:* Kooperativa bujqësore e Rremasit, shoku Enver, që nga përfundimi i kullimit të tokave ka tre vjet që merr më shumë prodhime.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Më kanë raportuar për këtë, prandaj porositë që janë dhënë, të vihen mirë në zbatim. Importit nuk i dihet. Ai është i sigurt kur ke të blesh me para në dorë, domethënë kur gjen treg për shitjen e mallrave të tua dhe disponon fondet nga të ardhurat e eksportit për të blerë ato mallra që ke vënë në plan. Në blerjen e mallrave që na nevojiten, duhet të ketë prioritet. Në qoftë se do t'i japim rëndësi bujqësisë, atëherë të parat që do të blihen jashtë shtetit, duhet të jenë pompat, në qoftë se nuk i bëjmë dot këtu, megjithëse mendoj se ne mund t'i bëjmë.

Mallrat e kontraktuara ne parashikojmë të na vijjnë në fund të vitit, por mundet edhe të mos na vijjnë. Ato do të na vijjnë në fund të vitit, kur ne të kemi çelur me kohë kredi. Kështu do të ndodhë edhe për pompat, kur këto të jenë porositur një vit e gjysmë përpara, ndryshe nuk jemi të sigurt për ardhjen e tyre. Importi kërkon fonde në kliring dhe në devizë të lirë. Pompat që na nevojiten mund të gjenden në ato ven-

de ku kemi saldo plus. Atëherë pse nuk sillen? Mbase nuk sillen se nuk janë gati ata që duhet të na i shesin. Prandaj shumë nga këto gjëra, që kemi mundësi t'i prodhojmë vetë, qoftë edhe me pak vonesë, të luftojmë që të mos i importojmë.

Mungesat nuk janë të gjitha për faj të Ministrisë së Tregtisë së Jashtme. Ajo, natyrisht, duhet të bëjë punën e saj, por në këtë drejtim ka mungesë kokëçarjeje edhe nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe nga dikasteret e tjera, që bëjnë kërkesa për një pjesë të madhe materialesh që i duan gati nga importi, pa menduar se ku do të gjenden fondet. Detyrat në bujqësi nuk realizohen, si pasojë eksporti pengohet, kurse kërkesat e importit vazhdojnë!

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

## **DERI NË FRYMËMARRJEN E FUNDIT BESNIK I PARTISË, I POPULLIT, I SOCIALIZMIT**

*Fjala<sup>1</sup> me rastin e vdekjes së shokut Hysni Kapo*

**24 shtator 1979**

**Shokë dhe shoqe!**

Këtë mbledhje të përbashkët të jashtëzakonshme të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të Këshillit të Ministrave dhe të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë e thirrëm që t'ju vëmë në dijeni për një lajm jashtëzakonisht të hidhur, që ka pllakosur zemrat tona, të Partisë, të të gjithë popullit, për vdekjen e shokut tonë të shtrenjtë Hysni Kapo.

Shoku Hysni Kapo vdiq dje në një klinikë të spe-

---

1. Ky fjalim u mbajt në mbledhjen e përbashkët të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të Qeverisë dhe të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

cializuar të Parisit në orën 21<sup>30</sup>. Ai deri në minutat e fundit ishte i kthjellët dhe mbylli sytë i qetë. Ju ftoj të nderojmë, duke u ngritur në këmbë, në heshtje, kujtimin e shokut tonë të shtrenjtë, që do të mbetet i paharruar në shekuj.

*Pasi mbahet heshtja shoku Enver Hoxha vazhdon:*  
Të rrojë Partia!

Dëshiroj t'ju vë tani, shkurtimisht, në dijeni për zhvillimin e evolucionit të sëmundjes së rëndë dhe të pashërueshme të shokut Hysni. Ai ishte prekur nga kanceri në pankreas, që u zhvillua me një shpejtësi të jashtëzakonshme. Sëmundja e tij filloi nga fundi i muajit korrik, pikërisht në kohën kur shoku Hysni ishte duke pushuar në Pogradec. Shëtisnim atje çdo ditë së toku. U duk sikur mori një të ftohtë dhe i hipi ca temperatura. U thirrën për ta vizituar mjekët tanë më të mirë, që dita me ditë përpigeshin t'i përcaktonin diagnozën, por temperatura vazhdonte t'i ngrihej. Edhe vetë unë veja e shikoja çdo ditë në shtëpi. Në një nga ato ditë i thashë: «E mo, shoku Hysni, do të dalim nesër të shëtisim?».

«Dalim, — m'u përgjigj, — po mbrëmë kam pasur një dhimbje të madhe, këtu pas, — dhe më tregoi vendin. — Siç duket, — vazhdoi ai, — do të jetë një sëmundje e vjetër, siç thonë mjekët, ja këtu më dhemb, në palcën e kurrizit, po do të kalojë».

Por shoku Hysni e kishte zakon që nuk qajej kurrë. Mirëpo temperatura nuk i ulej. Atëherë mjekët dyshuan për një sëmundje në tëmth, sipas tyre, analizat dhe vizitat që po i bëheshin nga ana klinike le-

jonin të dyshohej për këtë sëmundje. U thirrën nga Tirana edhe kirurgët tanë më të shquar për të qenë aty në gatishmëri, se mos lindte nevoja për ndonjë operacion urgjent në tëmth. Por nga ana klinike nuk dukej të kishte nevojë për ndërhyrje urgjente, prandaj mjekët menduan të prisnim edhe disa ditë në Pogradec, pastaj të operohej; vetëm se për të bërë operacionin, duhej çuar patjetër në Tiranë, mendonin ata. Duke ditur që shoku Hysni kishte kaluar dy infarkte të rënda, ishte edhe diabetik, ne vendosëm të mos e mbanim as tri ditë në Pogradec, se mos i rritej më tej temperatura dhe pastaj bëhej i pamundur transportimi i tij për në Tiranë.

Aty për aty përnjëherë vendosa dhe i sugjerova Hysniut: «Hysni, analizat le t'i bëjmë më mirë në Paris, prandaj mendoj që të ngrihesh e të largohesh menjëherë nga Pogradeci, që nesër bile».

Hysniu, siç e kishte zakon, duke menduar se shpenzimet që do të bëheshin me këtë rast për të do ta rëndonin shtetin, të cilin ai e donte aq shumë dhe që t'i evitonte shpenzimet, u përgjigj: «Mirë, shoku Enver, unë pranoj të largohem këtej, po të shkojmë njëherë në Tiranë, të bëj atje analizat e nevojshme pastaj shohim». Deri në atë kohë dyshohej vetëm për sëmundje në tëmth. Për të mos ia prishur qejfin, i thashë: «Mirë, Hysni, atëherë nisu për në Tiranë», por në të njëjtën kohë njoftova shokët që të porositnin ardhjen e një avioni special nga Parisi për ta transportuar sa më shpejt atje. Dhe avioni erdhi. Ai u nis të shtunën apo të dielën nga Pogradeci, në qoftë se nuk gabohem,

kurse të hënën në mëngjes arriti avioni nga Parisi dhe u nis.

Para se të nisej për në Francë, të gjithë ishim të vendosur, edhe vetë shoku Hysni ishte i vendosur, që ai ta bënte operacionin e tëmthit. Kishim vetëm një frikë, se mos pësonte gjë nga zemra gjatë operacionit, nëse do ta mbante dot zemra e tij këtë operacion apo jo, duke marrë parasysh infarktët që kishte kaluar. Por, fakt është, vetëm se këtë gjë ne e themi tani, zemra e tij, sido që kishte pasur dy goditje infarkti, qëndroi deri në fund, asnjë komplikacion i vështirë nuk i erdhi nga ky organ.

Para se të çohet në sallën e operacionit, nën kujdesin e doktor profesor Pol Miliezit, një nga personalitetet më të shquara mjekësore të Francës, që është njëkohësisht edhe kryetar i Shoqatës Francë-Shqipëri, si dhe nga një ekip i tërë doktorësh francezë dhe shqiptarë, i bënë Hysniut ekzaminime me aparate moderne që bënë të ditur për një hije në pankreas dhe në duoden. Po se çfarë ishte kjo hije nuk përcaktohej dot. Prandaj u vendos t'i bëhej përnjëherë një operacion, se pankreasi mund të shpërthente dhe të bëhej peritonit, gjë kjo shumë e rrezikshme për shëndetin e tij. Kështu Hysniu u fut në sallën e operacionit, ku e hapën, por mjerisht panë se i gjithë pankreasi ishte i prekur nga kanceri.

Zakonisht në një gjendje të tillë operacioni ndërpritet, prerja mbyllet menjëherë, por mjekët vendosën të bënin në organet e brendshme një pastrim radikal, që të mund t'ia zgjatnin edhe ca jetën e shokut Hysni.

Kështu ata ia hoqën edhe tëmthin, që në këto kushte u bë sëmundje sekondare, pse primare mbetej tanë kanceri i pankreasit, i cili ia kishte mbuluar krejt dhe në mënyrë tinzare këtë organ, pa dhënë as shenjën më të vogël. Mjekët bënë kështu një operacion të gjerë, në mënyrë që të shmangnin sa të ishte e mundur rrezikun e një metastaze. Operacioni ishte shumë i rëndë dhe vazhdoi gati dhjetë orë. Megjithëkëtë zemra e shokut Hysni e përballoi në mënyrë të mrekullueshme operacionin, gjatë të cilit të gjitha parametrat e kërkuar i kishte në rregull.

Pas gjithë këtij spastrimi të madh, si te mjekët tanë e francezë, edhe te ne shokët e Byrosë Politike, që e dinim dhe e ndiqnim me kujdes sëmundjen e shokut Hysni, lindën shpresat që, po të kapërcehej situata e vështirë me këtë operacion e spastrim që u bë, ai mund të na rronte edhe disa vjet, se për më shumë një sëmundje e tillë nuk të fal.

Pra, pas përfundimit të operacionit me sukses kaluan disa ditë e net dhe ne rronim me shpresa, por edhe me një ankth të madh në zemër për shokun tonë të dashur. Tri-katër herë në ditë merrnim nga Parisi buletin mjekësor për gjendjen shëndetësore të shokut Hysni, ndiqnim oshilacionet, uljet dhe ngritjet e temperaturës. Sidoqoftë shpresat kurrë nuk i humbëm, pse duke mësuar që operacioni doli me sukses dhe kirurgët njoftuan se puna e tyre kishte mbaruar, se shoku Hysni filloi të ngrihej në krevat, bile pas operacionit e vunë edhe në kolltuk, filloi më pas të hidhte edhe disa çape nëpër dhomë e në korridorin e spita-

lit, vendosëm t'i përgatitnim një vend ku ai të kalonte një periudhë konvaleshence, pastaj të kthehej në atdhe. Të tilla ishin shpresat tona, të mëdha.

Mirëpo s'kaluan shumë ditë dhe temperatura filloi përsëri t'i ngrihej. Atëherë u luftua për t'ia ulur atë dhe për të gjetur shkakun e saj. Temperatura, në përgjithësi, dihet se shkaktohet nga ndonjë infeksion. «Mbase nga operacioni, — na shkante mendja, — ngaqë gjatë spastrimit, sado i kujdesshëm që iu bë, mund të kishte mbetur ndonjë vatër e vogël infeksioni që ia shkaktonte temperaturën shokut Hysni». Por kjo vazhdonte t'i ngrihej dhe të mos i ulej.

Për të luftuar këtë temperaturë u bënë të gjitha përpjekjet me analiza nga më të ndryshmet, por nuk ishte e mundur të zbulohej se ku ishte ky infeksion. Zakonisht sëmundja e kancerit jep edhe temperaturë, por ka raste që edhe nuk jep. Mjekët dyshonin se diku në organet e brendshme do të ishte kjo vatër që shkaktonte këtë gjendje, por nuk e gjenin dot ku ishte.

Gjatë gjithë kohës që Hysniut i ishin shfaqur dhimbjet, ishte i dobësuar shumë, pse sëmundja primare, domethënë kanceri, i shkaktonte dobësi dhe një anoreksi të madhe. Këto ishin pikërisht shenja të sëmundjes primare, por luftohej që gjendja të përballohej, duke e ushqyer ca me serume, ca nga goja, megjithëse këtë ushqim i merrte me zor, por me durim, me vullnet e kurajë të madhe shoku Hysni përpiqej të hante diçka.

Në këto kushte u vendos t'i bëhej një ekzaminim me skaner, një aparaturë moderne. Me këtë aparaturë

u diktua më në fund një vatër infeksioni në mëlçi. Fotografitë e skanerit treguan se në këtë organ ai kishte një hije sa një kokërr arrë brenda, konturi i së cilës linte të dyshohej se ishte fjala për një metastazë, çka donte të thoshte se kanceri ishte përhapur edhe në këtë organ. Në këto kushte vihej problemi që të zhdukej medoemos kjo vatër, për arsye se, po të mos merrreshin masa, atëherë do t'i qelbëzohej gjithë mëlçia dhe, si rrjedhim, do të vinte vdekja, kurse po të zhdukej vatra, dhe ajo hiqej kollaj, do të spastrohej mëlçia, temperatura do të binte dhe pastaj do të pritej zhvillimi i zakonshëm i metastazave, të cilave nuk kishe çfarë t'u bëje, vetëm se nuk dihej sa kohë mund të na rronte shoku Hysni.

Në fillim të gjithë mjekët vendosën që të pritej edhe nja dy ditë, të bënin edhe disa ekzaminime. Nga të gjitha vëzhgimet që u bënë, u konstatua se zemra e shokut Hysni mund ta mbante edhe një operacion të dytë, pse ky do të ishte shumë më i lehtë nga i pari. Për këtë mendim të mjekëve na lajmëruan edhe ne, dhe ne vendosëm që mendimi i mjekëve, për shpëtimin imediat të jetës së shokut Hysni, të zbatohet. Dhe ai u operua përsëri, por sa u hap, nuk u konstatua të kishte infeksion, po shenja që dukej qenë metastazat që ishin përhapur në gjithë mëlçinë, mundet që ato qenë përhapur edhe në organet e tjera. Prandaj e mbyllën prerjen dhe filloi kështu agonia e madhe për Hysniun, për ne, për shokët tanë mjekë, për familjen e tij, sidomos për shoqen Vito, e cila me gjithë dy fëmijët kishte shkuar në Paris.

Ne prisnim çdo ditë me ankth se mos Hysniu kishte një fije përmirësimi dhe çështjen e shtruar kështu: në rast se sipas këshillave të mjekëve, tanë dhe francezë, do të shihej një përmirësim sado i vogël, atëherë do të merrnim disa masa të përshtatshme për të krijuar te shoku Hysni Kapo një situatë euforie të përkohshme dhe në këto kushte ai të kthehej që të vdiste në Shqipëri. Por, në qoftë se mjekët do të thoshin se një gjë e tillë nuk mund të ndodhte, ne menduam që shokut Hysni të mos i linim të kuptonte që jeta e tij kishte mbaruar, duke e sjellë në atdhe në gjendje shumë të rëndë.

Byroja Politike vendosi që mjekët tanë nga Parisi të na mbanin në korent çdo ditë. Atyre u thamë që, në qoftë se nuk do të kishte mundësi që shoku Hysni të ngrihej edhe një herë në këmbë, të bëheshin përpjekje për t'ia evituar dhimbjet. Mundet që ai ta kishte kuptuar gjendjen e tij, por mund që të kishte edhe një shpresë, prandaj menduam që këtë shpresë atij t'ia linim. Zemra na dhimbte. Në këtë gjendje ne donim që ta kishim gjallë këtu, pranë nesh, qoftë edhe dy orë, qoftë edhe një orë të vetme, por vendosëm në këtë mënyrë se s'kishte rrugë tjetër dhe prisnim në ankth. Çdo ditë e natë na vinin lajme se gjendja e tij po rëndohej, gjithë parametrat shkonin duke u shkatërruar, çka donte të thoshte se po arrihej momenti i agonisë, derisa mbrëmë morëm lajmin shumë të hidhur që zemra e tij pushoi.

Të gjitha këto dhimbje e vuajtje shoku Hysni i kaloi me qetësi dhe me një guxim të papërshtuar.

Mendjen ai edhe në këto kushte të vështira e kishte deri në fund te Partia, te ne shokët e tij, te populli, te puna.

Kështu u zhvilluan këto ngjarje që na sollën këtë humbje të madhe, e cila na hidhëroi shumë, pse Partia humbi një nga shokët më të mirë të saj, një bolshevik të vërtetë, një komunist të shquar e luftëtar të lavdishëm, që çdo gjë që kishte më të shtrenjtë, edhe jetën e vet, e hodhi në çdo moment në balancë për fitoren e Partisë e të popullit.

Shoku Hysni Kapo, pavarësisht se nuk u ndodh në mbledhjen e parë të Nëntorit 1941, ishte një nga themeluesit e Partisë. Në shënimet e mia, duke shkruar për ngjarjet e themelimit të Partisë, kur po sulmonim në ato ditë Anastas Lulën e Sadik Premten, i thosha një shoku që kisha afër: këta armiq ne do t'i mposhtim, pse kemi shokë të vendosur dhe në Vlorë kemi një shtyllë të fortë, Hysni Kapon.

Shoku Hysni qëndroi deri në frymëmarrjen e fundit besnik i Partisë, i popullit, i socializmit. Ai luftoi tërë jetën për kalitjen e radhëve të Partisë dhe mund të them se ishte një nga specialistët më të shquar për punët organizative, politike dhe ideologjike të saj. Gjithë veprimtaria e Partisë brendapërbrenda radhëve të saj dhe puna e saj e shumanshme me masat e gjera të popullit kanë në mes të tjerash edhe vulën e punës, të luftës dhe të përpjekjeve të shokut tonë të shtrenjtë Hysni Kapo.

Ai ishte njeri me një kurajë të papërs shkruar në çdo fushë veprimi. Kudo ku e caktoi Partia Hysniu shkoi

pa hezitim dhe drejtoi brigada, divizione e korparmata, drejtoi dikastere, drejtoi edhe Partinë. Ai ishte një nga udhëheqësit më të shquar të Partisë në Byronë Politike dhe në Komitetin Qendror të Partisë, ku jepte kontributin e tij të madh me shkathtësinë që e karakterizonte, si gjatë periudhës së luftës së armatosur, ashtu edhe gjatë gjithë periudhës së Pasçlirimit për ndërtimin e socializmit.

Shoku Hysni karakterizohej nga një qartësi e madhe politike. Ai e njihte mirë Partinë, zemrën e saj, njihte kuadrot e shumë komunistë personalisht dhe ishte shembull thjeshtësie, i dashur me të gjithë, por njëkohësisht ishte edhe shembull rreptësie, i pamëshirshëm e i palëkundshëm kundër armiqve të Partisë, ishte me një fjalë një shembull i madh për të gjithë ne në çdo drejtim. Hysni Kapoja ishte një nga shtyllat e Partisë. Prandaj humbja e tij është shumë e madhe për Partinë dhe për mbarë popullin tonë.

Por ne jemi komunistë, jemi shokë e shoqe që kemi kaluar Luftën Nacionalçlirimtare dhe si të tillë dhimbjen e madhe që na solli vdekja e shokut Hysni duhet ta kthejmë dhe do ta kthejmë në një forcë akoma edhe më të madhe për ta çuar socializmin përpara, për ta kalitur akoma më shumë Partinë, për ta mbrojtur atdheun tonë socialist dhe për ta lulëzuar gjithnjë e vazhdimisht jetën e popullit ashtu siç kanë dashur gjithë shokët tanë që kanë rënë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe gjatë luftës për ndërtimin e socializmit, ashtu siç deshte e siç luftoi e punoi edhe shoku Hysni.

Kujtimi i shokut Hysni Kapo do të mbetet i pav-

dekshëm për Partinë dhe për mbarë popullin tonë. Edhe ne vetë në udhëheqjen e Partisë do të punojmë e do të luftojmë ashtu siç punoi e luftoi intensivisht tërë jetën e tij Hysni Kapoja, me atë vendosmëri, me atë zgjuarsi, me atë shpirt të lartë sakrifice dhe ndërgjegje të kulluar proletare.

Në këto momente të vështira për Partinë ne duhet të shtrëngojmë radhët tona, të shtrëngojmë fort supet krah njëri-tjetrit. Partia jonë ka kaluar një histori të lavdishme me luftëra të gjata, të vështira, të shumta, por që kurrë nuk e kanë mposhtur, përkundrazi ato e kanë kalitur gjithnjë edhe më shumë, e kanë bërë përherë e më të fuqishme. Forca e madhe dhe uniteti i çeliktë i radhëve të Partisë dhe lidhjet e saj të ngushta me masat punonjëse e kanë bërë Shqipërinë tonë socialiste një vend ku populli rron i lumtur, i lirë, ndërton me sukses jetën e tij të begatshme dhe është bërë shembull i lartë frymëzimi revolucionar për popujt në botë.

Prandaj të ndjekim shembullin e shokut tonë të pavdekshëm Hysni Kapo, të ecim si kurdoherë në rrugën e drejtë që na udhëheq Partia. Të forcojmë unitetin, që është gjëja kryesore, që është ai faktor vendimtar, ajo forcë e madhe, që i bën Partinë e popullin tonë të çeliktë. Ky unitet ka qenë i çeliktë, është i çeliktë dhe do të bëhet akoma më i çeliktë, duke ecur me vendosmëri në rrugën që na tregon Partia. Përpara furtunave e rreziqeve, përpara hidhërimeve si ky që na solli vdekja e shokut Hysni Kapo, mobilizohemi më shumë për të ecur si kurdoherë përpara, për të plotë-

suar atë dëshirë dhe amanet të shokëve tanë të rënë në luftë, atë dëshirë dhe amanet që na la edhe Hysniu ynë i dashur.

Edhe shoku Hysni Kapo ra në krye të detyrës se ai nuk e kurseu veten në asnjë moment. Ai qëndroi në krye të një lufte të rreptë, që Partia dhe populli ynë për vite e vite me radhë po zhvillojnë me vendosmëri të pashembullt kundër armiqve, të jashtëm e të brendshëm, dhe vazhdimisht triumfojnë. Vetëm përpara një armiku të tillë, siç është kanceri, ne nuk fituam dot, ai është një armik që njerëzimi akoma nuk po e mposht, se shkenca botërore nuk e ka zbuluar mjekimin për ta zhdukur atë.

Prandaj, shokë, të jemi të fortë siç ishte Hysni Kapoja. Deri në momentin e fundit, pavarësisht se ishte në agoni, ai vështronte me ëmbëlsi dhe i qetë nga shoku Ramiz [Alia], të cilin e dërguam t'i qëndronte pranë tok me shoqen Vito e me fëmijët. Ai i përkëdhelte të tërë këta me sy dhe nëpërmjet tyre na përkëdhelte të gjithë ne dhe na thoshte me ato vështrime të tij ledhatuese: «Përpara, shokë, në luftë për atdheun socialist, për Partinë e lavdishme të Punës!». Dhe ne do ta kryejmë si kurdoherë ashtu si duhet detyrën ndaj atdheut dhe Partisë dhe brezat e ardhshëm do t'i edukojmë që të ecin në rrugën e heronjve të popullit, në rrugën që eci Hysniu, në rrugën që na udhëheq Partia.

Qoftë i përjetshëm kujtimi i shokut Hysni Kapo!  
Të rrojë Partia, shokë!

Tani ju lutemi shumë shokëve që kanë ardhur nga rrethet që të mos largohen, për arsye se nesër do të

vijë avioni që do të sjellë në atdhe trupin e shokut tonë të shtrenjtë, Hysni Kapos. Ne duhet të jemi të tërë në aerodrom që ta presim. S'na u kthye dot i gjallë Hysniu. Ne e dërguam Hysniun në Francë që të na kthehej shëndoshë, po kjo nuk qe e mundur.

Dua t'ju bëj të ditur më së fundi se grupi i mjekëve tanë që shkoi me të në Francë, si dhe grupi i mjekëve francezë, të kryesuar nga profesor Pol Miliezi, kanë treguar një kujdes të jashtëzakonshëm për mjekimin e shokut Hysni. Profesorët francezë, që e trajtuan dhe që janë nga më të dëgjuarit në botë, që janë njëkohësisht miq të vendit tonë, për këtë udhëheqës të Shqipërisë sonë socialiste lanë pushimet dhe i venin tri herë ditën për t'i bërë konsultë. Profesor Pol Miliezi u tha shokëve tanë mjekë që ne po e kurojmë Hysni Kapon njëlloj sikur të kuronim njeriun tonë dhe do të bëjmë ç'është e mundur që t'ia zgjatim jetën, por jo çdo gjë varet nga ne.

Prandaj, shokë, zemrat lart!

Të rrojë Partia!

*Botuar për herë të parë në librin: Hysni Kapo «Vepra të zgjedhura» vëll. V, f. 5*

*Botohet i plotë sipas origjinilit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## AI E NJIHITE PARTINË DHE E GJITHË PARTIA E NJIHITE ATË

*Nga biseda me familjen e shokut Hysni Kapo*

**25 shtator 1979**

**SHOKU ENVER HOXHA:** Vetë shëndoshë! Të rrojë Partia! Të rroni ju! Të rrosh ti, Vito, të rrojnë fëmija! Të rroni ju të gjithë!

Ishte një humbje e madhe për Partinë, për popullin, për të gjithë ne. Të na rrojë Partia!

**SHOQJA VITO KAPO:** Të na rroni ju, shoku Enver!

Nuk e dini ju të gjithë se ç'kanë bërë Partia dhe shoku Enver për të. Donin ta shpëtonin Hysniun, t'ia zgjatnin jetën qoftë edhe një ditë më shumë. Të tëra iu bënë!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kujtimi i tij do të mbetet i paharruar. Hysni Kapoja ishte njeri me kurajë të madhe, pa frikë, i kaloi me trimëri të gjitha vështirësitë, njeri me guxim, me pjekuri, me zgjuarsi, punëtor i palodhur, shembull për të gjithë ne.

Ai e njihte Partinë, ashtu siç e njihte atë gjithë

Partia. Të gjithë njerëzit e donin dhe e respektonin, i hapnin zemrën, bile edhe për halle që mezi thuhen, por Hysni Kapos ia thoshin se kishin besim të madh tek ai. Por jeta e tij kaq ishte, e shkurtër. Të punojmë e të luftojmë si Hysni Kapoja me radhë të shtrënguara. Partia e donte ta kishte atë akoma në radhët e saj si luftëtar të shquar, gjithashtu atdheu, populli, të gjithë e donin dhe ai i donte. Prandaj të rrojë Partia! Kështu thoshte Hysni Kapoja.

Shoqja Vito, shoqe jete e shokut Hysni Kapo dhe shoqja jonë do të jetë për ne e afërt si një person i shtrenjtë i shokut Hysni.

*SHOQJA VITO KAPO:* Është një nder i madh për mua dhe për fëmijët e mi sikur ne t'i ngjanim sado pak Hysniut. Apo jo, fëmijët e mi?! Ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet që ta justifikojmë këtë, kemi luftuar, por do të luftojmë akoma edhe më shumë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Medoemos, kemi luftuar dhe do të luftojmë. Dhe ju të gjithë, motra, vëllezër, të jeni kryelartë se nga gjiri juaj lindi heroi i lavdishëm Hysni Kapo. Siç më tha Vitoja gjatë rrugës kur po vinim, Hysni Kapoja ka qëndruar në mënyrë heroike përballë një sëmundjeje kaq të rëndë e të vështirë, ai ka qëndruar pikërisht si në luftë, nuk bëri asnjëherë «uf!», përkundrazi, të gjithëve që kishte pranë e kujdeseshin për të u jepte kurajë.

Ne ia bëmë të gjitha dhe shpresonim se Hysni do të na shpëtonte. Kurrë nuk e mendonim këtë që na ndodhi.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Shoku Enver, gjithë kohën

që ishim me të, Hysniu kishte kaq kurajë, sa neve na thoshte që na ka forcuar Partia, ajo na ka dhënë forca, prandaj duhet të qëndrojmë fort. Me qëndrimin e tij bëri për vete tërë francezët, që nga profesori e deri tek infermierja më e thjeshtë. Nuk kishte më vend në trup ku t'ia bënin inxheksionet, po ai u thoshte me kurajë: ma bëni këtu, në krah, këtu në këmbë a kudo ku të jetë e mundur. Dhe të gjitha këto ai i thoshte duke buzëqeshur. Të tërë çuditëshin me qëndrimin e tij, se ku e gjente ai gjithë atë forcë. Po Hysniu ynë ishte i tillë edhe me ato vështirësi që kaloi, ashtu siç e ka parë Partia kurdoherë.

Mua më tha vetë një nga kirurgët francezë se unë nuk po i bëj asgjë, po ai vetë e gjen forcën për ta përballuar sëmundjen. Unë vetëm teknikën përdor, se ai po lufton vetë që të jetojë, prandaj edhe ne e kemi për detyrë që të luftojmë t'ia shtojmë jetën qoftë edhe për një ditë. Ai është njeri që na mbush të tërëve me guxim.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Doktorët që e kuruan ishin doktorë të mëdhenj francezë. Ata u treguan të gatshëm për ta kuruar. Megjithëse ishin me pushime, i lanë këto, u kthyen në klinikën e tyre dhe vunë në dispozicion gjithë teknikën moderne që kishin në dispozicion. Ata për të kontrolluar e diagnostikuar Hysniun për sëmundjen përdorën një aparat që është një i vetëm në gjithë Francën. Doktor i madh që e mjekonte, profesor Pol Miliezi, na tha se Hysni Kapon ne e mjekojmë si njeriun tonë. Dhe kësaj here ata bënë të gjitha përpjekjet për t'ia zgjatur jetën.

**SHOQJA VITO KAPO:** Nuk kemi ç'të themi për ta. Mjekët francezë i bënë të gjitha. Partia i bëri të gjitha për të.

**SHOKU SULEJMAN KAPO<sup>1</sup>:** Ju, shoku Enver, vini e na ngushëlloni ne, por, në fakt, duhet që edhe ne t'ju ngushëllojmë ju, sepse keni një jetë të tërë me të, më tepër se 40 vjet, kurse me ne ai vetëm 23 vjet ka jetuar. Për ne Hysniu ka qenë simbol frymëzimi, ishte shembull për të gjithë njerëzit e familjes sonë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ai ashtu ka qenë dhe ashtu do të mbetet gjithmonë. Hysniu ka qenë i dashur me të gjithë, njerëzve u fliste me dashuri edhe kur i kritikonte. Kush shkonte në zyrën e tij dilte andej i bindur, i sqaruar. Ata që gabonin ai i kthente në rrugë të drejtë duke u vënë përpara e duke i bindur me mësimet e marksizëm-leninizmit. Hysni Kapoja ishte një nga anëtarët e Partisë që për çështjet organizative nuk kishte shok tjetër. Edhe ne shokët këshilloheshim me të kur të ishte nevoja, ditën dhe natën. Asgjë nuk ishte e vështirë për të, ai nuk u trembej vështirësive, ishte këmbëngulës deri në fund në çdo punë, në çdo detyrë që i ngarkohej. Kishte pastaj një dashuri të madhe për të gjithë shokët.

**SHOKU SULEJMAN KAPO:** Hysniu e donte popullin dhe kishte respekt për të gjithë ata që punonin, bile edhe për punëtorin më të thjeshtë. Kishte një respekt të çuditshëm për njerëzit e punës ai. Me ata që gabonin kishte durim, kishte një forcë bindëse të ha-

---

1. Vëllai i shokut Hysni Kapo.

bitshme. Kishte kuadro ushtarakë që thoshin se do të vete të takohem edhe një herë me shokun Hysni dhe do të bëj ashtu si të më thotë ai. Dhe vërtet kur dilnin nga takimi që bënin me të, largoheshin të bindur, shkolin atje ku i këshillonte ai dhe bënin ashtu siç u thoshte. Kështu ndodhte me këdo që kishte rast të bisedonte.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ashtu ngjiste me të, ai ishte me të vërtetë një komunist ashtu siç duhej.

Ishte pastaj punëtor i palodhur. Ne e shihnim se sa shumë punonte, prandaj edhe i flisnim shpesh: «Mjaft Hysni, mjaft». «Ja, edhe pak», na përgjigjej at dhe vazhdonte. Kur u kthye herën e parë nga Franca, ne vendosëm që të punonte më pak orë se përpara.

«Mirë», na u përgjigj ai, por punoi ashtu si i thamë ndonjë javë, pastaj vazhdoi të punonte njëloj si më parë. Punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror dhe shumë të tjerë venin e vinin në zyrën e tij. Bini një raport, u thoshte ai, bëni kështu, veproni ashtu. Çdo material që i jepej e shikonte me hollësi dhe priste vazhdimisht njerëzit.

«More Hysni, po ç'bën kështu?!» i thoshim. «E di, — na përgjigjej, — keni të drejtë, do të përpiqem». Por çështja është se ai donte më shumë Partinë sesa veten e tij, donte më shumë popullin sesa veten, donte më shumë shokët sesa veten e vet.

*SHOQJA VITO KAPO:* Kur vonohej shumë veja, më së fundi, dhe i thosha: «More Hysni po vajti ora 12, do të hamë darkë apo nuk do të hamë?!». Ishte

shumë i dhënë pas punës. «Nuk vdesin njerëzit nga puna» na thoshte ai.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Është e fortë kjo raca juaj e Kapove. Dy infarkte kaloi Hysniu, po zemra e tij qëndroi përsëri e fortë. Ne kishim frikë se mos i ndodhte gjë nga zemra gjatë dy operacioneve të rënda e të gjata që bëri, por jo, ajo qëndroi e fortë deri në fund.

**SHOQJA VITO KAPO:** Doktorët i thoshin se me gjithë këtë operacion që ke bërë ti, është njësoj sikur t'i kesh ardhur rreth e qark botës. «Hë, moj Vito, — më thoshte, — e shikon? Dhe ti më thua pastaj jo se të merret fryma, jo kështu e jo ashtu».

**SHOKU SULEJMAN KAPO:** Ishte në moshën 64 vjeç Hysniu, pra akoma i ri, dhe në një moshë të tillë ai mund të jepte shumë më tepër për Partinë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Armiqtë i kemi mundur, vetëm këtë sëmundjen e kancerit nuk e mundëm dot. Gjithë të tjerët i kemi vënë dhe do t'i vëmë nën këmbë, kurse këtë të shkretë akoma nuk ka arritur njerëzimi ta mposhtë. Tani duhet të çlodheni një çikë, duhet të çlodhen sidomos Vitoja dhe fëmijët, prandaj po largohemi.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Viton e kemi burrneshë, shoku Enver. Edhe Verën po kështu, edhe Besniku, gjithashtu, shumë trim është treguar. Dukeshin që ishin me të vërtetë njerëzit e afërt të Hysni Kapos.

**SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:** Pse ishin të tijtë prandaj edhe u treguan të fortë dhe të tillë do të jenë kurdoherë. Vitoja shqetësohej shumë për fëmijët kur

ndodhte ndonjë gjë, qoftë edhe fare e vogël, por ajo kur ndodhin gjëra të tilla të mëdha tregon kurajë të madhe, si shoqe e dalë nga lufta.

**SHOQJA VITO KAPO:** Ne u shqetësuam në fillim edhe për operacionin e parë, kolicistitin, kur ja, kaluam gjithë këtë sëmundje të madhe.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kujtimi i Hysniut do të rrojë përjetë. Të rrosh ti, të rrojnë fëmija! Të rrojë Partia!

Edhe ju fëmijët të bëheni të fortë ashtu siç ishte babai juaj! Të rrojë Partia! Të bëhet kyç e liga! — siç thotë populli.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

## **NË KONFERENCAT E PARTISË TË QËNDROHET NË PROBLEMET KAPITALE TË RREHIT**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**29 shtator 1979**

*Në këtë takim u bisedua për zhvillimin e konferencave të Partisë në disa rrethe. Pas disa ndërhyrjeve e mori fjalën:*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Neve na intereson të dimë si diskutohen problemet në konferencat e Partisë. E kam fjalën më shumë për qëndrimin e organeve dhe të organizatave të Partisë në rrethe e në ushtri lidhur me problemet që dalin në këto konferenca. Konsideratat e mira që na shprehen nga të deleguarit janë shumë të përgjithshme. Në qoftë se nuk ka kritikë paralele për dobësitë e të metat që vihen re, kjo flet për një qëndrim jo të drejtë që mbajnë delegatët ndaj problemeve që shtrohen. Në konferencë nuk duhet folur për të gjitha problemet, se kështu nuk mund t'i dilet mbanë, por të qëndrohet në problemet më kapitale që ka rrethi, qofshin këto politike dhe me karakter

edukimi, qofshin për çështjet ekonomike. Duke analizuar me objektivitet realizimet dhe mosrealizimet në fusha konkrete të jetës, atëherë do të ketë me siguri edhe kritikë të punës për të cilën Partia ka shumë nevojë. Nuk ka rëndësi çështja që kritika të bëhet vetëm me adresë për persona konkretë, ajo të bëhet me adresë, por edhe për objekte e probleme të veçanta e konkrete. Nga kjo analizë kritike që bëhet duhet t'u jepet nga një shuplakë edhe atyre që nuk punojnë, atyre që nuk realizojnë detyrat.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Rëndësi ka çështja që problemet të zgjidhen e t'u shkohet deri në fund.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, të zgjidhen problemet dhe të analizohen e të ballafaqohen rezultatet e mira dhe ato të këqijat. Këtu qëndron kritika me objekt konkret dhe të adresuar që duhet pasur parasysh në Parti. Mua më duket se është bërë e modës që në mbledhje pune, të çdo natyre e niveli qofshin këto, bëhet autokritikë. Unë nuk kam asistuar në ndonjë nga konferencat e Partisë që janë bërë kohët e fundit, por kam përshtypjen që nuk mungojnë rastet kur autokritika bëhet në përgjithësi, sa për të shkuar rradhën. Derisa bëhet autokritikë për moskryerjen e një detyre, duhet analizuar mirë e të zbulohet ndershmërisht përse nuk është kryer si duhet kjo ose ajo detyrë, se disa herë ndihet kënaqësi vetëm pse bëhet autokritikë.

Partia ka nevojë që komunisti, kuadri dhe çdo punonjës të kryejë detyrën, se po u arrit kjo, atëherë nuk ka nevojë për autokritikë. Ai që e ka neglizhuar

kryerjen me përpikëri të detyrës dhe vjen në konferencë ose në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë për të bërë një autokritikë, do të thotë se autokritika e tij ose është formale, ose ajo është false, se nuk është rezultat i një qëndrimi të ndërgjegjshëm ndaj dobësive dhe të metave që janë vënë re në punë. Një autokritikë, e cila vetëm pohon neglizhencën, pa zbuluar thellë pse nuk është realizuar detyra, nuk është në nivelin e atij qëndrimi të çiltër që kërkon Partia. Në qëndrime të tilla «autokritike» duket komprometimi i shprehur pak a shumë kështu: «Fol ti, bëj dhe një autokritikë, flas pas teje edhe unë dhe bëj autokritikë, kështu e kalojmë radhën»! Mirëpo detyrat e Partisë në fushën ekonomike apo në fusha të tjera nuk realizohen me këtë mënyrë. Këtu, disa gjëra duhet të na tërheqin vëmendjen:

**Së pari**, çështja që bëhet vetëm autokritikë dhe nuk bëhet kritikë, sidomos kritikë paralele, do të thotë që në qëndrimin reciprok ndaj dobësive për kryerjen e detyrave ka kompromis.

**Së dyti**, të bësh autokritikë do të thotë të kesh kuptuar që nuk e ke realizuar detyrën dhe, rrjedhimisht, të kesh njohur dhe të vësh në dukje shkaqet e këtij mosrealizimi. Ka shumë shkaqe pse nuk realizohet detyra. Midis tyre, mund të jetë mungesa e ngritjes së nivelit ideopolitik të atij që nuk ka kryer detyrën, mund të jetë mungesa e aftësive organizuese ose drejtuese e njerëzve të tjerë që i ka vënë pushteti ose Partia për të drejtuar. Kështu mund të radhiten edhe shumë shkaqe të tjera që të tregojnë se detyra

në përgjithësi nuk është pasur parasysh. Komunisti ose kuadri mund të mos jetë specialist, por me nivelin, pjekurinë, përvojën, kapacitetet teknike dhe organizative të përshtatshme që ka, ai duhet t'u qëndrojë punëve në krye.

Puna e Partisë duhet kuptuar thellë. Këtë e them edhe për ne, shokët e udhëheqjes. Në qoftë se është i drejtë shqetësimi për atë që nuk është realizuar, dhe unë besoj se është i drejtë, atëherë secili të mbajë përgjegjësi. Për këto çështje të përgjigjen të tërë.

Hysni Kapo, të cilin e humbëm këto ditë, dinte t'i lidhte e t'i bashkërendonte mirë problemet e ndryshme të Partisë. Të gjithë shokët, kur kthehen nga puna që kanë bërë në rrethe, duhet të raportojnë se ç'kanë parë, ç'kanë bërë dhe ç'mendime kanë për punën dhe për njerëzit. Kjo na intereson të gjithëve, edhe mua, edhe Ramizit, edhe Hekuranit e Prokopit e jo vetëm Simonit që ndjek zhvillimin e punimeve të konferencave. Vetë ndërtimi i Partisë sonë është i tillë që veprimtaria e saj nuk kufizohet vetëm në çështjet organizative. Puna e Partisë nuk është as thjesht ekonomike. Ajo është e gjithanshme, politike, ekonomike, organizative, teknike, kulturore etj. Kështu në konferencën e Partisë të rrethit të Përmetit, për shembull, do të analizohet nëse u realizuan apo nuk u realizuan detyrat në fushën e bujqësisë. Po kush do të na i thotë neve ç'doli në konferencë për këto? Sigurisht do të na informojë vetë komiteti i Partisë i rrethit, por ama ne kemi dërguar atje edhe të deleguarin e Komitetit Qendror, i cili, gjithashtu, duhet të na informojë e të

na ngrejë probleme. Se në bazë të gjithë këtyre të dhënave, ne, sekretarët e Komitetit Qendror do të ndërtojmë punën tonë, secili në linjën e sektorit që mbulon. Po të ketë ndonjë gjë që kërkon ndihmën time, pasi të informohem, duhet edhe unë të kontribuoj.

Pra, ne duhet të insistojmë ta praktikojmë një metodë të tillë pune. Nuk e di, po a kanë ardhur këtu në aparat të tërë të deleguarit që dërguam për të informuar dhe për të raportuar për zhvillimin e konferencave që kanë përfunduar deri tani. Nëse jo, ky është një qëndrim jo i drejtë. Përse shkon i deleguar në konferencë anëtar i Komitetit Qendror? Ai vete atje për të parë punën që ka bërë Partia në rreth, problemet me të cilat është ndeshur ajo, në periudhën midis dy konferencave, si raportohet në konferencë për to etj. Konferenca e Partisë në rreth i analizon këto probleme, diskuton për to, shqyrton si janë kuptuar e si janë realizuar detyrat e shtruara. Për të gjitha këto i deleguari duhet të vijë në aparat për t'i dhënë Komitetit Qendror një pasqyrë të gjendjes, e cila duhet të paraqesë jo vetëm punën për realizimin e planit, por edhe kuptimin politik e ideologjik të detyrave nga komunistët dhe punonjësit e rrethit, të flasë për mobilizimin dhe disiplinën e Partisë në rreth, për zhvillimin e vetë konferencës e për shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën e gjithanshme të Partisë.

Unë mendoj se thirrja e të deleguarve në aparat in e Komitetit Qendror është e domosdoshme dhe duhet bërë metodë pune në veprimtarinë tonë. Sepse caktimi i të deleguarve nga Komiteti Qendror nuk është qëllim

në vetvete, por bëhet si për të ndihmuar shokët e rrethit, por edhe për të sjellë informacionin e nevojshëm në Komitetin Qendror lidhur me gjendjen e punëve të Partisë në rrethe e në bazë dhe me problemet që dalin atje. Çdo i deleguar i Komitetit Qendror, para se të vejë për të asistuar në mbledhjen e byrosë, të plenumit apo në konferencën e Partisë të rrethit, vjen këtu, në aparatit e Komitetit Qendror dhe merr të gjitha të dhënat e nevojshme për situatën në rrethin ku do të shkojë. Kur them situatën, nuk kam parasysh atë që pambuku apo misri është kështu e është ashtu, por fjala është për qëndrimet dhe veprimtarinë e organizatës së Partisë të rrethit, shprehet mendimi dhe vlerësimi i aparatit për këto qëndrime, theksohet se ku duhet përqendruar më shumë vëmendja, cila është gjendja politike e rrethit, çfarë problemesh dalin, ç'mangësi vihen re etj. Në këtë mënyrë të deleguarit shkojnë e duhet të shkojnë në rreth të parapërgatitur. Pastaj, duke marrë pjesë në mbledhjen e byrosë e të plenumit para konferencës, ata i shtojnë, i saktësojnë dhe i pasurojnë më tej njohuritë që kanë marrë në aparatit e Komitetit Qendror. Kështu në konferencë ata shkojnë edhe më të përgatitur, por aty në rreth, njihen edhe më mirë me gjendjen dhe kështu mund të japin një ndihmesë më konkrete. Pastaj kur kthehen, vijnë e raportojnë për gjithçka në Komitetin Qendror të Partisë.

Mendoj se kështu vepron. Megjithatë, më duket se çështjen e parapërgatitjes së shokëve që venë në rrethe e në bazë, duhet ta shikojmë mirë. Ata shokë që do të venë në konferencat e Partisë të rretheve e në

ushtri si të deleguar, patjetër kur të kthehen, të informojnë Komitetin Qendror për punën që do të bëjnë. Kështu do të jemi në gjendje ne që të gjykojmë edhe për punën e Partisë në rrethe e në ushtri, e për kuadrot e saj, por edhe për shokët tanë që venë në këto konferenca, për të konkluduar si kanë punuar e ç'ndihmë kanë dhënë. Kështu do të shikojmë nëse japin ndonjë ndihmë konkrete ata, apo kanë mësuar disa formula që venë e i japin në mbledhje dhe pastaj kthehen. Ka shokë që diskutimin e tyre si të deleguar e përgatitin që këtu, akoma pa marrë pjesë në mbledhjen e byrosë e të plenumit, me një fjalë, pa e njohur gjendjen dhe problemet e rrethit.

Unë mendoj se shokët që venë si të deleguar në konferencat e Partisë në rrethe e çmojnë rolin e përgjegjësive të tyre, por çështja është që me seriozitetin dhe punën e tyre ata duhet t'i japin një gjallëri dhe impuls më të madh zhvillimit të punimeve të konferencës, duke lidhur mirë anën politiko-ideologjike me anën teknike dhe organizative të problemeve kyç që shfaqen në rreth apo në njësinë ushtarake. Kjo, sigurisht, lidhet me aftësitë e njerit e të tjetrit. Ne nuk mund të kërkojmë nga të gjithë anëtarët e Komitetit Qendror që të kenë aftësi të barabarta, prandaj disa prej këtyre duhen ndihmuar. S'ka dyshim se shumica e anëtarëve të Komitetit Qendror kanë aftësi të mëdha politike, organizative dhe teknike. Por çështja qëndron që në veprimtarinë e secilit ne të shohim ç'ka menduar për të kombinuar njohuritë që ka për punën me ato që do të dalin në konferencë, me mendimet që

do të shfaqen atje. Këtu është gjithë çështja. Po e kombinove si duhet atë që di, me ato që dalin atje, atëherë do të bësh me siguri edhe një konkluzion të mirë dhe do të jesh në gjendje t'i japësh Partisë një ndihmë të mëtëjshme. Ndryshe, të flasësh me receta të përgatitura që më parë, pa pasqyruar edhe atë që del gjatë zhvillimit të konferencës, do të thotë të bësh një punë formale.

Ju mund ta dini më mirë, por unë mendoj se edhe në konferencat e Partisë të rretheve tendenca është që të flitet vetëm ose më shumë për problemet ekonomike, si për planin, për rendimentin, për cilësinë, koston etj., kurse problemet e tjera, po aq të rëndësishme, siç janë ato politike, shoqërore, kulturore etj., sikur harrohen. Dhe ndodh që për problemet e agjitacionit dhe të propagandës, caktohet qysh më parë që të përgatitet e të diskutojë një person që «flet bukur». Diskutimi i tij, mendoj unë, do të jetë vërtet i mirë, në qoftë se ai do të bëjë një pasqyrë të vërtetë të gjendjes politike, të zhvillimit të kulturës dhe të propagandës. Ai që punon në uzinë, në sektorin e naftës ose në bujqësi, natyrisht, do të flasë edhe për çështje teknike e organizative, por njëkohësisht në diskutimin e tij duhet të bëjë edhe disa konsiderata politike dhe ideologjike. Dhe të tilla ka plot për të bërë. Vetëm kur bëhet një diskutim problematik, i parë ky në mënyrë të shumanshme, kjo atëherë do të thotë se diskutanti e ka kuptuar mirë përse në sektorin ose në repartin e tij nuk janë arritur rezultatet e duhura, nuk është vendosur një disiplinë e fortë dhe nuk ekziston një kuptim i

drejtë i vijës së Partisë për realizimin e planit; do të thotë se ai e di që te disa punonjës mungon kuptimi politik i problemeve, te disa të tjerë mungon ngritja teknike, arsimore, kulturore etj.

Gjatë diskutimeve mund e duhet të bëhen debate dhe ballafaqime. Prandaj nuk është e mjaftueshme të thuhet në konferencë vetëm që u bënë këto torno, u prodhua kjo ose ajo vegël, kemi apo s'kemi çelik etj., por të thuhet edhe përse s'kemi çelik dhe ai që është përgjegjës për këtë të ngrihet në mbledhje e të sqarojë delegatët. Por krahas autokritikës që mund të bëjë, ky mund e duhet të debatojë duke ngritur problemin se në disa ndërmarrje e sektorë çeliku apo lënda e parë harxhohen pa kriter, ngaqë, fjala vjen, kualifikimi i punëtorëve është akoma i dobët, ose sepse ka në ndërmarrje nga ata që nuk e kuptojnë politikisht bllokadën imperialisto-revizioniste, por e marrin këtë si një slogan të thjeshtë. Kuptimi politik në rastin konkret është që t'i kursesh në maksimum çeliquet, pse shteti ka vështirësi të mëdha për t'i siguruar ato. Kështu duhet bërë diskutimi.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Shoku Hysni i thërriste personalisht të deleguarit që ishin caktuar të venin në konferencat e Partisë të rretheve dhe i dëgjonte me kujdes, duke mos u mjaftuar me raportet që dërgonin. Kjo ishte një metodë shumë e mirë pune. Unë jam me mendimin e shokut Enver që duhen thirrur të deleguarit, bile mendoj t'i thërrasim, duke qenë, në disa raste, të katër sekretarët bashkë. Në qoftë se e bëjmë kështu këtë punë, atëherë do t'i mësojmë edhe shokët

që të vijnë vetë në aparatin e Komitetit Qendror.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Do të mësohen patjetër. Të gjithë ju drejtoni sektorë të veçantë. Kur shikoni se i deleguari në një rreth nuk po i zë në gojë fare çështjet që i interesojnë më shumë Partisë dhe flet në mënyrë të përgjithshme, si bie fjala: në konferencë kishte kritikë, kishte autokritikë, autokritika ishte personale, u realizua kjo, nuk u realizua ajo etj., atëherë t'i kërkohet që të na thotë se cilat ishin dobësitë konkrete në punën e Partisë në atë rreth. Neve na intereson më shumë të dimë për punën e Partisë në bazë, për organizatat shoqërore etj. Nga kjo bisedë ju do të shikoni nëse shoku i deleguar ka shkuar apo jo i përgatitur si udhëheqës partie për të parë problemet nga këndi i punës së Partisë dhe, nga ana tjetër, edhe ai do të përfitojë në aspektin e metodës së punës. Këtë praktikë ta kërkojmë medoemos që të zbatohet në punën e shokëve.

Kemi thënë edhe herë të tjera që në veprimtarinë tonë si punëtorë partie nuk duhet të dublojmë detyrat e pushtetit. Partia ka një rol shumë të madh, se është forca e vetme politike udhëheqëse e gjithë vendit, pra edhe e shtetit, por ajo nuk duhet të merret me detyrat që u takojnë organeve shtetërore. Duke njohur mirë rolin e organeve shtetërore dhe problemet që u takojnë atyre të kryejnë, Partia i udhëheq, i orienton, i ndihmon dhe i kontrollon këto, por në asnjë rast nuk duhet t'i dublojë. Komunistët punojnë në sektorë të ndryshëm të ndërtimit socialist, dikush në bujqësi, të tjerë në industri, në arsim, në ushtri etj. Këta edhe vetë pu-

nojnë, prodhojnë e drejtojnë e njëkohësisht, duke qenë udhëheqës të masave e duke punuar bashkë me to, me veprimtarinë e tyre bëjnë që të realizohet udhëheqja e Partisë në sektorët e ndryshëm ku ata militojnë.

Partia nuk jemi vetëm ne që jemi zgjedhur në udhëheqje, as ata që janë emëruar në aparatet e Partisë, por janë organizatat-bazë, është masa e komunistëve, që njohin mirë e zbatojnë politikën dhe direktivat e Partisë, por edhe anët teknike të problemeve. Partia duhet të punojë vazhdimisht që anëtarët e saj të bëhen më të ndërgjegjshëm politikisht e ideologjikisht që, në këtë kuadër, të zbatojnë mirë edhe detyrat funksionale. Udhëheqësit dhe kuadrot drejtues të Partisë në qoftë se do t'u flasin punonjësve vetëm për anët teknike të çështjeve, me siguri që do t'u flasin çalë, se ato nuk i njohin në thellësi. Por nuk është kjo puna e tyre. Ata duhet t'i shikojnë problemet në këndin e punës së Partisë, pra ç'bëhet me njerëzit, si punojnë, ç'qëndrime mbajnë këta, ç'koncepte kanë etj. Këto çështje t'i bëjnë probleme partie. Këtë gjë e kemi përsëritur ngaherë, megjithatë prapë kemi dobësi. Veprimtaria udhëheqëse e Partisë dhe veprimtaria e organeve shtetërore, megjithëse nuk janë të ndara me thikë, nuk duhen ngatërruar. Pa dubluar organet shtetërore Partia do t'i ndjekë e do të merret me këto probleme, ndryshe nuk do të jetë në udhëheqje dhe në gjendje që të realizojë si duhet qëllimet e saj.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Partia ka për qëllim të ndërtojë socializmin.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po ç'do të thotë të ndër-

tojë socializmin? Kjo do të thotë të realizohen të tërë treguesit e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës në të gjitha rrethet, në të gjitha qendrat e punës e të prodhimit.

Partia ka organizatat e masave, ka kuadrot e saj, të zgjedhurit, ka propagandistët, agjitorët etj. Secili prej këtyre duhet të jetë në vendin e vet. Partia i mobilizon dhe i drejton mirë këta të luajnë si duhet rolin që kanë në këtë punë të madhe për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Por qoftë sekretari i Partisë në rreth, qoftë instruktori i aparatit të komitetit të Partisë për punët e sektorit që mbulojnë nuk duhet të merren me gjëra në përgjithësi, por të jenë më konkretë, të njohin mirë orientimet e Partisë dhe problemet që lindin në praktikë gjatë zbatimit të saj. Këtej del që secili t'i futet më thellë njohjes me kompetencë të problemeve në sektorin që mbulon.

Kam përshtypjen që aparatet e Partisë nuk e bëjnë si duhet këtë punë. Natyrisht, me të tëra punët nuk mund të merret komiteti i Partisë, por për problemet kryesore që ka vendosur Komiteti Qendror, e ka për detyrë të interesohet. Ne do të marrim në shqyrtim në një mbledhje të ardhshme të Byrosë Politike çështjet e revolucionit tekniko-shkencor. Për mendimin tim, në qoftë se raporti mbështetet vetëm në ato që kam thënë unë ose që keni thënë ju për revolucionin tekniko-shkencor, raporti nuk do të vlejë. Raporti ose analiza, për të qenë e plotë, duhet të pasqyrojë edhe aspekte të tjera të këtij problemi. Ai ose ata që kanë qenë ngarkuar me studimin e këtij pro-

blemi duhet ta shikojnë çështjen në të gjitha drejtimet. Kur shikohet revolucioni tekniko-shkencor në fushën e industrisë, për shembull, qoftë ministria, qoftë grupi i punës të synojnë që të pasqyrojnë të gjitha aspektet e këtij problemi dhe jo vetëm ato që thotë një specialist i vetëm apo ç' thotë ministri. Ata e kanë për detyrë të bëjnë studime për problemet që ngre jeta dhe jo të veprohet siç thonë disa specialistë e studiues: «Ne veprouam kështu, se kështu na kanë thënë në ministri. Ne nuk vendosim, bëjmë vetëm studime». Por pranohet apo nuk pranohet studimi i tyre, vlerësohet nëse është ky i mirë apo i dobët, kjo është tjetër gjë për ta. Ç'është kjo punë kështu, ç'janë këto qëndrime të njëanshme që mbahen? Ky është një burokratizëm që rrjedh nga frika për të shprehur lirisht mendimet për mbarëvajtjen e punës. Kësaj i thonë të mos lejosh të shprehen mendime dhe të mos lësh njerëzit e mësuar t'i paraqitin mendimet që kanë.

Ekziston edhe koncepti se, meqë problemet më me rëndësi paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave, ministria s'ka pse të merret me to, por me punë të tjera më pak të rëndësishme. Natyrisht, kjo do të veprojë në bazë të kompetencave që ka dhe nuk do të vendosë për ato çështje që vendos Qeveria, por specialistët që janë në dikaster kanë dhe duhet të japin mendimet e tyre, të bëjnë propozime duke i argumentuar e duke i mbrojtur me kurajë ato. Nuk është e drejtë që mjafton të thuhet një fjalë nga organi më i lartë dhe kjo të merret shabllon nga organet vartëse e të veprohet pa përgjegjësi, duke u ju-

stifikuar me shprehjen: «Kështu ma the dhe kështu veprova». Qëndrime të tilla flasin për një mungesë edukate të shëndoshë revolucionare. Sa më shumë studime të kemi ne, aq më mirë është, se atëherë do të dimë të zgjedhim më të mirat. Vendimi për zbatimin e një ideje apo direktive të Partisë nuk varet as nga një apo dy veta, por duhet një punë kolegjiale, duhet mendimi dhe veprimi i gjerë i masave, i organeve qendrore e të bazës, duhen studime të thelluara e të argumentuara. Mirëpo, me sa kam mësuar, ka drejtues të ndonjë dikasteri që thonë: «More, po ç'na nxirrni telashe dhe pse ngulni këmbë kaq shumë ju të komisionit të studimit për këto punë?!». Një qëndrim i tillë nuk është i drejtë. Si mund t'u shmangemi ne «telasheve» të tilla pse këto studime kërkojnë punë që i shërben ndërtimit të socializmit?!

Ky është një problem që kërkon zgjidhje të drejtë në rrugë partie, sepse ekzistenca e koncepteve të tilla është serioze, se këtu është fjala për mungesën e një fryme partie. Këto probleme nuk vendosen në ministri nga një person. Nuk mund të vendoset atje për diçka pse dikush, qoftë ky edhe titullar, tha një fjalë për atë çështje. Para se të merret vendimi është e nevojshme që për çdo problem më parë të ndërmerren studime, me qëllim që të kihen parasysh të tëra variantet dhe alternativat e mundshme dhe më në fund të vendoset në mënyrë kolegjiale për atë që është më i drejtë.

Çështja qëndron në atë që kudo të krijojmë atë frymë të lartë revolucionare, atë frymë partie që ne-

vojitet për zgjidhjen e problemeve që lindin dhe që të mos vihet qerrja përpara buajve. Në qoftë se kjo apo ajo zgjidhje, që jepet nga studimi, kërkon, fjala vjen, më shumë shpenzime, për këtë do të vendosin organet kompetente. Por studimi është studim dhe studiuesit duhet të përpiqen që në të të japin mendime e konkluzione sa më të mira e sa më bindëse. Në qoftë se ministria ka vërejtje për studimin, këto të diskutohen e të shihen më vonë. Qeveria mund t'i marrë në konsideratë, sepse ministria është organ qendror i administratës shtetërore i specializuar për një degë veprimtarie dhe ministri është anëtar i Këshillit të Ministrave. Kështu duhet të veprohet edhe për çështjen e silikateve që u përmend këtu për qymyret, boksitet apo për të gjitha problemet e tjera. Pra merret mendimi i ministrisë, bëhet diskutimi dhe pastaj vendoset. Të gjitha këto gjëra duhet të bëhen me llogari, duke i hedhur në tavolinë mendimet e jo të veprohet ashtu siç mund të thotë një specialist.

Mora studimin që është bërë në Korçë për silikatet. Kisha merak se mos na mbetej në letër ky studim, prandaj porosita të bënin provën dhe të veprohej për këtë objekt pa humbur kohë e të merreshin të gjitha masat për këtë çështje, sepse ky studim është shumë interesant. Qymyrguri i Drenovës përmban një përqindje minerali të rrallë, prandaj edhe kjo çështje duhet parë.

Të tëra këto duhen parë me kujdes dhe të kombinuara mirë, se kanë interes të madh për ekonominë tonë, nuk janë gjëra të thjeshta. Një njeri që i shikon

këto studime me frymë burokratike, për të mos iu prishur rehati dhe për të mos iu cenuar vendi që ka zënë, është i gatshëm të mos e ndihmojë progresin. Këta njerëz, që janë të predispozuar të mbajnë vesh çfarë thotë dikush andej lart dhe të veprojnë për të genë brenda, nuk janë në rregull me orientimet e Partisë. Ne duhet t'i mësojmë punonjësit tanë që t'i respektojnë organet eprore, ministrat, zëvendësministrat etj., por edhe specialistët, duhet t'i inkurajojmë që t'i thonë mendimet e tyre, të vërtetat, me kurajë, pa asnjë druajtje, qoftë për anën teknike, për atë ekonomike, ashtu edhe për anën politike të çdo problemi. Në qoftë se dikasteri ia hedh poshtë studimin, komisioni ose specialisti i veçantë, që ka bindjen se qëndrimi i mbajtur nuk është me vend, mund të drejtohet më lart, pa pasur asnjë ngurrim, për sa kohë që është fjala për të mbrojtur interesat e socializmit. Në këtë kuptim, si drejtuesi, ashtu edhe specialisti, kanë të drejtat e tyre si komunistë e punonjës të shtetit. Kështu problemi që paraqet një interes të veçantë nuk mbetet më në mes dy vetave. Në qoftë se shpikja ose racionalizimi nuk i pëlqen drejtuesit, kur ka mosmarrëveshje, duhet të gjykojnë edhe të tjerët, deri edhe organi kryesor. Këto janë norma të centralizmit demokratik, ku bazohen organizimi i Partisë dhe i shtetit tonë dhe veprimtaria e tyre, gjithë jeta jonë politike dhe ekonomike. Puna e Partisë në këto fusha ka rëndësi shumë të madhe.

Nesër mbaron aksioni për likuidimin e pasojave të tërmetit, prandaj duhet të dalë komunikata e përbashkët e Komitetit Qendror të Partisë dhe e Këshillit të Ministrave<sup>1</sup>, ku të njoftohet populli ynë se vendimi i marrë nga Partia dhe nga Qeveria u realizua plotësisht dhe në afatin e caktuar. Në komunikatë duhet të përmendet sa shtëpi u ndërtuan, sa milionë lekë u harxhuan etj. Të vihet në dukje pjesëmarrja e mijëra vullnetarëve nga të gjitha anët e Shqipërisë me ekipe të organizuara, të vlerësohet puna e të gjithëve, e teknikëve dhe e vullnetarëve, se, në fakt, puna e tyre është jashtëzakonisht e mirë, prandaj është për t'u respektuar. Të trajtohet aspekti politik i gjithë kësaj pune kolosale, se kjo që u bë është një provë tjetër që vërteton se si ndërtohet socializmi, duke u mbështetur në forcat e veta, pa asnjë ndihmë nga jashtë. Në komunikatë të thuhet gjithashtu sa banorë u strehuan, duke bërë edhe ndonjë konkretizim se nga ndihma e shtetit përfiton një popullatë prej gati 90 mijë frymë, e barabartë, për shembull, me dyfishin e popullsisë së qytetit të Shkodrës. Dhe gjithë kjo punë kolosale mbaroi brenda pesë muajve. Të nënvizohet se kjo tregon forcën e madhe të Partisë dhe të shtetit tonë, unitetin e Partisë me popullin etj. Të shpallet gjithashtu se me vendim të Komitetit Qendror dhe të Këshillit të Ministrave të gjitha shtëpitë kalojnë pa asnjë shpërblim në pronësi të përhershme personale të familjeve që janë strehuar, ashtu siç është

---

1. Shih: «Zëri i popullit», nr. 236 (9724), 3 tetor 1979.

bërë traditë për të gjitha ndërtimet që janë bërë në shtëpitë e shkatërruara nga tërmetet e shumta të mëparshme në vendin tonë pas Çlirimit. Në komunikatë të trajtohet në mënyrë të tillë çështja që të rritet gëzimi i madh dhe optimizmi i popullit pas hidhërimit që patëm nga vdekja e shokut Hysni. Në fund të thuhet që Komiteti Qendror dhe Këshilli i Ministrave u urojnë të gjitha familjeve që t'i gëzojnë shtëpitë e reja dhe t'i ftojnë t'i përvishen punës që të realizojnë planet, të forcojnë ekonominë dhe republikën. Këto ide të jenë objekti i atyre që do të thuhën në të. Ajo të mos jetë si artikull, por koncize e me brendi të thellë politike.

Radioja, televizioni dhe ATSH-ja t'i grumbullojnë dhe t'i publikojnë materialet e përmbledhura për këtë ngjarje.

*SHOKU RAMIZ ALIA.* Po. Tani po përgatitet edhe një film, ku do të vihen në dukje shkatërrimet nga tërmeti, duke filluar që nga dita fatkeqe e 15 prillit e deri në mbarim të ndërtimeve, më 1 tetor.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Duhet të punohet edhe për dekorimet e rretheve që ndihmuan, veç të tjerave edhe duke dërguar vullnetarë, duke treguar kështu unitetin e popullit tonë me Partinë. Mund të dekorohen me këtë rast edhe grupe vullnetarësh. Unë besoj se të tërë kanë punuar mirë për likuidimin e pasojave të tërmetit, por ka që kanë punuar shumë mirë, prandaj edhe në dekorime të bëhen diferencime. Disa individë të shquar të disa rretheve duhet të dekorohen patjetër.

Edhe Hysniu, që e kishte mendjen te puna dhe hallet e Partisë, me gjithë kushtet aq të rënda të shëndetit të tij, i kishte thënë Vitos, se duhet të dekoroheshin disa njerëz të dalluar gjatë punës për zhdukjen e pasojave të tërmetit.

Unë mendoj që zyra e Hysniut duhet të mbetet e paprekur, ashtu siç e ka lënë ai. Herë pas here ajo të fshihet e të pastrohet nga punëtorët e shërbimit. Dokumentet e zyrës së shokut Hysni, kur të ketë kohë Ramizi, t'u hedhë një sy, pastaj të regjistrohen e të depozitohen, sipas rregullave, në Arkivin Qendror të Partisë.

Unë, përveç të tjerave, do t'i propozoj Byrosë Politike që, me rastin e 65-vjetorit të lindjes së Hysniut, që bie më 4 mars të vitit që vjen, të përgatiten veprat e zgjedhura të tij<sup>1</sup>, përmbledhje të fjalimeve e të referateve të tij të ndryshme, nga më të rëndësishmet. Të bëjmë një botim me rastin e ditëlindjes së tij, mendoj unë. Pastaj, me kohë, duhen klasifikuar të gjitha shkrimet e tij në një fond të veçantë, si diskutime, fjalime e të tëra çfarë ka. Të gjitha përnjëherë, natyrisht, nuk përfundohen dot ato, por të bëjmë një

---

1. Në bazë të këtij propozimi, Sekretariati i KQ të PPSH mori vendimin për botimin e 5 vëllimeve me Vepra të Zgjedhura të shokut Hysni Kapo. Me zbatimin e këtij vendimi u ngarkua Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH. Më 1 mars 1980, në prag të 65-vjetorit të lindjes së shokut Hysni Kapo, doli në qarkullim vëllimi I i Veprave të Zgjedhura të tij dhe deri në mars të vitit 1983 u botuan edhe katër vëllimet e tjera.

zgjedhje me kriter, në mënyrë që t'i shërbejnë Partisë. Shumë nga këto materiale janë botuar edhe nëpër buletine të Komitetit Qendror të Partisë, në gazeta etj.

Vitos duhet t'i themi që të pushojë ca, se ka shumë nevojë, prandaj le të shkojë ku të dojë, të marrë me vete edhe fëmijët, që janë dëshpëruar shumë nga humbja e babait.

Edhe profesor Petrit Gaçe mendoj se duhet çuar në pushime, se më tregoi Nexhmija që mbrëmë ai i qe dukur shumë i lodhur. Ai ka punuar jashtëzakonisht shumë në Paris gjatë gjithë kohës që vazhdoi sëmundja e Hysniut.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Dhe ka punuar shurnë mirë, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sipas Vitos, Petriti dhe mjeku Dine Abazi kanë punuar shumë, ata i kanë qëndruar vazhdimisht 24 orë te koka e krevatit, pa lëvizur fare nga vendi. Petriti ka punuar pastaj me zotësi të madhe, saqë, siç thotë Vitoja, kirurgu francez, nuk i thoshte *monsieur* Gaçe, por *mon excellent collègue*<sup>1</sup>. Ai është një specialist i zoti, po para së gjithash është njeri partie. Punon me partishmëri dhe ka kurajë të madhe.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

---

1. Kolegu im i shkëlqyer.

## **FILM KU TË PËRFSHIHET GJITHË JETA, LUFTA DHE VEPRIMTARIA E HYSNI KAPOS**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**1 tetor 1979**

Dua të shpreh disa mendime për filmin që do të bëhet për jetën, veprimtarinë dhe vdekjen e Hysniut e, natyrisht, do të bëj edhe disa sugjerime që mund të shërbejnë në këtë drejtim. Mendoj që në këtë film të pasqyrohet e gjithë jeta, lufta dhe veprimtaria e Hysni Kapos. Në të mund të vihet edhe diçka nga ceremonia e varrimit të tij. Por kryesorja është që në film të pasqyrohen në mënyrë sa më të plotë jeta e shokut Hysni, lufta e tij për çlirimin e vendit, për ndërtimin e socializmit, për kalitjen e Partisë e të pushtetit, për zhvillimin dhe intensifikimin e bujqësisë etj. Sigurisht ky film do të shfaqet në popull.

Por mendoj që të bëhet edhe një film tjetër, që do të ketë të gjitha ceremonitë e zhvilluara me rastin e vdekjes së tij. Ky film duhet të dalë një gjë me të vërtetë optimiste, e bukur, me ngjyra dhe bardhë e zi.

Ai nuk do të shfaqet tash, por të ruhet në arkiv dhe pas disa vjetësh mund të shfrytëzohet e të shfaqet<sup>1</sup>.

Filmi i parë, po e theksoj, ka rëndësi të madhe, prandaj skenari duhet të shihet mirë nga ju e të mos lihet vetëm në dorën e atyre që do të ngarkohen me këtë punë. Që filmi të dalë siç thashë, nuk është aq e lehtë, mbasi punonjësit e Kinostudios nuk kanë shumë materiale në dorë, sidomos fotografi, aq më tepër fotografi me ngjyra, kurse Arkivi Qendror i Partisë ka plot të tilla. Për zgjedhjen e materialit, për shembull, të një fjalimi të shokut Hysni, që do të paraqitet në film, të mos e lëmë vetëm në dorë të skenaristit e të regjisorit, por në bashkëpunim me ta, të punojnë edhe shokë të aparatit të Komitetit Qendror, me qëllim që në film të dalë tamam ajo pjesë, ajo fjalë e Hysni Kapos, ku të përmbliidhen idetë kryesore, ato momente që e japin të plotë figurën e Hysniut si udhëheqës partie. Domethënë në film të paraqitet nëpërmjet figurave veprimtaria e gjithanshme e tij, të jepet pra, Hysni Kapoja duke folur për Luftën Nacionalçlirimtare, për unitetin e Partisë, për zhvillimin e bujqësisë etj., etj. dhe jo të mjaftohet me atë që zgjedh regjisorin, i cili për këtë film mund të gjejë vetëm dy-tri fraza të përgjithshme, stereotipe e të kënaqet me kaq.

Prandaj mendoj që filmit për jetën dhe veprimtarinë e Hysniut t'i kushtojmë kujdes të veçantë. Të ca-

---

1. Ky film u përgatit dhe u shfaq me rastin e 70-vjetorit të lindjes së shokut Hysni Kapo.

ktohen nja dy a tre veta, regjisorë e operatorë që të punojnë për xhirimin e tij, pastaj, pasi të jetë përgatitur, të shihet mirë edhe nga shokët tanë. Them të shihet, mbasi kam vërejtje për emisionet televizive kushtuar heronjve dhe dëshmorëve të Luftës sonë Nacionalçlirimtare.

Në filmat dokumentarë të kësaj natyre, që jep televizioni ynë, të bie në sy një e metë e përgjithshme: mungon sensi i masës. Si pasojë po bëhen ekzagjerime. Për shembull, në një nga këto emisione flitet për një partizan të thjeshtë, atentator, që i ka pasë bërë pritë një spiuni. Ngrihet kaq lart në televizion akti i tij e i thuren aq lavde, sa njeriu i bën pyetje vetes: po ç'mbetet të thuhet tani për Hysni Kapon? Ose flitet e flitet aq shumë për një komandant toge të një brigade apo për një partizan të thjeshtë, sa nuk ruhet sensi i masës. Ata vërtet kanë luftuar, kanë bërë akte heroizmi e trimërie, për të cilat duhet folur. Por të mos harrojmë, se luftën nuk e bënë dhe nuk e fituan individë të veçuar. Prandaj të flasim për ata aq sa duhet të flitet, pa e tepruar. Se ç'ndodh? Ngrihet një kuadër e flet në televizion për 15 minuta rresht për një partizan dhe i ekzagjeron kaq shumë gjërat sa kur e dëgjon, thua se nuk mbeti gjë tjetër të thuhet për ata që kanë merita shumë më të mëdha, si, fjala vjen, për Hysni Kapon, i cili ka pasur tërë ato detyra e funksione me përgjegjësi, ka zhvilluar gjithë atë veprimtari të madhe e të gjithanshme politike, ideologjike, organizative, diplomatike, ushtarake etj.!

Unë e shtroj kështu këtë çështje: ashtu siç kemi kërkuar t'u vihet fre atyre shkrimeve në gazetë, që nuk pasqyrojnë me objektivitet historinë, po kështu duhet vepruar edhe për emisionet televizive e për filmat. Ndodhte që shkrimeve nëpër gazeta u vihehin tituj pompozë, bëheshin hosanara të mëdha për njërin apo tjetrin, kurse tani shohim që ka përpjekje për të qenë më të matur. Prandaj them që duhet të bëjmë më mirë të qarta kriteret për shtypin, por edhe për televizionin, që në pasqyrimin e historisë të ruhen objektiviteti, masa, përpjesëtimet, që secili të zërë në histori aq vend sa i takon. Ashtu si nuk mund të vihet në një plan trimëria e një partizani të thjeshtë me atë të një heroine të popullit, që ishte vajzë e re dhe armiqte e torturuan, rezistoi heroikisht e vdiq në tortura, po kështu nuk mund të vihet në një plan ajo me Hysni Kapon, që shkriu tërë jetën dhe energjitë e tij në shërbim të popullit, ai ka në aktivin e tij një veprimtari jashtëzakonisht të gjerë. Hysni Kapoja ishte një nga njerëzit më të mëdhenj të Shqipërisë. Tash ç'të bëjmë ne për Hysni Kapon, të kufizohemi duke folur 15 minuta njëlloj siç flasim për një partizan të thjeshtë apo për një komandant kompanie, makar edhe për një hero? Jo, nuk mund të veprojmë kështu.

Pashë në televizor një emision të përgatitur për luftën e Mushqetasë. Nuk di me sa përgjegjësi fliste njëri aty, po e dini ç'tha? «Nuk kishe ku të hidhje këmbët, sepse tërë rruga ishte mbushur me kufoma të gjermanëve!». E si të mos thuash atëherë që këto emi-

sione duhet të jenë më të studiuara, me qëllim që në to të ruhet masa, të ruhen përpjesëtimet kur flasim për fakte e ngjarje historike, për persona të veçantë? Dhe jo të ndodhë që të mblidhen tërë fjalët ditirambike për këtë apo atë person e të kalohet masa. Këtu duhet pasur parasysh se veprohet jo drejt edhe në një aspekt tjetër. Duhet trajtuar më me kujdes këto gjëra.

Para se të vdiste Hysniu, pashë në televizor një numër estrade, që me të vërtetë m'u neverit. Përmbajtja e skeçit ishte fare e ulët, sa, kur e shikoje, arrije menjëherë në konkluzionin sikur partizanët tanë nuk paskan luftuar fare, sepse kishin përpara një armik të dobët. Nuk e shikoja dot një skeç të tillë. E di si paraqiteshin ballistët atje? Frikacakë nga më të mëdhenjtë që mund të gjenden, të shtrirë fare e gjithë tmerr. Kurse realiteti s'ka qenë i tillë, se në fakt shqiptarë ishin dhe ata. Të merrnin gjak në vetull Hysni Lepenica, Tahir Hoxha dhe të tjerë. Po kështu edhe ballistët e Veriut, si Gjon Mark Gjoni e të tjerë. Pse ashtu siç i paraqesin këto figura nëpër skeçe kanë qenë këta njerëz?! Këta që përgatisin të tilla programe nuk e kuptojnë se me këtë mënyrë poshtërohet lufta jonë? Po me kë luftuam ne, nuk luftuam me armiq të egër, kriminelë që, po të mos i vrisje, të vrisnin? Jo, nuk duhen lejuar trajtime të tilla, se jo vetëm që nuk bëjnë efekt pozitiv, por përkundrazi e ulin madhështinë dhe vlerën e luftës sonë. Ajo nuk ka qenë aspak siç paraqitet në disa skeçe apo në emisione të tilla. Mund të thuash që Safet Butka, Du-

le Alarupi ishin budallenj?! Po Lumo Skëndoja?! Jo, Lumo Skëndoja ishte diplomat, Ali Këlcyra ishte gjithashtu një diplomat, bile shumë dinak. Qazim Koculi po ashtu. Pse kështu ishin ballistët, që dridheshin dhe shtriheshin poshtë tavolinave sa dëgjonin krismat e armëve? Ç'janë këto gjëra kështu?! Prandaj të bëhet kujdes në këtë drejtim.

Teksti i Historisë së Shqipërisë është shkruar dhe ne kemi diskutuar rreth tij, që kur na u paraqit maketi. Ajo që shkruhet në të vlen si një orientim, sepse nuk jepen me hollësi gjërat. Kurse kështu siç veprohet në disa artikuj dhe emisione televizive, do të thotë të mos e paraqesësh drejt dhe saktë historinë.

Filmi që do të bëhet për Hysniun duhet të dalë i mirë. Për këtë qëllim të shihen me kujdes e të shfrytëzohen si duhet fototekat. Fotografii të tijat, që janë me ngjyra, ka plot. Ato të kohës së luftës janë pa ngjyra, megjithatë të mira janë dhe mund të përdoren në film siç janë. Në kohën e luftës nuk kemi pasur mundësi të tjera përveç fotografimit. Megjithatë ilustrimi në film me anë të fotografive është një art më vete dhe u takon atyre që do të punojnë për të që këtë punë ta bëjnë mirë. Sidoqoftë, në radhë të parë, duhet të bëhet skenari i filmit.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Po, ashtu do të veprohet. Emisioni që dha televizioni ditët e fundit ishte një punë e shpejtë, jepte një ide të përgjithshme të jetës dhe veprimtarisë së shokut Hysni, kurse ky që do të përgatisim mendojmë se do të bëhet më i mirë. Filmin

që do të pasqyrojë ceremoninë e vdekjes së shokut Hysni, ata të Kinostudios e kanë bërë me ngjyra.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Tash populli është në fazën e punës, të realizimeve, të mobilizimit e të gëzimeve. Kujtimin e Hysniut asnjëri nuk e harron, prandaj të kujdesemi që të përgatisim filmin i cili, natyrisht, nuk mund të bëhet dot brenda disa ditëve, por ta kemi gati në ditën e lindjes së shokut Hysni.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Po, ditën e 65-vjetorit të lindjes ne duhet ta shfaqim atë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Prandaj, Ramiz, interesohu të caktohen njerëz të aftë që do të merren me të dhe të kihet parasysh që çdo gjë të bëhet me plan e me tema të veçanta sipas fushave ku Hysniu ka zhvilluar veprimtarinë e tij të madhe si udhëheqës i Partisë e i shtetit, në politikë, në ideologji, në diplomaci, në ushtri etj.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar që gjendet në AQP*

## **THELBI I METODES QENDRON NË ORGANIZIMIN E MIRE TË PUNËS**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**8 tetor 1979**

Këto ditë, nëpër rrethe, zhvilloheshin konferencat e Partisë për dhënie llogari e zgjedhje. Problemet që dilnin nga këto konferenca bëheshin objekt diskutimi midis sekretarëve të Komitetit Qendror të Partisë. Në këtë takim u shtruan disa të meta e dobësi, që ishin vënë re në punën e Partisë, veçanërisht në rrethin e Vlorës. Shoku Enver Hoxha, duke i kritikuar këto dobësi, vuri theksin në disa çështje të organizimit e të drejtimit të punës së Partisë.

Në teori thuhet se Partia e realizon udhëheqjen e saj edhe nëpërmjet levave dhe në fakt kështu është, por mua më duket se disa nga drejtuesit kryesorë të Partisë dhe të pushtetit në rrethe nuk e organizojnë si duhet punën për funksionimin e tyre. Kjo ndodh për arsye se nuk janë kuptuar thellë detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë që u takojnë atyre.

Në sipërfaqe duket sikur orientimet e Partisë për këtë problem dihen mirë, por, kur analizohet çështja konkretisht, del se nuk është kuptuar thellë mënyra e organizimit të të gjitha forcave të Partisë, të pushtetit e të klasës punëtore për plotësimin e detyrave të planit, për ngritjen politike e morale dhe për edukimin ideologjik të kuadrove e të masave. Po t'i kishin kuptuar si duhet të gjithë shokët drejtues detyrat që kanë Partia, organet e pushtetit dhe organizatat e masave në këtë fushë me rëndësi, rrethet do të arrinin tregues shumë më të lartë nga këto që kanë arritur aktualisht në plotësimin e detyrave.

Nga të gjitha raportet që lexojmë, del se format e organizimit të punës së Partisë dhe të shtetit në industri, në bujqësi, në institucionet socialkulturore etj., nuk njihen ose nuk zbatohen kudo mirë dhe për këtë nuk kërkohet si duhet llogari. Thelbi i metodës qëndron në organizimin e mirë të punës, në shpjegimin e qartë të udhëzimeve që u jepen kuadrove dhe në kërkesën e llogarisë sidomos ndaj disa kuadrove, që nuk bëjnë përpjekje për të zbërthyer qëllimet dhe përmbajtjen e direktivave dhe për t'ua mësuar të tjerëve në praktikë.

Thuhet shpesh se dobësitë në metodën dhe në stilin e punës kanë shkaktuar këtë ose atë mosrealizim. Por ky konstatim, sido që është i drejtë, nuk mjafton për të kryer detyrat. Kjo që thuhet në raste të tilla është vetëm një autokritikë e pakonkretizuar, pra është autokritikë e sipërfaqshme, globale, përderisa mjaft kuadro, që i kemi caktuar në krye të detyra-

ve sipas sektorëve dhe u kemi dhënë kompetenca për drejtimin kolektiv dhe individual, vazhdojnë të mos shqetësohen fort edhe pas kësaj autokritike për mbarrëvajtjen e punëve. Dhe kuadro të tillë, që nuk e vrasin shumë mendjen, nuk janë një e dy, por me dhjetëra në ndërmarrje, në kooperativa ose në institucione të ndryshme. Duke e parë në thellësi punën e tyre, shpesh të krijohet mendimi që ajo është rutinë burokratike.

Drejtnesit e ndryshëm janë zgjedhur ose janë emëruar nga Partia dhe nga pushteti për të kryer detyrat e ngarkuara. Të jesh kryeinxhinier, ekonomist, agronom para së gjithash do të thotë që të shqetësohesh për të kryer funksionin që të është besuar. Dhe këtë funksion nuk e realizon dot mirë po nuk aktivizove dhe po nuk u kërkove llogari për punën punonjësve që ke në varësi dhe që janë kapabël. Në rrethet punonjësore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia, që janë një masë e ngritur, me eksperiencë të pasur, me kualifikim të lartë ose të mesëm. Edhe të rinjtë, që mund të mos kenë shumë eksperiencë, prapë kanë nivel arsimor dhe teknik të kënaqshëm. Tërë kjo masë punonjësish duhet udhëhequr, edukuar dhe organizuar. Këtë punë me përgjegjësi të madhe e drejtojnë kuadrot e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë në rreth.

Në nivelin e punës që bëhet në këtë drejtim, duhen kërkuar edhe shkaqet e të metave që konstatovti. Ramiz, në Vlorë, të cilat, ku më shumë e ku më pak, ndeshen edhe në rrethet e tjera. Në Vlorë ka

mijëra kuadro me arsim të lartë, që punojnë në industri dhe në bujqësi. Atje ka plot punëtorë që punojnë në ndërmarrjet dhe në ofiçinat e rrethit. Këta punëtorë kanë tradita të mira, se u bënë nga 15 ose nga 20 vjet që punojnë. Po ç'i shtyn disa prej tyre të jenë të padisiplinuar, të mungojnë në punë, të mos realizojnë planin, të mos përmirësojnë teknologjinë, të mos ngrihen politikisht? Punëtorët e ndërgjegjshëm dhe të dalluar në punë duhet të formojnë një bllok të çeliktë në ndërmarrje ose në kooperativë për t'iu kundërvënë dobësive, ata duhet të analizojnë të mirat e të këqijat dhe, me ndjenjën e përgjegjësisë së klasës, të vendosin që të mirat t'i përvetësojnë, kurse të këqijat t'i luftojnë jo vetëm në aspektin administrativ, por sidomos në aspektin politik-ideologjik.

Burokratizmi nuk është i shprehur vetëm në letra, ai zë vend sidomos në konceptet, në metodën dhe në stilin e punës. Aspekti burokratik në shkresat është gjëja më e vogël në krahasim me drejtimit e tjera. Kufizimi i luftës kundër burokratizmit vetëm në letrat dhe shkresat do të ishte një mbulesë e burokratizmit të vërtetë.

Burokratizmi përcaktohet, veç të tjerave, nga kuptimi i ngushtë, në prizmin personal, i interesave të ndryshëm, nga prirja drejt rehatllëkut, moskokëçarjes dhe mbylljes në vetvete, duke menduar: është më mirë të mos vete në këtë ose në atë mbledhje, se mund të më ngarkojnë me përgjegjësi, të mos u shpjegoj njerëzve detyrat që të mos hap telashe, të mos kontrolloj që të mos i prish qejfin njërit e tjetrit etj.

Pikërisht këtu, më duket mua, qëndron e keqja për mjaft kuadro që nuk e kryejnë detyrën.

Nuk është aspak mirë që të përdoret akoma një metodë pune e vjetër. Puna në zhvillim nuk mund ta durojë qëndrimin statik, prandaj që të drejtosh me sukses, duhet të vesh ta shikosh e ta kontrollosh punën vazhdimisht. Vajtja në bazë, te masat, shpeshherë nuk kuptohet drejt nga disa përgjegjës. Këto shfaqje janë të dëmshme dhe duhen luftuar nga ana e Partisë, organizatave shoqërore dhe e pushtetit në rreth.

Vlonjati ka treguar historikisht se është njeri i pushkës. Mirëpo atdheu kërkon që trimi i mirë të bëhet edhe punëtor i mirë i ndërtimit të socializmit. Të kuptohemi qartë, unë nuk dua të mohoj aspak që edhe në Vlorë punohet si kudo gjetkë, por është fakt se edhe atje ka shfaqje të indiferentizmit në kryerjen e detyrave në punë e në prodhim. Për ç'arsye ndodh kjo me këta njerëz kaq patriotë e të sakrificës? Natyrisht kjo është një sëmundje, kundër së cilës rrethi duhet të përqendrojë punën politike. Por, që ai ta përqendrojë punën në këtë drejtim, duhet që më parë të analizojë mirë gjendjen dhe të gjejë format e metodat e përshtatshme se si do ta forcojë këtë gjendje, se për këtë forcim nuk mjafton vetëm një vërejtje e përgjithshme. Udhëheqja e Partisë në rrethet të nxitë vullnetin e njerëzve dhe t'u bëjë thirrje atyre për të rritur sedrën revolucionare në punë.

Në kooperativat tona bujqësore shpesh ka formalizëm në punë. Ka formalizëm sepse nuk funksionoj-

në dhe nuk veprojnë gjallërisht këshillat popullorë të fshatrave të bashkuara në kooperativat dhe mbledhjet e përgjithshme të kooperativës, detyrë kjo që e kemi shtruar, por nuk e kemi kontrolluar si është zbatuar. Nuk mund t'u varen në qafë të gjitha punët vetëm kryetarit të kooperativës dhe sekretarit të byrosë së Partisë. Në krye edhe atje është Partia, domethënë është organizata-bazë e Partisë, kurse sekretari i byrosë është një rregullues i veprimtarisë së organizatës së Partisë.

Bashkimi i kooperativave bujqësore te ne nuk u bë për pakësimin e kontakteve të drejtpërdrejta me bazën, përkundrazi. Rrallimi i kontakteve me njerëzit e bazës nuk është qëndrim marksist. Shkëputja e kryetarit të kooperativës dhe e sekretarit të byrosë së Partisë nga baza ka rrezik të ushqejë kultin e personit të tyre. Në qoftë se kryetari i kooperativës mendon se nuk ka kohë të marrë kontakt me të gjitha brigadat e kooperativistët, sepse i duhet të drejtojë, ky mendim nuk është i drejtë. Kryetari të gjykojë nga ana marksiste se, për të drejtuar punët, nuk është i vetëm. Ai ka shumë kuadro të tjerë me vlerë, që duhet t'i aktivizojë për të drejtuar.

Kooperativa bujqësore është një ekonomi kolektive, që nuk i përket vetëm kryetarit, por të gjithë kooperativistëve kolektivisht. Kooperativa ka tre, pesë apo shtatë sektorë, që kanë drejtuesit e tyre, pastaj ajo ka edhe kuadrot teknike, që janë një mbështetje e madhe e saj dhe e kryesisë së kooperativës, e cila duhet të mbledhet shpesh. Këto mbledhje vërtet do

të heqin për pak kohë nga puna prodhuese disa njerëz, por kjo nuk dëmton, sepse mbledhjet e kryesisë i shërbejnë punës, ato vendosin në dobi të shtimit të prodhimit. «Dëmi» që mund të vinte nga këto mbledhje nuk është asgjë para humbjeve që i shkaktohen kooperativës nga ata kooperativistë që mungojnë në punë pa arsye. Këta 9, 10 apo 15 veta të kryesisë së kooperativës, vërtet mund të humbasin një ditë pune, por do të fitojnë ditë të tëra kur t'i vënë punët përpara. Në qoftë se ata veprojnë në bazë të parimit të kolegjalitetit dhe zgjidhin probleme me rëndësi, në qoftë se ata do të bëjnë mbledhje «me bukë», siç i themi, nuk humbasin asgjë, përkundrazi fitojnë shumë. Kryesia e kooperativës mund të luajë rol të madh, sepse në përbërje të saj janë zgjedhur njerëz të mirë, atje mund të thërriten në raport teknikët, agronomët, veterinerët dhe tërë brigadierët dhe, bashkë me ta, përcaktohen detyrat e stinës për shërbimet, për përmirësimin e tokave, për luftën kundër shpërdorimeve etj.

Dihet se kooperativa është një ekonomi kolektive socialiste e krijuar nga bashkimi vullnetar i anëtarëve të saj. Në qytet, ku kemi fabrika etj., etj., për drejtimin e punës së tyre kemi një komitet ekzekutiv të këshillit popullor, por edhe në fshat kemi këshillin popullor të fshatrave të bashkuara. Komitetit ekzekutiv të këshillit popullor në qytet i kërkohet të kontrollojë si punohet në fushën e industrisë, të tregtisë, të financës, të komunalet etj. dhe të marrë masat sipas kompetencave ligjore që i janë dhënë. Në fshat nuk i kërkohet këshillit popullor të fshatit apo të fsha-

tit të bashkuar që edhe ai të ndihmojë të kontrollojë e të marrë masa për zhvillimin e bujqësisë e të blegtorisë, për shtimin e prodhimit të drithërave të bukës, për forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativës, për thellimin e demokracisë kooperativiste, të thërrasë në raport përkatësisht brigadierin ose kryesinë e kooperativës bujqësore etj., etj.

Megjithëse me ligj edhe këshilli popullor i fshatit të bashkuar ka mjaft kompetenca, këto nuk ushtrohen si duhet nga ana e tij, sepse mbahen sytë vetëm te kryetari i kooperativës, i cili, në mjaft raste, nuk mban lidhje të rregullta me këshillin popullor. Po atëherë si do të drejtojë ky këshill dhe si do t'i raportojë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit për punët që kryhen dhe për ato që lihen mangët në kooperativën bujqësore? Këshilli popullor i fshatit të bashkuar ka shumë detyra që duhet të kryejë dhe që kanë të bëjnë me ruajtjen e administrimin e pronës, me problemet e financave e jo vetëm të kredive që jep shteti. Këshilli popullor i fshatit mbikëqyr punën e mësuesit, të mjekut e të shumë kadrove të tjerë që punojnë në juridiksionin e tij administrativ, ai ndihmohet në fushën e zbatimit të ligjeve edhe nga ndihmësgjyqtarët e nga prokurorët popullorë etj. Po nuk i kreu si duhet këto detyra këshilli popullor në fshat, atëherë organet lokale të pushtetit në bazë nuk mund të jenë shumë operuese. Kjo gjë është ngritur edhe në Presidiumin e Kuvendit Popullor, prandaj duhet riparuar *medoemos*.

Edhe në gjirin e këshillit popullor të rrethit ka

gjithë ato komisione që nuk aktivizohen kurdoherë në nivelin që kërkohet dhe, rrjedhimisht, nuk i kryejnë mirë detyrat, nuk i njohin e nuk i zbatojnë si duhet ligjet etj.

Të gjitha këto detyra që përmendëm nuk zbatohen mirë jo vetëm në Vlorë, por edhe në rrethe të tjera. Prandaj në këtë drejtim të bëhet kthesë, dhe nevojën e kësaj kthese, në radhë të parë, ta kuptojë Partia.

Aparati i Kryeministrisë është kryesisht për të kontrolluar organet lokale të administratës shtetërore për zbatimin e detyrave dhe të vendimeve. Por, sido që të punojë aparati i Kryeministrisë në këtë drejtim, pa ndihmën e Partisë nuk mund të ecet si duhet. Këto punë, natyrisht, nuk janë të ndara me thikë, por funksionet e caktuara nuk duhen ngatërruar. Partia udhëheq, por që të udhëheqë duhet të organizojë punën më mirë në bazë, t'i ngrejë më tej njerëzit politikisht e ideologjikisht, të vërë në lëvizje organet kompetente që të kontrollojnë punën dhe t'i bëjë ato të ndërjegjshme për këtë kontroll. Kur organizata e Partisë konstaton që normat nuk realizohen, t'i thotë organit shtetëror përkatës ta studiojë këtë problem që të vihet në vend si duhet zbatimi i normave. Po kështu, kur vërehet se s'ka disiplinë, organizata e Partisë të kërkojë që të vendoset disiplina.

Partia të punojë që t'i edukojë njerëzit me ndjenjën e disiplinës, por zbatimin e disiplinës shtetërore në punë ta kërkojë organi i pushtetit. Kështu të veprohet, me radhë, për të tëra. Komiteti i Partisë i rrethit duhet ta njohë problemin që, lidhur me të, të

mund të ndërtojë drejt punën politike, por ai nuk duhet t'i marrë funksionet komitetit ekzekutiv dhe të lërë pas dore anën politike. Ana politike dhe ideologjike e problemeve ka raste që neglizhohet për arsye se sekretari apo sekretarja e Partisë flasin vetëm për rendimentet. Ata futen në probleme që nuk u takojnë dhe nuk shohin, për shembull, nëse kryetari i komitetit ekzekutiv i kontrollon dhe a i mbledh shefat e seksioneve.

Edhe ne, si aparat i Komitetit Qendror, kemi përgjegjësi për këto dobësi. I njohin instruktorët tanë të metat që vihen re në punën e organeve lokale të pushtetit, apo nuk i njohin? Unë them se ata i dinë këto të meta; dobësitë i dinë edhe komitetet e Partisë, edhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve bashkë me seksionet e tyre. Po pse atëherë nuk zbatohen si duhet detyrat? Nuk zbatohen për arsye se edhe instruktorët tanë ruajnë një dozë rutine në punën e tyre. Edhe në punën e organeve të pushtetit ka rutinë, metodë e stil të vjetër, pra ka të meta. Anët pozitive në punën e organeve të pushtetit janë më të mëdha se anët negative. Për këtë nuk ka asnjë dyshim. Por, në qoftë se një fenomen negativ bëhet i përgjithshëm në një rreth dhe nuk merren masat e përshtatshme, efikase, për ta luftuar, një gjendje e tillë e dobëson pushtetin tonë. Nuk mund të pretendojmë që të metat në punë të zhduken të tëra menjëherë dhe plotësisht, se kjo do të ishte diçka ideale, ajo që kërkohet është që të metat të shkojnë vazhdimisht duke u kufizuar.

Këtë vit e realizuam më mirë se vjet planin e prodhimit të grurit. Shumë bukur, por, kur shohim që nga mijëra hektarë merren nga 45 ose nga 50 kuintalë grurë, lind pyetja: sa grurë do të merrnim sikur të pakësoheshin të metat që vihen re në disa ekonomi, sikur në to të ishte treguar një kujdes më i madh nga ky që është treguar, sikur atje puna të ishte më e organizuar sesa është, sikur të vritej mendja më shumë nga ç'po vritet tashti? Në këtë drejtim duhet të ngulim këmbë. Nuk kërkohet të shpikim gjëra të reja, se të tëra këto që themi janë të ditura e të thëna shumë herë, por të zbatohet mirë ajo që kërkohet.

Si është e mundur që në një ndërmarrje, ku ka, për shembull, 300 punëtorë, ku ka 40 komunistë, ku ka gjithë këta të rinj e të reja, të ketë njerëz që vjedhin?! Vallë tërë këta njerëz, që shohin shumë të meta në punë dhe ankohen deri edhe në Komitetin Qendror, nuk shikojnë ç'bëhet rreth tyre, nuk shohin edhe shokun me të cilin punojnë për të evituar veprimin e dënueshëm të tij? Kur mbyllen sytë para veprimeve të tilla kjo tregon se në atë kolektiv nuk janë kuptuar mirë normat e Partisë, nuk janë futur thellë në njerëzit edukata politike dhe ideologjia e Partisë. Po pse ndodh kështu? Sepse mendohet që shumë gjëra dihen mirë nga drejtuesit edhe kur ato, në fakt, nuk dihen. Nuk merret mundimi që të përsëritet ajo që dihet ose të vritet mendja për të gjetur një formë të re pune e lufte kundër të metave.

Ndër të tjera duhet tërhequr vëmendja se mate-

rialet e ndryshme që boton Partia nuk duhen lexuar thjesht për të kënaqur kuriozitetin, por që të shfrytëzohen në dobi të punës. Këto materiale, si fjalime, artikuj etj., që botohen, pasqyrojnë eksperiencën e Partisë sonë. Komunistët e kuadrot duhet t'u kthehen materialeve të botuara më parë, sepse në to trajtohen probleme që do të vazhdojnë të jenë në qendër të vëmendjes së Partisë e të shoqërisë sonë, si mund të edukohet njeriu i ri, si mund të ndryshohet mentaliteti i fshatarëve dhe i malësorëve, si mund të kuptohen thellë lufta e klasave, zbatimi i vijës së masave, lidhjet e Partisë me masat, edukimi individual, edukimi kolektiv etj. Të gjitha këto çështje trajtohen në materiale të ndryshme të Partisë sonë, por atyre nuk u kthehem sa duhet për t'i studiuar e ristudiuar.

Duhet insistuar shumë në përmirësimin e punës së Partisë për edukimin e njerëzve, se kjo punë ka rëndësi të madhe për të ecur përpara.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1978-1979», f. 312*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1978-1979», f. 312*

## **NË PUNËN E PARTISË TË JEMI SA MË KONKRETE**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**9 tetor 1979**

*Në fillim të takimit shoku Hekuran Isai informoi rreth zhvillimit të Konferencës së 22-të të Partisë të rrethit të Fierit dhe problemeve që u trajtuan aty. Pas disa ndërhyrjeve, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Është e domosdoshme, është në vijën e Partisë që në krye të udhëheqjes së çdo instance e të çdo sektori të vëmë njerëzit më të zotë dhe të mos nise-mi nga familjariteti, nga konsiderata sentimentale e subjektiviste. Në këtë çështje duhet të qëndrojmë në pozita realiste, për të mirën e punës e jo për të mos i prishur qejfin njërit ose tjetrit. Dhe dihet që, po i prishe «qejfin» punës, nuk je në rrugë partie.

Në konferencat e Partisë në rrethe si në raportet e mbajtura, ashtu edhe në diskutimet, preken shumë çështje, por pikërisht për ato që janë hallka të rëndësishme për realizimin e prodhimit, ka raste që nuk

flitet. Zakonisht nëpër diskutimet jepen thjesht konstatime, kurse shkaqet e mosrealizimeve as që përmednen fare, gjë që në këto konferenca është e domosdoshme të bëhet. Pikërisht, duke folur edhe për realizimin e planit është mirë të theksohet se ku ka çaluar puna që nuk janë plotësuar të gjitha detyrat e shtruar, të dalë mirë përgjegjësia si individë dhe si forum dhe mbi këtë bazë të gjykohet se ç'duhet bërë për ta shëndoshur gjendjen e krijuar.

Mosrealizimet e planit janë mosrealizime dhe nuk duhen nxjerrë si shkak për këto përvetësimi i pronës, siç bëjnë disa. Vjedhja është një problem tjetër, por nuk ka si të mbulohet mosrealizimi i planit me të. Të dyja këto dukuri janë negative dhe, natyrisht, kanë shkaqet e tyre, e kanë burimin në psikologjinë e njerëzve, por edhe në punën e dobët edukative, politike, ideologjike që bëhet me ta. Në to ndikojnë edhe mungesat në anët teknike, edhe dobësitë në organizim e në kontroll.

Për këto çështje kemi diskutuar e kemi folur vazhdimisht, udhëheqja e Partisë ka dërguar në bazë edhe letra, por, me sa duket, ato trajtohen në sipërfaqe, nuk ngulet këmbë që të bëhen ballafaqime konkrete të gjendjes në organizatën-bazë, në kolektiv dhe te çdo individ me ato që thuhet aty. Prandaj më duket e panevojshme të nxjerrim ndonjë letër tjetër, por them që organizatat e Partisë t'u kthehen dokumenteve të Partisë për këto probleme, t'i studiojnë në mënyrë të organizuar dhe në mënyrë individuale dhe pastaj në bazë të tyre të bëjnë analizën e punëve dhe

të gjendjes konkrete. Kush i ka penguar organizatat e Partisë, organet e pushtetit, apo organizatat e masave të organizojnë studimin e ballafaqimin me këto dokumente të Partisë? Askush. Është Partia ajo që duhet të jetë në krye të kësaj pune dhe që duhet t'i drejtojë, t'i përgjithësojë përvojat e mira, të organizojë e të realizojë luftën kundër shfaqjeve të huaja. Kjo, pra, është një detyrë e saj.

Nga të gjithë vihet re që ka raste të përvetësimit e të shpërdorimit të pronës, po se çfarë duhet bërë për të krijuar një ambient mbytës, frenues për të tilla veprime, nuk e vret shumë mendjen njeri, ia dërgojmë edhe gjyqit ata që vjedhin dhe mjaftohemi me kaq. I humbet ndonjërit një bagëti apo ku e di unë çfarë tjetër dhe bëhet kontroll gati në tërë fshatin. Po ç'është kjo?! Kjo është shkelje e demokracisë. Kurse kur është fjala për vjedhjet nëpër ndërmarrje a kooperative nuk bëhet çështje, nuk flet njeri.

Ne i konstatojmë këto gjëra. Mirëpo, duke i parë çështjet në përgjithësi, kur konstatojmë e s'bëjmë gjë, dalim në sokaqe të tilla që janë pa krye. Po si do t'i ndreqim të metat që konstatojmë? Për këtë duhet vepruar, se nuk mjafton vetëm të konstatojmë e të themi që «unë mendoj», «ne kemi menduar kështu», «Partia ka menduar kështu». Problemet që dalin, duhet të zgjidhen aty ku dalin dhe kur dalin. Çështja shtrohet që t'i mësojmë njerëzit tanë të mos merren me llafe, por të veprojnë konkretisht për zbatimin e orientimeve, të vendimeve e të udhëzimeve. Pra, kërkohet punë konkrete. Kjo duhet të bëhet metodë pune e

Partisë, e organizatave dhe e organeve të saj, e aparateve, si në qendër edhe në bazë, metodë pune e Qeverisë, e ministrive dhe e komiteteve ekzekutive. Sepse nuk shoh të merren masa konkrete efikase organizative dhe administrative për zgjidhjen e këtyre problemeve shqetësuese që na ngjasin, për t'u vënë kufi dhe për t'i luftuar këto të këqija. Konkluzioni që nxjerr unë është se bëhet një punë e përgjithshme, pa u mbështetur në ato që ngjasin konkretisht në jetë. Po të lidhet ngushtë me problemet më akute, me realitetin konkret që i nxjerr këto probleme, puna e këtyre organeve e organizmave, atëherë medoemos do të kishim përmirësime.

Thuhet shpesh që oborri kooperativist bëhet pengesë për pjesëmarrjen në punë të kooperativistëve. Unë mendoj që nuk ka pse të ndodhë kështu. Është fare e qartë që në atë oborr aq të vogël nuk mund të punojë veçse një njeri, dhe jo gjithë ditën. Po në orët e ditët e tjera çfarë bën ai? Pra, shkak për mospjesëmarrjen e kooperativistit në punë nuk është oborri. Partia u ka lënë kooperativistëve oborrin për arsye se ai akoma është i nevojshëm. Edhe ajo që u tha se fshatari merr goxha të ardhura nga ky oborr, është e pabesueshme. Unë mendoj se oborri përmendet vetëm si një mbulesë për të fshehur faktin që bagëtitë e oborrit kullosin në arat e kooperativës.

Oborri kooperativist në parim dhe në praktikë duhet t'i shërbejë kooperativistit si një faktor ndihmës në përmirësimin e gjendjes e të jetesës së familjes. Kjo do të thotë që atje të prodhohen zarzavate,

foragjere, ca misër për të rritur pula në atë sasi që lejohet, për të mbajtur bagëti në numrin e caktuar etj. A e shohin me këtë sy problemin shokët drejtues të kooperativës dhe organizata-bazë e Partisë atje? Unë mendoj se për këtë problem nuk duhen mbajtur qëndrime të tilla siç bëjnë disa drejtues kooperativash, të cilët, ngaqë nuk janë në gjendje të përmirësojnë situatën në kooperativë, shprehin pikëpamje që parimisht nuk janë të drejta, duke ia hedhur të gjitha fajet oborrit vetjak e duke kërkuar heqjen e këtij oborri. Ata që veprojnë kështu nuk veprojnë as në interesin e fshatarësisë, as në interesin e Partisë. Por nga ana tjetër, në fshat duhet punuar me kooperativistin që ai edhe të mos e ndërpresë punën në kooperativë as të mos dëmtojë prodhimet e kooperativës nga bagëtitë e oborrit. Bile në rastet kur ai e dëmton kooperativën, të zbatohen rregullat e ligjet që kooperativisti ta zhdëmtojë, pra të mos mbahen qëndrime liberale.

Oborri do t'i mbetet kooperativistit se nuk shtrohet problemi që t'i hiqet, por në këtë rast t'i thuhet fshatarit se ai mund e duhet të shtojë punën në kooperativë.

Na thuhet se tufëzimi i bagëtive po bëhet në mënyrë «të shkëlqyer», kështu e ashtu. Por, kur shoh në një raport që më është dhënë me statistika për këtë çështje, mësoj se disa dhjetëra mijë bagëti të imëta (siç shkruhej atje, e zeza mbi të bardhën) janë dëmtuar nga kooperativistët, sepse ata nuk kanë dashur t'i tufëzojnë, duke pasur frikë se mos këto po u

kolektivizohen. Kjo do të thotë që vija e Partisë për këtë problem nuk po zbatohet në mënyrë «të shkëlqyer», siç na thuhet, ndryshe nuk do të ndodhnin këto fakte të hidhura. Të dëmtohen mijëra kokë bagëti të imëta, siç thuhet në raportin që m'u dha, kjo tregon se në ato rrethe Partia në këtë çështje nuk ka punuar mirë.

Nuk u shkon në mendje vallë njerëzve të Partisë e të pushtetit në fshat se si të veprojnë për këto probleme?! Mua më duket se ata nuk preokupohen sa duhet. Në asnjë mënyrë nuk duhet konfunduar çështja e oborrit kooperativist apo ajo e pjesëmarrjes në punët shtetërore për të dalë në konkluzionin që për shkak të tyre të ardhurat në kooperativë janë më të pakta nga të ardhurat e oborrit kooperativist.

Shteti ka nevojë që mirditori, për shembull, të punojë në minierë. Dhe ai do të punojë e mund të marrë edhe 800 lekë, apo edhe 1 200 lekë në muaj. Ky është shpërblimi që ai merr për punën e tij si punëtor, në bazë të ligjeve të vendosura nga shoqëria socialiste. Çështja tjetër është që gruaja dhe vajza e tij, për shembull, duhet të punojnë në kooperativë. Edhe ky është një problem, se në bazë të statutit kjo familje do të ketë edhe oborrin kooperativist. Por, jo siç thotë ndonjëri që pse ai është në marrëdhënie pune me shtetin, t'i heqim oborrin kooperativist. Që duke punuar në minierë, jeta e mirditorit është përmirësuar, ky është fakt dhe ne kënaqemi për këtë. Por ama nuk duhet të lejojmë pikëpamje që parimisht nuk janë të drejta. Ç't'i bëjmë mirditorit, t'i themi:

shko puno në kooperativë! Po ai ka tërë jetën që punon në minierë! Cilin të dërgojmë për të punuar atje?

Pra këto, më duket mua, janë probleme të rëndësishme ekonomike e politike që duhet të studiohen dhe të mos lihen kështu.

Çështja është që instruktorëve tanë këtu, në aparatet e Komitetit Qendror, u duhen shtruar e t'u bëhen të qarta këto probleme, pastaj t'u vihet si detyrë të rishikojnë e të ristudiojnë direktivat e Partisë në këto drejtime, zbatimin e të cilave ata të venë e ta shohin konkretisht në bazë. Pra, të kontrollojnë si i kanë kuptuar këto direktiva komiteti ekzekutiv i këshillit popullor dhe komiteti i Partisë i rrethit dhe si i zbatojnë në jetë. Kjo ka rëndësi të bëhet nga shokët tanë këtu. Ndryshe, pse janë instruktorë? Pikërisht për këto gjëra, që të ndihmojnë e të kontrollojnë zbatimin e udhëzimeve e të direktivave që ka dhënë Komiteti Qendror. Se ka komitete partie dhe komitete ekzekutive që këtë punë e bëjnë në mënyrë të çalë dhe nuk u hapin njerëzve në bazë horizonte pune, për të zhdukur të metat e për të përmirësuar gjendjen.

Këto janë probleme të punës së Partisë, të lidhura me jetën praktike, me realizimet e planeve ekonomike. Ashtu siç janë edhe problemet e punës ideologjike, të luftës kundër fesë. Partia e ka shpjeguar qartë se si është lidhur feja me jetën e njerëzve, me faktorët e shumtë të saj, me ndryshimet në mënyrën e jetesës e me zakonet. Feja ka lënë gjurmët e saj në ndërgjegjen e njerëzve dhe në zakonet e tyre. Që

të zhduken këto gjurmë do të duhet të kalojnë akoma disa breza dhe kjo jo me qëndrime apatike, po me një punë të dendur politike, duke shpjeguar rrezikshmërinë e fesë në këto çështje. Prandaj, për çrrënjosjen e tyre duhet punuar vazhdimisht nga Partia e nga të gjitha organizatat e masave.

Kështu mund të themi edhe për shfaqjet e lokalizmit. Shoqëria jonë socialiste nuk mund t'i pranojë këto, ajo nuk mund të ecë përpara me të tilla mbeturina. Në socializëm është bërë një përzierje e familjeve dhe e njerëzve nga rrethe e zona të ndryshme të vendit. Djali apo vajza e sarandjotit ose e gjirokastritit shkojnë për të punuar në Pukë, për shembull, ku krijojnë familje dhe vendosen atje përgjithmonë. Dhe anasjelltas, pukjani shkon punon në Ballsh apo gjetkë në Jug, ku edhe mund të qëndrojë për ngahera. Pra, nuk ka ndonjë problem këtu, jemi shqiptarë të gjithë, nuk ekzistojnë më dasitë e dikurshme në toskë e gegë; te ne sot ka vetëm shqiptarë. Ka vetëm një popull, që është populli shqiptar, dhe një minoritet, që është minoriteti grek, të cilin e njohim si të tillë. Prandaj është e nevojshme të gjenden rrënjët e shfaqjeve të lokalizmit, të cilat janë shumë të dëmshme, ndaj dhe duhen luftuar.

Mendoj se për këtë vendimtare është puna që bën e duhet të bëjë Partia, e cila nuk mjafton vetëm të konstatojë, por të shohë se aty ku diçka nuk ecën, të ndërhyjë, të ngrejë opinionin në këmbë që ta rregullojë gjendjen. Nuk duhet të ecim me mendimin se në të kaluarën ai që ishte më trim, ishte për pushkë dhe

punonte më pak. Një mendim i tillë, që në ndonjë zonë të vendit tonë ka lënë gjurmë, nuk është i drejtë. Nuk ka qenë dhe nuk është kjo në karakterin e shqiptarit. Në Myzeqe, fjala vjen, ku njerëzit ishin të shtypur, ishin dhe janë shumë të lidhur pas tokës, pas punës, prandaj s'ka pse të mos ecin të tërë përpara.

Me sa duket ndihet se në disa rrethe dhe ekonomi ka një farë vetëkënaqësie për realizimet, rendimentet, të ardhurat që marrin. Kjo është e dëmshme, shokë, se të vë në qetësi, në gjumë. Por nuk ndodh kudo kështu. E theksova dhe po e ritheksoj që këtu kryesore është puna e Partisë, çështja e organizimit dhe e kontrollit, është çështja se disa organizata-bazë partie nuk janë si duhet në rolin e tyre udhëheqës. Këto, mendoj unë, duhet të analizohen nga Partia dhe pastaj të dilet në disa probleme tipike ideologjike, politike e morale për të cilat duhet ndërtuar një punë e menduar politike, sqaruese e bindëse.

Nuk është e mjaftueshme që sekretari i organizatës-bazë të Partisë në një kooperativë të bashkuar, për shembull, t'i thotë brigadierit apo ndonjë shoqeje të organizatës së rinisë që t'u lexojë kooperativistëve gazetën çdo mëngjes për pesë ose shtatë minuta. Mirë, edhe gazeta duhet të lexohet, po çështja është që sekretari ta vrasë mendjen më shumë duke e parë gjendjen e kooperativës në këtë prizëm: pa të shoh me ç'brumë kam të bëj unë në kooperativën time, ç'njerëz janë, nga kanë ardhur, si shkojnë me njëri-tjetrin, ku ka prapambetje, në ç'sektorë e pse të ketë prapa-

mbetje; të mendojë çfarë pune duhet të bëjë që njerëzit t'i bashkojë në një unitet të fortë dhe të zhduket fryma lokaliste që ekziston, të zhduken konceptet që frenojnë unitetin. Pikërisht në këto drejtime e gjen armiku shtegun që të punojë.

Për të gjitha këto probleme ideologjike e politike t'u shkojë mendja kuadrove të Partisë që të ndalen seriozisht e të ndërtojnë një punë politike e ideologjike, të tillë siç e vura në dukje, që të kuptojnë se këto marrëdhënie përbëjnë jetën politike të popullit dhe kontribuojnë në unitetin e kombit.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

## **VËNIA NË SHFRYTËZIM E NJË PUSI NAFTE ESHTË GËZIM I MADH**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**12 tetor 1979**

Puset që po vihen në shfrytëzim janë puse fontane, por duhet të mbahen në një regjim normal e të jenë nën kontroll, që të shfrytëzohen si duhet. Për këtë arsye, shokët e Partisë atje duhet të organizojnë një cikël temash edukimi tekniko-politike me punonjësit e puseve të kësaj fushe, gjerësinë dhe debitet e ardhshme të së cilës akoma nuk i dimë. Puset që janë në shfrytëzim tani duhet t'i mbajmë në një regjim të rreptë shkencor, që të evitojmë avaritë e ndryshme në to. Drejtuesit e punës së Partisë atje dhe personeli teknik të mos mendojnë se i dinë të gjitha problemet e disiplinës e të kontrollit shkencor, se, kur vjen puna për të parë gjendjen konkretisht, del që disiplina e kontrolli çalojnë dhe puset bien në avari, siç ka ndodhur, sepse regjimi i tyre ndryshohet.

Në këtë drejtim duhen marrë masa që tani, të

cilat të planifikohen mirë. Është tjetër gjë të vesh atje me duar në xhepa e të thuash disa fjalë dhe është një gjë tjetër të studiosh dhe të përcaktosh masa në mënyrë shkencore. Fjalët mund të vlejné e shumta si një orientim, vetëm për punonjësit e kësaj fushe, por masat e studiuara vlejné më tepër. Njerëzit, që punojné në naftë, i njohin mirë këto çështje, por, nganjëherë, ndodhin të papritura se shkelen rregullat, gjë që tregon se atje ka liberalizëm në kontrollin e zbatimit të detyrave.

Kjo fushë, për të cilën po flasim, është e njohur, prandaj shfrytëzimi i saj duhet të na japë shtesë. Por ne nuk duam lajme të mira vetëm për pusë të veçanta, që të na thuhet, për shembull, se ky ose ai pus dha këtë apo atë rezultat. Ne tani, në bazë të të dhënave shkencore, themi që pusët do të na dalin mirë. Derisa rezultojnë që një pus, në thellësinë, fjala vjen, 3 000 metra na jep naftë, atëherë edhe pesë pusë aty pranë do të japin.

Punonjësve të naftës u del detyrë që pusët ndërmjetëse të shpohen në rregull, pa avari, me shpejtësi dhe me shpenzime të pakta. Ky është shtesë që kërkoi tani Partia. Që të japë prodhim një pus, nuk ka asgjë për t'u çuditur, por që të ngjasin tri avari në pusët e tjera këtë s'e presim. Po ndodhi kështu, kjo tregon se puna nuk është në rregull. Ne kemi shumë pusë e, në qoftë se na bien edhe këto në avari, atëherë fondet do t'i harxhojmë për eliminimin e këtyre авариве.

Të gjithë e dimë sa kohë na u desh për të vënë në shfrytëzim këto pusë. Po nga vjen kjo vonesë? Unë besoj

se llogaritë nuk duhet të jenë bërë keq, së pari, se kjo fushë tashti është e njohur; së dyti, se ana strukturore e saj gjithashtu dihet dhe sondat i kemi. Atëherë, gjithë puna është që shpimi të fillojë me kujdes, të bëhet në rregull, pa avari dhe brenda kohës së caktuar. Kjo është një detyrë me shumë rëndësi. Vënia në shfrytëzim e një pusi që jep rezultat, është një gëzim i madh për secilin nga ne, se energjetikës sonë i shtohet një debit i ri, por, që ky ose ai pus në zonën e zbuluar duhet të japin, kjo gjë është e njohur nga të gjithë.

Tani është e nevojshme të zbulojmë lidhjet e fushave me njëra-tjetrën. Kjo njohje, që po e përmendim ngaherë, ka rëndësi shumë të madhe. Të dhënat nga pusët duhet të shërbejnë për të gjetur këtë lidhje, prandaj të vëzhgohen sondat me një kujdes të jashtëzakonshëm. Partia, në sektorin e naftës dhe specialistët e këtij sektori, t'u rrinë mbi kokë këtyre punëve që hapin perspektivë të madhe për ekonominë tonë. Në këtë drejtim të na japin shtohet e jo për pusët në këtë fushë, që duhet të punojnë normalisht.

Në fushat e naftës ka gjithashtu rëndësi konturimi, i cili duhet të bëhet siç kemi thënë dhe të mos harrohet që bazën kryesore e përbën shpim-kërkimi. Në dhënien e një pusi për konturim edhe mund të gabohemi dhe të themi që këtu nuk ka naftë, e cila mund të jetë disa kilometra më tutje. Çështja varet shumë nga studimi dhe projektimi i puseve, duke marrë parasysh thyerjet tektonike të tokës, në këtë apo në atë zonë. Ky është drejtimi ku duhet të përqendrohet e të shtohet kujdesi i shokëve tanë të naftës. Kujdesi, natyrisht,

nuk tregohet vetëm me fjalë, por edhe me mjete, të cilat të jenë kurdoherë në gatishmëri.

Duhet të fitojmë kohë jo vetëm nga shpejtësia e sondës, por edhe nga vendosja, zhvendosja dhe riparimi i saj. Sa më shpejt të bëhen këto, aq më shumë kohë fitojmë. Manovrimi i sondës dhe mungesa e avarive shpejtojnë shpimin dhe shfrytëzimin e fushës së naftës.

Ashtu si çdo gjë që ka të papriturat e saj, edhe fushat naftëmbajtëse, ca më tepër, kanë të papriturat e tyre. Unë mendoj se specialistët e Institutit të Naftës duhet t'i marrin çdo ditë të dhënat e puseve që shfrytëzohen dhe këto të mos i marrin thjesht për të mësuar sa dha e sa nuk dha sot ky ose ai pus, por që të shohin perspektivën.

Mjeku, para se të përcaktojë diagnozën, bën shumë pyetje e sondazhe, i vë edhe termometrën të sëmurit për të vërejtur çfarë temperature ka, bën analiza etj. dhe nga këto ai zbulon sëmundjen dhe shkakun e saj. Edhe për naftën kështu duhet të veprohet. Në qoftë se një pus ul debitin, ekipet e studimit ta marrin në analizë këtë çështje, për të gjetur arsyet pse po na bie ky debit, pse ndodh ky fenomen, ç'ka ngjarë. Kështu duhet vepruar kur në një moment vërehet që gazi ose nafta shtohet apo pakësohet, ose kur del ujë. Në një rast të tillë të shihet edhe pusi tjetër pranë që ka një debit iks, dhe pusi me një lartësi më të madhe, që ka një debit iksilon. Nga krahasimi i të dhënave të shtrohet pyetja: pse ka ngjarë kjo rënie dhe duhet apo nuk duhet të ngjasë? Unë besoj se një ekip i tillë studiuesish për

naftën dhe gazin duhet të ekzistojë dhe të funksionojë. Dhe, në qoftë se ekziston, siç thoni ju, shokët që punojnë atje ta bëjnë si duhet punën dhe të mos ndodhë që të na vijnë një mëngjes e të na thonë: «U mbush kolona me ujë, u inonduan puset, ndodhën këto ose ato defekte». Ne do të parashikojmë që edhe mund të inondohen këto puse, por parashikimin ta bëjmë me kohë, që të marrim masat e nevojshme, duke praktikuar metoda dhe mjete që, me ndërgjegje, ta ulim debitin atëherë kur duhet. Ka një sërë masash që duhet të merren, të cilat, unë, natyrisht, nuk i di si specialistët, por në parim mendoj që kështu të vepron.

Specialistët, nën drejtimin e Partisë, të parashikojnë nëse një fushë, për shembull, do të inondohet apo jo. Në rast se po, duhet parashikuar se pas sa vjetësh do të inondohet dhe pse të inondohet? Organizata e Partisë në naftë ka eksperiencën e saj për inon-datat nën tokë.

Një seksion i veçantë në këtë sektor të merret jo vetëm me problemin e naftës, por edhe me problemin e ujërave nëntokësore; të bëjë sondazhe dhe studime për ujërat, me qëllim që të nxjerrë konkluzione për naftën, por, njëkohësisht, edhe për lëvizjen e ujërave. Ka ligjësi për lidhjet që ekzistojnë midis rrjedhës së ujërave, reshjeve, strukturës së tokave, moshës së tyre etj. Por këto ligjësi duhen zbuluar në terrenin konkret se nuk janë kudo të barabarta. Ato kushte që mund të gjesh, për shembull, në Sahara, nuk i gjen dot në Kaliforni, se tjetër është këtu përbërja e tokës,

mosha e saj, sasia e reshjeve etj. Prandaj kërkohet eksperimentimi, që ka rëndësi për debitet e puseve, për jetën e tyre.

Në qoftë se do të futet ujë për metodat e dyta e intensifikuese, më përpara duhet mësuar ka apo nuk ka ujë atje, a mund të merret ujë që andej apo jo. Nuk di në qoftë se bëhen studime të tilla, por ne, këto, duhet t'i vëmë në rrugë të mirë e frytdhënëse. Për studime edhe mund të jetë menduar, por unë theksoj këtu rëndësinë e tyre dhe nevojën që kemi për to.

Po të studiohen seriozisht metodat e dyta dhe intensifikuese, po të jepen fonde për makineritë që duhen e për të tjera, do të kemi mundësi të rritim nxjerrjen e naftës. Për këto metoda fushat i kemi të njohura se sa naftë kanë brenda, me ç'forcë dhe me ç'përqindje mund ta nxjerrim naftën prej tyre. Për mendimin tim, këto metoda janë po aq të rëndësishme sa edhe shpim-kërkimet, të cilat deri tani na kanë kushuar shtrenjtë.

Që të zgjidhen këto çështje, duhet që pusët të përbëjnë objektin e një vëzhgimi të përhershëm, që nga dhënia e pikës së shpimit e deri në marrjen e pikës së fundit të naftës. Por kam bindjen se shpesh nuk veprohet kështu. Problemi i naftës është jashtëzakonisht delikat e serioz. Shkenca që studion këtë fushë është shumë e ndërlikuar dhe neve nuk na mungojnë njerëzit që e njohin mirë këtë shkencë. Megjithatë, duhet të themi që kuadrot tanë, të këtij sektori, kanë nevojë të mësojnë akoma, se në radhët e tyre ka raste që vërehet një indiferentizëm në këtë drejtim, vërehet mungesë

zelli për të studiuar teorinë, por edhe për të mësuar nga praktika e përditshme. Nuk duhet harruar se nga praktika njeriu mëson shumë, mirëpo pikërisht në këtë drejtim ka neglizhencë.

Këto shfaqje duhet t'i shikojë Partia në sektorin e naftës dhe jo vetëm t'i shikojë me kujdes, por edhe të programojë punën studimore, ta nxitë, ta kontrollojë dhe të mos lejojë kurrë që të veprohet kuturu, në 'ym.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda e  
incizuar, që gjendet në AQP*

# TE RRËNJOSIM THELLË NDJENJËN E KURSIMIT PËR ÇDO PIKË NAFTË E PËR ÇDO GRUSHT QYMYRGURI

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

13 tetor 1979

Problemi që shqyrtojmë sot në këtë mbledhje të Byrosë Politike, lidhur me bazën energjetike të vendit, rrugët për rritjen e fuqizimit të mëtejshëm të saj, përdorimi me kursim dhe shtimi i eksportit, ka qenë dhe mbetet një ndër problemet kyç me rëndësi kapitale për zhvillimin aktual e perspektiv të ekonomisë sonë socialiste, për forcimin e pavarësisë dhe të aftësisë mbrojtëse të atdheut. Baza energjetike është ajo që ndihmon për të vënë në lëvizje mekanizmat prodhues, për të transformuar e për të vënë në qarkullim eko-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth studimit kompleks të problemit të lëndëve djegëse energjetike, naftës, gazit, qymyrgurit e hidroenergjisë dhe për masat që duhen marrë për shtimin e prodhimit, për kursimin dhe mundësitë e shtimit të eksportit, paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

nomik burimet e lëndëve të para e pasuritë e tjera natyrore, për të zhvilluar e për të fuqizuar transportin dhe të gjitha degët e tjera të ekonomisë. Pa energji nuk ka zhvillim, nuk ka përparim të forcave prodhuese. Është kjo arsyeja që Partia dhe shteti ynë e kanë parë dhe duhet të vazhdojnë ta shikojnë edhe në të ardhmen me precedencë problemin e zhvillimit e të fuqizimit të kësaj baze, duke i dhënë asaj ritme më të shpejta zhvillimi në krahasim me degët e tjera të ekonomisë, sepse vetëm kështu i paraprihet dhe i hapet rrugë e gjerë zhvillimi ekonomisë sonë socialiste, garantohet ecja e saj e sigurt dhe e pandërprerë përpara.

Ne po e shohim qartë se ç'luftë e ashpër po bëhet sot në botë për naftën, se çfarë krize e rëndë energjetike, e pleksur me atë politike, ekonomike, ushtarake, të strukturës e të superstrukturës, e ka mbërthyer për fyti botën kapitaliste e revizioniste.

Prioriteti i rendit tonë socialist duket qartë edhe në këtë fushë. Në sajë të vijës së drejtë të Partisë ne jo vetëm nuk vuajmë nga ajo e ashtuquajtur uri e energjisë, siç ndodh në vendet e tjera, por, përkundrazi, kemi arritur të sigurojmë një bilanc pozitiv të energjisë, që plotësojmë nevojat e vendit dhe pjesërisht edhe eksportojmë. Me perspektivat që ka çelur Partia, vendi ynë ecën i sigurt edhe në këtë fushë. Nga ajo çka ndodh në botë, ne nxjerrim edhe një herë konkluzionin se sa e drejtë ka qenë dhe mbetet vija e përgjithshme marksiste-leniniste e Partisë sonë për ndërtimin socialist, për zhvillimin e ekonomisë e të bazës energjetike dhe pse armiqtë tanë, të brendshëm

e të jashtëm, kurdoherë, në synimet e tyre për të na dëmtuar e sabotuar në ekonomi, në epiqendër kanë pasur industrinë e naftës dhe degët e tjera energjetike e të industrisë së rëndë.

Prandaj, në qoftë se ne e shqyrtojmë dhe e diskutojmë me kujdes e vëmendje të përhershme këtë problem, e bëjmë duke u nisur nga pikësynimi si ta zhvillojmë e ta fuqizojmë më tej këtë bazë energjetike, si t'i presim rrugën shpërdorimeve e qëndrimeve të pakujdesshme dhe antiekonomike, si t'i shfrytëzojmë më mirë koniunkturat e krijuara në tregun ndërkombëtar për të rritur më tej eksportin edhe nga kjo degë e rëndësishme e ekonomisë sonë.

Partia nuk duhet të lejojë të krijohet tek askush mendimi se ne notojmë mbi naftë e shkelim mbi qymyrguri. Përkundrazi, tek të gjithë të rrënjosim thellë ndjenjën e kursimit për çdo pikë nafte e për çdo grusht qymyrguri. Secili ta ketë mirë të qartë se ato nxirren me shumë mund, djersë e sakrifica dhe se nga shtimi e përdorimi i tyre me kursim të rreptë varen në një masë të madhe zhvillimi e fuqizimi i vendit, forcimi e çelikosja e aftësisë mbrojtëse të atdheut. Prandaj, ashtu siç duhet punuar e luftuar për shtimin e prodhimit të naftës e të gazit, të qymyrgurit e të energjisë elektrike, më shumë akoma duhet punuar për përdorimin me kursim të tyre.

Duke i parë problemet me këtë sy, mendoj se disa nga çështjet që trajtohen në material kanë nevojë të studiohen thellë, të zgjidhen më shpejt e në baza më shkencore.

**Disa çështje lidhur me shtimin e prodhimit.** Për sa i përket rritjes së rezervave dhe të prodhimit të natës, Byroja Politike dhe Qeveria kanë dhënë orientime e kanë caktuar detyra, të cilat duhet të zbatohen me rigorozitet të madh. Gjithashtu, në kushtet kur sasia e gazit që do të nxirret, do të rritet, kërkohet që të mënjanohet çdo humbje e të luftohet me rreptësi çdo pakujdesi për nxjerrjen e përdorimin e tij për nevoja teknologjike dhe për prodhimin e energjisë elektrike vetëm nga disa termocentrale, veçanërisht në periudhën e verës.

Në kushtet kur prodhimi shoqëror do të vazhdojë të rritet me ritme të shpejta, kur duhet zbatuar pa as më të voglin lëshim zëvendësimi i lëndëve djegëse të lëngëta me qymyrguri, duke menduar edhe për shtimin e eksportit, nevojat për qymyrguri do të rriten mjaft. Këto nevoja në rritje të plotësohen në dy rrugët: edhe duke shtuar prodhimin, por sidomos duke e përdorur atë sa më me kursim, duke pakësuar humbjet të prodhuesit, të transportuesit dhe të konsumatorët.

Është një gjë e madhe për ekonominë tonë që në qendrën kryesore industriale të vendit, në Tiranë, ndodhet pellgu më i madh qymyrguror. Në materialin e paraqitur, përveç vështirësive teknike e minerare të shtresave të këtij pellgu, na numërohen edhe disa të meta subjektive. Këto duhen luftuar dhe zhdukur me një organizim të fortë. Për sa i përket intensifikimit të kërkimeve edhe në Shqipërinë e Veriut dhe shfrytëzimit të disa rezervave paraprake që janë zbuluar në disa rrethe, përpara se të planifikohet hapja e minierave

të reja, duhet llogaritur mirë leverdia ekonomike dhe ku e përse do të përdoret ky qymyr.

Lidhur me shtimin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet, ne kemi diskutuar e kemi vendosur që të punohet për hidrocentralin e Komarit dhe për atë të Bushatit. Por më duket se këtu del një problem. Në sistem po krijohet një gjendje e atillë që prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet është përqendruar në një anë, në Veri, ndërsa konsumatorët më të mëdhenj janë në Shqipërinë e Mesme e në atë të Jugut. Duke harmonizuar leverdinë e prodhimit të energjisë elektrike edhe me furnizimin e garantuar të konsumatorëve dhe me rritjen e sigurisë në punë të sistemit në tërësi, ndoshta do të ishte e drejtë në të ardhmen që të studioheshin dhe të dilej me propozime konkrete për burimet hidrike dhe ndërtimin e hidrocentraleve edhe në lumin e Vjosës, ose në lumenjtë e tjerë të Shqipërisë së Mesme e të Jugut. Studimi i tyre është mirë të bëhet në kompleks, lidhur ngushtë edhe me shtimin e aftësisë ujitëse të fushës së Myzeqesë dhe të fushave të tjera, sepse, nga sa jam informuar, Shkumbini në verë sjell sasi më të vogla uji se aftësia e kanaleve që lidhen me të. Pra, krijohet një deficit i ndjeshëm, gjë që mund të kapërcehet, me zgjidhjen në kompleks të veprave hidroenergjetike edhe në këto zona.

Por, sikurse del edhe nga studimi i paraqitur, krahas detyrave të rëndësishme për shtimin e prodhimit, problemet më serioze dhe rezervat më të mëdha ne i kemi dhe duhet t'i kërkojmë e t'i zbulojmë në fushën e përdorimit e të konsumit të burimeve energjetike. Nuk

është gjithnjë i fortë dhe i pasur ai vend që prodhon shumë, por ai që edhe prodhon shumë e aq sa i nevojiten, e veçanërisht, që edhe di ta përdorë çdo gjë me nikoqirllëk. Rendi ynë socialist e ka në natyrën e vet kursimin, ai është ligj objektiv në shoqërinë tonë. Por nëse i përdor dhe i përfiton në shkallën e duhur ato epërsi, që krijon ky rend edhe në fushën e kursimit, kjo varet nga njerëzit, nga puna e Partisë, e organeve të pushtetit etj.

Përgjithësisht, unë jam dakord me rrugët që do të ndiqen tani dhe gjatë pesëvjeçarit që vjen për pakësimin e harxhimit të lëndëve djegëse, duke i zëvendësuar me gaz dhe duke ulur në maksimum firot dhe humbjet. Bile kam mendimin se problemi i lëndëve djegëse duhet parë akoma më mirë në drejtim të kursimit, duke i pasqyruar ato që në planin e vitit 1980, dhe, veçanërisht, në planin që po studiohet e po hartohet për pesëvjeçarin e shtatë.

Pse them se problemi duhet parë më mirë? Këtë vit janë bërë kurse, si në përdorimin e karburanteve dhe të energjisë elektrike e, megjithatë, siç po shohim, nga kjo, realizimi i planit të prodhimit industrial nuk u pengua; po kështu bujqësisë nuk i ka munguar furnizimi as me energji elektrike, as me karburantet e nevojshme. Kjo flet si për planifikimin me rezerva dhe për normativa të vjetruara të harxhimit të karburanteve e të energjisë elektrike, ashtu dhe për një luftë e përpjekje të pamjaftueshme për të kursyer. Kjo masë u mor nga lart dhe përgjithësisht u realizua, por, po t'i bëhet thirrje gjithë klasës punëtore e punonjësve që

të japin mendime e të gjejnë rrugë të reja për të kursyer më shumë karburante e energji elektrike, atëherë do të shohim se rezultatet do të jenë akoma më të mëdha. Këtë e vërteton edhe fakti se nga informatat që kam, lufta dhe përpjekjet nuk bëhen kudo njëlloj. Rreth të tilla, si Durrësi, Elbasani, Shkodra, Vlora dhe ndonjë tjetër, që janë dhe konsumatorë të rëndësishëm, jo vetëm që nuk luftuan si duhet për kursimin e energjisë elektrike, por morën edhe më shumë nga plani i shtetit.

Natyrisht, kur them se ka vend dhe duhet të bëhen më shumë kursime, duhet pasur kujdes që të mos kalohet në absurditete të atilla, siç ka ndodhur në TEC-et e Fierit, të Vlorës e të Cërrikut, që ua prenë fare karburantin edhe për automjetet e riparimit të avarive në sistem. Në vend që të bëhet kjo, pse nuk merren masa të rrepta dhe të ndreqet gjendja për fakte të atilla si ai i kthimit mbrapsht këtë verë të shumë kamionëve të mbushur me domate e fruta nga Porti i Durrësit, duke harxhuar kot karburantin?

E theksoj se problemi shihet me liberalizëm, për shembull, në justifikimet për humbjet që na ndodhin në qymyret te prodhuesit, në stacionet tranzite, te konsumatorët etj., etj. dhe nuk luftohet me këmbëngulje për të mos ndodhur këto humbje. Këto probleme vazhdimisht janë ngritur dhe shpesh i dëgjojmë të na përsëriten, por pak janë realizuar. Asgjë s'duhet të mbetet në letër, sepse çdo gjë mbetet në letra, kur nuk drejtohet zbatimi, kur nuk është kuptuar rëndësia politike, ekonomike dhe organizative e problemit. Të

gjitha ato probleme që ngrihen në material për qymyret janë të drejta, janë masa të mira. Por këto dihet, nuk i mësuam sot, atëherë pse nuk janë marrë masa më parë? Të ruhem nga «raportimet», nga «konstatimet». Këto t'i bëjmë, por rëndësi vendimtare ka t'i vëmë në jetë, se mjaft herë thuhet e përsëriten si zbulime të reja, si veza e Kolombit!

Në studim shtrohet problemi i punës që do të bëhet për përdorimin më të mirë dhe për mënjanimin e humbjeve të pajustificuara të naftës. Në kaldajat e në pajisjet që punojnë me naftë na thuhet se duke filluar nga gjashtëmujori i dytë i vitit 1980 do të kursehen naftë e produkte naftë 5 për qind të normave të sotme të harxhimit. Unë pyes, në ç'bazë ka dalë kjo përqindje? U bë ndonjë rishikim mbi kritere të shëndosha teknike e shkencore i të gjitha normativave ekzistuese të harxhimit të naftës e të produkteve të saj, apo është një gjë e llogaritur në mënyrë të përafërt? Këtu më duket se ka vend për t'u thelluar më tej, duke i marrë një nga një normativat e harxhimit të naftës e të produkteve të saj, duke mbajtur mirë parasysh përparimet në fushën e prodhimit, përvojat e përparuar, novacionet, që janë bërë nga disa shoferë e traktoristë, që kanë prodhuar edhe vegla apostafat për kursimin e karburanteve, por që në praktikë shohim një ngadalësim të pajustificueshëm në zbatimin e tyre. Përmirësimet cilësore që ka sjellë në nënproduktet e naftës vënia në shfrytëzim e Uzinës së Ballshit etj., etj. Pasi të studiohen të gjitha këto e faktorë të tjerë, atëherë mund të dilët edhe me rishikimin në ulje akoma më të mëdha

të normativave të harxhimit të naftës e të produkteve të saj dhe me këto normativa të reja teknike e shkencore të hartojmë edhe pesëvjeçarin e ri për këtë lloj karburanti.

Për sa i përket zbatimit të detyrës së shtruar nga Partia për zëvendësimin e lëndëve djegëse të lëngöta me qymyrguri në termocentralet, në kaldajat etj., mendoj se përveç atyre që punojnë dhe do të punojnë me gaz, të tjerat, duke përfshirë kaldajat e vogla, duhen zëvendësuar sa më shpejt me qymyrguri. Afati duhet të shkurtohet shumë. Po të punohet me këmbëngulje, vështirësitë kapërcehen. Në ndërmarrjet që i kanë këto kaldaja të evitohen shqetësimet që sjell ky ndryshim. Gjithashtu, të shpejtohet studimi i filluar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Minerave për mundësinë e përdorimit të energjisë elektrike në periudhën e dimrit në serrat që përdorin sot mijëra tonë naftë. Kjo do ta bënte shumë më të leverdishëm edhe prodhimin e perimeve të ndryshme në serrat, duke ulur shpenzimet për energjinë e çdo kilogrami disa herë.

Meqë ra fjala për serrat, dhe është shtruar detyra që të shtohet sasia e tyre, këtu, me sa duket, ka nevojë për një punë më me mend dhe më të studiuar. Nga sa jemi në dijeni, serrat e reja po mendohet të ndërtohen duke përdorur si lëndë djegëse qymyrguri. Po mund të ishte më e leverdishme që në periudhën e dimrit, kur kemi shumë ujë, mund të përdoret energjia elektrike. Siç thashë, kjo të studiohet dhe, pasi të eksperimentohet, të vendoset. Di, gjithashtu, se në vende të tjera, serrat

i ndërtojnë pranë termocentraleve që prodhojnë avull, siç është vepruar te ne në Cërrik, ose siç veprohet tani edhe në Elbasan. Po përse nuk u veprua kështu edhe në Tiranë apo gjetkë? Sikurse shihet, këtu ka disa probleme, që nuk u jepet zgjidhja më e drejtë e optimale, sepse veprojnë interesat dikasteriale, nga njëri dikaster varen TEC-et, nga tjetri serrat, transporti nga një dikaster tjetër e kështu me radhë. Ky organizim i domosdoshëm nuk duhet të thyejë unitetin, që ekziston në ekonominë tonë socialiste, të cilit duhet t'i përgjigjet kurdoherë edhe uniteti në drejtim. Ky unitet të gjejë zbatim në zgjidhjet më optimale që duhet t'u jepen problemeve. Përse i kemi dikasteret dhe Komisionin e Planit të Shtetit? Ato të ngrenë para Qeverisë më shumë probleme të tilla.

Tani që qymyrguri do të përdoret në mënyrë më masive si lëndë djegëse dhe për qëllime teknologjike dhe, kur sasi të tij do të rriten, kërkohet që të merren masa më të forta dhe në baza më shkencore në disa drejtime.

Në kushtet kur industria dhe zhvillimi i ekonomisë sonë kanë arritur në këtë nivel, del e nevojshme që qymyrguret tona të mos shikohen vetëm si lëndë djegëse natyrore, por me një kënd më të gjerë edhe si lëndë teknologjike për shkrirjen e metaleve me ngjyra, të gizës, hekurit e çelikut.

Është me leverdi të madhe për ekonominë tonë që qymyret e disa minierave kanë shumë pak squfur, sepse kjo na çel rrugën për t'i përdorur ato në metalurgjinë me ngjyra dhe të hekur-nikelit. Këto qymyre

nuk duhet të përdoren dosido, pa e caktuar mirë shkencërisht destinimin e tyre; veç kësaj duhet parashikuar edhe zgjerimi i këtyre minierave. Aq më tepër kjo duhet mbajtur mirë parasysh tani, kur Partia ka shtruar me forcë gjetjen e rrugëve për të pakësuar importimin e qymyreve të koksifikueshëm e të koksit. I njëjti proces po ndodh edhe me gazin. Në qoftë se para disa vjetësh gazi përdorej kryesisht për djegie, sot e në perspektivë ai përdoret e do të përdoret akoma më shumë edhe për disa lloje të tjera produktesh e plehrash kimike.

Me këtë lidhet ngushtë edhe problemi i rishikimit me sy kritik të rajonizimit më të mirë të përdorimit të qymyreve, duke marrë parasysh si destinacionin më të leverdishëm, për të cilin fola më lart, ashtu edhe shkurtimin në maksimum të rrezes së transportimit dhe të llojeve të transportit që do të përdoren. Këtu duhen llogaritje e të punojë më shumë kalemi, ndryshe harxhojmë kot jo vetëm mjaft mjete transporti, por edhe karburante.

Problem i rëndësishëm mbetet për vendin tonë çështja e pasurimit të qymyreve. Dihet se kudo në botë qymyret me kalori të ulëta e përzierje të tjera, siç janë mjaft qymyre të vendit tonë, përpara se të digjen, pasurohen, në mënyrë që të mos transportohen dhera e lëndë të tjera të panevojshme, si dhe të rritet vlera e tyre kalorifike. Në raste të tjera, pranë minierave me këto lloj qymyresh ngrihen termocentrale dhe, në vend që të transportohet qymyr, energjia transmetohet si energji elektrike. Ne edhe këtyre llogarive duhet t'u

futemi. Por, tani për tani, detyrë urgjente del çështja e pasurimit të mjaft qymyreve tona, pastaj le të shikohet edhe briketimi. Për këtë kërkohet të studiohet e të punohet më seriozisht në mënyrë që, me forcat tona, ne t'i shtojmë fabrikat e pasurimit si dhe të zgjerojmë kapacitetet e atyre ekzistueseve.

Problemi i cilësisë së djegies së qymyreve është një ndër çështjet më të rëndësishme në qoftë se duam, siç thotë populli, «të kapet demi për brirësh». Marrja dhe çlirimi i energjisë nga lëndët djegëse fillon me djegien e tyre, prandaj edhe kujdesi ynë këtu duhet përqendruar shumë më tepër se deri tani. Nuk po ndalem në atë se si ndodh sot në praktikë, sepse puna arrin deri aty sa nga mënyra jo e drejtë e djegies në disa kaldaja ndodh që 20-30 për qind e fuqisë kalorifike të mos shfrytëzohet për arsye se ai nuk digjet plotësisht, kurse lufta të bëhet për të marrë maksimumin e energjisë që përmban çdo lloj qymyri. Për këtë, përveç masave që parashikohen në studimin e paraqitur, duhet punuar më mirë sidomos në disa drejtime:

Kryesore këtu është të forcohet kontrolli për djegien me cilësi të lartë të qymyreve. Kjo punë sot i është lënë pothuajse spontaneitetit dhe është e decentralizuar, nuk ka një organ kontrolli të djegies, siç është, për shembull, dega e kontrollit të pajisjeve nën presion që vepron në shkallë republike ose ndonjë mënyrë tjetër kontrolli. Nga sa jam në dijeni, në qoftë se për disa termocentrale ka disa aparatura kontrolli dhe sektor që e ndjek, megjithëse dhe këtu ka vend për një përmirësim të mëtejshëm të punës, në kaldajat e tjera

që djegin më shumë se gjysmën tjetër të qymyrgurit, çështja e kontrollit të lëndës djegëse është pothuajse jashtë vëmendjes së drejtuesve. Ata e kanë mendjen te plani, te prodhimi kryesor dhe nuk i kushtojnë kujdes këtij problemi kaq të rëndësishëm për shtetin dhe për ekonominë tonë. Prandaj duhet menduar për sigurimin e aparateve të nevojshme dhe për forcimin e mjeteve të kontrollit. Ne kontrollojmë përdorimin e ujit të pijshëm me aparate, po me atë kujdes të kontrollojmë si përdoret nafta, gazi, energjia elektrike si dhe djegien gjer në fund të qymyrgurit. Për sigurimin e këtyre aparateve të mendohet e të organizohet prodhimi dhe riparimi në vend i tyre. Kjo është njëra anë e çështjes. Kryesorja është që të organizohet mirë kontrolli, duke caktuar edhe sanksione të rrepta për shkelësit e rregullave që do të vendosen.

Një punë më e studiuar duhet bërë për t'ua përshtatur pajisjet llojeve e vetive të qymyreve, të mos lejohet më gjatë kjo gjendje që ekziston sot. Po ashtu të shpejtohet eksperimentimi dhe rikonstruksioni i kal-dajave ekzistuese me zgarë me aftësi mbi 4 tonë/orë avull për t'i kthyer ato në sistemin e djegies me pluhurizim. . .

Në materialin e paraqitur na thuhet se nga studimet paraprake del se është me leverdi të mirë ekonomike përdorimi i energjisë elektrike për prodhimin e ferro-kromit, të nikel-silikatit dhe në transportin hekurudhor. Këto të studiohen me kujdes dhe të dilet me propozime konkrete, por sa kohë që ne kemi tepriçë të energjisë elektrike të vazhdojë edhe eksporti i

saj. Në qoftë se do të duhet të shtohet edhe energji elektrike, kjo të shikohet. Ndërsa përdorimi i energjisë elektrike në të ardhmen për metalurgjinë e nikel-silikatit, mund të ishte më i leverdishëm aty ku burimet hidroenergjetike i kemi sa më afër.

Detyrat për zhvillimin e industrisë energjetike dhe përdorimin sa më me kursim të burimeve energjetike në t'i shohim të lidhura ngushtë me detyrat për shtimin e eksportit dhe për pakësimin e importit edhe në këtë degë. Neve na duhet të krijojmë sa më shumë devizë për të përballuar importin. Eksportimi edhe nga kjo degë duhet konsideruar si mjet i importimit të impianteve të reja të pesëvjeçarit të shtatë.

Ne sot eksportojmë edhe nënprodukte të naftës, edhe energji elektrike, gjithashtu eksportojmë sasi të vogla qymyrguri. Nafta dhe nënproduktet e saj e kanë rrugën e hapur ditën dhe natën në eksport. Në rrugë të mbarë është futur edhe eksporti i energjisë elektrike. Më mirë duhet menduar e punuar qysh tash për të gjetur tregje për eksportin e qymyrgurit, sepse, siç po shohim, nga dita në ditë po rritet çmimi i tij. Nga kjo do të varen në një masë të ndjeshme edhe investimet suplementare që do të duhet të bëjmë. Kur themi të rriten të ardhurat nga eksportet e lëndëve energjetike, këtë ta shohim konkretisht, sepse nga sa jam informuar, ndërsa thuhet u kursyen aq e kaq, nuk shoh të shtohen në shkallën e duhur as rezervat, as eksporti.

Në materialin e paraqitur shtrohet edhe çështja e zëvendësimit të druve të zjarrit me qymyrgur ose bri-keta. Duke marrë parasysh rëndësinë e të ardhurave

nga eksporti i qymyreve, duhet parë kostoja e zëvendësimit të druve të zjarrit. Në qoftë se ne marrim masa të mbjellim drurë më tepër sesa të djegim, në qoftë se ngrohja e popullatës me dru dhe me avull o me gaz na leverdis më mirë, të vazhdojmë edhe për ca kohë. Të mos harrojmë se përdorimi i qymyrit lyp stufa speciale, që duhen bërë me shumicë. Megjithatë, atje ku ka mungesa të mëdha për lëndë druri, siç është fusha e Myzeqesë, apo ndonjë zonë tjetër, dhe llogaritë tregojnë se na leverdis të prodhojmë briketa apo të përdorim ndonjë lloj qymyri, kjo le të studiohet e të dilet me propozime konkrete për pesëvjeçarin e ardhshëm. . .

Përveç kësaj, unë di se ndërtimi i linjës Elbasan-Fierzë u vendos nga Qeveria, në qershor të këtij viti, për të rritur garancinë e sistemit tonë elektrik, domethënë për një çështje që ne na shqetëson mjaft. Prandaj si veprojmë kështu, dje e vendosim për të mirë të punës dhe nesër heqim dorë nga një vendim i drejtë? Ne duhet të rritim gatishmërinë e sigurinë e furnizimit me energji elektrike jo vetëm nga sistemi, por edhe brenda ndërmarrjeve, sidomos në Kombinatin Metalurgjik e në PVC-në e Vlorës, ku edhe pse kanë ardhur e janë instaluar aparaturat e lidhjes automatike të rezervës, ka zvarritje e ngurime për vënien e tyre në funksionim.

Por, duke shtruar këtë çështje, në të njëjtën kohë, unë kam parasysh se përderisa kemi tepëri të energjisë elektrike në periudhën me shumë ujë, ne duhet të mendojmë më mirë e të gjejmë rrugë të reja për të shtuar eksportin e saj. Nga sa më kanë informuar, kosovarët nëpërmjet tregtisë së jashtme, kanë kërkuar dy he-

rë për t'u lidhur me energji elektrike. Këtej mund të ndiqej rruga që ndjekim edhe sot, domethënë duke shkëputur agregate të tjera nga Hidrocentrali i Fierzës. Megjithatë kjo çështje të studiohet më thellë, sepse ne jemi në dijeni edhe të pengesave të jugosllavëve, edhe të mospranimit nga ana e tyre të rritjes së çmimeve të eksportit të energjisë elektrike siç u rritën me Greqinë.

Siç mendohet të punohet më mirë për shtimin e eksportit, është e nevojshme të mendohet e të punohet më mirë edhe për pakësimin e importit të qymyreve të koksifikueshme e të koksit. Problemi bëhet akoma më serioz, po të mbahet parasysh se në krahasim me çmimet e vitit 1978, këtë vit qymyrgarin e blejmë më shtrenjtë.

Partia me kohë ka shtruar detyrën që të luftohet për të zbuluar në vend qymyre të koksifikueshme dhe, në të njëjtën kohë, të punohet që edhe për qymyret ekzistuese të gjenden rrugë për t'i përdorur më gjerë si në metalurgjinë me ngjyra, ashtu edhe në metalurgjinë e zezë.

Sikurse shihet, kur flasim për bazën tonë energjetike, kemi të bëjmë me një problem shumë të madh e të rëndësishëm. Mjaft çështje që lidhen me zhvillimin aktual e perspektiv të saj, Komiteti Qendror dhe Qeveria i kanë zgjidhur dhe kanë dhënë edhe orientimet përkatëse. Për industrinë e naftës e të gazit dhe për studimin dhe projektimin e burimeve hidroenergjetike, për projektimin e hidrocentraleve, për zbulimin dhe nxjerrjen e qymyreve, ne kemi ngritur edhe institute të veçanta, të cilat kanë bërë e bëjnë një punë të lav-

dërueshme. Por më duket se për problemet e termo-energjisë, domethënë për cilësinë e djegies së lëndëve djegëse, për problemet që dalin lidhur me bilancin energjetik si dhe rrugët për përdorimin më racional të kësaj apo të asaj lloj lënde djegëse, për drejtimin shkencor të sistemit unik të energjisë elektrike, për projektimin e impianteve termike sa më ekonomike etj., ka nevojë për më shumë studime e përgjithësime. Ndoshta duhet studiuar ngritja e ndonjë bërthame që t'i studiojë e t'u japë rrugë më shkencore këtyre problemeve në shkallën e të gjithë vendit. Prandaj, pa tërhequr mendimin, pa u shqetësuar më shumë dhe pa u mobilizuar të gjithë, nuk mund të zbatohen me sukses tërë ata objektiva e pikësynime të mëdha që ka caktuar Partia dhe Qeveria në këtë fushë.

Shumë nga këto probleme i përkasin pesëvjeçarit të shtatë. Qeveria të aktivizohet më tepër, sepse mjaft prej tyre që duhet të përfundonin, janë lënë pas dore të papërfunduara, kurse ato duhet të kryheshin sa më parë. Për të tjerat Qeveria të caktojë të bëhen studime sa më ekzakte dhe ato që do të vendosim të futen në plan, të jenë shumë të sakta nga ana e rentabilitetit ekonomik, kostoja, sigurimi i pagesave për objektet e reja, prioriteti dhe format e reja të organizimit, të stilit e të metodës së punës.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1978-1979», f. 324*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

## **ME SHUMË PËRGJEGJESI PËR KRYERJEN DHE VËNIEN NË JETË TË STUDIMEVE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**13 tetor 1979**

Doja të thosha edhe unë disa fjalë për problemin që u shqyrtua sot në këtë mbledhje të Byrosë Politike. Në radhë të parë, do të bëj një vërejtje për raportin e paraqitur nga Kryesia e Këshillit të Ministrave, i cili është shumë i dobët. Pse e them këtë? Janë angazhuar gjithë këta kuadro në grupet e studimit, për të cilat u fol këtu, por ato studime që na përmenden në raport kanë qenë caktuar qysh më parë, në kuadrin e revolucionit tekniko-shkencor që Komiteti Qendror e ka propaganduar shumë kohë para se të merreshin masat organizative që dimë. Por ç'ka dhënë ky organizim dhe fuqi-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth raportit «Për punën që kanë bërë grupet e studimit për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor, rezultatet e deritanishme dhe masat që duhen marrë».

zim, ç'gjëra kanë përfunduar, si janë drejtuar e udhëzuar këto grupe dhe si është kontrolluar puna e tyre? Përkërisht një gjë e tillë nuk pasqyrohet në këtë raport. Krijimi i këshillave tekniko-shkencorë, si udhëheqje të veçanta shkencore në ministri e në komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, duhet parë me kujdes. Pra, të shihet se me çfarë merren gjithë këta njerëz rrogëtarë? Unë e di se janë kryer mjaft prej detyrave të planifikuara, por një mori e madhe nuk janë zbatuar, bile janë larg realizimit dhe afateve që janë caktuar.

Kam përshtypjen, gjë që e kam vënë edhe herë të tjera në dukje, se këto grupe të shumta që u formuan as nuk u kontrolluan e as nuk u ndihmuan si duhet nga ministrinë, përveç ndonjë mbledhjeje formale që u bë me to. Këtë gjë e kam ngritur vazhdimisht në mbledhjet e Sekretariatit të Komitetit Qendror. Studimet e shumta, të caktuara me programe dhe me data, gjatë gjithë këtij procesi, duhej të merreshin në rregull, të rishikoheshin herë pas here për një rikrasitje të atyre që ishin kryer ose ishin duke u kryer. Mirëpo nuk u rishqyrtuan as ato, as radha e tyre për të parë se kujt i duhej dhënë prioritet në mënyrë që të përdorreshin racionalisht forcat shkencore dhe t'u jepej këtyre gjithë ndihma e nevojshme materiale e financiare. Një gjë e tillë, që duhej bërë qysh në fillim, më duket se akoma edhe tani nuk është bërë. Janë marrë disa masa vetëm për ato studime që thashë, për disa studime laboratorike dhe për disa objekte të mëdha siç është fabrika e sheqerit ose ndonjë tjetër, kurse në fakt

janë gjithë ato probleme të tjera tekniko-shkencore, për zgjidhjen e të cilave nuk janë marrë masat e duhura materiale e financiare. Sikur vetëm problemet e Qeverisë të marrim, e konstatojmë një gjë të tillë. Këto bëjnë pastaj që studimet zvarriten, lihen mënjanë dhe shokët ministra ose drejtorë hezitojnë të bëjnë kërkesa, pa të cilat nuk mund të zgjidhet problemi.

Me këtë fakt është e lidhur edhe ajo që thuhet në raport e që u diskutua edhe këtu, se ndërmarrjet ose komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë kanë nxjerrë pengesa për vendosjen e kuadrove të aftë në grupet e studimit. Kjo mund të ketë dy arsye:

**E para**, ose ata që duhet të lejojnë kuadrot për të marrë pjesë në këto grupe nuk e kuptojnë rëndësinë e krijimit të grupit të studimit.

**E dyta**, ose dobësohet drejtimi teknik i ndërmarrjes.

Këtyre qëndrimeve e shqetësimeve u duhej dalë përpara me kohë dhe të mos vinte puna deri këtu që të na thuhet tani se «ndërmarrjet, komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë kanë nxjerrë pengesa për vendosjen e kuadrove të aftë në këto grupe ose i heqin nga to», duke penguar punën etj., etj., kur ka kaluar një kohë e gjatë që janë planifikuar temat dhe problemet që do të studiohen.

Gjithashtu, në raport, nuk shoh të na thuhet nëse me krijimin e këtyre grupeve byrotë teknike në ndërmarrje e shtuan veprimtarinë apo qëndruan në vend, u dobësuan, bënë një punë paralele me grupet e krijuara pranë tyre dhe u konfunduan me to apo jo? Kjo ka rëndësi të madhe për ne. Këtu foli edhe Piloja

[Peristeri], folën edhe shokët e tjerë që thanë se ka gjëra të mëdha, por ka edhe të tjera shumë të vogla. Atëherë duhet të na thuhet që kemi forca, që këto i kemi organizuar e i kemi drejtuar mirë për të shtuar veprimtarinë edhe në grupet e punës, por edhe në byrotë teknike.

Prandaj raporti i paraqitur është një raport i parë thjesht, me sy administrativ, i cekët e burokratik, që flet qartë edhe për ndjekjen e dobët që i bëhet këtij problemi nga organet dhe njerëzit e ngarkuar drejtpërdrejt me këtë punë, por edhe për një kontroll e ndihmë të pamjaftueshme nga dikasteret. Ai nuk na nxit, sepse nuk na jep mendime e sugjerime si të çohet përpara kjo punë.

Edhe projektvendimi i paraqitur këtu pothuajse nuk ka lidhje fare me problemin që raportohet. Atje përsëriten, në mënyrë shumë të përgjithshme, disa drejtime ku duhet të thellohet revolucioni tekniko-shkençor, ndërkohë që këto orientime i ka dhënë me hollësi Kongresi i 7-të i Partisë, Byroja Politike, Sekretariati i Komitetit Qendror. Ç'na duhej ne ky projektvendim, që është më i madh se raporti kur i kemi të qarta vendimet për këtë çështje e duhet vetëm t'i zbatojmë? Çfarë po bëhet me këto orientime e detyra? Si po vihen ato në jetë? Ç'rezultate kemi e ç'vështirësi hasen në praktikë? Këto duhet të na paraqiteshin këtu.

Çështja e grupeve të punës, që janë ngritur për studimin, projektimin, eksperimentimin dhe zbatimin e mjaft problemeve të të gjitha nomenklaturave që nga Qeveria, dikasteret, në rrethe apo ndërmarrje, duhet të

merret në dorë dhe me seriozitetin më të madh nga organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë, nga baza deri në qendër. Këtu koha nuk pret dhe situatat nuk pranojnë e nuk lejojnë zvarritje, mbasi dëmtohet ekonomia e vendit. Nga të gjithë kërkohet seriozitet i madh, përgjegjësi për detyrën e ngarkuar, zbatim në kohë i planit të aprovuar. Një pjesë e mirë e temave dhe e problemeve që studiohen dhe eksperimentohen kanë të bëjnë drejtpërdrejt me planin e ri pesëvjeçar, që mbështetet plotësisht në forcat tona e që do të fillojmë ta shqyrtojmë pas një viti. Prandaj, a e kuptojnë mirë të gjithë ata që janë angazhuar në studime dhe ata që i drejtojnë këto probleme se këtu nuk mund të luhet e nuk mund të shtyhen afatet si pa të keq? Se pastaj do të na grumbullohen të gjitha problemet bashkë e nuk do të kemi si t'i zgjidhim dot të tëra.

Disa nga problemet që në raport paraqiten si të studiuara, për shembull, pasurimi i fosforiteve, i kuarciteve etj., që u përmendën këtu, ka kohë që janë vënë në dukje, mirëpo transportimi i këtyre mineraleve për në destinacionin e prodhimit, në fabrika, ashtu siç janë, gjysmë të përpunuara, edhe tash akoma po zvarritet. Dhe për këtë nxirren disa shkaqe pa baza, që duhen luftuar. Cilat janë këto shkaqe? Janë përralla të atilla, si për shembull: ne për këtë gjë, për pasurimin e kuarcit, do të ndërtojmë një fabrikë të madhe, na thuhet, e cila kushton kaq ose aq milionë dollarë dhe meqenëse jemi duke e studiuar këtë objekt dhe duke u marrë me projektet, ndaj edhe kuarцитet e fosforitet qëndrojnë atje, në vend. Pra, nuk punohet, siç

tha shoku Adil [Çarçani], që të bëhet me etapa kjo vepër, domethënë në qoftë se tani do të hedhim një pjesë të mineralit, kur të ndërtojmë fabrikën, do të hedhim për përpunim pesëfishin e sasisë. Mirëpo, për t'u justifikuar na nxjerrin përpara fabrikën, dale na thonë, do të ndërtojmë ato të mëdhatë më parë.

Zvarritje ka edhe në shkripëzimin dhe në vënien e plotë në shfrytëzim të tokave të kripura. Për këtë kemi folur shumë herë, vazhdimisht, mund të themi. Disa herë na është folur, gjithashtu, për gjurmë metallesh të rralla në vendin tonë, mirëpo prej tyre nuk po mbetet gjë në shoshë. Po ashtu edhe mjaft probleme, që lidhen me rikonstruksionin dhe me zgjerimin e uzinave e të fabrikave ekzistuese, ecin shumë ngadalë, gjë që i sjell dëme të mëdha ekonomisë. Çështja që përmendi shoku Ramiz, përmirësimi i teknologjisë së prodhimit, ka rëndësi të jashtëzakonshme për ne, pse është më me leverdi të bëhet kjo, sesa të mendojmë të investojmë miliona dollarë për të ndërtuar një fabrikë të re, të paktën të përmirësojmë procesin teknologjik të këtyre që kemi dhe, sigurisht, me shpenzime më të pakta.

Nga sa jam informuar, një pjesë e mirë e temave që po studiohen, kanë arritur tani në fazën e projektimit. Ky është një moment i rëndësishëm që kërkon një bashkërendim më të organizuar të forcave studiuëse, projektuese dhe zbatuese. Mirëpo kjo nuk bëhet si duhet, këto studime mbeten në libra dhe depozitohen.

Nuk pret koha e nuk na leverdis aspak që t'i kush-tohen vite të tëra studimit të pajisjeve e objekteve dhe

pastaj të pritet një kohë tjetër e gjatë për vënien e tyre në jetë. Këtu del nevoja e bashkëpunimit dhe e bashkërendimit të punës për anën studimore me atë projektuese e zbatuese, si kusht i domosdoshëm për shkurtimin e afateve e përcaktimin e radhës, për sa i përket vënies së tyre në jetë, zgjidhjes së problemeve të bazës materialo-teknike e financiare. Këto janë probleme me rëndësi të madhe. Po nuk u zgjidhën këto, po nuk u programuan, po nuk u hartuan, po nuk u caktuan fondet për to nuk mund të vihen në jetë studimet, sepse njëra sikur të çalojë, pengohet gjithë puna, pse të tëra janë të lidhura si hallkat e një zinxhiri.

Ishte një sukses i rëndësishëm projektimi dhe zgjerimi me forcat tona i kapacitetit të Kombinatit të prodhimit të Sheqerit në Maliq. Për këtë duhen përgëzuar të gjithë ata që morën pjesë, punëtorët e specialistët e disa uzinave të ndryshme të vendit, si dhe ata të rrethit të Korçës. Por në të njëjtën kohë përfundimi me sukses i kësaj vepre, si dhe i veprave të tjera të rëndësishme, duhet të na shërbejë edhe për të nxjerrë konkluzione për sa u përket vështirësive që u hasën, rrugeve që u ndoqën për kapërcimin e tyre, dobësive e pengesave jo të pakta që u ndeshën, një pjesë e mirë e të cilave vinin nga një planifikim, kooperim dhe bashkërendim jo i mirë i punës, si dhe nga moszbatimi në kohë e me grafik i detyrave të ngarkuara. Për kapërcimin e një pjese të këtyre vështirësive u desh të merrnin organet e larta, që nga Komiteti Qendror e Qeveria, deri te ministrat e kuadro të tjerë me përgjegjësi.

Mirëpo në pesëvjeçarin që vjen nuk do të projek-

tojmë e ndërtojme me forcat tona vetëm një vepër si kjo, por me dhjetëra. Një tipar i rëndësishëm i pesëvjeçarit të shtatë do të jetë shtimi i prodhimit si rezultat i zgjerimit, rikonstruksionit e modernizimit të aftësive prodhuese të mjaft ndërmarrjeve ekzistuese, si edhe ndërtimi i shumë veprave krejtësisht të reja. Prandaj, në këto kushte kërkohet një planifikim, një kooperim, një bashkëpunim i sinkronizuar i forcave të mjaft kolektivave punonjës, ndryshe problemet do të na mbeten në mes të rrugës ose do të zvarriten, gjë që ne nuk duhet ta lejojmë në asnjë mënyrë, se do të kemi humbje të mëdha.

Revizionistët kinezë na lanë të papërfunduara e na sabotuan tërë ato vepra, por njerëzit tanë të mrekullueshëm, shumë prej tyre i vunë në shfrytëzim dhe një pjesë tjetër janë duke i përfunduar. Edhe këtë përvojë duhet ta kemi mirë parasysht për t'i çuar në projektim, në ndërtim e në zbatim studimet, që po kryejnë grupet e punës. Prandaj t'u kushtohet më shumë kujdes grupeve të punës studimore shkencore. Atje ku shikohet e arsyeshme, me qëllim që punët e tyre të mos mbeten nëpër sirtare e të mos kalojnë nga një dorë në tjetrën, grupet duhet të forcohen nga pikëpamja e drejtimit shkencor. Këtu të aktivizohen në shkallë më të gjerë Akademia e Shkencave, Universiteti si dhe institucionet e tjera kërkimore-shkencore pranë dikastereve, që janë të shumta. Por në të njëjtën kohë problemet që studiohen, sipas rastit, duhet t'i bëhen të njohura Qeverisë dhe të hidhen për diskutim në kolektivat e ndryshëm punonjës, të cilët me mendi-

met që do të japin mund të ndihmojnë e të kontribuojnë për një zgjidhje më të drejtë të vënies së tyre në zbatim.

Duhet theksuar se masat punonjëse i janë përveshur një pune frontale për zhvillimin e thellimin e revolucionit tekniko-shkencor, kur ne kemi shumë përparime. Çështja është që ato të përkrahen, të mbështeten fuqimisht nga Partia, nga organet e pushtetit, të ekonomisë dhe të nxiten që të ketë një zhvillim të mëtejshëm kjo punë me rëndësi kaq të madhe për ndërtimin e socializmit. Me këto probleme, mendoj unë, duhet të merren më mirë edhe sektorët tanë në aparatën e Komitetit Qendror, sidomos sektori për shkencën dhe sektori për ekonominë. Për këto probleme të vihet në lëvizje sa më shumë dhe mbi të gjithë Partia dhe, kur themi Partia, kuptohet që kemi vënë në lëvizje gjithë komunistët, kudo që veprojnë, në pushtet, në organizatat e masave etj., të cilët duhet të jenë medoemos në krye të situatës. Por që të jenë në krye, ata duhet të kuptojnë detyrat.

Kuadrot drejtues të Partisë, veçanërisht, duhet t'i kenë kurdoherë parasysh këto mësimë, sepse ndodh që ata marrin më tepër kompetencat e kuadrove të pushtetit, në vend që t'i bëjnë këta kuadro të ndërgjegjshëm për punën e tyre, t'i ngrenë politikisht e ideologjikisht për të kryer detyrat e Partisë atje ku janë caktuar me detyra shtetërore, apo në organizatën e bashkimeve profesionale, në organizatën e gruas, në organizatën e rinisë etj., duke dhënë vetë shembullin e tyre personal.

Vazhdimisht kam konstatuar se ne kemi kuadro me të vërtetë të ngritur, të aftë e me nivel të lartë politik, ideologjik e teknik. Atëherë ç'mungon? Këtu, më duket mua, ka një ngathtësi. Nga vjen kjo? Mund të thuhet se vjen për shumë arsye, kurse unë them se vjen më tepër nga metoda dhe stili i punës, i organizimit, i kontrollit të drejtimit. Këtu Partia duhet të luajë rolin e saj kryesor dhe këtë rol, shokë, ta rishikojmë imtësisht dhe ta lidhim me punën konkrete e jo me të kaluarën. E kaluara përbën një thesar të madh që ekziston, por tani duhet të japësh rezultate atje ku të ka caktuar Partia. Ajo do ta çmojë secilin në punë nëse ecën përpara, apo qëndron në vend dhe në qoftë se qëndron në vend, të vijë një tjetër në vendin e tij që është më i zoti nga i pari. Natyrisht, të kaluarën nuk e hedhim poshtë, por kur njëri deri në njëfarë mase jep, por më tutje nuk shkon, nuk ka rezultate, atëherë të zëvendësohet.

Ashtu siç thanë edhe shokët që diskutuan, besoj se mund dhe duhet t'i japim një hov më të madh këtij problemi kaq të rëndësishëm.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për shkencën» (Përmbledhje veprash), vëll. II, f. 213*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Për shkencën» (Përmbledhje veprash), vëll. II, f. 213*

## TREGUESIT

1. INTRODUZIONE	1
2. IL TREGUESIT	2
3. IL TREGUESIT	3
4. IL TREGUESIT	4
5. IL TREGUESIT	5
6. IL TREGUESIT	6
7. IL TREGUESIT	7
8. IL TREGUESIT	8
9. IL TREGUESIT	9
10. IL TREGUESIT	10
11. IL TREGUESIT	11
12. IL TREGUESIT	12
13. IL TREGUESIT	13
14. IL TREGUESIT	14
15. IL TREGUESIT	15
16. IL TREGUESIT	16
17. IL TREGUESIT	17
18. IL TREGUESIT	18
19. IL TREGUESIT	19
20. IL TREGUESIT	20
21. IL TREGUESIT	21
22. IL TREGUESIT	22
23. IL TREGUESIT	23
24. IL TREGUESIT	24
25. IL TREGUESIT	25
26. IL TREGUESIT	26
27. IL TREGUESIT	27
28. IL TREGUESIT	28
29. IL TREGUESIT	29
30. IL TREGUESIT	30
31. IL TREGUESIT	31
32. IL TREGUESIT	32
33. IL TREGUESIT	33
34. IL TREGUESIT	34
35. IL TREGUESIT	35
36. IL TREGUESIT	36
37. IL TREGUESIT	37
38. IL TREGUESIT	38
39. IL TREGUESIT	39
40. IL TREGUESIT	40
41. IL TREGUESIT	41
42. IL TREGUESIT	42
43. IL TREGUESIT	43
44. IL TREGUESIT	44
45. IL TREGUESIT	45
46. IL TREGUESIT	46
47. IL TREGUESIT	47
48. IL TREGUESIT	48
49. IL TREGUESIT	49
50. IL TREGUESIT	50
51. IL TREGUESIT	51
52. IL TREGUESIT	52
53. IL TREGUESIT	53
54. IL TREGUESIT	54
55. IL TREGUESIT	55
56. IL TREGUESIT	56
57. IL TREGUESIT	57
58. IL TREGUESIT	58
59. IL TREGUESIT	59
60. IL TREGUESIT	60
61. IL TREGUESIT	61
62. IL TREGUESIT	62
63. IL TREGUESIT	63
64. IL TREGUESIT	64
65. IL TREGUESIT	65
66. IL TREGUESIT	66
67. IL TREGUESIT	67
68. IL TREGUESIT	68
69. IL TREGUESIT	69
70. IL TREGUESIT	70
71. IL TREGUESIT	71
72. IL TREGUESIT	72
73. IL TREGUESIT	73
74. IL TREGUESIT	74
75. IL TREGUESIT	75
76. IL TREGUESIT	76
77. IL TREGUESIT	77
78. IL TREGUESIT	78
79. IL TREGUESIT	79
80. IL TREGUESIT	80
81. IL TREGUESIT	81
82. IL TREGUESIT	82
83. IL TREGUESIT	83
84. IL TREGUESIT	84
85. IL TREGUESIT	85
86. IL TREGUESIT	86
87. IL TREGUESIT	87
88. IL TREGUESIT	88
89. IL TREGUESIT	89
90. IL TREGUESIT	90
91. IL TREGUESIT	91
92. IL TREGUESIT	92
93. IL TREGUESIT	93
94. IL TREGUESIT	94
95. IL TREGUESIT	95
96. IL TREGUESIT	96
97. IL TREGUESIT	97
98. IL TREGUESIT	98
99. IL TREGUESIT	99
100. IL TREGUESIT	100



## TREGUESI I LENDËS

### A

*Administrata shtetërore, punonjësit* — 90-92, 95, 235-236.

*Aftësia prodhuese, shfrytëzimi i saj; ruajtja dhe mirëmbajtja e mjeteve të punës* — 160-161, 167-168, 277.

*Akumulimi socialist* — 96-97.

*Arkitektura, arkitektët* — 89-90, 246-247, 249-251.

*Armiqtë, veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre* — 9-10, 54, 55, 59, 61-62, 393-394.

*Arsimi në RPSSH — zhvillimi i arsimit* — 41-42, 77.

### B

*Bashkimet Profesionale të Shqipërisë* — 144, 178, 238;

— detyrat; revolucionarizimi, gjallërimi i jetës së tyre — 28-29, 100, 143-164, 233, 235-237, 240-242, 262-263;

— forumet, kuadrot — 237-239, 240.

*Bashkimi Sovjetik, socialimperializmi sovjetik*

— gjendja e brendshme, politika e jashtme; strategjia dhe taktikat; kontradiktat me vendet revizioniste — 191, 195-196, 198-200;

— qëndrimi ndaj Shqipërisë — 39.

*Borgjezia; borgjezia e re në vendet revizioniste* — 82, 201.

*Bujqësia në RPSSH; organizimi dhe drejtimi i punës* — 49-52, 113, 159-164;

— mekanika bujqësore, gatishmëria e saj — 159-163, 283;

— toka, sistemimi i saj; qëndrimi i kulturave bujqësore. Bonifikimet; serrat — 276-277, 278-280, 282-284, 312-313, 400-401;

— drithërat; perimet — 160-163, 164, 284-285.

*Burokratizmi, lufta kundër shfaqjeve të tij* — 85-86, 140, 180, 235-236, 240-241, 285 348, 366-367.

## C

*Centralizmi demokratik* — 351.

## D

*Demokracia socialiste* — 348, 351.

*Disiplina proletare, forcimi i saj* — 25, 28-29, 104-105, 146-147, 149.

## E

*Edukimi komunist — edukimi ideopolitik; edukimi dhe masat administrative* — 23, 122-123, 267, 372, 374.

*Efektiviteti i ekonomisë* — 155-156, 169, 282-283, 288, 395-397, 400-402, 404-406.

*Ekonomia popullore; struktura e degëve të saj; fuqizimi i bazës energjetike* — 25, 280, 392-394, 407-408.

*Emulacioni socialist* — 148-149, 220.

*Engels, Fridrih* — 8, 54, 58.

*Enver Hoxha — të dhëna au-*

*tobiografike* — 2-3, 7-9, 11-12, 14-15, 32-33, 34, 36, 37, 38, 43, 77, 107, 261, 275, 301, 317, 324.

## F

*Familja — krijimi i familjes së re socialiste* — 309-310.

*Feja, lufta kundër saj* — 116-117, 381.

*Financat — kontrolli financiar* — 93-94.

*Folklori, kënga popullore* — 36-37, 43.

*Fronti Nacionalçlirimtar — Fronti Demokratik i Shqipërisë; roli udhëheqës i Partisë, detyrat e tij për edukimin e masave* — 9, 66-67, 69-70, 75, 144;

— roli i tij për bashkimin politik dhe mobilizimin e popullit në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, në ndërtimin socialist të vendit dhe në mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut — 5, 58-59, 66, 69-70, 75;

— Kongresi i 5-të i FDSH (4-6 qershor 1979) — 53-54, 68-72, 73-74, 75, 77-78, 79-80, 83-84.

*Fshatarësia, fshatarësia kooperative* — 12, 29-30, 48, 49, 100-110, 122-123, 378-391;

— edukimi i saj ideopolitik — 122-123, 271-275.

*Fuqia punëtore, shpërndarja e saj* — 172-173.

*Furnizimi materialo-teknik; kontratat ndërmjet ndërmarrjeve; stoqet* — 87, 88-89, 92, 93-94.

## G

*Gruaja dhe Bashkimi i Grave të Shqipërisë; ngritja e gruas së përgjegjësi* — 121, 144, 310.

## H

*Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare* — objektiviteti shkencor i shkrimeve dhe i dokumenteve për luftën; kujtimet për luftën — 15-16, 258-361.

*Historia e popujve të botës e kulturës dhe e qytetërimit të tyre* — 300.

*Historia e Shqipërisë.*

— luftërat e popullit shqiptar për liri, pavarësi e përparim shoqëror — 7, 54-56;

— rilindësit — 44;

— situata politike në Shqipëri pas vitit 1912 — 57-59;

— dijetarë të huaj për historinë e Shqipërisë — 42.

## I

*Industria e lehtë në RPSSH; industria e prodhimit të mallrave të konsumit të gjerë; industria e qelqit* — 228-229, 278, 287-289, 305.

*Industria e rëndë në RPSSH — politika e Partisë për zhvillimin e saj* — 157-158;

— industria minerale; qymyret — 169, 395-396, 401-403;

— industria e lëndëve djegëse — 165-166, 169-170, 394-395, 403-404;

— industria mekanike, prodhimi në vend i fabrikave dhe i pjesëve të ndërrimit — 167-168, 176, 278, 312-315, 413-414;

— industria elektrike — 223-226, 395, 396, 404-405, 406-408;

— industria e drurit dhe e letrës — 231-232, 286-287.

*Industrializimi socialist* —

*nxjerrja dhe përpunimi në vend i lëndëve të para* — 226, 278, 306, 413-414;

— *kuadrot, specialistët. Studimet shkencore* — 286-289, 350.

*Iniciativa dhe vetëveprimi* — 40-41, 286-289.

*Inteligjencia para Çlirimit* — 57-58, 140.

## J

*Jugosllavia, revizionizmi jugosllav; gjendja e brendshme, kriza ekonomike dhe politike*

— 40, 200-202, 203-204;

— *qëndrimi armiqësor ndaj Shqipërisë* — 38.

## K

*Kapitalizmi, karakteristika të zhvillimit të tij; kriza ekonomike dhe energjetike* — 63 65-66, 82, 155, 161, 185-193, 393.

*Kërkesa dhe oferta në socializëm* — 92-93.

*Këshillat popullore; komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, seksionet e tyre* — 93, 94, 97, 159, 163, 172-173, 369, 372, 378, 381, 411;

— *Komiteti Ekzekutiv i KP të Rrethit të Dibrës* — 109, 111, 112, 113, 114, 119, 123;

— *komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të Elbasanit, të Lezhës dhe të Fierit* — 177, 285, 298;

— *këshillat popullore të fshatrave të bashkuara* — 367-368, 369-370;

*Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave* — 18, 51, 52, 89 95, 98, 103, 112, 114, 155, 158-159, 166-167, 174-175, 178, 180, 224, 228, 237, 285, 286, 343, 350, 371, 379, 395, 406, 407, 408, 409.

*Kina, revizionizmi kinez; kriza ekonomike, politika e jashtme* — 186, 193-194, 195;

— *marrëdhëniet dhe kontraktat me fqinjët; presionet ndaj Vietnamit* — 197-198;

— *qëndrimi ndaj Shqipërisë* — 39, 416.

*Kinematografia, filmi në RPSSH* — 356-362.

*Klasa punëtore në RPSSH — roli i saj udhëheqës, detyrat* — 86-86, 141, 144-145, 153, 178, 264-265;

— *edukimi i saj komunist,*

- lufta kundër shfaqjeve të huaja — 150, 151, 366, 373.
- Klasa punëtore në vendet borogjeze e revizioniste* — 201.
- Kolektivizimi socialist* — politika e Partisë për kolektivizimin e fshatit — 49.
- Kompetencat, përgjegjësitë* — 46, 52, 90-92, 95, 97, 100, 105, 111-112, 113, 117, 119, 120, 177, 227, 239, 364-365.
- Komunalja* — shërbimet komunale, mirëmbajtja e banesave — 259-262.
- Komunisti, detyrat* — 23-24, 66, 97, 147, 150, 151, 238-239, 253, 271-272, 273, 275-276, 374, 417.
- Kontrolli dhe kërkesa e llogarisë* — 22-23, 26, 27-28, 104, 111-112.
- Kooperativat bujqësore* — formimi, organizimi dhe drejtimi i punës në to; ndihma dhe kontrolli — 50, 271-275;
- bashkimi i kooperativave; kooperativat e zonave malore — 47-49;
  - pjesëmarrja e kooperativistëve në punë; të ardhurat — 109-110, 121-122;
  - kuadrot, specialistët; grupet e punës, studimet — 45-49, 118-120, 163-164, 272, 281-286, 367-370, 379;
  - transporti në kooperativat bujqësore — 284-286, 311-312.
- Kreditë, ndihmat ndërmjet shteteve; kuptimi marksist-leninist i tyre* — 38-39, 62-63
- Kritika dhe autokritika* — 105-108, 111, 248.
- Kuadrot, specialistët* — politika dhe kushti i Partisë për kuadrin; vendosja dhe kualifikimi i kuadrove; lufta kundër të metave e gabimeve në punën me kuadrin — 227, 229, 230, 245-251;
- cilësitë, detyrat; metoda dhe stili i tyre në punë; lidhjet me bazën — 114, 234, 241, 261, 286-287, 348-349, 350-351, 364-365, 367, 368, 374, 418;
  - lufta kundër shfaqjeve të huaja dhe koncepteve të vjetra të kuadrot — 118-120, 264-265, 275, 367;
  - kuadrot e Partisë — 123-124, 346, 347, 384, 417-418.
- Kultura në RPSSH* — 64.
- Kultura përparimtare botërore* — 36-37.

## L

*Lenin, Vladimir Iliç* — 9, 10, 54, 56, 58, 139, 152, 235.

*Letrat e popullit* — 227, 256-257.

*Ligjshmëria socialiste, ligjet në RPSSH — përsosja e tyre; njohja dhe zbatimi i ligjeve* — 20-21, 23, 24, 27, 89, 95, 96, 105, 146-147, 159, 269, 371.

*Lufta Antifashiste Nacional-çlirimtare e popullit shqiptar; objektivat, qëllimi; rëndësia dhe mësimet e saj* — 4-5, 7-9, 53-54, 70, 207.

*Lufta e Dytë Botërore — dëmet e saj në Shqipëri* — 37-38, 61.

*Luftërat, shkaqet dhe shkaktarët e shpërthimit të tyre* — 189-190.

## M

*Marksizëm-leninizmi, vitaliteti i tij* — 38-39, 54, 56, 58, 63, 75, 81, 139, 206-207.

*Marks, Karl* — 8, 54, 56, 58.

*Mbështetja në forcat e veta* — 38-40, 62, 64-65, 76, 81, 415-416.

*Mbrojtja e atdheut* — 82-83.

*Metoda dhe stili në punë* — 171-173, 182.

*Mërgimi, shqiptarët e mërguar* — 7, 43-44.

*Ministritë dhe kuadrot e tyre; detyrat* — 51, 86, 89, 90, 33, 94,

105, 158-159, 169, 173-174, 177, 180, 246, 247, 251, 315, 378, 401;

— Komisioni i Planit të Shtetit — 93-94, 95-96, 97, 111, 172, 247, 251, 401;

— Ministria e Financave — 94, 95, 111;

— Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 98, 103, 158, 232, 287, 315, 348, 349, 350, 400;

— Ministria e Energjetikës — 226-227;

— Ministria e Bujqësisë — 51-52, 111, 112, 164, 276, 278, 279, 280-281, 282, 287, 310, 400;

— Ministria e Ndërtimit — 51, 89-90, 247;

— Ministria e Komunikacioneve — 212, 214;

— Ministria e Tregtisë së Brendshme — 285;

— Ministria e Tregtisë së Jashtme — 178, 315;

— Ministria e Arsimit dhe e Kulturës — 246.

*Minoriteti grek në Shqipëri* — 382.

## N

*Nafta — politika e Partisë për zhvillimin e sektorit të naftës;*

*studimet shkencore* — 169-170, 385-391;

— organizimi dhe drejtimi i punës në sektorin e naftës — 97-101;

— kuadrot, specialistët dhe punonjësit e naftës — 385-389, 390-391.

*Ndërmarrjet socialiste* — drejtimi i tyre ekonomik; ndërmarrjet e tregtisë së jashtme — 88-89, 96-97, 229-230.

*Ndërtimet në RPSSH* — politika e Partisë në fushën e ndërtimeve — 89-90, 415-416;

— projektimet, ndërtimi i hidrocentraleve; ndërtimet me parafabrikate: ndërtimet në fshat — 248-251, 260, 396, 414-416.

*Ndërtimi i socializmit në Shqipëri; parime, karakteristika të ndërtimit socialist* — 10-11, 41-42, 43, 61-62, 63-65, 66, 70, 81-82, 208, 209-210, 301, 346-347, 382, 393-394.

## O

*Organet shtetërore dhe ato ekonomike* — 20, 21, 26, 89, 94-95, 105, 112, 123, 139, 154, 260, 274-275, 278, 284, 364, 371, 377, 413.

*Organizata-bazë e Partisë* —

*detyrat; sekretari* — 26, 27, 136, 151, 153-154, 264, 267-268, 271-272;

— mbledhjet, gjallërimi i jetës së brendshme — 115, 120-121;

— organizatat-bazë të Partisë në ndërmarrjet industriale dhe në kooperativat bujqësore — 90-92, 383-384.

*Organizatat e masave* — *detyrat; përsosja e metodës së punës* — 22, 26, 28-29, 104, 105, 112, 123, 147-148, 153, 154, 243-244, 364, 377, 382.

*Organizimi dhe drejtimi* — 30-31, 173-174, 224-226, 281-283, 284-285, 364-367.

## P

*Partia e Punës e Shqipërisë* — *vija, vendime, direktiva, ndërtimi dhe jeta e brendshme*

— themelimi i PKSh — 58;

— *vija, vendime, direktiva; njohja dhe zbatimi i tyre* 25, 49, 75-76, 104-105, 112, 114, 117-118, 119, 129, 146-147, 153, 159, 165, 169, 267, 282, 364, 375, 381, 393;

— *roli udhëheqës i Partisë; vija e saj në Luftën Antifashiste Nacionalçlirim-*

- tare dhe për ndërtimin e socializmit — 7-9, 58-62, 69, 75-76, 114, 121, 146, 153, 173, 345-346, 363;
- pranimet në Parti; kriteret e pranimit — 133;
  - parimet dhe normat e Partisë; kolegjaliteti dhe përgjegjësia personale — 105, 290-293;
  - forcimi dhe gjallërimi i jetës së saj të brendshme; kritika dhe autokritika — 175, 218, 293, 295-296, 337-339;
  - zgjedhjet në Parti, kriteret për zgjedhjet në organet drejtuese të Partisë — 125-142;
  - puna e Partisë, metoda dhe stili i saj në punë; bashkërendimi i punës me organet shtetërore; ndihma dhe kontrolli për bazën, lidhja me masat — 16, 20-21, 30-31, 91-92, 113, 115-117, 120, 121-123, 180-181, 217, 219, 221-222, 243-244, 252-270, 271-279, 290-298, 336-353, 364-367, 377-378, 381-383;
  - edukimi në Parti; materialet e Partisë, studimi dhe përvetësimi i tyre; informimi në Parti — 66, 238, 275-276, 373-374, 376-377;
  - lufta kundër shfaqjeve të huaja që dëmtojnë unitetin në Parti — 257-258;
  - materialet, raportet, informacionet për organet udhëheqëse — 18-20, 102-103, 166, 171-172, 216, 223, 233-234, 339-341, 409-410, 411-412.
- Partia e Punës e Shqipërisë — organet udhëheqëse qendrore dhe në rrethe*
- Kongresi VII i PPSH (1-7 nëntor 1976) — 230, 312, 412;
  - Plenumi i 4-t i KQ të PPSH (26-28 qershor 1973) — 18-19;
  - Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati i KQ — 18-19, 30, 92, 102, 103, 104, 125, 166, 169, 173, 176, 179, 252, 258-259, 284, 312, 395, 407, 409, 412;
  - aparati i KQ, instruktorët — 25, 118-119, 123-124, 279, 372, 381, 417;
  - konferencat e Partisë në rrethe — 336-345, 375-376;
  - komitetet e Partisë në rrethe; sekretarët, instruktorët — 25, 117-118, 120,

- 126, 135, 138, 163, 254, 255-256, 264, 347, 371-372, 381, 411;
- komitetet e Partisë të rretheve të Tiranës, të Lushnjës dhe të Beratit — 173, 297;
  - komitetet e Partisë të rretheve të Dibërës, të Krujës dhe të Lezhës — 109, 113, 115, 145-146, 298.
- Patriotizmi, patriotët* — 55.
- Përvoja e përparuar, përgjithësimi i saj* — 280, 281-282, 297-298.
- Planifikimi i ekonomisë popullore; organet e planifikimit, kuadrot, metoda dhe stili i tyre në punë* — 88, 111-112;
- lufta kundër të metave e gabimeve në planifikimin dhe në realizimin e planeve; ndihma dhe kontrolli — 85-101, 179, 239-240, 375-376;
  - plani i gjashtë (1976—1980) dhe i shtatë (1981—1985) pesëvjeçar — 81, 397, 408, 415-416;
  - planifikimi në bujqësi — 283-284.
- Politika e jashtme e RPSSH — parimet themelore të saj; vritja e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH dhe të RPSSH në botë; të huajt për Shqipërinë* — 34-36, 42, 48-49, 64, 76, 82-83, 206, 207-208;
- marrëdhëniet me vende të ndryshme të botës — 32, 35-36, 302-303;
  - marrëdhëniet me vendet arabe; marrëdhëniet me Irakun — 299-301, 302;
  - marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj vendeve fqinje; marrëdhëniet me Turqinë — 202, 299, 302.
- Populli shqiptar — cilësitë* — 39, 40, 54, 60, 61, 63, 80, 81;
- pjesëmarrja në LANÇ dhe roli i tij në ndërtimin socialist të vendit — 54, 81.
- Popullsia — demografia* — 283, 382.
- Prodhimi material, cilësia* — 231-232, 286-287, 303, 305.
- Prona në RPSSH — qëndrimi socialist ndaj saj, forcimi dhe ruajtja e pasurisë socialiste* — 18-24, 262, 266-267, 274, 377;
- oborri kooperativist — 109-110, 378-380.
- Propaganda, agjitacioni — përmbajtja, format, mjetet* — 20-24, 116-117.
- Puna — qëndrimi socialist ndaj saj* — 121-122, 178-179.

## R

*Regjimi i kursimit — kursimi i lëndëve të para, normativat e harrxhimit të materialeve*

— 154-158, 165-166, 168, 170, 174-175, 211-215, 223-226, 234, 303, 311-312, 394, 397-400;

— zëvendësimi i lëndëve djegëse të lëngëta dhe i druve të zjarrit me qymyrguri — 400, 405-406.

*Revizionizmi modern — lufta e tij kundër marksizëm-leninizmit* — 62-63.

*Revolucioni popullor në Shqipëri* — 60.

*Revolucioni tekniko-shkencor — politika e Partisë për zhvillimin dhe thellimin e tij* — 347, 417;

— teknologjia, përmirësimi i proceseve teknologjike — 231-232, 286-287 414;

— këshillat tekniko-shkencorë dhe grupet e punës, organizimi i punës në to; studimet — 347-348, 409-415, 416-417.

*Rinia dhe Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë; edukimi i saj kulturor* — 32, 144.

## RR

*Rrethimi, bllokada e presioni*

*imperialisto-revizionist dhe lufta për përballimin e tyre* — 26-27, 183, 300, 344.

## S

*Socialdemokracia* — 204-205.

*Socializmi — karakteristika* — 65, 82.

*SMT (Stacionet e makinave dhe të traktorëve), traktoristët* — 159, 279, 283.

*Stalin, Josif Visarionoviç* — 8, 10, 54, 56, 58, 139.

*Stimujt moralë dhe materialë* — 2, 5, 6, 353-354.

*Strehimi i popullsisë* — 250-261.

## SH

*Shfaqjet e huaja dhe lufta kundër tyre* — 19-23, 28-31, 242.

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika e jashtme* — 186, 191-192;

— gjendja e brendshme; kriza ekonomike dhe politike — 185-190.

*Shtypi dhe botimet në RPSSH — përmbajtja dhe shfrytëzimi i tyre; gazetarët* — 105-102, 145, 156, 172, 181-182, 219-

-221, 230-231, 248-250, 354-355, 359, 393.

## T

*Teatri, estrada* — 360-361.

*Tërmetet — mobilizimi i Partisë e i popullit për zhdukjen e pasojave të tyre* — 39-40, 64-65, 70, 243, 352-353.

*Transporti në RPSSH; transporti hekurudhor, automobilitik dhe detar* — 86, 154-155, 156, 157, 211-215, 304.

*Tregtia e brendshme — organet e tregtisë së brendshme dhe punonjësit e tyre; furnizimi i popullit* — 88-89, 117, 183.

*Tregtia e jashtme — politika e Partisë për zhvillimin e tregtisë së jashtme* — 178, 208-209, 299-308;

— *eksporti, importi; zëvendësimi i mallrave të importit me ato të vendit* — 169, 177, 228, 288, 302, 305-307, 313-315, 405-407.

## U

*Uji i pijshëm* — 156-157.

*Uniteti i popullit, uniteti Partii—popull* — 48-49, 63, 70-71, 75, 80, 326, 352-353.

*Urbanistika* — 250.

## V

*Vendet arabe — forcimi i unitetit ndërmjet tyre* — 187, 190-191, 192, 300-301.

*Vështirësitë, lufta për kapërcimin e tyre* — 74-75, 86, 176-177, 183, 207, 415.

*Vigjilenca revolucionare* — 100-101, 185, 207, 208, 209, 264.

*Vija e masave* — 149, 158

## Z

*Zonat malore — zhvillimi i tyre* — 243, 265.

## ZH

*Zhvillimi, thelbi i kuptimit materialist dialektik të zhvillimit* — 220-221.



## TREGUESI I EMRAVE

### A

Alia, Ramiz — 78, 86, 87, 98,  
89, 152-153, 221, 327, 330-331,  
334, 337, 339, 344-345, 346,  
353, 354, 355, 361-362, 365,  
414.

Abazi, Dine — 355.

Ajzenhauer, Duajt — 43.

Aiarupi, Dule — 360-361.

Antoni, Kristaq — 69.

### B

Baftjari, Qazim — 69

Bakariç, Vladimir — 201.

Bakiri, Subi — 69.

Bakr, Ahmed Hasan el — 191.

Bali, Osman — 7.

Begin, Menahem — 192.

Berberi, Sako — 304.

Berlinguer, Enriko — 205.

Berlioz, Hektor — 36-37.

Bernar, Klod — 34.

Biba, Gjela — 78.

Bize, Zhorzh — 36.

Brezhnjev, Leonid — 198

Butka, Safet — 360.

### C

Ceka, Hysen — 11, 12, 14, 15.

Ciu, Qibrie — 69.

Curri, Bajram — 56, 57, 58.

### Ç

Çarçani, Adil — 174, 178, 229,  
414.

Çuko, Lenka — 138.

Çaushesku, Nikolae — 200.

### D

Dekart, Rene — 34.

Dervishi, Persefoni — 69.

D'Estën, Zhiskar — 43.

Dë Gol, Sharl — 43.

Dishnica, Esat — 7, 12, 14, 15.

Dishnica, Ruze — 15.  
Doçi, Aishe — 69.

## F

Firjubin, Nikolai — 195-196.  
Frashëri, Mithat (Lumo Skëndo) — 361.  
Frashëri, Sami — 44.  
Furceva, Ekaterina — 195.

## G

Gaçe, Petrit — 355.  
Geci, Ismail — 69.  
Gliozheni, Kiço — 69.

## GJ

Gjoni, Gjon Marka — 360.

## H

Hoxha, Nexhmije — 34, 334-335, 355.  
Hakrama, Jonuz — 15.  
Hoxha, Nedin — 299, 303.  
Hoxha, Tahir — 360.  
Hrushov, Nikita — 38, 39.  
Hua Kuo Fen — 193, 196.

## I

Isai, Hekuran — 97, 99, 132, 158, 165, 166, 168, 169, 211, 212, 215, 339, 375.

## K

Kapo, Hysni — 45, 49, 50, 100, 168, 211, 252, 316-323, 329-335, 339, 353, 354, 355, 356-359, 360, 361, 362.  
Kallagan, Xhejms — 205, 206  
Kapo, Sulejman — 332-333, 334.  
Kapo, Vito — 322, 327, 329, 330, 332, 333-334, 335, 354, 355.  
Karter, Xhimi — 186, 188.  
Kemal, Namik — 44.  
Këlcyra, Ali — 361.  
Këllezi, Abdyl — 165.  
Klosi, Bilbil — 69.  
Koculi, Qazim — 361.  
Kraksi, Betino — 205.

## L

Lepenica, Hysni — 360.  
Li Hsien Nien — 194, 195.  
List, Franc — 36.  
Lula, Anastas — 324.  
Lutaj, Sulo — 69.

## LL

Lleshi, Haxhi — 2.

## M

Marko, Rita — 143, 233, 236.  
238, 242.

Miska, Pali — 175.

Murra, Prokop — 45, 50-51,  
87, 90, 161, 309, 310, 311, 312,  
314, 339.

Maknamara, Robert — 203.

Mao Ce Dun — 154.

Marshe, Zhorzh — 205.

Miliez, Pol — 33, 35, 319, 328,  
331.

Miteran, Fransua — 205.

Montenj, Mishel — 42.

Mulosmani, Avdi — 69.

## N

Nushi, Gogo — 69.

## P

Peristeri, Pilo — 73, 411-412.

Pastër, Lui — 34.

Peza, Dashamir — 2.

Peza, Myslim — 1-17, 73.

Peza, Partizan — 2.

Pol Pot — 197.

Popa, Agim — 172.

Premte, Sadik — 324.

Puliken, Iv — 32, 33, 34, 35-36,  
37, 38, 39, 41, 43, 44.

## Q

Qamili, Haxhi — 6-7.

Qemali, Ismail — 68.

## R

Rexha, Shaban — 2, 14, 15.

Robo, Xhorxhi — 78.

Ronsar, Pjer — 42.

Rustemi, Avni — 56, 57, 58.

## S

Skënderbeu, Gjergj Kastrioti  
— 42.

Stefani, Simon — 339.

Sadat, Anvar el — 192.

Sihanuk, Norodom — 197.

Sinani, Kasem — 1.

## SH

Shehu, Mehmet — 99.

Shkrepi, Theme — 304.

Shopen, Frederik — 36.

Shtino, Xhemali — 304, 305.

Shtraus, Johan — 36.

**T**

Ten Hsiao Pin — 186, 193, 194.  
 Tito, Josip Broz — 201, 202,  
 204.  
 Toptani, Esat Pashë — 56.

**TH**

Theçer, Margaret — 204, 205,  
 206.  
 Thomai, Themije — 174.

**V**

Veleshnja, Zylyftar — 69.

Vërlaci, Shefqet — 7.

**XH**

Xhepa, Dem — 3.

**Z**

Ziu, Vasil — 69.  
 Zogu, Ahmet — 7.

**ZH**

Zholio-Kyri, Frederik — 34.

## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

Afrikë — 200, 308.  
Akademia e Shkencave e  
RPSSH — 416.  
Amerika Latine — 308.  
Arabia Saudite — 42, 190.  
Arbanë (Tiranë) — 8.  
Arkivi Qendror i Partisë —  
357.  
«Atdheu» (organizata ~) —  
58.  
ATSh (Agjencia Telegrafike  
Shqiptare) — 353.  
Azi — 197.

### B

«Baas» (partia ~, Irak) —  
191.  
Bagdad — 300.  
Balli Kombëtar (organizata  
~) — 59, 60.  
Ballkan — 202-203.  
Banka Bujqësore e Shtetit —  
109-110, 111-112.

«Bashkimi» (shoqëria ~) —  
58.

Beograd — 203.  
Berat — 298.  
Berlin — 198.  
Beteja e Mushqetasë (nëntor  
1944) — 359.  
Britania e Madhe — 204, 205-  
-206.  
Bullgari — 203.

### C

CIA (Agjencia Qendrore e  
Shërbimit Informativ në  
ShBA) — 191.  
Cikallesh (Durrës) — 8.

### Ç

Çekosllovakia — 200.

### D

Deti i Kinës Jugore — 196.  
Dibër — 65, 111, 112, 116, 119,  
120.

Drejtoria e Përgjithshme e  
Ekonomisë Komunale, Tiranë

— 262.

Durrës — 330.

## E

Egjipt — 192.

Elbasan — 250, 285.

ENI (Shoqëria Kombëtare e  
Hidrokarbureve në Itali) —

157.

Euftrat (lumi ~) — 300.

Evropë, «Evropa e Bashkuar»

— 155, 189, 193, 194, 196, 197,

201, 204, 307.

## F

Fabrika e Letrës, Lushnjë —  
238.

Fabrika e Plastmasës [Uzina  
e Lëndëve Plastike], Lushnjë  
— 287-288.

Fakulteti i Gjeologjisë dhe i  
Minierave, Tiranë — 159.

Francë — 36, 37, 41, 195, 205.

## G

Greqi — 202, 203, 407.

## GJ

Gjermania Perëndimore (RF e  
Gjermanisë) — 188, 200, 204.  
Gjirokastër — 261, 265, 304.

## H

Hekal (Fier) — 99.

Hidrocentrali i Bushatit, Shko-  
dër — 396.

Hidrocentrali i Fierzës [Hi-  
drocentrali «Drita e Partisë»]  
— 407.

Hidrocentrali i Komanit [Hi-  
drocentrali «Enver Hoxha»]  
— 396.

«Historia e Shqipërisë» (tek-  
sti ~) — 361.

«Hosteni» (revista ~) — 181

## I

Indokinë — 198.

Instituti i Naftës e i Gazit,  
Fier — 98, 99-100, 388.

Instituti i Studimeve dhe i  
Projekttimeve Nr. 1, Tiranë —  
247.

Instituti i Studimeve Mark-  
siste-Leniniste pranë KQ të  
PPSh. Tiranë — 118.

Irak — 191, 300.

Iran — 190, 191, 192.

Itali — 202, 204, 205.

Izrael — 187, 301.

## J

Japoni — 188.

Jemen — 42.

## K

Kamboxia — 197.

Karavastaja e Vogël (këneta  
~) — 276, 277, 313.

Kinostudio «Shqipëria e re»,  
Tiranë — 357.

KNER (Këshilli i Ndhmës  
Ekonomike Reciproke) — 199-  
-200.

Kombinati i materialeve të  
ndërtimit «Josif Pashko», Ti-  
ranë — 246.

Kombinati i sheqerit «8 Nën-  
tori» i Maliqit, Korçë — 225,  
313, 415.

Kombinati i trikotazheve  
«Drapër e çekan», Korçë —  
225.

Kombinati metalurgjik «Çeli-  
ku i Partisë», Elbasan — 406.

Konferenca e Parë Nacional-  
çlirimtare e Pezës (16 shtator  
1942) — 59.

Kooperativa Bujqësore e Ba-

shkuar e Donofrosës, Berat —  
297, 298.

Kooperativa Bujqësore e Ba-  
shkuar e Hysgjokajt, Lushnjë  
— 280.

Kooperativa Bujqësore e Ba-  
shkuar e Shirgjanit, Elbasan  
— 285.

Kooperativa Bujqësore e Tipit  
të Lartë e Këmishtajt, Lush-  
një — 297, 311.

Kooperativa Bujqësore e Tipit  
të Lartë e Lapardhasë, Berat  
— 297.

Kooperativa Bujqësore e Tipit  
të Lartë e Plasës [Ndërmarrja  
bujqësore «Enver Hoxha»],  
Korçë — 280, 281.

Korçë — 156, 158, 166, 225,  
243, 276, 312, 313, 350, 415.

Kroaci — 201.

Krujë — 65, 226.

Kukës — 265, 278.

## L

Lezhë — 65, 298.

Lindja e Mesme — 190, 191,  
192, 308.

«Luftëtari» (gazeta ~) — 105.

Lushnjë — 276, 278, 279, 280,  
284, 286.

**M**

- Maknor (Tiranë) — 8.  
 Maliq (fusha ~) — 312.  
 Maqedoni — 203.  
 Mat — 65.  
 Mesopotami (fusha ~, Irak)  
 — 300.  
 Miniera e Qymyrgurit e Mbo-  
 rje-Drenovës, Korçë — 169,  
 350.  
 Miniera e Qymyrgurit e Vali-  
 asit, Tiranë — 158, 173.  
 Mirditë — 65.  
 Myzeqe (fusha ~) — 283, 396.

**N**

- NATO (Organizata e Traktatit  
 të Atlantikut Verior) — 186,  
 203.

**O**

- OPEK (Organizata e Vendeve  
 Eksportuese të Naftës) — 192,  
 196.

**P**

- Paris — 56, 320, 323.  
 Pezë (Tiranë) — 4, 6, 7, 8-9,  
 59.  
 Përmet — 265.

- Pogradec — 211.  
 Poloni — 200.  
 Porti i Durrësit [Porti detar  
 «Enver Hoxha»] — 393.  
 Pukë — 65.

**R**

- Radiotelevizioni Shqiptar —  
 353.  
 Revolucioni i vitit 1848 në  
 Francë — 42.  
 Rumani — 199, 200, 202.

**S**

- Siberi — 199.  
 Siri — 191.  
 Stacioni Hekurudhor, Durrës  
 — 220.

**SH**

- Shkodër — 65, 259.  
 Shkumbin (lumi ~) — 396.

**T**

- Termoelektrocentrali i Cërri-  
 kut — 398, 401.  
 Termoelektrocentrali i Elbasa-  
 nit — 401.

Termoelektrocentrali i Fierit  
— 398.

Termoelektrocentrali i Korçës  
— 225.

Termoelektrocentrali i Tiranës  
— 225, 226, 401.

Termoelektrocentrali i Vlorës  
— 398.

Tigër (lumi ~) — 300.

Tiranë — 173, 395.

Traktati egjiptiano-izraelit  
(mars 1979) — 190.

Traktati i Varshavës — 199,  
200.

Tropojë — 65.

Turqi — 44, 203.

## U

Universiteti i Tiranës [Uni-  
versiteti i Tiranës «Enver  
Hoxha»] — 416.

Uzina e Gomë-Plastikës (Fa-  
brika e gomës «Kozma Nu-  
shi»), Durrës — 288.

Uzina Elektromekanike, Ti-  
ranë — 313-314.

Uzina e Përpunimit të Thellë  
të Naftës e Ballshit, Fier —  
399.

Uzina e Sodës dhe e PVC, Vlo-  
rë — 287-288, 406.

## V

«Vepra të zgjedhura (Enver  
Hoxha, Œuvres choisies I) —  
275.

Vërzhezhë (Skrapar) — 213.

Vietnam — 197, 198.

Vjosë (lumi ~) — 396.

Vlorë — 53, 63, 84, 265, 324,  
365-366, 367 371.

## Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~)  
— 107, 145, 154-155, 181, 182,  
219-220, 231, 248.



## L E N D A

<b>PARATHËNIE PËR VELLIMIN E 71-TË .....</b>	<b>V—IX</b>
<b>MYSLIM PEZA — LUFTËTAR I LAVDISHËM I POPULLIT — Nga biseda në darkën me rastin e 80-vjetorit të lindjes së shokut Myslim Peza (1 maj 1979) ...</b>	<b>1—17</b>
<b>QËNDRIMET E HUAJA NDAJ PRONËS NUK LUFTOHEN VETËM DUKE I BËRË THIRRJE NDËRGJEGJES — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (3 maj 1979) .....</b>	<b>18—31</b>
<b>ÇDO GJË NË SHQIPËRINË E RE E KEMI BËRË VETË, ME FORCAT TONA — Nga biseda me Iv Puliken (9 maj 1979) .....</b>	<b>32—44</b>
<b>TË PËRSOSEN MË TEJ ORGANIZIMI E DREJTIMI NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE TË BASHKUARA — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (11 maj 1979) .....</b>	<b>45—52</b>
<b>FRONTI DEMOKRATIK I UDHËHEQUR NGA PARTIA ËSHTË ORGANIZATA E MADHE E BASHKIMIT, E ORGANIZIMIT DHE E EDUKIMIT POLITIK TË POPULLIT — Artikulli i botuar në gazetën «Bashkimi» (3 qershor 1979) .....</b>	<b>53—67</b>
<b>FJALA E HAPJES NË KONGRESIN E 5-TË TË FRONTIT DEMOKRATIK TË SHQIPËRISË (4 qershor 1979) .....</b>	<b>68—73</b>

- NDERIN QË NA U BË DO TA SHPËRBLEJMË ME PUNË, ME VENDOSMËRI, ME NDËRGJEGJE TË LARTË** — Fjala në mbledhjen e parë të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë (6 qershor 1979) ..... 73—78
- DO TË PUNOJMË PA U LËDHUR PËR NDËRTIMIN E SOCIALIZMIT** — Fjala e mbylljes në Kongresin e 5-të të Frontit Demokratik të Shqipërisë (6 qershor 1979) ..... 79—84
- REALIZIMI RITMIK I PLANIT KËRKON PËRSO-SJEN E ORGANIZIMIT, TË DREJTIMIT, DISIPLINË DHE KONTROLL TË VAZHDUESHËM** — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (11 qershor 1979) ..... 85—101
- KUSH BËN GABIME DUHET TË KRITIKOHET SIPAS PËRGJEGJËSISË QË KA** — Shënime (14 qershor 1979) ..... 102—108
- PUNA E PARTISË TË MOS JETË PUNË RUTINË DHE AS BUROKRATIKE** — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (18 qershor 1979) ..... 109—124
- EDHE NJË HERË PËR KUPTIMIN DHE ZBATIMIN E DREJTË TË ORIENTIMEVE PËR PËRBËRJEN E FORUMEVE TË PARTISË** — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (20 qershor 1979) ..... 125—142
- ORGANIZATA E BASHKIMEVE PROFESIONALE ËSHITË AJO QË DUHET TA NGREJË FORT ZËRIN KUNDËR BUROKRATIZMIT** — Nga biseda në taki-

min ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (22 qershor 1979) .....	143—164
<b>TË ORGANIZOHET MË MIRË PUNA PËR MËNJANIMIN E HUMBJEVE NË QYMYRET</b> — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (28 qershor 1979) .....	165—170
<b>NË PUNË SECILI TË MARRË PËRGJEGJESINË QË I TAKON</b> — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (30 qershor 1979) .....	171—184
<b>KRONIKA E NGJARJEVE TË KËTYRE DITËVE DHE ÇFARË KONKLuzionESH MUND TË NXJERRIM PREJ TYRE</b> — Shënime (19 korrik 1979) .....	185—210
<b>KURSIMI I NAFTËS NUK DUHET LËNË NË DËSHIRËN E SECILIT</b> — Shënime (20 korrik 1979) .....	211—215
<b>TË VLERËSOJMË ME OBJEKTIVITET SI MANGËSITË, ASHTU EDHE ARRITJET</b> — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (22 gusht 1979) .....	216—222
<b>ÇDONJËRI TË PËRGJIGJET PËR DETYRËN E TIJ</b> — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (24 gusht 1979) .....	223—232
<b>ÇDO DIREKTIVË E POROSI TË SHTROHET E TË ZBËRTHEHET MIRË ME GJITHË PUNËTORËT E PUNONJËSIT</b> — Nga biseda me shokun Rita Marko (28 gusht 1979) .....	233—244

- PUNA ME KUADRIN ËSHTË ME PËRGJEGJËSI, SE KE TË BËSH ME NJERËZIT — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (5 shtator 1979) ..... 245—251
- PUNA E PARTISË PLEKSET ME PUNËN E PUSH-TETIT, POR JO TË DUBLOHET — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (10 shtator 1979) ..... 252—270
- PËR NJË BASHKËRENDIM MË TË MIRË TË PUNËS SË PARTISË ME ORGANET SHTETËRORE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (14 shtator 1979) ..... 271—289
- TË ZBULOJMË E TË SHKËMBEJMË EKSPERIENCËN E MIRË EDHE PËR METODËN E STILIN E PUNËS — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (17 shtator 1979) ..... 290—298
- TË ZGJEROJMË SHKËMBIMET TREGTARE ME VENDET E TJERA — Nga biseda me shokun Nedin Hoxha (17 shtator 1979) ..... 299—308
- TË ORGANIZOHET E TË BASHKËRENDOHET MË MIRË PUNA PËR TË PRODHUAR NË VEND DISA MALLRA QË IMPORTOHEN — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (20 shtator 1979) ..... 309—315
- DERI NË FRYMËMARRJEN E FUNDIT **BESNIK** I PARTISË, I POPULLIT, I SOCIALIZMIT — Fjala

- me rastin e vdekjes së shokut Hysni Kapo (24 shtator 1979) ..... 316—328
- AI E NJIHTË PARTINË DHE E GJITHË PARTIA E NJIHTË ATË — Nga biseda me familjen e shokut Hysni Kapo (25 shtator 1979) ..... 329—335**
- NË KONFERENCAT E PARTISË TË QËNDROHET NË PROBLEMET KAPITALE TË RRETHIT — Nga biseda në takimnin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (29 shtator 1979) ..... 336—355**
- FILM KU TË PËRFSHIHET GJITHË JETA, LUFTA DHE VEPRIMTARIA E HYSNI KAPOS — Nga biseda në takimnin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (1 tetor 1979) ..... 356—362**
- THELBI I METODËS QËNDRON NË ORGANIZIMIN E MIRË TË PUNËS — Nga biseda në takimnin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (8 tetor 1979) ..... 363—374**
- NË PUNËN E PARTISË TË JEMI SA MË KONKRETË — Nga biseda në takimnin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (9 tetor 1979) ..... 375—384**
- VENIA NË SHFRYTËZIM E NJË PUSI NAFTE ESHTË GËZIM I MADH — Nga biseda në takimnin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (12 tetor 1979) ... 385—391**
- TË RRËNJOSIM THELLË NDJENJËN E KURSIMIT PËR ÇDO PIKË NAFTE E PËR ÇDO GRUSHT QYMYRGURI — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 tetor 1979) ..... 392—408**

ME SHUMË PËRGJEGJËSI PËR KRYERJEN DHE VËNIEN NË JETË TË STUDIMEVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 tetor 1979) .....	409—418
TREGUESI I LËNDËS .....	421
TREGUESI I EMRAVE .....	433
TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA .....	437

Formati 56x84/16

Stash 2204-82

---

Shtypur Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1990